

Qershor 2018

NR. 12



REVISTË
SHKENCORE
PERIODIKE

BOTIM I
UNIVERSITETIT
MESDHETAR
TË SHQIPËRISË

EURO

MEDITERRANEAN

DREJTËSIA PËR TË MITURIT, REALITETE DHE SFIDA

19 Shkurt 2018

BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

EURO MEDITERRANEAN

Revistë periodike shkencore

Nr. 12

Qershor 2018

EUROMEDITERRANEAN Revistë shkencore

Botim i UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Nën Drejtimin e Akademik. Prof. Dr Anastas ANGJELI

Bordi i Nderit

Akademik Prof. Dr. Gudar Beqiraj

Akademik Prof. Dr. Vasil Tole

Prof. Dr. Artistotel Pano

Prof. Dr. Ilia Kristo

Redaktore Shkencore

Prof. Asoc. Nevila RAMA Dr. Kriton KUÇI

MA. Eros ANGJELI

Kryeredaktor

MA. Ilir HEBOVIJA

Redaktore

Dr. Morena Braçaj

MA. Zirina LLAMBRO

Design & Layout:

Eyes Advertising & Eduard Bujari



Bordi Drejtues-Shkencor -Editorial

Kryetar

Akademik Prof. Dr. ANASTAS ANGJELI

Anetar

Prof. Asoc. Nexhmi Dumani

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Prof. Asoc. Niko Pano

Prof. Asoc. Greta ANGJELI

Prof. Asoc. Nevila Rama

Prof. Asoc. Alqi Naqellari

Prof. Dr. Dhimiter Tole

Prof. Asoc. Perparim Kabo

Prof. Dr. Ilia Kristo

Prof. Dr. Orfea Dhuci

Dr. Hysen Çela

Dr. Altin Hoti

Dr. Fatos Ibrahim

MA. Gjergj Teneqexhi

MA. Jona MARASHI

Dr. Kriton Kuci

Dr. Emilio Cika

MA. Besnik Leskaj

Dr. Edon Qesari

PËRMBAJTJA

DREJTËSIA PËR TË MITURIT, REALITETE DHE SFIDA

QËLLIMI DHE RISITË E KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR Shefqet Muçi	13
TË MITURIT NË MJEDISËT E PARABURGIMIT DHE TË BURGIMIT Luljeta Kodra	24
PËRPARËSIA E MASAVE ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE DHE NGA DËNIMI I TË MITURVE Arqilea Koça	35
ASPEKTE KRAHASUESE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR: KOSOVA, EVROPA QËNDORE DHE EVROPA LINDORE Bashkim Rrahmani, Veton Vula	44
TË MITURIT DHE SISTEMI PENAL – NDËRLIDHJA MIDIS INTELIGJENCËS EMOTIVE DHE SJELLJEVE KRIMINALE Enida Bozheku	54
DREJTËSIA PENALE PËR TË MITUR NË AUSTRI Besmir Premalaj	65
ASPEKTE TË SË DREJTËS PENALE FRANCEZE PËR TË MITURIT Diana Skrapari, Besmir Alushi	72
THE PRINCIPLE OF THE BEST INTEREST OF THE CHILD IN THE JUVENILE CRIMINAL CODE Arben Shehu	80
DHUNA NË FAMILJE, MEKANIZMAT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE KUNDËR SAJ ME THEKS TË VEÇANTË TEK TË MITURIT Dardan Ukaj, Dardan Lajçi	87
DHUNA TEK FËMIJËT DHE INFORMIMI LIGJOR I SHOQËRISË RRETH KËTIJ FENOMENI Arjana Muçaj, Shkëlqim Xeka, Igli Muçaj	95
KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR DHE LLOJET E VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA TË MITURIT NË SHQIPËRI Bajram Ibraj	103
TË DREJTAT E FËMIJËVE NË OPTIKËN E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE Dritan Hoti	112
MASS MEDIA AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET NË RAPORT ME TË MITURIT Ilda Kashami	119



RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË TË MITURVE NË DREJTËSINË SHQIPTARE Kozeta Ligeja	126
QËLLIMI DHE RISITË E KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT Lorena Musai, Enkeleda Millonai	135
GARANCITË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTËN PËR LIRI DHE SIGURI PËR TË MITURIT Lulëzim Barjamemaj	144
RREGULLIMI LEGJISLATIV I LLOJEVE TË DENIMEVE DHE MASAVE PËR TË MITUR NE VENDET E RAJONIT Majlinda Belegu	156
MASAT E SIGURIMIT PËR TË MITUR Mirela Fana	170
RISITË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË KUADËR TË HARMONIZIMIT ME STANDARDET E KONVENTËS SË OKB-SË MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE Oljana Hoxhaj	178
GARANCITË EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE TË MBROJTJES TË TË DREJTAVE TË TË MITURIT SI AUTOR DHE VIKTIMA TE VEPRAVE PENALE! Ingrida Mustafa	186
QËLLIMI DHE RISITË E KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT Sonila Qerolla, Albina Kola	195
E DREJTA E QASJES DHE PAJTUESHMËRISË PËR KUJDES SPECIAL, KUJDES SHËNDETËSOR DHE ASISTENCË PËR TË MITURIT JETIMË ME AFTËSI NDRYSHË: DIREKTIVA UDHËZUESE Suela Ndoja	205
BURGU - RRUGA MË E LEHTË PËR KORREKTIMIN E TË MITURVE, POR ME REZULTATE AFATSHKURTRA Valbona Omeri	216
TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE SIGURIA E TYRE NË INTERNET. Marsi Abdi	225
UNACCOMPANIED MINORS IN EUROPE Ejona Xhemalaj, Era Buçpapaj	235
KONFLIKTET JURIDIKE NË DREJTËSINË PENALE PËR TË MITURIT Irida Danaj	243
DREJTËSI NËPËRMJET RIEDUKIMIT TË TË MITURVE Eriola Hoxha	254
PERGJEGJESIA PENALE PER TE MITURIT NE KENDVESHTRIMIN KRAHASUES ME LEGJISLACIONIN PENAL TË DISA VENDEVE EUROPIANE Arben V. Prifti, Alketa Elezi, Nevila Rama	263
PARIMET BAZË TË DREJTËSISË PENALE PËR FËMIJËT Elona Doko	288

REFERATET E MBAJTURA NË SEANCËN
PLENARE TË KONFERENCËS SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE

**“DREJTËSIA PËR TË MITURIT,
REALITETE DHE SFIDA”**

E ORGANIZUAR NGA UNIVERSITETI
MESDHETAR I SHQIPËRISË

në datë 19 shkurt 2018.

**Fjala e mbajtur nga Prof. Dr. Vasilika Hysi,
zëvendëskryetare e Kuvendit
të Shqipërisë në Konferencën
ndërkombëtare për Drejtësinë penale të
të miturve, organizuar nga Univesiteti
Mesdhetar, Tiranë, 19 shkurt 2018**

I nderuar Prof. Dr. Angjeli,

Të nderuar kolegë panelistë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Ju falenderoj për ftesën për të marrë pjesë në këtë konferencë ndërkombëtare që ka në fokus të saj drejtësinë për të miturit, realitetet dhe sfidat të cilat duhet t'i trajtojmë për të ndërtuar një sistem drejtësie në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Në vitin 2014, Kuvendi i Shqipërisë mori iniciativën dhe kreu reformën më të rëndësishme dhe të nevojshme për Shqipërinë dhe shqiptarët: reformën në drejtësi. Reforma u bazua në shtatë shtylla kryesore dhe boshti i saj ishte lufta kundër korrupsionit dhe mbrojtja më e mirë e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe i grupeve të më të dobëta, në veçanti. Një nga rezultatet e kësaj reforme është miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i pari në historinë e Shqipërisë. Qëllimi i është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tij, rehabilitimi i fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijës dëshmitar, viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit të tij, parandalimi i kryerjes së veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Duke analizuar këto qëllime të ligjvënësit del e qartë se drejtësia penale në Shqipëri ka një rrugë të gjatë për të bërë në mënyrë që të mbrohen të drejtat e të miturit në kontakt me sistemin e drejtësisë penale. Nga ana tjetër, që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të funksionojë, që viktimat në kontakt me këtë sistem të trajtohet me dinjitet dhe të gëzojë realisht të drejtat e saj, ka nevojë për

një sërë nismash dhe hapash konkretë që duhen ndërmarrë, mes tyre disa prej tyre janë me rëndësi të nënvizohen si: ndërtimi i institucioneve të reja, forcimi i atyre ekzistuese, informimi ligjor i publikut, formimi fillestar dhe vazhdues i profesionistëve që punojnë dhe/ose do të punojnë më të miturit dhe specializimi i tyre në fushat që kanë të bëjnë me të miturin, koordinimi mes institucioneve në nivel qendror dhe vendor dhe përfshirja e universiteteve dhe studiuesve në fushën e kërkimeve shkencore në fushë.

Zbatimi i rregullave të reja të parashikuara në kodin e procedurës penale dhe në kodin për drejtësinë penale për të mitur bën të nevojshme ngritjen dhe funksionimin me efikasitet të mekanizmave të referimit dhe koordinimi mes tyre në gjithë vendin. Duke qenë se shumë shërbime për të miturin ofrohen në nivel vendor, një nga sfidat që duhet të kapërcejmë menjëherë është krijimi i mekanizmave vendore të referimit të viktimave të mitur ose të dhunës në familje, aty ku ato tashmë ekzistojnë, krijimi i tyre në ato bashki ku mekanizmi nuk është ngritur ende; ofrimi i shërbimeve sociale si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile, përfshirë edhe sektorin privat dhe iniversitetet.

Në këtë proces, nuk duhet të harrojmë se nevojat e të miturve në konflikt me ligjin që janë nën moshën 14 vjeç, 14-18 vjeç dhe 18 -21 vjeç mund të jenë të ndryshme sikurse edhe të viktimës për kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera. Të gjitha këto diktojnë nevojën e njohjes reale të nivelit të viktimizimit dhe llojeve të tij dhe të nevojave që mund të kenë secila nga këto kategori.

Të nderuar kolegë profesorë, profesionistë dhe punonjës të praktikës, studentë/e, Parashikimi i të drejtave të të miturve dhe të viktimës në ligj në mënyrë të detajuar është një hap mjaft pozitiv, por ky nuk mjafton. Informimi i viktimës, trajtimi me humanizëm dhe dinjitet, krijimi i grupeve të profesionistëve dhe të personelit të specializuar për kategori të veçanta të viktimave, përfshirë edhe të miturin, janë sfida që duhet të kapërcehen në një kohë sa më të shkurtër. Kjo mund të arrihet kur të gjithë, sipas përgjegjësive që kemi dhe mundësive tona, do të kontribuonin dhe do të punonim me zemër dhe me përkushtim. Krahas kualifikimit dhe specializimit të punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, avokatëve, psikologëve dhe punonjësve sociale, punonjësve të shërbimit të provës dhe sistemit të burgjeve me rëndësi është financimi i mjaftueshëm

i shërbimeve nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të parashikuara nga ligji. Si profesionistë të fushës dhe ju studentë/e që po formoheni në programet master dhe doktoraturë në profesione të tilla si: juristë, psikologë, avokatë etj keni mundësi për të kontribuar në njohjen dhe ndërtimin e sistemit të drejtësisë për të miturit. Njohja e mekanizmave vendore, informimi i qytetarëve, përdorimi i tyre, por edhe rritja e profesionalizmit të punonjësve që punojnë në këto shërbime vendore, qoftë edhe vullnetarisht, është nevojë e domosdoshme dhe parësore. Publiku ka nevojë të informohet, të njohë ligjet dhe t'i zbatojë ato.

Ligji për punën vullnetare dhe angazhimi i të rinjve në ofrimin e shërbimeve sociale, krijimi i klinikave të ndihmës ligjore falas nga shteti dhe përfshirja e universiteteve në këtë proces përbëjnë një mundësi shumë të mirë për angazhimin e profesionistëve të rinj dhe aftësimin e tyre më të mirë.

Së fundi, për nga radha, por jo nga rëndësia. Duke qenë se jam mes kolegësh që kemi punuar gjatë për të ndërtuar një sistem drejtësie për të miturit dhe pjesa e madhe e jona vjen nga bota akademike dhe mësimdhënia; meqënëse jam në panel me dekanë dhe profesorë të nderuar të fakulteteve të drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit dhe me drejtues të institucioneve të drejtësisë, do dëshiroja t'ju ftoja dhe që të rishikojmë kurrikulën e shkollës lidhur formimin e studentëve për aspekte që kanë të bëjnë me drejtësinë penale të të miturive, me qëllim formimin e profesionistëve të rinj të specializuar, të risim njohuritë për viktimologjinë dhe futjen e saj në programet mësimore; të risim numrin e kërkimeve shkencore, jo vetëm mes përdorimit të metodave sasiore, por edhe atyre cilësore, anketimet në fushë; të inkurajojmë dhe përfshijnë sa më shumë studentë të mirë që të bëjnë pjesë të punimeve të tyre në programet master dhe doktoraturë, aspekte të drejtësisë së të miturve, të viktimave, të parandalimit të përfshirjes së të miturve në krim etj.

Duke qenë se prej disa vitesh jam e angazhuar në politikëbërje, do të dëshiroja të theksoja se pjesëmarrja e publikut dhe studentëve në procesin e hartimit dhe konsultimit të ligjeve, përfshirja e të miturve në këtë proces është i domosdoshëm. Kuvendi ka përfshirë në procedurë parlamentare projektstrategjinë e edukimit ligjor të publikut që synon të rrisë nivelin e informimit dhe edukimit ligjor të publikut. Ju ftoj të bëheni pjesë e njohjes dhe zbatimit të kësaj strategjie sapo ajo të miratohet nga Kuvendi.

Gjithashtu, jeni të mirëpritur dhe unë si parlamentare do ta vlerësoja shumë

angazhimin tuaj në veprimtaritë parlamentare. Do ju inkuraroja fort të nderuar kolegë pedagogë që të ishit pjesë e konsultimit publik dhe e dëgjësave për çështje që lidhen me drejtësinë, reformën në drejtësi dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve të refomës në drejtësi, përfshirë edhe zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Kuvendi ka krijuar grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve” që synon të risë ndjeshmërinë e Kuvendit në hartimin e ligjeve që parashikojnë dhe garantojnë gëzimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kuvendi i Shqipërisë angazhohet mes komisioneve të përhershëm dhe nënkomisionieve të tij për hartimin e rezolutave në fusha konkrete, përfshirë edhe në mbrojtje e fëmijëve dhe në monitorimin e zbatimit të tyre. Jeni të ftuar në bashkëpunojmë në këtë proces për të përmbushur interesin më të lartë të fëmijës në në çdo hap të veprimtarisë sonë. Suksese punimeve të kësaj konference dhe njëherë faleminderit që më bëtë pjesë të saj!

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese z.Bashkim Dedja

I nderuar z. Angjeli,

Të nderuar pjesmarrës, kolegë,

Të nderuar të ftuar akademikë dhe praktikantë të ligjit,

Parimet bazë të zhvillimit të një shoqërie demokratike janë respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe forcimi i shtetit të së drejtës. Që në preambulën e Kushtetutës sonë është shprehur aspirata e popullit shqiptar për të ndërtuar një shtet të aftë për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Të drejtat e njeriut janë një sfidë universale, edhe pse ndër shekuj është luftuar për to, edhe pse janë reflektuar në një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare, dinamika e shoqërisë, mendësia dhe ndërgjegjësimi i individit për të drejtat që gëzon dhe ato që duhet të gëzojë vazhdon të vërë shtetet dhe organet kompetente para përgjegjesisë për të përmirësuar dhe për të mundësuar efektivisht ushtrimin e tyre të plotë nga individët.

Të drejtat e fëmijëve janë pjesë e kësaj sfide!

Shteti ynë ka detyrimin për marrjen e të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmijët të jenë efektivisht të mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve, të përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tyre, ashtu si dhe të jenë subjekt gëzimi të të drejtave të tyre civile, sociale, ekonomike, kulturore, penale në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre.

Shqipëria është shtet anëtar i Këshillit të Europës, ratifikues i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, prandaj dhe Kushtetuta jonë shpesh konfrontohet dhe ballafaqohet me përmbajtjen dhe interpretimin e Konventës.

Po kështu, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, është autoritet detyrues për Gjykatën, e cila duhet të përmbahet standardeve të kërkuara prej saj. KDF ka dhe tre protokolle opsionale, i pari “Mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të ar-

matosura” (2000)¹, i dyti “Për mbrojtjen e shitjes së fëmijëve, prostituiimin dhe pornografinë me fëmijë” (2000), si dhe protokollin e tretë opsional “Mbi procedurat e komunikimit” (2011), të cilat janë ratifikuar nga shteti shqiptar².

Kjo gjykatë është një burim i evidentimit dhe elaborimit të vlerave kushtetuese me veprimtarinë e saj. Ajo është e ndërgjegjshme për ndikimin e saj në demokratizimin e institucioneve dhe në elaborimin e vlerave kushtetuese, ku objekt të kontrolli ka jo vetëm ligjet kombëtare dhe pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, por edhe detyrimet ndërkombëtare krahasuar me ligjet kombëtare si dhe vetë rëndësinë/pozicionin e Kushtetutës apo konventave në këtë proces.

Neni 54 i Kushtetutës i jep një mbrojtje të veçantë fëmijëve në raport me kategori të tjera të shoqërisë. Kjo gjykatë ka interpretuar këtë nen, ashtu si dhe *nenet 3, 9/3 dhe 10/2 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës*, duke u shprehur se, në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. E drejta e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit (edhe kur prindërit banojnë në shtete të ndryshme), që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës duhet, respektuar nga shteti³. Gjykata ka theksuar se detyrimi për të mbrojtur interesin e fëmijës është një parim thelbësor në sistemin juridik shqiptar dhe, në këtë kuptim, nënvizon se institucionet shtetërore kanë detyrimin t'i trajtojnë me përparësi dhe shpejtësi çështjet, të cilat lidhen me interesat e fëmijëve. Gjykata vlerëson se në rastet kur fëmijët janë të përfshirë në proces, detyrimi i institucioneve shtetërore për të zbatuar në mënyrë efektive konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj buron jo vetëm nga statusi i së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik vendas, por edhe nga angazhimet për mbrojtjen e të drejtave në mënyrë konkrete dhe efektive⁴.

Në çështje të cilat kanë për objekt të drejtat e fëmijëve, jurisprudenca e Gjykatës është modeste, dhe për më tepër këto lloj vendimesh kanë qenë të orientuar drjet nenit 42 të Kushtetutës, procesi i rregullt ligjor, dhe më konkretisht mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë mbi çështjet e kujdestarisë,

1 Shteti shqiptar e ka ratifikuar në datë 17.04.2003.

2 Shteti shqiptar e ka ratifikuar në datë 29.05.2013. Për më tepër mbi procedurat e ankimit pranë Komitetit, on-line: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIndex.aspx>

3 Vendimi nr.12, datë 15.04.2011 i Gjykatës Kushtetuese

4 Vendim nr. 17 datë 15.03.2016 i Gjykatës Kushtetuese

brenda një afati të arsyeshëm. I njëjti trend verehet dhe në jurisprudencën e GJEDNJ kundër Shqipërisë, ku ka vetëm një çështje kundër Shqipërisë, me kërkuar *Bajrami* dhe objekt është mosekzekutimi i vendimit gjyqësor nga autoritetet shqiptare⁵. Sipas GJEDNJ, në rrethanat e çështjes, pavarësisht nga fakti se shtetit të paditur i lejohet një lloj hapësire, përpjekjet e autoriteteve shqiptare nuk ishin të duhura dhe efikase për të realizuar të drejtën e aplikantit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, i cili përcaktonte të drejtën e tij për t'u kujdesur për fëmijën pas divorcit. Autoritetet kishin neglizhuar të ndërmerrnin masat e nevojshme për të zbuluar vendndodhjen e së bijës, në zbatim të vendimit të kujdestarisë në favor të tij. Si rrjedhim, ishte shkelur neni 8 i Konventës dhe Shqipëria u gjobit.

Edhe GJEDNJ-ja në çështje të këtij lloji ka vlerësuar se përshtatshmëria e një mase gjykohe nga shpejtësia e ekzekutimit të saj, meqenëse kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pandreqshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit që nuk jeton me të⁶.

Eshtë për t'u përshendetur nisma e Kuvendit për të pasur një Kodi Drejtësie për të Mitur, duke i dhënë vemendje të posaçme kësaj kategori vulnerabël dhe duke i dhënë trajtim ligjor më të posaçëm në kontekstin e të drejtave të natyrës penale. Si legjislacion i ri, besoj se autoritetet publike të fushës, por edhe aktorët e tjerë të sektorit privat apo shoqërisë civile, do të kenë sfida në të kuptuar dhe të zbatuar të këtij Kodi.

Në këtë kontekst, mendoj se temat që do të zhvillohen prej pjesmarrësve në drejtim të të drejtave të fëmijëve në procese gjyqësore, do të ngjallin interes dhe debat shkencor e praktik në terrenin shqiptar.

Së fundmi, falenderoj Universitetin për organizimin dhe mundësimin e kësaj konference. Organizime të tilla janë të nevojshme gjithmonë për shkak të vlerave që përcojnë, në shkëmbimin e ideve/eksperiencave apo zhvillimin e debateve bashkëkohore në fushën e të drejtave të fëmijëve, pro edhe më gjerë.

Ju uroj një ditë të këndshme sot me diskutime dhe komente frytdhënëse.

Falemnderit!

5 Çështja Bajrami kundër Shqipërisë, aplikimi nr.35853/04, vendim i datës 12 dhjetor 2006.
6 Vendimi i GJEDNJ-së në çështjen Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë, nr. 31679/96, i datës 25 janar 2000, § 102

Fjala përshëndetëse e Perfaqesuesit te Kolegjit AAB, Dr. Petrit Bushi

Te nderuar:

Prof. Anastas Angjeli- President i Universitetit Mesdhetar

Prof. Vasilika Hysi- Nenkryetare e Parlamentit te Republikes se Shqiperise

Znj. Gjonaj-Ministre e Drejtesise

Z. Dedja- Kryetar i Gjykates Kushtetuese

Z.Manja- Kryetar i Komisionit te Ligjeve

Perfaqesues te:

UNICEF

Universitetit te Barit

Universitetit te Polonise

Universitetit te Tiranës

Me lejoni, qe ne emer te rektorit te Kolegjit AAB, Prishtine, Prof. Dr. Lulzim Tafa, t`Ju sjell pershendetjet e sinqerta duke deshruar pune te mbare konferences. Me lejoni te them disa fjale nga letra qe Rektori i dërgon pjesemarrësve ne konference:

“Perkunder deshires se madhe per te qene sot ne Tirane ne hapjen e Konferences shkencore nderkombetare me teme „Drejtesia per te mitur-realitete e sfida“, event i rendesishem per shkencen shqiptare, me ndjeni per pamundesine e pranise time fizike ne kete konference.

Bashkepunimi yne ka dhene rezultate ne fushen e kerkimit shkencor dhe po jep edhe me kete konference si dhe ne bashkepunimin e planifikuar per muajt e ardhshem.

Per shkak te aktiviteteve te 10 Vjetorit te Pavaresise se Kosoves, me mirkuptoni per mospjesemarrjen, duke Ju percjell, nepermjet Dekanit te Fakultetit Administrate Publike, Dr. Petrit Bushi, pershendetjet me te ngrohta e vellazerore, duke Ju uruar per konferencen dhe pjesemarrësve pune te mbare e suksese.

Miqesisht

Rektori Prof. Lulzim Tafa

Me lejoni qe dhe ne emrin tim personal t'Ju uroj pune tembare Konferences dhe suksese pjesemarresve.

Kosova ka nje experience te trasheguar dhe dhe nje legjislacion bashkekohor per drejtesine e te miturve, si dhe institucione relevante per drejtesine e te miturve.

Praktika e Kosoves vjen ne kete konference me nje kontribut konkret nepermjet artikujve shkencor nga stafi i profesoreve te fakulteteve te Kolegjit AAB.

Drejtesia per te mitur eshte komplekse realizimi ise ciles kerkon pjesemarrjen e shume aktoreve, te drejtesise, policise, shoqerise, psikologe, edukimit etj.

Artikujt e paraqitur ne kete konference nga stafi i profesoreve fokusohen ne keto drejtime kryesore.

Pjesemarrja e perfaqesuesve te pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqesor dhe organeve te pavarura me ben te besoj ne suksesin dhe funksionalizimin e drejtesise per te mitur ne Shqiperi.

Ju uroj pune te mbare

Dr. Petrit Bushi

Perfaqesues i Kolegjit AAB

QËLLIMI DHE RISITË E KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

Prof. Asoc. Dr. Shefqet Muçi

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

shefqetmuci@gmail.com

ABSTRAKT

Ky Kod është Kodi i Parë i të Miturve në Kodin Penal Shqiptar. Ai garanton një kornizë ligjore për të miturit, sipas standardeve ndërkombëtare. Qëllimi i tij është të mbrojë të miturit në konflikt me të drejtën penale, dëshmitarët e mitur dhe viktimat të veprave penale. Qëllimi i veçantë është rritja e llogaridhënies dhe profesionalizmit të organeve kompetente të drejtësisë për të mitur. Në këtë temë janë evidentuar risitë që ky kod ka sjellë. Ai u jep prioritet masave alternative për të shmangur të miturit nga ndjekja penale, kufizimin e burgimit, zbatimin e edukimit restaurues, ndihmën juridike dhe psikologjike për të miturit, trajtimin dhe funksionimin e institucioneve që merren me programet e edukimit dhe rehabilitimit të të miturve etj.

Ky kod, përveç mbrojtjes së rasteve më të larta të të miturve në konflikt me ligjin penal, gjithashtu mbron në veçanti të miturit që janë viktimat të veprës dhe të miturit në pyetje si dëshmitarë. Ky kod përbëhet nga një normë e karakterit material dhe procedural në të njëjtën kohë. Ai parashikon llojet e dënimeve për të mitur, të cilat bien në kuadër të ligjit penal dhe rregullave të shmangies nga hetimet dhe gjykimet ose rregullat e tjera procedurale deri në përfundimin e vuajtjes së dënimit.

Fjalët kyçe: Kodi Penal për të miturit, kundërvajtësi, dëshmitar i mitur, viktimitë e mitur e veprave penale

HYRJE

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është miratuar në paketën e ligjeve për reformën në drejtësi dhe është pjesë e legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë. Detyrat dhe qëllimi i tij janë të lidhura me detyrat e të drejtës penale

dhe me qëllimin e dënimit e të masave të tjera penale, që janë mbrojtja e rendit ekonomiko-shoqëror nga veprat penale, lufta dhe parandalimi i kriminalitetit, edukimi dhe rehabilitimi i personave të dënuar apo në konflikt me ligjin penal. Veçoria kryesore e këtij Kodi, në raport me Kodin Penal, qëndron në faktin se fuqia e tij shtrihet vetëm në një kategori të caktuar subjektësh, vetëm ndaj të miturve në konflikt me ligjin penal dhe, nga pikëpamja procedurale, edhe ndaj të miturve viktime apo dëshmitarë të veprave penale, duke parashikuar rregullime të posaçme për përgjegjësinë dhe procedurat e ndjekjes penale të të miturve, deri në rehabilitimin e tyre.

Qëllimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikohet në nenin 2 të tij, i cili synon dy drejtime kryesore, mbrojtjen e të miturit dhe interesat e tij, nga njëra anë, dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe të profesionalizmit të organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, nga ana tjetër.

Në këtë vështrim, me miratimin e këtij kodi, së pari, krijohet dhe garantohet një kuadër i ri ligjor i drejtësisë penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit.

Së dyti, krijohen kushte dhe mundësi reale që dënimi dhe masat e tjera me karakter penal të jenë efektive dhe të përmbushin qëllimin e tyre, i cili, në kushtet e përafritimit të legjislacioneve pozitive dhe ndërkombëtarizimit të mjaft aspekteve të dënimit penal, “synon katër objektiva: **ndëshkimin, parandalimin e përgjithshëm, parandalimin e posaçëm dhe rehabilitimin.**”⁷ Sipas pikëpamjeve të Antoni Ellis dhe Antoni Daf (A. Duff), objektivat e qëllimit të dënimit përmblihen në **aspektin ekspresiv** dhe **aspektin reformues** të tij⁸

Në aspektin ekspresiv, qëllimi i dënimit është të ndëshkojë autorin e veprës penale, që deklarohet fajtorë për kryerjen e saj dhe ta ndalojë atë dhe persona të tjerë nga kryerja e veprave penale të tjera në të ardhmen. Ndërsa në aspektin reformues, qëllimi i tij dhe i masave të tjera me karakter penal është

7 Criminal law- (Wikipedia, the free encyclopedia; http://en.wikipedia.org/wiki/Criminal_law).

8 Anthony Ellis, "Critical Study Recent Work on Punishment", "The Philosophical Quarterly", Vol 45, No 179, April, 1995.

më i gjerë, të ndikojë në riedukimin dhe rehabilitimin e të dënuarit, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, si dhe të shprehë gjykimin e shoqërisë për veprën penale duke ndikuar në edukimin e shtetasve e tjerë me ndjenjën e respektimit të ligjit.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur e plotëson aspektin reformues të legjislacionit penal me ide dhe institute të reja dhe u jep përparësi masave edukuese, parimit të humanizmit dhe mbrojtjes më të lartë të intersit të të miturit, autor, viktimë apo dëshmitar i veprës penale qoftë. Ndër detyrat e rëndësishme të tij për organet e administrimit të drejtësisë nënvizon promovimin e riintegritit dhe garantimin e rishoqërizimit të të miturit në konflikt me ligjin penal, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje, si dhe të mbrojtje dhe të parandalojë të miturin viktimë e veprës penale nga riviktimizimi, nga rënia viktimë e një veprë tjetër penale.

Dhe së treti, ky kod synon të mbrojtë parimet e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur, të rrisë përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur dhe të sigurojë ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për realizimin e misionit dhe detyrave të tij.

Kodi Penal në fuqi parashikonte fillimisht vetëm një masë edukuese për të miturit, vendosjen në një institucion edukimi, kurse tashmë, pas ndryshimeve të bëra në mars 2017, nuk parashikon më masa edukuese konkrete. Ato parashikohen nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili u jep atyre rëndësi dhe prioritet, në numër e në përmbajtje, gjë që rrezaton një nga risitë kryesore të tij. Masat edukuese ndaj të miturve në konflikt me ligjin penal përfshihen në institutin e shmangies nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative, llojet e të cilave përcaktohen në nenin 62 të tij këtij kodi.

Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale janë:

- a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- b) këshillimi për të miturin dhe familjen;
- c) paralajmërimi me gojë;
- ç) paralajmërimi me shkrim;

d) masat detyruese;

dh) vendosja nën kujdes.

Një tjeër risi e këtij kodi është se masat alternative jepen, sipas rastit, nga prokurori ose gjykata, mbështetur në raportin e vlerësimit individual të të miturit, përgatitja e të cilit është e detyrueshme dhe bëhet sipas rregullave të hollësishme, ku pasqyrohen karakteristikat individuale të të miturit, sjellja dhe nevojat e tij, rreziku i kryerjes së veprave penale dhe elementë të tjerë. Në varësi të rastit, raporti i vlerësimit individual rekomandon masën apo masat alternative konkrete të shmangies nga ndjekja penale ose nga dënimi, duke mbajtur parasysh si interesin më të lartë të të miturit, ashtu edhe interesin publik për fillimin ose jo të ndjekjes penale apo të vazhdimin ose jo të saj, kur ka filluar, si dhe një varg kriteresh ligjore të tjera.

Në çdo rast, në qoftë se ndaj të miturit në konflikt me ligjin zbatohen masa alternative të tilla, prokurori vendos mosfillimin e çështjes penale ndaj të miturit ose, nëse ka filluar, pushimin e saj. Prokurori e ushtron këtë të drejtë me nismën e tij ose me kërkesën e të miturit a përfaqësuesit përkatës, por kurdoherë gjer sa nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa nga masat alternative të shmangies nga ndjekja penale, por ato duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit, duke marrë parasysh edhe interesin e viktimës. Nga ana tjetër, asnjë nga masat e lartpërmendura nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së tyre. Ato vendosen vetëm me pëlqimin me shkrim të tij dhe, kur është e përshtatshme, edhe të përfaqësuesit ligjor të tij.

Masat alternative të shmangies nga ndjekja penale ose nga dënimi zbatohen kur ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një vepër penale, për të cilën parashikohet dënim me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Ato nuk zbatohen për vepra penale që parashikojnë dënim me burgim tej këtij maksimumi. Përpara ndryshimeve në Kodin Penal, mars 2017, masa edukuese jepej kur vërtetohej kryerja e veprës penale nga i mituri dhe bëhej përjashtimi i tij nga dënimi. Tashmë ato lidhen me “dyshimin e arsyeshëm”, pasi i mituri nuk i nënshtrohet më procesit të gjykimit. Përkundrazi, i shmanget ndjekjes penale dhe, u tha më lart, masat merren me pëlqimin e të tij ose të përfaqësuesit ligjor përkatës. Ato janë të karakterit vullnetar.

Në këtë rast, ai ndodhet në mbikëqyrje të vazhdueshme nga ana e një personi ose nga shërbimi i specializuar, detyrohet të qëndrojë në ambientet e institucionit të edukimit, të ketë takime të programuara me prindërit ose me persona të tjerë, sipas rregullores së institucionit, etj.

Nëse i mituri e ka përmbushur masën e shmangies nga përgjegjësia penale, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes dhe ndaj tij nuk mund të ngrihet asnjë akuzënë lidhje me po këtë veprë penale. Ai konsiderohet i padënuar për atë veprë penale dhe nuk mund të trajtohet si person me të kaluar kriminale. Në të kundërtën, kur nuk përmbushen detyrimet, masa rishikohet.

Mospërmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale nuk përbën veprë penale dhe nuk sjell automatikisht kufizimin ose heqjen e lirisë së të miturit, nuk shpie detyrimisht në revokimin e vendimit.⁹ Prokurori rishqyrton masën dhe, sipas rastit dhe rekomandimit të Shërbimit të Provës, mund të vendosë:

a) revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale;

b) ndryshimin e llojit të masës së shmangies;

c) zgjatjen e kohës së marrëveshjes.

Kodit i Drejtësisë Penale për të Mitur, në nenin 64 të tij, parashikon për herë të parë në legjislacionin tonë penal ndërmjetësimin si procedurë jashtëgjyqësore, që zhvillohet nga nga ndërmjetësi sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjit në fuqi për ndërmjetësimin. Ai bëhet kurdoherë dhe vetëm me pëlqimin e lirë të të miturit që akuzohet si autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar, si dhe me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar dhe sipas rregullave të këtij kodi. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund të zbatohet, sipas rastit, si masë shmangieje nga ndjekja penale ose si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

Në këtë drejtim, Kodi Penal i Republikës së Kosovës përdor vërejtjen gjyqësore,¹⁰ si formë e qortimit shoqëror, e cila mund të zbatohet ndaj të gjithë personave, të mitur e madhor, kur gjykata çmon se dënimi është i panevojshëm

9 Nenet 71 e 72 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.

10 Neni 86 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, v. 2012.

dhe vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit, kuptohet për vepra dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Mirëpo, për të miturit që nuk kanë arritur moshën e përgjegjesisë penale është krijuar një mospërputhje apo kontradiktë mes Kodit Penal dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, lidhur me llojin e masës edukuese dhe të organit kompetent që duhet ta vendosë atë. Kështu, Kodi Penal parashikon se masat edukuese mund të jepen edhe ndaj të miturit që për shkak të moshës nuk ka përgjegjësi penale, pa përcaktuar llojin e tyre. Ndërkohë, për caktimin dhe revokimin e masave edukuese për të miturit në konflikt me ligjin në përgjithësi, ashtu sikurse edhe për masat mjekësore, Kodi Penal të referon tek rregullat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Nga ana tjetër, ky i fundit shprehet, në nenin 4/3 të tij, se këto rregulla nuk përfshijnë të miturit nën moshën e përgjegjesisë penale, ndaj të cilëve nuk fillon procedimi penal ose, nëse ka filluar, pushohet menjëherë dhe për ta vihen në lëvizje strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe zbatohen të gjitha masat e parashikuara nga ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Shtrohet pyetja se kush i vë në lëvizje këto struktura, prokurori apo gjykata dhe në ç' mënyrë, gjë që ka nevojë të saktësohet apo të plotësohet me ligj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka sjellë dukuri të reja edhe në masat e sigurimit, duke parashikuar, përveç atyre të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, masa të tjera të veçanta ndaj të miturit në konflikt me ligjin, si vendosja e të miturit në mbikëqyrje dhe vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar. Kjo bëhet në mbrojtje të interesit më të lartë të të miturit, për të plotësuar nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukuese, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri, çka mundësohet nga një mbikëqyrje e posaçme dhe nga institucione ose persona juridikë të licencuar edhe për këtë qëllim.¹¹

Ndryshime të rëndësishme janë bërë lidhur me kriteret për zbatimin e masës së arrestit me burgim, e cila mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm për krime sanksioni të cilëve është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet, krahas kriterëve të tjerë ligjorë.¹² Pët më tepër, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se gjysma e kohës

11 Nenet 82 e 83 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.

12 .Neni 86 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.

së paraburgimit të caktuar për të rriturin, sipas Kodit të Procedurës Penale. Njëkohësisht, në mjediset e paraburgimit gëzon të gjitha të drejtat që gëzon i mituri i dënuar me burgim. Ai vendoset në mjediset të veçanta nga të rriturit, në mjediset të ndara nga njëri-tjetri sipas gjinisë dhe, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin, i ofrohet ndihmë sociale, edukuese, psikologjike, mjekësore dhe fizike¹³

Në fazën e gjykimit përmendim detyrimin që gjykimi i një të mituri në konflikt me ligjin zhvillohet në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura dhe me pjesëmarrjen e tij të detyrueshme. Pra, i mituri nuk mund të gjykohej e të dënohet në mungesë të tij. Gjithashtu, dënimi me burgim i të miturit është mjeti i fundit i mundshëm, i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies, të parashikuara në kreun VII të këtij Kodi, janë të papërshtatshme, Urdhri Penal i parashikuar në nenin 406/a deri në nenin 406/f, të Kodit të Procedurës Penale, nuk zbatohet ndaj tij dhe gjykimi me marrëveshje, parashikuar nga neni 406/d deri në nenin 406/f, të Kodit të Procedurës Penale, zbatohet në rastin e zbatimit të masës së shmangies për të miturin në konflikt me ligjin.

Kodi Penal parashikon si dënime kryesore burgimin e përjetshëm, burgimin dhe gjobën, si dhe dënimet plotësuese të përcaktuara në nenin 30 të tij. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk zbatohet për të miturit. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka sjellë edhe një risi tjetër lidhur me llojet e dënimit për të miturit, duke i shtuar alternativat e tij dhe duke u dhënë përparësi dënimeve jo me burgim dhe dënimeve plotësuese, të cilët janë ndryshme nga ato që zbatohen ndaj madhorëve. Ai i ndan dënimet për të miturit në dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim. Në dënimet jo me burgim përfshihen:

- a) kufizimi i lirisë;
- b) qëndrimi në shtëpi;
- c) gjoba;
- ç) kryerja e një pune me interes publik;
- d) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- dh) përmbushja e detyrimeve të caktuara.¹⁴

13 Nenet 84 -86 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.

14 Nenet 95 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017



Burgimi, kufizimi i lirisë dhe gjoba janë dënime kryesore, ndërsa llojet e tjera janë dënime plotësuese.

Këto shtesa janë bërë pa pasur parasysh llojet e alternativave të dënimit me burgim të parashikuara në Kodin Penal, duke përdorur emërtime të njëjta për koncepte apo nocione të ndryshme të së drejtës penale. Kësisoj, qndrimi në shtëpi dhe kryerja e një pune në interesin publik trajtohen nga Kodi Penal si alternativa të dënimit me burgim, si mënyra të vuajtjes së këtij dënimi, ndërsa në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur parashikohen si lloje të të veçanta dënimi, mangësi që duhet të rregullohet me ligj.

Në dy kodet penale të mëparshme, si dhe në kodin penal në fuqi deri në ndryshimet e tij të vitit 2013, maksimumi i dënimit me burgim ka qenë njëzetë e pesë vjet.¹⁵

Në nenin 32 të Kodit Penal, të ndryshuar, thuhet se dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet, kurse për kundërvajtjet penale nga pesë ditë deri në dy vjet. Ndërsa, ndaj të miturit që ka mbushur moshën e përgjegjshmërisë penale (14 – 18 vjeç), sipas nenit 97 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer dhe, në maksimum, jo më shumë se 12 vjet. Njëkohësisht, ai zbatohet vetëm për veprë penale me minimum të përcaktuar me jo më pak se 7 vjet burgim dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë, të cilat vlerësohen në kuadrin e të gjitha rrethanave të çështjes që lidhen me shkallën e pjekurisë së të miturit dhe me kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin e tij profesional. Në kushtet kur në legjislacionin penal shqiptar maksimumi i dënimit me burgim është 35 vjet, gjysmëdënimi ka vlerë vetëm për vepra penale që dënohen deri në 24 vjet burgim. Tej kësaj shifre zbatohen njëkohësisht moskalimi i gjysmëdënimit dhe moskalimi i dymbëdhjetëvjetëshit.

Pa mohuar nevojën dhe rëndësinë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur si garanci për mbrojtjen e interesit të miturve në konflikt me ligjin penal, viktima apo dishmitarë të veprës penale, do të thoshim se ai ka edhe mangësitë e tij në fushë e dënimit me burgim të të miturve, sepse nuk bën diferencime mes të

15 Neni 51 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, v. 2017 dhe neni 97 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017

miturve 14 – 18 vjeç, pjekuria medore e të cilëve rritet bashkë me rritjen e viteve. Në këtë drejtim, legjislacionet penale me tradita, si ai italian, francez apo i shteteve të tjerë me legjislacion të përpunuar bashkëkohor, mbajnë qëndrime të studiuara shkencërisht dhe parashikojnë dënime me burgim të shkallëzuar në raport me rritjen e moshës së miturit.

Kështu, Kodi Penal italian, i cili moshën e përgjegjësive penale për të mitur e ka 14 – 18 vjeç, ashtu sikurse edhe kodi ynë, parashikon përgjegjësinë penale relative për këta të mitur. Në nenin 98 të tij thuhet se *për personin që në kohën e kryerjes së veprës penale ishte mbi moshën katërmëdhjetë vjeç, por jo edhe tetëmbëdhjetë vjeç, dhe kishte aftësinë për të kuptuar e për të dëshiruar, dënimi zvogëlohet.*

Në parim, të miturit 14 – 18 vjeç u nënshtrohen dënimeve të njëjta si të rriturit, por në një formë të zbutur. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet automatikisht me njëzet e katër vjet burg. Për dënimin me burgim, zvogëlimi apo ulja e tij bëhet në raport me shkallën e pjekurisë së tyre, ashtu sikurse edhe për kohëzgjatjen e paraburgimit, e cila reduktohet përgjysmë për të miturit nga gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dhe në dy të tretat për moshat midis katërmëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Po ashtu, edhe dënimi me gjobë, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, mund të zbatohet ndaj të miturit nëse ai ka të ardhura monetare nga një burim i ligjshëm dhe masa e saj është sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri në të njëjtat kushte.¹⁶ Siç shihet, ky formulim ndryshon nga ai i gjysmëdënitimit me burgim dhe nuk qëndron nga pikëpamja shkencore, sepse e detyron gjykatën të imagjinojë të miturin si të rritur dhe të imagjinojë kushte të njëjta, kur mund të përdorte formulën shkencore që ka përdorur për dënimin me burgim, si “masa e saj është sa gjysma e gjobës që parashikon ligji për veprën penale të kryer.”

Formulimit i dispozitës “masa e saj është sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri në të njëjtat kushte”, na duket i pasaktë nga pikëpamja shkencore sepse na çon tek teoria e “njeriut mesatar”, që nuk pranohet nga e drejta penale. Nuk ka kushte të njëjta, pasi çdo gjë është identike ose e njëjtë vetëm me vetveten. Kushtet mund të jenë të ngjashme ose të përafërta. Formulimi i drejtë shkencor do të ishte “masa e saj është sa gjysma e gjobës që parashikon ligji për

16 Neni 99 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.

veprën penale të kryer.”

Llojet dhe mënyra e caktimit të dënimeve plotësuese përcaktohen në nenin 30 të Kodit Penal, i cili parashikon se për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen një ose disa prej dënimeve të radhitura në këtë nen. Janë 10 lloje dënimesh plotësuese.

Këto dënime plotësuese nuk zbatohen ndaj personave të mitur. Ndaj tyre zbatohen dënimet plotësuese të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Ato janë:

- a) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- b) kryerja e një pune me interes publik;
- c) përmbushja e detyrimeve të caktuara;
- ç) qëndrimi në shtëpi;

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur nuk shprehet nëse dënimet plotësuese ndaj tyre jepen vetëm si shoqërues të dënimit kryesor apo edhe vetëm. Ai mjaftohet me parashikimin se ndaj të miturit mund të jepet vetëm një dënim kryesor dhe se bashkë me të nuk mund të jepet më shumë se një dënim plotësues,¹⁷ e ndryshme kjo nga madhorët për të cilët dënimit kryesor mund t'i shtohen një ose disa dënime plotësuese.

Për sa i përket kryerjes së një pune me interes publik, ajo mund të zbatohet si dënim plotësues ose si zëvendësim i dënimit me burgim. Neni 101/6 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon se puna me interes publik, si një vendim plotësues, mund të zbatohet ndaj një të mituri edhe në rastet kur neni përkatës i Kodit Penal nuk e parashikon atë si një lloj dënimi. Ky parashikim është i pasaktë për sa i përket termit “vendim plotësues”, sepse ligji nuk e përdor në ndonjë dispozitë të tij këtë term. Ai flet për dënim plotësues dhe zëvendësim të burgimit me punë me interes publik. E dyta dhe kryesorja, nuk ka asnjë nen të Kodit Penal që ta parashikojë atë si lloj dënimi, sepse dispozitat e veçanta të Kodit Penal parashikojnë vetëm dënimin kryesor. Puna me interes publik parashikohet vetëm si një alternativë e dënimit me burgim, si zëvendësuese në rastin e pezullimit të tij.

17

Neni 96, pikat 4 e 5, i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017

Ndryshime dhe dukuri të reja në favor të të miturit ky kod ka sjellë edhe për procedurat dhe rregullat e ekzekutimit të vendimeve penale ndaj të miturve. Kështu, ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe i mituri vazhdon të vuajë dënimin jo me burgim ose me kusht si i mitur edhe nëse ka mbushur moshën 18 vjeç para fillimit të ekzekutimit ose gjatë ekzekutimit të këtij vendimi. Për herë të parë parashikohet mbrojtësi i të miturit gjatë ekzekutimit të vendimeve penale. për realizimin e të drejtave të tij në procesin e fazës së ekzekutimit, i cili caktohet kryesisht sipas dispozitave të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqiose, me pëlqimin e të miturit dhe kur kjo është në interes të tij, vazhdon mbrojtësi që e ka përfaqësuar atë në fazat e mëparshme të procesit.¹⁸ Rregulla të hollësishme parashikohen për organizimin e programeve edukuese dhe rehabilituese, si sigurimi i asimit bazë të detyrueshëm apo, sipas rastit, edhe arsimit mesëm ose i lartë, mundësitë për punë e banim, lehtësime lidhur me lirin me kusht, mbështetje pas lirimit nga organet kompetente për të bërë të mundur një riintegrim të suksesshëm të tij, zbatimin e planit të integritit dhe të mbikëqyrjes së shërbimeve ndaj të miturit të paktën deri në 6 muaj pas lirimit, etj.

BIBLIOGRAFIA:

1. Konventa mbi të drejtat e fëmijës, v 1992.
2. Shefqet Muçi, E Drejta Penale e RSH (pjesa e përgjithshme), Tiranë 2017.
3. Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, v. 2017.
4. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.
5. Kodit Penal të Republikës së Kosovës, v. 2012.
6. Kodi Penal italian, v 1930.
7. Kodi Penal francez, v 1992.
8. Criminal law- Wikipedia, the free encyclopedia; http://en.wikipedia.org/wiki/Criminal_law).
9. Anthony Ellis, "Critical Study Recent Work on Punishment", "The Philosophical Quarterly", Vol 45, No 179, April, 1995.

18 . Nenet 107 e 112 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, v. 2017.



TË MITURIT NË MJEDISET E PARABURGIMIT DHE TË BURGIMIT

Dr. Luljeta Kodra

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

luljeta.kodra@umsh.edu.al

ABSTRAKT

Në aspektin e drejtësisë penale për të mitur, legjislacioni shqiptar mund të konsiderohet një kuadër i plotë ligjor, në përputhje me Kushtetutën, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e tjera ndërkombëtare, që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit.

Shifrat, faktet dhe gjendja aktuale e të miturve, të cilët kanë kryer vepra penale dhe trajtohen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si të paraburgosur apo të dënuar, mund të konsiderohet tepër shqetësuese.

Hallka e fundit në zinxhirin e sistemit të drejtësisë është sistemi penitenciar, në të cilin precipitojnë problematika të shumta, me karakter ligjor, social, ekonomik dhe arsimor. Sensitive në këtë drejtim është zbatimi i drejtësisë për të mitur. Pa përmirësuar sistemin e drejtësisë, nuk mund të pretendohet për mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturve në konflikt me ligjin. Arritja e synimit, për mbrojtjen e të miturve që kanë kryer vepra penale, për rishoqërimin dhe për parandalimin e përsëritjes së veprave penale, është një detyrë e vështirë, e cila kërkon masa efikase për t'u zbatuar.

Reforma në sistemin e drejtësisë, profesionalizmi dhe përgjegjshmëria e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur, si dhe bashkëpunimi i institucioneve përgjegjëse mund të çojnë në mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie të miturish dhe kthimin e tyre në qytetarë të dobishëm për shoqërinë.

Fjalë kyçe: I mitur në konflikt me ligjin, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, mbrojtja e të miturve, rehabilitim

HYRJE

Të drejtat e të miturve janë pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë dhe respektimi i këtyre të drejtave është pjesë përbërëse e reformës në drejtësi. Respektimi i të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin ka problematikat dhe sfidat e veta. Këto problematika nuk është mirë të mbeten të mbyllura dhe të trajtohen vetëm nga disa institucione, por duhet të bëhen transparente dhe të jenë në vëmendjen e gjithë shoqërisë dhe institucioneve shtetërore, sepse kanë të bëjnë me të drejtat e një kategorie shoqërore tepër sensitive, e cila mbart probleme të shumta të karakterit ligjor, social, ekonomik, arsimor etj.

Të miturit në konflikt me ligjin janë kryesisht produkt i shoqërisë dhe shoqëria ka detyrimin ligjor e moral të kujdeset për ta. Ata kanë nevojë për vëmendje e kujdes, trajtim njerëzor e drejtësi, kanë të drejtën e garantimit të një të ardhmeje si të çdo qytetari të lirë. Për mbrojtjen e të miturve në vendin tonë ekziston një kuadër i plotë ligjor dhe institucional, në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, rekomandimet e Këshillit të Europës, me standardet e normat e tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin në fuqi. Të gjitha këto akte kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit. Për t'u përshëndetur është hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesingjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin, ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.¹⁹ Gjithashtu një hap konkret është krijimi i Drejtorisë së Hetimit për të Mitur, nën vartësinë e Prokurorisë së Përgjithshme, e cila do të mundësojë riorganizimin e punës në institucionin e akuzës me të miturit. Por, ndërsa mund të thuhet se ekziston një kuadër i plotë ligjor i drejtësisë për të mitur, në aspektin praktik ka shumë problematika e mangësi.

1. Situata e të miturve në konflikt me ligjin.

Është me rëndësi të sqarohen fillimisht kufijtë moshorë për të miturit e përfshirë në aktivitete kriminale me qëllim evidentimin dhe përcaktimin e grupit të synuar bazuar në legjislacionin shqiptar. Kufiri minimal për të pasur përgjegjë-

19 Ligj Nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur



si penale është 14 vjeç. Për personat e moshës 14-18 vjeç ligji penal përdor termin “i mitur”.²⁰

Në Shqipëri, në vitin 2016, rezultojnë 14.800 të dënuar, nga të cilët 14.233 janë të rritur dhe 567 janë të mitur. Krahasuar me vitet paraardhëse rezultojnë një rënie e numrit të të dënuarve të mitur vit pas viti. Kështu, në vitin 2012 kishte 883, në 2013- 680, në 2014 – 773, në 2015 – 601 dhe në 2016 – 567.²¹ *(Termi të dënuar shqiptohet për personat të cilët me veprat apo sjelljet e tyre kanë cënuar apo kanë dëmtuar të mirat juridike që mbrohen me ligj, ndaj këtyre personave aplikohen sanksione penale të cilat konsistojnë në dënime me burg ose dënime alternative. Dënimet alternative mund të jenë gjysmëliria, punë në interes publik, pezullimi dhe qëndrimi në shtëpi.)*

Në vitin 2016 rezultojnë gjithsej 5946 të burgosur, nga të cilët 58 janë të mitur. Nga këta 58 të burgosur të mitur, 13 janë të dënuar me burg dhe 45 të paraburgosur.²² Të burgosurit e mitur vuajnë dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Kavajë, Vlorë, Korçë dhe Lezhë.²³ Nga këto 4 institucione, ai i Kavajës funksionon për të dënuarit e mitur dhe shërben si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkollë për të miturit, me kapacitet 40 persona. Tre IEVP-të e tjera kanë seksione paraburgimi të veçanta për të miturit. Nga studime të ndryshme në lidhje me kriminalitetin tek të miturit, rezultojnë se përfshirja e tyre në aktivitete të jashtëligjshme është pasojë e faktorëve psiko-socialë, është e lidhur me faktorë individualë, familjarë dhe shoqërorë, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Nga studimet paraardhëse, evidencat ekzistuese dhe intervistat e realizuara me të miturit në konflikt me ligjin rezultojnë se një pjesë e tyre vijnë nga familje-problematike, me histori divorci, dhune, pa njërin prind, apo prindër në emigracion. Përsa i përket aspektit gjeografik, kriminaliteti haset më shpesh tek të miturit që jetojnë në mjedise heterogjene, sidomos tek të ardhurit rishtaz nga zonat rurale në zonat urbane. Kriminaliteti i të miturve rezultojnë se është shumë më i lartë në zonat urbane me popullsi heterogjene, si Tirana apo Durrësi.

20 Po aty, f.2

21 INSTAT 2017, Vjetari Statistikor 2017, Statistikat juridike, <http://www.instat.gov.al/media/3655/vjetari-statistikor-2017.pdf>

22 INSTAT 2017

23 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, www.dpbsh.gov.al

Një aspekt tjetër me rëndësi është roli i arsimit. Një pjesë e të miturve në konflikt meligjin nuk kanë kryer arsimin e detyruar, pasi për arsye të ndryshme, social-ekonomike janë detyruar ta ndërpresin ciklin e shkollimit.²⁴ Nga studime të kryera në Shqipëri mbi të dhënat për kriminalitetin e të miturve, rezulton se krahas autorëve të veprave penale, një numër i konsiderueshëm të miturish janë viktima të këtyre veprave me autorë bashkëmoshatarët e tyre.

Veprat penale më kryesore për të cilat janë burgosur të miturit janë: Vjedhje, vjedhje në bashkëpunim, armëmbajtje pa leje, trafikim i lëndëve narkotike, plagosje, vrasje, marrëdhënie seksuale/homoseksuale me minorene etj. (Në vitin 2015 janë dënuar 10 të mitur për vrasje.) Vihet re se vepra penale që kryejnë të miturit më së shumti është ajo e vjedhjes. Gjithashtu shtimi i numrit të të miturve që kryejnë veprën penale të shpërndarjes, apo përdorimit të lëndëve narkotike është shqetësues, sidomos gjatë viteve të fundit.

Shqetësues gjithashtu është shkalla e lartë e recidivizmit (specifik dhe të përgjithshëm), e cila mund të rrethohet 40%.²⁵ Është fakt se kriminaliteti tek të miturit është një dukuri në rritje. Të miturit, gjithnjë e më shumë po kryejnë vepra penale të ngjashme me ato që kryejnë të rriturit. Në këtë kontekst duhet përmendur se strukturat për mbështetjen dhe ri-integrimin e të miturve autorë të veprave penale pas kryerjes së dënimit janë të pakta, ose mungojnë.

2. Trajtimi i të miturve në institucionet e vuajtjes së dënimit

2.1. Profili i të miturve gjatë vuajtjes së dënimit

Karakteristike për të miturit që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare janë sjelljet delinkuente, të cilat janë pasojë e faktorëve të brendshëm, si mungesa e aftësive për të zhvilluar sjellje prosociale dhe të faktorëve të jashtëm, si familja, bashkëmoshatarët, media, etj. Në përgjithësi këta të mitur janë impulsivë, egocentrikë, kanë vështirësi në kontrollin e zemërimit. Afro 10% e këtyre të miturve rezultojnë të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor.²⁶ Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon në sjelljet e tyre është mjedisi familjar, të cilët përgjithësisht vijnë nga familje të divorcuara dhe me konflikte familjare. Vihet

24 Beqo A, Doçi B, Të miturit në konflikt me ligjin, Nëntor 2015

25 INSTAT 2017, Vjetari Statistikor 2017, Statistikat juridike, <http://www.instat.gov.al/media/3655/vjetari-statistikor-2017.pdf>

26 Beqo A, Doçi B, Të miturit në konflikt me ligjin, Nëntor 2015

re mungesë e theksuar edukimi dhe mungesë autoriteti prindëror. Ata vijnë nga familje me probleme ekonomike dhe me prindër me nivel të ulët arsimor. Rreth 20% e tyre nuk kanë mbaruar arsimin 5 vjeçar. Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë histori me përdorimin e lëndëve narkotike. Këta të mitur kanë mungesë besimi ndaj autoriteteve, mungesë empatie dhe vetëkontroll të pakët.

2.2. Trajtimi i të miturve gjatë vuajtjes së dënimit

Ekziston një doktrinë dhe korpus i plotë ligjor për trajtimin e të miturve në institucionet e vuajtjes së dënimit, me ligje, rregullore, udhëzime, manuale, studime etj, me synim respektimin e të drejtave dhe rehabilitimin e tyre.

- Në IEVP-të ekziston një ekip multidisiplinor, ku rolin kryesor e ka psikologu, i cili merr kontakt me të miturin që në momentin e parë dhe harton raportin e vlerësimit psikologjik të tij.
- Bazuar në vlerësimin psikologjik, hartohen programe individuale trajnimi, të cilat përfshijnë asistencën psikologjike, arsimimin, kurse profesionale, aktivitete në grup me karakter edukues, sportiv dhe argëtues.²⁷

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon masa lehtësuese për këtë kategori. “1. Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një veprë penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. 2. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.”²⁸ – Parashikohet në Kod. Ky kod parashikon qartë masat, procedurat dhe detyrimet konkrete e specifike që duhen zbatuar me të miturit, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme. Më poshtë do të parashtroj disa nga detyrimet që përcakton Kodi, të shoqëruara me gjendjen konkrete, problematikat dhe faktorët pengues.

- “Në mjediset, në të cilat realizohet kufizimi i lirisë: a) niveli i masave të sigurisë është i ulët;²⁹ – përcaktohet në Kod.

27 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, www.dpbsh.gov.al

28 Ligj Nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, neni 97

29 Po aty, neni 98, pika 2, a

Ky detyrim paraqet vështirësi në I EVP Korçë dhe Lezhë, të cilët kategorizohen si burgje të sigurisë së lartë. Për shkak të shpërndarjes gjeografike në të gjithë territorin e vendit, me qëllim që të miturve t'u garantohet kontakti me familjarët e tyre, ata vuajnë dënimin në burgjet e Korçës dhe të Lezhës. Por vuajtja e dënimit të tyre në këto I EVP të sigurisë së lartë, ku vëmendja kryesore përqëndrohet tek siguria, vështirëson trajtimin individual të tyre.

- “Numri i të miturve të vendosur në to është sa më i vogël, me qëllim që të mundësohet trajtimi individual i tyre.”³⁰ – përcaktohet në Kod.

Kjo masë paraqet vështirësi për tu realizuar jo vetëm për shkak të përfshirjes gjeografike të një I EVP-je, por edhe të mbipopullimit të burgjeve. Në I EVP Korçë, i cili ka kapacitet 312 vetë, mbipopullimi ka arritur deri në 480 vetë, pra mbi 40%.

- “Për garantimin e interesit më të lartë të të miturit, institucioni përkatës i paraburgimit ose iburgimit duhet të ketë personel të mjaftueshëm, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi.”

Aftësitë profesionale të personelit të I EVP-ve që merren me të mitur janë problem madhor. Ka vështirësi të mëdha në emërimin e personelit, promovimin dhe motivimin e tyre. Për personelin policor të burgjeve nuk ka ndonjë shkollë të mirëfilltë. Kurset e trajnimit mund të thuhet se janë të pamjaftueshme. Roli i punonjësit social dhe psikologut është tejet i rëndësishëm në misionin e këtyre institucioneve, por mënyra e përzgjedhjes dhe cilësia e psikologëve lë shumë për të dëshiruar. Kurset apo trajnimet një apo disa ditore janë të pamjaftueshme për të qënë në lartësinë e detyrës. Psikologu, sipas rregullores së burgjeve, duhet të qëndrojë me minorenët nga ora 9-13 dhe të zhvillojë programe individuale dhe në grup. Mungesa e një statusi për punonjës social, për psikologun dhe motivimi i pakët i tyre, rëndon mbi edukimin e pamjaftueshëm të të miturve. Sipas statistikave, shumica e punonjësve social/psikologëve, e kanë kohën e qëndrimit në sistemin e burgjeve jo më shumë se tre vjet. Vendosja dhe zbatimi i kriterëve profesionale për rekrutimin, trajnimin e mëtejshëm dhe motivimin e kësaj kategorie

nëpunësish do të ishte në të mirë të tyre, por edhe të misionit të I EVP-ve.

- “Të pandehurve/të dënuarve të mitur/të rinj u sigurohet arsimi bazë i detyrueshëm dhe, sipasrastit, edhe arsimi i mesëm ose i lartë.”³¹ –përcakton Kodi.

Faktikisht ka plane bashkëpunimi, midis I EVP-ve dhe Drejtorive Arsimore, por cilësia e mësuesve që caktohen nga drejtoritë arsimore për të dhënë mësim në burg, motivimi i tyre, interesi i I EVP-së për cilësinë e procesit mësimor lë shumë për të dëshiruar.Procesi mësimor gjithashtu vështirësohet edhe për shkak të moshës së ndryshme të të miturve, si dhe të kohës së qëndrimit të tyre në I EVP.

- “Të burgosurve të mitur/të rinj u krijohen mundësi për trajnim profesional, sipas interesave dhe prirjeve të tyre dhe që do të ndihmojë në punësimin e tyre pas largimit nga institucioni.”³² – përcakton Kodi.

Ka plane bashkëpunimi midis I EVP-ve dhe Drejtorive të Formimit Profesional.Vihet re se interesi dhe vëmendja e të miturve për të ndjekur kurse profesionale si kuzhinier, kopshtar, riparues kompjuterash etj është i ulët.

- “I mituri ka të drejtë të kryejë një punë që shpërblehet. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur nxit kryerjen e punës së shpërblyer. Kur është e mundur, i pandehuri/i dënuari i mitur mund të punojë edhe jashtë këtij institucioni, duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës lidhurme punësimin e të miturve.”³³ – thuhet në Kod.

Punësimi është një element i rëndësishëm për rehabilitimin e të burgosurit.Ka të dënuar që nuk kanë punuar kurrë në jetën e tyre.Ka të tjerë që punë apo profesion njohin ilegalen. Mund të konsiderohet i pashpjegueshëm dhe në kufijtë e absurdit realiteti aktual në drejtim të punësimit të të dënuarve dhe tëparaburgosurve.Vlerat e punësimit janë progresive, si për kohën e vuajtjes së dënimit, ashtu dhe pas saj.

Bota e qytetëruar e ka futur punësimin, me qëllimin kryesor të rehabilitimit, kohë më parë. Burgjet e vendeve perëndimore nuk mund të konceptohen

31 Po aty, neni 117, pika 1

32 Ligj Nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, neni 117, pika 4

33 Po aty, neni 118, pika 1

pa punësimin dhe hapësirat e mjediseve të punësimit janë po aq të mëdha sa edhe mjediset e burgjeve. Punësimi shërben jo vetëm për kalimin në mënyrë të mbarë të kohës në burg, jo vetëm për uljen e dënimit dhe përfitim financiar, por edhe për marrjen e një profesioni të nevojshëm për mbas burgut. Për punësimin dhe shpërblimin e punës ka nevojë të bëhen përmirësime ligjore, kryesisht në drejtim të pagës së të burgosurve.

Është e vërtetë se bëhen përpjekje për punësim të të dënuarve dhe paraburgosurve, si dhe për kurse profesionale, por gjithsesi ato janë të pamjaftueshme. Aktualisht, të punësuarit në burgje, të cilët nuk mund të arrijnë më shumë se 10%, përfitojnë afro 4 ditë në muaj ulje dënimi, si dhe kanë kuota më të larta kalorie se sa pjesa tjetër e të dënuarve dhe paraburgosurve.³⁴ Ata punojnë si sanitarë, ndihmëskuzhinierë, shpërndarës ushqimi, kopshtarë, hidraulikë etj. Programet e punësimit nuk mund të bëhen vetëm nga sistemi i burgjeve, pa mbështetje të qeverisë, pushtetit lokal dhe institucioneve të tjera. Pozitive është se disa sponsorë të huaj, të mbështetur edhe nga ambasadat e tyre, nga shtete të BE-së, në vendin tonë, kanë shprehur interes për programe punësimi.

Një problem tjetër shqetësues në respektimin e të drejtave të të miturve të burgosur është trajtimi i tyre nga gjykatat në mënyrë të drejtë dhe në një kohë sa më të shkurtër, duke marrë në konsideratë nivelin e tyre familjar dhe pamundësitë e tyre ekonomike.

Në vitet 2005-2015 gjykatat kanë proceduar e më pas shpallur të pafajshëm 25 të mitur, duke i shkaktuar këtyre të fundit kosto emocionale, shoqërore, shkollore dhe ekonomike. Në këto dhjetë vite, gjykata ka pushuar 128 procedime gjyqësore për veprat penale subjekt aktiv, i proceduari i të cilave ka qenë i mitur.³⁵

Në rekomandimet e Këshillit të Evropës në lidhje me Sistemin Penitenciar përcaktohet: "Në rastet kur, si masë e fundit, të dyshuarit në moshë të mitur mbahehen në arrest me burg, kjo nuk duhet të bëhet për më shumë se gjashtë muaj para nisjes së gjykimit."³⁶

34 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, www.dpbsh.gov.al

35 Vjetarë Statistikorë të MD (2005-2015), <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1882/Te-mitur-te-denuar-per-vepra-penale-2005-2015>

36 Rekomandime të Këshillit të Evropës në lidhje me Sistemin Penitenciar, f.87, Recommendation CM/Rec(2008)11 of the Committee of Ministers to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions or measures, [https://www.unicef.org/tdad/councilofeuropeljrec08\(1\).pdf](https://www.unicef.org/tdad/councilofeuropeljrec08(1).pdf)

REKOMANDIME

1. Rritja e cilësisë së stafit policor dhe civil në sistemin e burgjeve. Motivimi i tyre për një përkushtim më të mirë në detyrë. Vendosja e kriterëve më profesionalë për rekrutimin, trajnimin e mëtejshëm dhe motivimin e personelit civil. *(Bazuar në verifikimin e kryer nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve deri tani rezulton që rreth 130 persona janë me dënime penale.)* Zbatimi i kriterëve të rekrutimit, promovimit në gradë e detyrë dhe motivimit të personelit policor. Hapja e një shkolle, apo kurse profesional për personelin e Policisë së Burgjeve, sipas gradave, nga grada Nëninspektor (*inspektor, kryeinspektor*) e deri në gradën Kryekomisar (*nënkomisar, komisar*).
2. Dhënia nga gjykatat e vendimit të dënimit për të miturit që mbahen në arrest me burg, në një kohëjo më shumë se 6 muaj. Dhënia sa më shumë të jetë e mundur e dënimeve alternative.
3. Vlerësimi si masë i kryerjes së dënimit në burgje të hapura, ku të miturit të kenë mundësinë të shkojnë të shkollohen, të marrin pjesë në programe edukuese, të punojnë gjatë ditës, edhe nëpërmjet projekteve të partneritetit publik-privat dhe më pas të kthehen në qeli për të vuajtur dënimin e caktuar.
4. *(“Qendër/institucion për rehabilitimin e të miturit” është një strukturë ose program ku vendoset i mituri i dënuar ose jo, e cila është e pajisur me infrastrukurën dhe personelin e duhur për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.)*³⁷ Funksionimi i qendrave/institucione rezidenciale për rehabilitimin e kësaj kategorie minorësh, sidomos për masën e kufizimit të lirisë, apo për kohën pas vuajtjes së dënimit, konform Kodit³⁸ dhe me partneritet publik-privat, do të ishte një projekt pozitiv. *(Instituti i të Miturve në Kavajë, i cili shërben si një qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit është projekt i realizuar me investim të BE me një fond prej 2.4 milion euro. Kapacitetet akomoduese të institucionit janë për 40 persona. Në këtë IEVP, rreth 80% e stafit është civil dhe pjesa tjetër policor.)*³⁹ Por, referuar të dhënave, 40% e

37 Ligj Nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, neni 3, pika 19

38 Ligj Nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, neni 98, pika 1

39 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, www.dpbsh.gov.al

këtyre të miturve janë recidivistë, si dhe se shteti shqiptar shpenzon rreth 15 euro në ditë për një të dënuar. Funkcionimi i qendrave/institucioneve me personel të trajnuar dhe specializuar në çështjet penale me të mitur dhe të rinj, psikologë dhe punonjës socialë do të ishte efektiv.)

5. Vënia në zbatim e skemës së shpërblimit të të burgosurve të punësuar, me përparësi të miturit.
6. Zbatimi i procesit arsimor të detyruar për të miturit. Mbështetje më e mirë nga MAS.
7. Sigurimi i bazës didaktike për arsimimin e të miturve, si dhe të bazës materiale për zhvillimin e procesit të formimit profesional në përgjithësi.
8. Krijimi i ambjenteve të përshtatshme në IEVP, ashtu si e përcakton edhe Kodi, për këshillimin, aktivitete kulturore e sportive.
9. Krijimi i një raporti më fleksibël, midis vendbanimit të të miturit dhe IEVP-së ku vuan dënimin, në interes të të miturve, duke qënë ata sa më larg të dënuarve të tjerë, sidomos të atyre të sigurisë së lartë.

BIBLIOGRAFIA

1. Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), ratifikuar nga Shqipëria më 27 shkurt 1992;
2. Udhëzimet e OKB-së, Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mosarrestimit (1990);
3. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut KEDNJ dhe Protokollat nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;7;
4. Rekomandime të Këshillit të Evropës në lidhje me Sistemin Penitenciar (Recommendation CM/Rec(2008)11of the Committee of Ministers to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions or measures.);
5. EU Projects, Support to the Penitentiary System and the Probation Service in Albania, 16 - 19 June 2016, https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/.../default_en.asp



6. Ligj Nr.10 347, Datë 4.11.2010 Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
7. Ligj Nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur;
8. Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve, www.dpbsh.gov.al;
9. Studim “Të miturit në konflikt me ligjin.”, Beqo A, Doçi B, www.dpbsh.gov.al;
10. Manual per Sherbimin e Ndermjetesimit ne burgje, <https://albania.savethechildren.net/sites/albania>
11. Vjetari statistikor, Ministria e Drejtësisë, www.drejtësia.gov.al/
12. INSTAT, Krimet dhe drejtësia penale, <http://www.instat.gov.al/>

PËRPARËSIA E MASAVE ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE DHE NGA DËNIMI I TË MITURVE

Arqilea Koça

Prokuror, Prokuroria e Përgjithshme.

arqile.koca@pp.gov.al

ABSTRAKT

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, si pjesë e reformës në drejtësi, hyri në fuqi më datë 01.01.2018. Në mjaft aspekte Kodi reflekton një rregullim mjaft specifik të veprimtarisë procedurale të organeve kompetente, të detyruara sipas tij të koordinojnë veprimtarinë e tyre në përmbushje të synimit final të Kodit, për një një drejtësi të orjentuar nga interesi më i lartë i të miturit.

Ky punim do të synojë të trajtojë një institut krejtësisht të ri dhe të panjohur më parë në të drejtën tonë procedurale penale sikurse është instituti i shmangies nga ndjekja penale si një alternativë e procesit penal dhe dënimit të të miturit.

Punimi ka dy synime kryesore: Së pari të japë një shpjegim të qartë teorik të të gjithë elementëve që përshihen në këtë institut duke bërë krahasimet e nevojshme me konceptet e traditës juridike dhe, së dyti, të evidentojë problematikat që ai pasqyron si në aspektin teorik ashtu dhe në aspektin praktik me synimin e vetëm, interpretimin dhe zbatimin sa më drejt të tij dhe përmirësimin e këtyre parashikimeve duke e parë këtë si një proces dinamik.

Nga sa më lart, rëndësia e tij është e dyanshme. Ai ka rëndësi teorike dhe praktike. Ka rëndësi teorike pasi synon të krijojë një bazë teorike mbi kuptimin e këtij instituti dhe ka rëndësi praktike për shkak të nevojave të zbatimit në praktikë.

Fjalët kyçe: përparësi, shmangie, i mitur, ndjekje penale

HYRJE

Para se të kalojmë në një analizë më të detajuar të trajtimit të masave alternative tëshmangies nga procedimi penal që zbatohen ndaj të miturve, mendoj se është vendi të bëjmë një trajtesë të shkurtër me një natyrë më të përgjithshme në lidhje disa momente që kanë të bëjnë vecanërisht me nevojën e një Kodi për të Mitur, me disa risi dhe koncepte të reja që hasim në këtë Kod, për të kaluar natyrshëm në trajtimin e institutit të shmangies nga procedimi penal. Një gjë e tillë është e nevojshme për të kuptuar filozofinë që transmeton kyKod, filozofi e cila do të përcaktojë filozofinë e të vepruarit në praktikë, qasjen e ndryshme që duhet të adoptohet kur do të trajtohen çështje penale në të cilat i mituri është autor i veprës penale, viktimë e saj apo dëshmitar në një proces penal.

Si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, kyKod është vlerësuar si ndër më të rëndësishmit. Nevoja për një qasje të re ndaj të miturit kishte kohë që ishte vënë në plan të parë të shumë propozimeve të mëparshme, të shumë projekteve dhe komisioneve të mëparshme që synonin amendimin e K.Pr.Penale. Kjo qasje e re kishte lindur e kushtëzuar nga shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Në lidhje me faktorët e brendshëm mund të evidentojmë faktin se për vite me radhë procesi penal ndaj të miturve nuk po realizonte qëllimet e synuara për rehabilitimin e të miturve. Ai ende ishte i orientuar drejt ndëshkimit dhe nuk kishte qasje drejt një drejtësie restauruese. Alternativat e dënimit të ofruara, nuk krijonin mundësi për një qasje të tillë duke e bërë sistemin të mos kishte një qasje miqësore ndaj të miturve. Kuadri ligjor, strukturor dhe edukues i organizmave të lidhura me drejtësinë me të mitur nuk po jepte rezultatet e pritshme. Vëmendja që po i kushtohej të miturve nga sistemi i drejtësisë nuk ishte në raport të drejtë me angazhimet që shteti shqiptar kishte marë në nivel ndërkombëtar. E pikërisht vlerësimi krahasues i situatës me angazhimet e mara nëpër instrumente të ndryshme ndërkombëtare, i qëndrimit krahasues me standartet e BE, e shndëroi në domosdoshmëri orientimin e drejtësisë për të mitur drejt një qasjeje miqësore.

Sistemi ynë i ndërtimit të kodeve ndjek logjikën që të bëjë ndarjen e tyre bazuar në fushën e veprimit të marrëdhënieve shoqërore duke i rregulluar ato në marrëdhënie juridike përkatëse.

Është hera e parë që ligjvënësi vendos të ndërtojë një Kod bazuar në ndërthurjen

e dy kritereve :fushën e veprimit me subjektin sikurse në rastin konkret, fusha e drejtësisë penale dhe subjekti i mitur. Për këtë arsye ne mund të konkludojmë se në këtë aspekt,ky kod përbën një revolucion në sistemin e ndërtimit të legjislacionit.

Po cilat ishin shkaqet që e çuan ligjvënësin në konkluzionin se përmbledhja e të gjitha rregullimeve ligjore mbi mënyrën e të vepruarit të organeve kompetente të ndjkejes penale dhe jo vetëm, ndaj një të mituri të përfshirë në njëçështje penale, do të duhet të përfshiheshin në një akt të vetëm? Nëse analizon me kujdes të gjitha dispozitat e këtij Kodi, lehtësisht arrin në konkluzionin se shkak kryesor është parimi që e përshkon të gjithë atë dhe që në të gjithë legjislacionin ndërkombëtar dhe jurisprudencën përkatëse që lidhet me të miturit njihet si **“interesi më i lartë i të miturit”**. Ky interes kushtëzoi domosdoshmërinë e kohezionit në normave juridike. Ky kohezion supozohet të krijojë lehtësi si për subjektet aktive ashtu dhe për subjektet pasive të drejtësisë, për të krijuar mjedisin e përshtatshëm miqësor në të cilin do të mund të realizohet drejtësia me të mitur. Interesi më i lartë i të miturit kushtëzoi jo vetëm hartimin e një kodi si përmbledhës të rregullimeve procedurale penale por ky interes, kushtëzoi përfshirjen në kod të qasjes së gjithë aktorëve që vihen në lëvizje me rastin e përfshirjes së një të mituri në një çështje penale e vecanërisht të atij në konflikt me ligjin.

Parashikimet e detajuara në aktivitetit prokurorisë, gjykatës, avokatisë, policisë së shtetit, shërbimeve sociale, shërbimit të provës, sistemit të burgjeve,etj., të cilat duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin dhe sidomos për rehabilitimin e tyre, e bën këtë kod të ketë një dallim esencial nga një kod i zakonshëm procedure penale. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, në dallim nga K.Pr.Penale, pasqyron një rregullim të detajuar të gjithë zinxhirit që përfshin konceptin e ndjekjes penale që nga momenti i kryerjes së një vepre penale e deri në përfundim të ekzekutimit të dënimit të mundshëm duke përfshirë në të, në mënyrë të detajuar, dhe rregullat e ekzekutimit të dënimit e duke krijuar në këtë mënyrë një panoramë të qartë dhe të përmbledhur të gjithë pritshmërisë që i mituri do të ketë në rastin e kryerjes së një vepre penale. Në këtë mënyrë na shfaqet qartëkarakteri integral⁴⁰ të tij. Për

40 Komisioni i Ligjeve.Raport për projektligjin “Kodi i Drejtësisë Penalepër të Miturit në Republikëne Shqipërisë”

më tepër ky Kod, nuk e konsideron të kryer detyrën e vendosjes së drejtësisë në këtë moment por në momentin e përfundimit të procesit të riintegritimit të të miturit ç'ka do të thotë se ai shkon përtej një procesi formal procedural. Mendoj se është pikërisht kjo qasje integrale dhe multidisiplinore që ka përcaktuar dhe emërtimin e tij jo thjesht si një kod procedure penale por si një kod drejtësie për të miturit.

“SHMANGIA” SI THYERJE E SISTEMIT OBLIGATOR.

Por risia kryesore që mendojmë se pasqyron Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është përfshirja në të, elementëve diskrecionalë të procedimit. Fakti që sistemi ynë i ndjekjes penale është një sistem obligator, nuk është një konstataim i ri për ne. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, për herë të parë na ofron një mundësi për të vepruar ndryshe nga sa më sipër. Për herë të parë shfaqet në këtë Kod mundësia e organit kompetent, që në kuptim të K.Pr.Penale është organi procedues, që bazuar në vlerësime që nuk lidhen domosdoshmërisht me përcaktime eksplicite ligjore, të disponojë për të mos e përfshirë të miturin në konflikt me ligjin, në një procedim penal por t'a shmangë atë duke e zëvendësuar ndjekjen penale me ndërmarjen e një procedure krejt të re. Procedura e re synon nga njëra anë restaurimin dhe riintegrimin e të miturit por nga ana tjetër siguron dhe parandalimin e të miturit nga kryerja e veprave penale të tjera.

Në nenin 3/23, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, na jep kuptimin e institutit të “Shmangies” duke e përcaktuar atë si **“masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të këtij Kodi”**⁴¹

Po kështu, neni 14 i Kodit na bën me dije se **“në procedurën e drejtësisë penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal.”** Dhe më tej parashikohet se: **“Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget vënja në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij”**

Sipas këtij Kodi, aktiviteti procedural që zhvillohet në lidhje me këtë institut nuk e barazon atë me një procedim penal të mirëfilltë dhe për pasojë, masat alternative që jepen, nuk e identifikojnë të miturin sitë dënuar. Në këtë mënyrë mund të thuhet se ky aktivitet mund të cilësohet si “paradrejtësi” pasi gërshe-

41 Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

ton një aktivitet joproceduarl penal të mirëfilltë, me ushtrimin e tij nga subjekt procedural penal sikurse është prokurori apo gjykata.

Pra, “Shmangia” si institut i pasqyrimin të diskrecionit të organit procedues, nënkupton mundësinë e tij, që bazuar në vlerësimin e rrethanave të rastit konkret të të miturit që ka kryer një vepër penale, të vendosë të mos e përfshijë të miturin në konflikt me ligjin në një procedurë të ndjekjes penale që synon dënimin penal të tij, por të ndërmarë ndaj tij një procedurë restauruese që synonrishoqërizimit, rehabilitimit e të miturit dhe parandalimin nga kryerja e shkeljeve të ligjit.

Është pikërisht mundësia e vendimmarrjes bazuar në vlerësimin individual tëçdo rasti,që merr parasysh rrethanat specifike të tij dhe që lidhen me moshën, niveline zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyrën e rritjes dhe zhvillimit, edukimin dhe arsimimin, gjendjen shëndetësore, gjendjen familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat e bëjnë këtë institut të konsiderohet si shprehje e natyrës diskrecionale të Kodit.

Po cilat janë parimet dhe cila është teknologjia që duhet të përdorin organet kompetente në vlerësimin e rastit, nëse ndaj të miturit në konflikt me ligjin do të ushtrohet ndjekja penale apo do të vendoset shmangia prej saj.

Sikurse u tha dhe më lart, parimi kryesor që përshkon gjithë kodin është parimi i të udhëhequrit në çdo hap të aktivitetit nga interesi mëi lartëi të miturit. Edhe pse një parim i tillë ka qenëi njohur më parë, për herë të parëky Kod, në nenin 10⁴² të tij na përshkruan në mënyrë të qartë se ç’do të thotë të udhëhiqesh nga ky parim.

Për më tepër, kjo dispozitë dhe të tjera që lidhen me të, parashikojnë si garanci,

42 Neni 10

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit.

2. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatesinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

detyrimin e organit procedues që në vendimet që merr të analizojë në mënyrë të detajuar mënyrën e vlerësimit të këtij parimi.

Përveç parimit të mësipërm, rëndësi të veçantë merr parimi i përparësisë që duhet të këtë shmangia nga procedimi penal në raport me këtë të fundit. Ky parim shprehet qartë në nënin 14 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur kur thuhet se: *“Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese **vlerësohen si mundësia e pare**”* dhe më tej *“Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmangjet vënia në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij.”*

Ky parim nënkupton që organet proceduese, në arsyetimin e çdo vendimarrje që orjentohet drejt procedimit penal, duhet të analizojnëme kujdes paraprakisht se pse aplikimi i shmangies nga procedimi penal nuk mund të realizojë qëllimet e drejtësisë.

Theksimi i gjithë sa u tha më sipër krijon përshtypjen shpesh herë se ky Kod, e për më tepër ky institut, si një ndër përbërësit kryesorë të tij, krijon premisa qëi mituri të mos marë mbi vete përgjegjësi për shkeljet penale apo krijon perceptimin sikur interesi publik është i nënflësuar.

Atëhere lid pyetja se cilat janë objektivat që organi kompetent duhet të realizojë nëpërmjet shmangies nga ndëjkja penale, që shërbejnë si parakushte për të disponuar me shmangien dhe përcaktimin e masave alternative të saj? Cilët janë idikatorët vlerësues?

Edhe pse në ligj në mënyrë të përsëritur theksohet seqëllimi i drejtësisë penale për të mitur është rishoqërimin dhe rehabilitimin e të miturit, në mënyrë ndoshta jo shumë të qartë evidentohet se nëpërmjet realizimit të këtyre qëllimeve, synohet që të parandalohet të miturin nga kryerja e veprave penale të tjera.

Kjo naçon në konkluzionin se, në vendimarrjen e organit procedues (kompetent), harmonizimi i interesave të individit me ato të shoqërisë në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, realizohen nëpërmjet përfitimit të këtij të fundit nga shmangia nga procesi penal me mbartjen e detyrimit të të miturit për moskryerjen e veprave penale të tjera. Kjo do të mund të garantohet nga tërësia e masave alternative që do të imponohen si dhe nga qëndrimi i të gjitha strukturrave të tjera të përfshira në drejtësinë restauruese.

Përpos vlerësimeve parimore të përmenduara më sipër, Kodi, në nenin 55 të tij, përcakton dhe elemente të vecantë që lidhen me kriteret dhe kushtet të cilat duhet të merren parasysh nëse do të aplikohet ose jo shmangia nga procedimi penal.

Nga mënyra si është ndërtuar dispozita dhe gjuha e përdorur, krijon një paqartësi në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të kësaj dispozite. Së pari, lind pyetja nëse dispozita është me natyrë orjentuese apo përcaktuese. Duke u nisur nga fryma e Kodit, semantika gjuhësore e shprehjes “*Në mënyrë të vecantë masa e shmangies ...zbatohet nëse*”, si dhe duke u nisur nga natyra pothuajse e ndërtimit të nenit, mendoj se parashikimet e bëra në këtë dispozitë janë me karakter orjentues. Së dyti, a kërkohet që këto parashikime të jenë kumulative apo jo? Në vijim të interpretimit të mësipërm mendoj se domosdoshmëria e pranisë së një apo disa kushteve është në raport me natyrën e parashikimit dhe domosdoshmërinë e pranisë së saj.

Masa e shmangies mund të iniciohet nga prokurori ose nga i mituri a perfaqësuesi i tij. Pëlqimi i të miturit në lidhje me masën e shmangies është kusht pa të cilin, pëlqim nga i cili aimund të heqë dorë nëçdo kohe.

Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë:

- a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- b) këshillimin për të miturin dhe familjen e tij;
- c) paralajmërimin me gojë;
- ç) paralajmërimin me shkrim;
- d) masat detyruese;
- dh) vendosjen nën kujdes.

Zbatimi i programve të drejtësisë restauruese synon krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit ose shoqërisë. Programi i drejtësisë restauruese mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohet:

a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;

b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit ose shoqërisë;

c) t'i kërkojë falje viktimës; dhe

ç) të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimë ose/dhe komuniteti.

Masat e drejtësisë restauruese mund të përfshijnë pjesëmarrjen në një program të ndërmjetësimit dhe/ose të punës në interes publik si dhe çdo program tjetër që çon në rehabilitimin e pasojave të veprës penale të kryer nga një i mitur.

Ndërmjetësimi mund të jetë individual, familjar apo në grup. Ai synon sqarimin e rrethanave të konfliktit midis autorit dhe viktimës, pranimin e fajësisë, angazhimin për përmirësimin e sjelljes dhe synon përmirësimin e raporteve mes palëve në konflikt. Ndërmjetësimi familjar dhe në grup është një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës.

Këshillimi si masë alternative, konsiston në informimin e të miturit dhe/ose familjes së tij, se ai ka kryer një veprë të dëmshme, të rrezikshme, e cila përbën veprë penale dhe me pasojë negative për viktimën dhe komunitetin.

Paralajmërimi, si masë alternative nënkupton gjithë shpjegimet që i jepen të miturit nga organet kompetente, mbi dëmin e shkaktuar prej veprimeve të tij dhe pasojave që ai mund të ketë nëse vepra penale do të përsëritet.

Masat detyruese që mund të caktohen ndaj të miturit kanë si synim korrigjimin e sjelljes dhe zakoneve të të miturit, rritjen e nivelit arsimor, rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij, punësimin, parandalimin nga kryerja e veprave të tjera penale.

Vendosja e të miturit nën kujdes për ndjekjen e një programi edukativ dhe korrigjues, aplikohet si masë kur mundësia e prindit apo kujdestarit për mbikëqyrjen e tij në realizimin e masave detyruese, nuk garanton rezultatin. Në këto raste dhe për shkak të nevojës së një kujdesi të specializuar dhe të vazhdueshëm, i mituri mund të përfshihet në një program të tillë që realizohet nga struktura të specializuara.

Nëse i mituri i përmbush detyrimet sipas marrëveshjes së shmangies, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes.

Nga analiza e ligjit dhe parashikimeve të tij vlerësohet prania e një sërë problematikave që lidhen me sa më poshtë:

- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ka patur nevojë për një kohë maturimi. Kjo për shkak të natyrës komplekse të tij, të majft risive që ka sjellë sinë konceptim ashtu dhe në institute e subjekte.
- Hyrja në fuqi e Kodit pa ndërtuar gjithë infrastrukturën përkatëse nënligjore, strukturore, organizative e trajnuese për zbatimin e tij ka shkakuar konfuzion në zbatuesit e ligjit.
- Kodi parashikon një aktivitet të integruar të disa agjensive dhe afate veprimesh të cilat do të krijojnë vështirësi për një kohë deri në standartizimin e tyre. Rekomandohet që ngritja e një organizmi koordinues që do të lehtësonte punën e organeve kompetente në realizimin e drejtësisë.
- Shpesh herë gjuha e përdorur në Kod përmban formulime më tepër karakteristike për një dokument politikbërës, me percaktime të jo shumëqarta mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe përsëritje të pa-nevojshme. Për këtë rekomandohet që në të ardhmen të ripunohet për të përfutuar më shumë elementët e shkruar të një ligji.

BIBLIOGRAFI

Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar.

Ligji Nr. 37/2017 “Kodii Drejtësisë Penalepërtë Mitur”

Ligji Nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodii Procedurës PenaleiRepublikëssë Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës.

Komisioni i Ligeve. Raport për Projektligjin “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit në Republikën e Shqipërisë”

ASPEKTE KRAHASUESE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR: KOSOVA, EVROPA QËNDORE DHE EVROPA LINDORE

Prof. Asoc. Dr. Bashkim Rrahmani

Kolegji AAB Prishtinë

Prof. Ass. Dr. Veton Vula

Kolegji AAB Prishtinë

bashkim.rrahmani@universitetiaab.com

ABSTRAKT

Me këtë punim do të vlerësohen politikat dhe praktikrat e drejtësisë për të mitur nga një perspektivë krahasuese. Punimi përqëndrohet në analizë të legjislacionit të drejtësisë për të mitur, duke u marrë gjithashtu edhe me punën e prokurorëve dhe gjyqtarëve për të mitur. Në shumë shtete të Evropës sikundër edhe në Kosovë janë zhvilluar strategji për reformë të sistemit të drejtësisë, të cilat kanë shënuar ndryshime kualitative dhe me këtë është vërejtur një shkallë e dalluar e konvergencës në mes të sistemeve të shteteve të Evropës. Duke përdorur metodologjinë cilësore dhe me përdorimin e metodës së analizës krahasuese, metodën e analizës historike, etj., autorët do të përqëndrohen në zhvillimin historik të sistemit të drejtësisë për të mitur në Kosovë, në kontekst të zhvillimeve të kësaj fushe në shtete të ndryshme të Evropës Qëndrore dhe Lindore. Punimi krahas shpjegimit të nocioneve dhe krahasimit të tyre do të nxjerrë rekomandime, të cilat i shërbejnë studiuesve dhe institucioneve të angazhuara drejtpëdrejt në fushën e drejtësisë për të mitur.

Fjalët kyçe: *drejtësia për të mitur, prokurori, gjyqtarët, strategji, reformë, institucione*

HYRJE

Ligjet dhe procedurat lidhur me kryerësit të mitur kanë një histori të gjatë, mijërave vjet të vjetër. Kodi i Hamurabit, rreth 4000 vjet p.e.s. (v.2270 Para Krish-tit) përfshinë referenca për të larguarit/të ikurit nga prindërit, për fëmijët të cilët nuk iu bindën prindërve të tyre dhe fëmijët të cilët u mallkuan nga etërit e tyre. Ligji civil romak dhe ligji kanunor (kisha) 2000 vjet më parë gjithashtu dallonin të rriturit dhe të miturit duke u bazuar në idenë e “moshës së përgjegjësive”. Në të drejtën e hershme jezuide, Talmudi ndërtoi kushtet nën të cilat papjekuria do të konsiderohej në imponimin e dënimit. E drejta muslimane thërret për një shpirtbutësi në të dënuarit e kryerësve të mitur dhe për fëmijët nën moshën 17 vjeçare që të përjashtohen nga dënimi me vdekje. Deri në shek V. në të drejtën romake fëmijët nën moshën 7 vjeçare klasifikohen si fëmijë dhe nuk përgjigjeshin penalisht. Të rinjtë që po i qaseshin moshës së pubertetit, të cilët dinin të bënë dallimin në mes të asaj që është e drejtë dhe jo e drejtë (e mirë dhe e keqe) mbaheshin të përgjegjshëm. Moshë legale e pubertetit (14 vjet për djemta dhe 12 vjet për vajzat) ishte moshë kur fëmijët supozohej të dinin dallimin në mes të keqes dhe të mirës (e drejta dhe e padrejta) dhe përgjigjeshin penalisht.⁴³

Gjykatat *Chancery* në shek.15 në Angli u krijuan për të marrë në konsideratë petitionet e atyre në nevojë apo për intervenim, përgjithësisht gratë dhe fëmijët që ishin në nevojë për ndihmë nga shkaku se ishin braktisur, shkukurëzuar apo nga vdekja e bashkëshortit. Përmes këtyre gjykatave, mbreti mund të ekzekutonte të drejtën e *parens patriae* (“prindi i një vendi”) dhe gjykatat vepronin në *loco parentis* (“në vendin e prindërve”) për të dhënë shërbime të ndihmës ndaj grave dhe fëmijëve në nevojë. Parimi i *parens patriae* më vonë bëhet bazë e drejtësisë për të mitur në Amerikë. Doktrina i jep gjykatës autoritet mbi të miturit në nevojë për udhëzime dhe mbrojtje, ndërsa shteti mundet pastaj, të veproj në *loco parentis* (në vendin e prindërve) për të dhënë udhëzime dhe për të marrë vendime lidhur me interesat më të mira të fëmijëve.⁴⁴

E drejta penale për të miturështë grumbull rregullash ligjore me të cilat përcaktohet *statusi penalo juridik i të miturve* (si kryes të veprave penale gjegjësisht

43 HISTORY AND DEVELOPMENT OF THE JUVENILE COURT AND JUSTICE PROCESS - https://uk.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/19434_Section_1.pdf (qasur me 26.01.2018)

44 Më gjerësisht për historinë e drejtësisë për të mitur shih: HISTORY AND DEVELOPMENT OF THE JUVENILE COURT AND JUSTICE PROCESS - https://uk.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/19434_Section_1.pdf (qasur me 26.01.2018)

personave të mitur si viktime të veprës penale). Kjo përshkruan një tretman të veçantë ndaj kryesve të veprave penale të të miturve. Kështu, ky titull, i cili shpesh në teorinë juridike përcaktohet si postulat kriminalo-politik përfshin degën me rregulla penalo juridike që aplikohen ndaj kryesve të mitur të veprave penale dhe të cilat reflektojnë karakter specifik dhe të vecantë të kësaj dege të të drejtës. Kjo është e drejtë e cila bazohet në personalitetin e kryesit të veprës penale (Taterstrafrecht) dhe jo në deliktin (Tatstrafrecht).⁴⁵

Sistemi i e të drejtës penale për të mitur përfshinë: të drejtën penale materiale, të drejtën penale procedurale dhe të drejtën penale ekzekutive.

Në aspektin kriminologjik, nocioni kriminalitet i të rinjve përdoret për të theksuar aktivitetin kriminal të gjithë të rinjve pa marrë parasysh moshën.⁴⁶ Por, megjithatë për moshën në teori dhe në praktikë ka kufij të caktuar që në të vërtetë nuk dallojnë shumë nga vendi në vend apo nga shteti në shtet, siç do të shohim më poshtë. Nga të dhënat e kërkimeve kriminologjike dhe praktika gjyqësore, vërehet se delikuentët e mitur marrin pjesë dukshëm në kriminalitetin kundër pasurisë, në kriminalitetin kundër sigurisë në trafik, në kryerjen e krimeve në grupe dhe shoqata të organizuara kriminale, në aktivitetin rreth shpërndarjes dhe konsumimit të drogës, në veprime të tjera të dhunës, e sidomos në krime kundër jetës dhe trupit dhe në delikte seksuale.⁴⁷

Shkaqet e delikuencës së të miturve janë të ngjajshme me shkaqet e kriminalitetit të të rriturve, mirëpo në literaturë theksohen disa faktorë që deri diku janë më tipik për këtë moshë të delikuentëve. Kësisoj, posaçërisht si faktorë përmenden: ambienti familjar, edukata familjare, procesi i edukimit dhe arsimimit, ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv, sidomos ndikimi i shtypit revial, televizionit, filmit, literaturës, familjes, urbanizimit, migrimit.⁴⁸

TRENDI BASHKËKOHOR NË POLITIKAT E DREJTËSISË PËR TË MITUR

Në dekadat e fundit sistemi i drejtësisë për të mitur në Evropë ka kaluar nëpër ndryshime të konsiderueshme dhe kjo veçanërisht në shtetet e Evropës qën-

45 D. JOVAŠEVIĆ, Osnovne karakteristike novog maloletničkog krivičnog prava Republike Srbije, Zb. Prav. fak. Sveuč.Rij. (1991) v. 27, br. 2, 1055-1087 (2006)

46 Po aty

47 Halili Ragip, Kriminologjia, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000 fq.207

48 Për më tepër shih: Halili Ragip, Kriminologjia, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000 fq.209 dhe Juvenile Delinquency, Youth Report 2003, fq.193-196 (<http://www.un.org/esa/socdev/unyin/documents/ch07.pdf> qasur me 27.01.2018)

drore dhe lindore. Në këtë kontekst më shumë është vërejtur *një ekspansion i masave të diversitetit* kurse heqja nga liria është konsideruar si “zgjedhja e fundit”. Sa i përket dënimit me burgim për të mitur, në shumë shtete, dënimi me heqje të lirisë për të mitur zbatohet në institucione të veçanta dhe për ekzekutimin e tij vlejné disa rregulla dhe parime të cilat janë në përputhje me nevojën e një tretmani dhe terapie ndëshkimore që u përgjigjet vetive të këtyre personave të rinj. Kësisoj, ekziston një bindje e përgjithshme se tretmani ndaj personave të dënuar me burg për të mitur, duhet të jetë më pak i ngarkuar me masa represive dhe shtrënguese, e më tepër me masa të përmirësimit, riedukimit, angazhimit në mësim, punë dhe aktivitete të lira kulturore – zbavitëse e sportive.⁴⁹

Me përjashtim të disa krimeve të rënda, shumica e kryesve të rinjnë Evropë është trajtuar jashtë gjykatave me mjete të masave joformale të diversitetit: p.sh. në Belgjikë 80%, Gjermani rreth 70%⁵⁰. Në disa shtete, si në Kroaci, Francë, Holandë, Serbi dhe Slloveni kjo është konsekuencë direkte e parimit gjatë të njohur të të dhënurit prokurorëve dhe madje edhe policisë një shkallë diskrecioni i ashtuquajtur i parimi i dobishmërisë. Përjashtimet ku një diskrecion i tillë nuk lejohet mund të gjindet në disa vende të Evropës Lindore dhe Qëndrore, por në këto rastet duhet vënë re se, për shembull, krimet kundër pronës të cilat shkaktojnë vetëm dëme të vogla nuk janë gjithmonë të trajtuara si vepra penale statutoe. Italia si një shembull tjetër jep një falje gjyqësore cili është i ngajshëm me përjashtimet diversive nga dënimi, por që jepet nga gjyqtari i gjykatës për të mitur. Kështu, ekziston një formë e gjerë e mosintervenimit apo imponimit të sanksioneve minore (formale apo joformale).⁵¹ E gjykatat për të mitur janë dukshëm zhvillime të shekullit XX. Gjatë shekullit XIX fëmijët e akuzuar për krime janë ndjekur penalisht në gjykata për persona madhor dhe janë dënuar me burg me madhorët. Ndryshimet e mëdha ekonomike dhe ndryshimet shoqërore me revolucionin industrial nxitën megjithatë, një rimendim për vendin e të rinjve në shoqëri. Rezultati ishte krijimi i gjykatave të specializuara që do të merren me fëmijë. Mandati historik i gjykatave për të mitur ishte të shpëtojë fëmijët nga jeta kriminale duke u dhënë kujdes mbrojtjeje, të cilën dikur ua jepnin prindërit

49 Halili Ragip, Penologjia, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000, fq.197
50 http://www.ojj.org/sites/default/files/comparative_report_alternatives_to_custody_for_young_offenders.pdf
51 FRIEDER DÜNKEL, Juvenile Justice Systems in Europe – Reform developments between justice, welfare and ‘neë punitiveness’



natyral.⁵²

Praktika të mira evropiane në fushën e drejtësisë për të mitur i takojnë tri fushave kryesore: preventiva, trajtimi edukativ në komunitete lokale apo në qendra dhe integrimi socio-profesional⁵³, kurse për zhvillimin e mëtejshëm të drejtës penale për të mitur, e rëndësishme së veçantë është Rezoluta XVII e Kongresit të shoqatës ndërkombëtare për të drejtën penale që është mbajtur në Pekin në vitin 2004, ku janë aprovuar sugjerime të rëndësishme.⁵⁴

REFORMAT

Që herët në të nëntëdhjetat kemi pasur një lëvizje dinamike për reformë në ligje dhe në praktikë. Kjo është thjeshtëzuar jo vetëm në projekte të shumta por gjithashtu edhe në emërimin e komisioneve për reformë në legjislacion dhe në shumë raste në aprovimin e ligjeve siç është shembulli i Estonisë, Lituaniës, Serbisë, Sllovenisë dhe Republikës Çeke. Në shtetet baltike nuk kemi akoma gjykatat të pavarura për të mitur.

Me qëllim që të frenoj recidivistët dhe në veçanti kryerësit të rinj, disa nga këto ligjet e reja, jo vetëm që përfshijnë sanksionet të reja të komunitetit dhe mundësi për diversifikim, por gjithashtu mbajnë dënime të ashpra. Mungesa e infrastrukturës adekuate dhe pranimi i gjërësishëm i sanksioneve komunitare akoma rezulton me dënime frekvente me burgim. Megjithatë, zhvillimet në Rusi p.sh. tregojnë se kthimi tek modele të kaluara të sanksioneve, ku afërsisht 50% i të gjithë kryerësve ish-in dënuar me burgim nuk është paraqitur. Në vend të kësaj, forma të probacionit (probation) janë tani kuantitativisht më të zakonshme dhe më shumë të përdorura se sa dënimet me burgim.⁵⁵ Sidoqoftë ka një shkallë të pranuar të konvergencës mes sistemeve në Evropën Perëndimore, Qëndrore dhe Lindore.

52 Neubauer W. David, *Debating Crime Rhetoric and Reality*, University of New Orleans-wadsworth Thomson Learning, fq.176

53 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52006IE0414> (qasur me 27.01.2018)

54 XVIII INTERNATIONAL CONGRESS OF PENAL LAW (BEIJING, 12 - 19 SEPTEMBER 2004 - <http://www.penal.org/sites/default/files/files/RICPL.pdf> (qasur me 27.01.2018)

55 FRIEDER DÜNKEL, *Juvenile Justice Systems in Europe – Reform developments between justice, welfare and 'new punitiveness'*

Mosha e përgjegjësisë penale në vende të ndryshme

Vendi-shteti	Mosha minimale për masa edukative nga familja/gjykata për të mitur (ligji i mirëqenies për të mitur)	Mosha për përgjegjësi penale (ligji penal për të mitur)	Përgjegjësia e plotë penale (ligji penal për të rritur mund/duhet të zbatohet; ligji për të mitur dhe sanksionet për të mitur mund të zbatohen)	Rradha e moshës për burgim të të rinjve/ kujdestari apo forma të ngjajshme të privimit të lirisë
1	2	3	4	5
Austria		14	18/21	14/27
Belgjika		18	16b/18	Vetëm institucione të mirëqenies
Bjelorusia		14c/16	14/16	14/21
Bulgaria		14	18	14-21
Kroacia		14/16b	18/21	14/21
Qipro		14	16/18/21	14/21
Republika Çeke		15	18/18+(denime te zbutura)	15/19
Danimarka	d10	15	15/18/21	15/23
Anglia/Wales		10/12/15a	18	10/15-21
Estonia		14	18	14-21
Finlanda		15	15/18	15-21
Franca	10	13	18	13-18+6m/23
Gjermania		14	18/21	14-24
Greqia	8	15	18/21	15-21/25
Hungaria		14	18	14-24
Irlanda		10/12/16a	18	10/12/16 18-21
Italia		14	18/21	14-21
Kosova		14	18/21	16-23
Latvia		14	18	14-21
Lituania		14c/16	18/21	14-21
Maqedonia		14c/16	14/16	14-21
Moldavia		14c/16	14/16	14-21
Mali i Zi		14/16a	18/21	16-23
Holanda		12	16/18/21	12-21
Irlanda Veriore		10	17/18/21	10-16/17-21



Norvegjia d		15	18	15-21
Polonia	13		15/17/18	13-18/15-21
Portugalia	12		15/21	12/16-21
Rumania		14/16	18/(20)	14-21
Rusia		14c/16	18/21	14-21
Skotlanda	8e	12e/16	18/21	16-21
Serbia		14/16a	18/21	14-23
Sllovakia		14/15	18/21	14-18
Sllovenia		14/16a	18/21	14-23
Spanja		14	18	14-21
Suedia		15	15/18/21	15-21g
Zvicrra		10/15a	18f	10/15-22
Turqia		12	15/18	12-18/21
Ukraina		14c/16	18	14-22

10. Në Danimarkë moshë është ulur në 14 vjeç në vitin 2010. Më pastaj, megjithatë, qeveria e re e zgjedhur në Danimarkë ka rikthyer konsensusin dhe ka ngritur moshën e përgjegjësisë penale në 15 vjeç.

- a. Përgjegjësia penale që rezulton me ndalimin e të miturve (burgosje e të miturit apo sanksione kujdestarie të njehta nën regjimin e Ministrisë së Drejtësisë).
- b. Vetëm shkeljet/veprat në komunikacion dhe përjashtimisht për shkelje/vepra shumë serioze.
- c. Vetëm shkelje/vepra serioze.
- d. Vetëm zbutjen e dënimit pa legjislacion të ndarë të drejtësisë për të mitur.
- e. Moshë për ndjekje penale është 12 vjeç por për fëmijët nga 8 deri në moshën 16 aplikohet sistemi i dëgjimit, kështu duke parandaluar procedurat më shumë formale kriminale.
- f. Neni 61 i Kodit Zvicerran për të rritur jep një formë të mbajtjes së veçantë, një dënim me burg për persona 18-25 vjeçar të cilët janë të vendosur në institucion të ndarë për madhorët e mitur, ku ata mund të qën-

drojnë deri sa të arrin moshën 30 vjeçare.

- g. Kujdestari për të mitur. Ka gjithashtu departamente të veçanta për kryerësit e mitur/të rinj në sistemin e përgjithshëm të burgjeve (për madhorët e rinj deri në moshën 25 vjeçare).⁵⁶

E drejta penale për të mitur në Kosovë

Kodi i Drejtësisë për të Mitur rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur.⁵⁷Qëllimi i drejtësisë për të mitur përcaktohet i atillëqë të sigurojë mirëqenien e të miturve dhe që masat dhe dënimet e shqiptuara ndaj të miturve të jenë në proporcion me nevojat për largimin nga rruga e kriminalitetit dhe edukimi i tyre.⁵⁸Përkufizimet e mëposhtme, japin në mënyrë të mjaftueshme orientime për analizë, se çka në të vërtetë rregullohet me këtë kod. Këto janë:Fëmijë; I mitur; I mitur i ri; I mitur i rritur; Madhor i ri; I ri; Madhor;Edukim i specializuar;Burgim për të mitur; Objekt për kujdes të posaçëm; Organ i kujdestarisë; Gjyqtar për të mitur; Prokuror për të mitur; Trup gjykues për të mitur; Shërbim sprovues.⁵⁹

Sistemi i drejtësisë për të mitur “synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.”⁶⁰Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës, në parimet udhëzuese, tregon se rëndësi dhe prioritet i jepet masave të diversitetit dhe masave edukative, sipas nevojës, kurse privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës se privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.⁶¹Më tutje, në këtë kod janë specifikuar masat dhe dënimet e zbatueshme, ndaj të miturve.⁶²

56 Tabela bashkë me shpjegimet lidhur me te është marrë nga punimi i FRIEDER DÜNKEL, *Juvenile Justice Systems in Europe – Reform developments between justice, welfare and ‘new punitiveness’*

57 Neni 1 i Kodit i Drejtësisë për të Mitur,Nr.03/L-193.

58 Doracak për përgatitje e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë Kosovë/UNDP Kosovë, botimi i tretë, 2009, fq.157

59 Neni 2 i Kodit, Kodi i Drejtësisë për të Mitur,Nr.03/L-193

60 Neni 3, paragrafi 1 i Kodit, Kodi i Drejtësisë për të Mitur,Nr.03/L-193

61 Paragrafi3, neni 3, Kodi i Drejtësisë për të Mitur,Nr.03/L-193

62 Neni 7, Kodi i Drejtësisë për të Mitur,Nr.03/L-193

Masat e diversitetit kanë për qëllim ta eliminojnë mundësinë e rikryerjes së veprës penale nga ana e të miturit me anë të ndihmës për rehabilitimin e tij dhe riintegrimin e tij në bashkësinë ku ai jeton dhe vepron.⁶³ Kur gjykata merr ose shqipton ndonjë masë apo dënim, ajo gjithnjë merr parasysh interesin e të miturit. Kështu gjykata merr parasysh edhe rrethanat si lloji dhe vepra penale, mosha e të miturit, niveli i zhvillimit psikologjik, karakterin dhe prirjet e të miturit, motivet që e kanë nxitur që të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës, pastaj gjithashtu merr parasysh nëse është shqiptuar masë apo dënim më heret dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.⁶⁴

Nga neni 8 e deri në nenin 13, Kodi ka rregulluar çështje si vijon: zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme, shqiptimi i masave ndaj madhorit të ri për veprë penale të kryer si i mitur nën moshën 16 vjet, shqiptimi i masave dhe i dënimeve ndaj madhorit për vepra penale të kryera si i mitur i cili ka mbushur moshën 16 vjet, shqiptimi i masave ose i dënimeve ndaj madhorit të ri për veprë penale të kryer si madhor i ri, efekti i dënimit në masën edukative, evidenca e masave dhe e dënimeve.

Prokurori, gjyqtari për të mitur apo kolegji për të mitur mund të propozoj ndërmjetësimin nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme duke pas parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe re-integrimi i tij në shoqëri.⁶⁵

PËRFUNDIMET

Përgjithësisht trendi i sistemeve të drejtësisë për të mitur, kudo në Evropë por edhe në Kosovë ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve dhe të të miturve. Përafërsisht zgjidhjet për të gjitha elementet e drejtësisë për të mitur janë të njejta, sikundër edhe përkufizimet lidhur me atë që konsiderohet fëmijë, person i mitur, madhor i mitur, etj. Parimisht më shumë i është kushtuar rëndësi ma-

63 Komentar për ligjin penal për të mitur, juristi.info, fq.2

64 Më gjërësisht shih nenin 8, Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193

65 Më gjërësisht neni 14 dhe shih dipozitat e Ligjit Ligji Nr.03/L-057 për Ndërmjetësim i Republikës së Kosovës

save diversive krahasuar me dënimet, sidomos krahasuar me dënimet me burg për të miturit. Në disa vende ka pasur një traditë të organizimit komunitar e në disa vende kanë ekzistuar edhe punëtorës social që janë marrë me çështjen e drejtësisë për të mitur. Kategorizimi sipas moshës lidhur me përgjegjësinë e të miturve dhe të madhorëve të mitur nuk dallojnë shumë nga një vend në tjetrin. Dallimet më shumë vërehen në aspekt të institucioneve që merren me të drejtën procedurale penale.

Legjislacioni i Kosovës, vitet e fundit ka rrumbullakësuar një punë të rëndësishme duke mbuluar me ligje të gjithë atë që i takon drejtësisë për të mitur, në aspektin material dhe në aspektin procesual. Masat dhe dënimet e parapara janë të një fryme moderne për të vënë në pah interesin e të miturve. Edhe pse legjislacioni është plotësuar, edhe pse edhe institucionet jo vetëm gjyqësore veprojnë në fushën e drejtësisë për të mitur, megjithatë është herët të nxjerret ndonjë përfundim lidhur me efektivitetin qoftë parandalues por edhe me efektivitetin e masave dhe/apo edhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve. Tashmë është koha për një analizë të efekteve të infrastrukturës legale të kësaj fushe, dhe kjo analizë do duhej bërë nga të dyja: hulumtimet nga bota akademike por edhe nga ata që janë direkt të angazhuar në fushën e drejtësisë për të mitur. Vetëm pas një analize të tillë, mund të matet efektiviteti i tërë infrastrukturës dhe mund të nxjerren rekomandime nëse ka nevojë dhe në ç'masë të bëhen ndryshime në sistemin ekzistues.

BIBLIOGRAFIA

- Alternatives To Custody For Young Offenders And The Influence Of Foster Care In European Juvenile Justice, (http://www.oiji.org/sites/default/files/comparative_report_alternatives_to_custody_for_young_offenders.pdf) - European Project 'Alternatives to Custody for Young Offenders - Developing Intensive and Remand Fostering Programmes'
- Alternatives to custody for young offenders, And The Influence Of Foster Care In European Juvenile Justice.
- Doracak për përgatitje e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë Kosovë/UNDP Kosovë, botimi i tretë, 2009

- FRIEDER DÜNKEL, Juvenile Justice Systems in Europe – Reform developments between justice, welfare and ‘neë punitiveness’
- Halili Ragip, Kriminologjia, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000
- Halili Ragip, Penologjia, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000
- HISTORY AND DEVELOPMENT OF THE JUVENILE COURT AND JUSTICE PROCESS, https://uk.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/19434_Section_I.pdf
http://www.oijj.org/sites/default/files/comparative_report_alternatives_to_custody_for_young_offenders.pdf
- Juvenile Delinquency, Youth Report 2003 - <http://www.un.org/esa/socdev/unyin/documents/ch07.pdf>
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KODI NR. 04/L-082
- Komentar për ligjin penal për të mitur, Juristi.info
- Ligji Nr.03/L-057 për Ndërmjetësim i Republikës së Kosovës
- Neubauer W.David, Debating Crime Rhetoric and Reality, University of New Orleans-Wadsworth Thomson Learning
- XVIII INTERNATIONAL CONGRESS OF PENAL LAW (BEIJING, 12 - 19 SEPTEMBER 2004 - <http://www.penal.org/sites/default/files/files/RICPL.pdf>
- Zakon o maloletnim učiniocima krivičnih dela i krivičnopravnoj zaštiti maloletnih lica (“Sl. glasnik RS”, br. 85/2005)

TË MITURIT DHE SISTEMI PENAL - NDËRLIDHJA MIDIS INTELIGJENCËS EMOTIVE DHE SJELLJEVE KRIMINALE

**Ph.D. Attorney at Law Enida Bozheku
(Ph.D. Cand.)**

enidabozheku@yahoo.it

ABSTRACT

Children are among the most vulnerable members of society. The law of the state protects children until they are deemed to be able to interact in society as adults. For this reason children are treated differently from adults by the criminal justice system. The law which deals with children is a breach of the criminal law and it is contained in the Criminal Children Code amended by the law n° 37/2017. In criminal justice knowing the meaning of the word “child” is very important, because it will produce its effects to the age of criminal responsibility that will be applied to the child response. So, child means a person below the age of 18 which has criminal responsibility from age 14 to age 18. The Criminal Children Code also contains in specific articles the rules for young people between the ages of 18 and 21. The aim of this new form of regulation is to guarantee a legal framework that punishes the criminal offenses committed by children but, at the same time, protects their rights, when they are victims of criminal offense. In this area, particular attention is paid to the children emotional intelligence, on the basis of which, the court will have to assess the correctness of punishment that must be applied to them. In this sorting of the child criminal behavior very important is to know that emotional intelligence (EI) is the capacity to understand and manage emotion. The Psychotherapists Mayer and Salovey, the who originally used the term, defined EI: “*The ability to perceive emotion, integrate emotion to facilitate thought, understand emotions, and to regulate emotions to promote personal growth*”. According to this definition, judges, prosecutors and all members that have to deal with children in the criminal justice are obligated to follow specific specialisations that will help them to understand better the reasons, the behavior, the rehabilitation and



the risocialisation process applied to children that have committed a criminal offenses. In such meaning emotional intelligence is deeply related to aggression and offending.

Key words: Criminal behavior, emotional intelligence, specialisations, criminal responsibility

HYRJE

Në datë 20.03.2017, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoj Ligjin nr. 37/2017, në fushën e së Drejtës Penale Minorile, duke e titulluar “*Kodi i drejtësisë penale për të mitur*”. Miratimi i këtij kodi, ligji organik, është për Shqipërinë një risi dhe vullnet institucional i pa precedent, i cili ka për bazë mbrojtjen dhe garantimin e një procesi të drejtë në fushën penale minorile. Kodi penal minoril lind si nevojë e Shtetit për të ndihmuar dhe zhvilluar garancit bazë për të miturit që kryejnë vepra penale dhe për t’i dhënë atyre mundësinë e rehabilitimit dhe rihyrjes në shoqëri me qëllim rekuperimin e tyre. Të miturit, ndryshe nga të rriturit, për karakteristikat psiko-sociale që paraqesin janë më të presispozuar të ndryshojnë për mirë dhe të mund të rilidhin marrëdhëniet e tyre me shoqërinë nëse ndihomohen dhe ndaj tyre përdoren programe rekuperimi pozitivë dhe me efekte të tilla që parandalojnë përsëritjen e kryerjes së veprave penale. Ndërhyrja legjislative në këtë fushë, duke rregulluar aspektet procedurale të aplikueshme ndaj të miturve - si kusht për t’u adaptuar me sa parashikuar nga Bashkimi European dhe në respektim të direktivës europiane BE n. 800/2016 miratuar më datë 11 maj 2016 nga Parlamenti European - ofron një sinjal të fortë të vullnetit shtetëror për të garantuar të drejtat e një pjese të shoqërisë që shpeshherë lihet e abandonuar ndaj vetvetes dhe që nesër prodhojnë efekte sociale, të cilat mund të jenë të dëmshme për zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe paqësore. Shqipëria, si vënd që synon antarësimin në Bashkimin European dhe si ratifikuese e shumë konventave dhe marrëveshjeve Ndërkombëtare⁶⁶ që kanë për synim mbrojtjen e të drejtave të të miturve, me përgjigjen ligjore të krijimit të kuadrit normativ *ad hoc* për garantimin e një procesi të rregullt dhe garantist në përputhje me egzigjencat e të miturve, duket të tregojë një pjekuri institucionale legjitime dhe konform kërkesave bashkëkohore.

“KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR” - GJEOGRAFIA NORMATIVE

Kodi penal i të miturve përbëhet nga XVI kreh dhe 143 nene, në të cilët janë parashikuar të gjitha hetapat zhvëllimore të procesit penal minoril, garancitë e aplikueshme ndaj të miturve, viktimave, rekuperimi dhe rehabilitimi social i tyre, llojet e denimeve, ndihma psiko-sociale, sistrumente absolutisht të domosdoshëm për rifutjen në shoqëri të të miturve. Njohja dhe atashimi i strukturave të specializuara në fushën minorile pranë Gjykatave të Rrethit, specializmi i stafit gjyqësorë, qoftë ai hetues, si prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore ashtu dhe bashkëpunimi i ngushtë midis strukturave të drejtësisë minorile me staf mjekësorë dhe psikolog të formuar dhe trajnuar në fushën e psiko-patologjisë të të miturve që kryejnë vepra penale, është një vlerë e shtuar për kujdesin ndaj të miturve panvarsisht statusit të tyre në kuadrin penal. Kodi penal minoril hapet, me nenin 1, i quajtur “objekti”, ku përfshihet tërësia e rregullimeve tipike të kodit procedurial penal. Risi e kodit, në pikën 2 të nenit 1 është shtrirja e efekteve të tij edhe për grup – moshat nga 18 deri 21 vjeç ashtu siç parashikohet në nenin 4⁶⁷, pika 2 të tij Kodi, në nenin 7 të tij, përcakton moshën e subjekteve ndaj të cilëve gjen aplikueshmëri përgjegjësia penale, ku për krime ajo është 14 vjeç dhe për kundravajtje penale 16 vjeç; sa kaq dhe në përputhje dhe harmonizim interpretues të sa parashikuar në nenin 12 të kodit penal. Në Kod, në nenin 10, merr rëndësi specifike njohja e principit të: *“interesit më të lartë të fëmijës”*, ku shprehimisht në zbatim të këtij kodi merren parasysh: nevojat e fëmijës për zhvillim fizik dhe psikologjik, edukim, qëndrueshmëria emotive, rrijtja dhe përkatësia familjare; mendimi i fëmijës nisur nga zhvillimi i tij psiko-social, historia personale e tij, abuzimet e pësuar, shfrytëzimi apo forma të tjera dhune të ushtruara nga ai dhe ndaj tij; kujdesi prindëror dhe aftësia e tyre për t’i qëndruar afër dhe ndihmuar në rekuperim të të miturit; zhvillimi i raporteve sociale në një kontekst emocionalisht të sigurtë dhe edukativ. Tjetër element garantist i këtij Kodi është se, i mituri, ka të drejtë të përfaqësohet nga një mbrojtës gjatë gjithë fazave procedimentale; ai gëzon të drejtën të ketë pranë subjektet që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore ndaj tij ose në mungesë të tyre të një kujdestari të caktuar nga gjykata. Një formë tjetër për aplikimin proporcional të ligjit penal, karshi të miturit është hartimi i “raport vlersimit individual”, i gër-

67 Shih neni 4, pika 2 K.D.M.



shetuar me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 13 të Kodit⁶⁸ me nenin 47 të po këtij Kodi, ku del qartë vullneti i legjislatorit për t'i dhënë garanci dhe përparësi figurës së të miturit me qëllim mos “humbjen” e tij në strukturat penale por mundësinë për ti dhënë atij një chance të dytë për tu bërë nesër një qytetar i përgjegjshëm. Strumenti i vlersimit psiko-atitudinal, i përcaktuar në nenin 47⁶⁹ të Kodit minoril në bashkërendim me nenin 13 të po këtij Kodi, ka një vlerë të shtuar për dhënien drejtësi, pasi prokurori dhe trupi gjykues në bazë të karakteristikave përcaktuese të personalitetit të të miturit do të mund edhe të vendosin mbi cilat do të jenë masat e caktimit të dënimit apo të shmangies. Ky nen i jep përparësindërveprimi institucional kompetent për të dhënë një përjasje sa më reale të atij që është profili zhvëllimor – kriminal i të miturit, i cili ka përbazë atë të dhënies së mendimit mbi cilat janë potencialet zhvëllimore dhe aftësia reintegruese e të miturit në shoqëri duke e koordinuar atë me aplikimin ose jo të masave alternative, siç është ajo e shmangies; përcaktimin e llojit të dënimit më të përshtatshëm për të miturin; ekzekutimi i dënimit – në rastet kur dënimi jepet për subjekt të cilat hynë në grup – moshën 18 deri 21 vjeç dhe e kanë kryer veprën penale para mbriritjes së moshës madhore; shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht kur rezultojn të jetë arritur rezultati i reintegrimit dhe rehabilitimit social. Duke ju rikthyer shmangies, parashikuar në nenin 55 Kodi Minoril, terminologjia e përdorur për të, në ndryshim nga ajo kanoniste e njohur në procedurën penale ku flitet “për pushimin e akuzës”, është specifike për mos ushtrimin e ndjekjes penale nga ana e prokurorit në një procedim penal të ngritur ndaj një të mituri. **Shmangia**, sipas nenit 58⁷⁰ pika 1 ka si qëllim, mos mosfillimin e procedimit penal, nëse procedimi penal nuk ka filluar, dhe pushimin e tij nëse procedimi penal ka filluar. Shmangia që të jepet nga prokurori duhet t'i nënshtrohet disa kriterëve, të cilat janë të detyrueshme të aplikohen nga i mituri me qëllim realizimin e objektivit të shmangies. Kështu neni 61⁷¹, pika 1 parashikon detyrimet që i mituri duhet të plotësojë për të përfituar shmangien e ndjekjes penale apo pezullimin e gjykimit në rastet kur procesi ka filluar – në këtë rast është gjykata e cila vendos, me kërkesë të prokurorit, të aplikoj institutin e shmangies deri para se të jetë dhënë vendimi përfundimtar (neni 57, pika 3). Me përmbushjen e këtyre detyrimeve ndaj të miturit pushohet

68 Shih neni 13 K.D.M.

69 Shih nenin 47 K.D.M. - Raport vlersimi

70 Shih neni 58, pika e K.D.M.

71 Shih nenin 61 e vazhdim K.D.M.

procedimi penal i hapur ndaj tij ose jepet vendim për pushim të çështjes nga ana e gjykatës. Përveç detyrimeve të përshkruara më lartë, shmangia mund të arrihet edhe me anë të disa mjeteve të tjera alternative, të përcaktuara në mënyrë taksative nga Kodi Minoril, egzakhtësisht në nenin 62⁷², pika 1. Element tjetër risie dhe që karakterizon frymën pozitiviste të Kodit minoril është edhe limiti brënda të cilit duhet aplikuar masa e heqjes së lirisë së të miturit në rast të kryerjes së një krimi. Neni 15⁷³ i Kodit flet për heqjen e lirisë si masë të fundit dhe ekstreme që mund të aplikohet ndaj të miturit. Parashikimi i dhënë në këtë nen e faktit se masa e arrestit me burg, në kushtet e flagrancës apo si masë ndëshkimore, si pasoj e caktimit të dënimit duhet të bëhet ekskluzivisht kur çdo formë tjetër e kufizimit të lirisë është e pamundur. Edhe në rastet kur kjo masë ndëshkimore ndërmurore aplikohet, ajo duhet të jetë objekt rishikimi dhe rivlersimi nga gjykata në çdo kohë me qëllim rekuperimin dhe rifutjen në shoqëri sa më shpejtë të të miturit të rehabilituar. Në bashkëpunim me pikat 2 dhe 3, të nenit 15 është neni 82 i Kodit minoril, i cili parashikon, përveç masave të sigurimit të parashikuara në nenin 230 e vazhdim të Kodit të Procedurës Penale, për sa të aplikueshëm, edhe dy masa alternative specifike për të ruajtur integritetin psiko-social të të miturve⁷⁴. Këto masa alternative aplikohen në rastet kur ndaj të miturit është e nevojshme caktimi i një mase sigurie, në përputhje me kriteret e parashikuara nga kombinimi i neneve 228 dhe 229 i K.Pr.P. me nenin 81⁷⁵ Kod. Minoril. Në rastin kur i mituri dënohet në kuptim të nenit 92⁷⁶, Kodi Minoril parashikon një sërë mekanizmash, të cilat kanë për qëllim rishoqërimin, reintegrimin, rehabilitimin dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale apo një veprë penale tjetër duke i ofruar të miturit asistencë, kujdes dhe mbikëqyrje. Tendenca e legjislatorit është ajo e ruajtjes së integritetit psiko-emotiv të të miturit, kalibrimin proporcional të nivelit të ndëshkueshmërisë karshi tij dhe veprës penale të kryer nga ai dhe reintegrimin e të miturit sa më shpejtë dhe me sa më pak pasoja në shoqëri. Risi e kodit janë dhe ambjentet në të cilët të miturit qoftë kur aplikohet masa e sigurisë arrest me burg qoftë kur dënohen me vuajtjen e dënimit me burg, t'i vendosin të miturit pranë strukturave të specializuara dhe të përshtatshme për to, ashtu sic parashikohet në neni 110⁷⁷ të Kodit Minoril.

72 Shih nenin 62, pika 1 i K.D.M. – Masat Alternative

73 Shih nen 15 K.D.M.

74 Shih në nen:a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje dhe b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar

75 Shih nen 81 K.D.M.

76 Shih nenin 95, pika 2 K.D.M.

77 Shih nen 110 K.D.M – Masat e Sigurisë

Neni në fjalë kujdeset posaçërisht që stafi i personalit që do të mbikqyrë dhe do të punojë me të miturit me qëllim rehabilitimin e tyre social të jetë sa më i specializuar dhe trajnuar për nevojat individuale dhe për t'i ofruar të miturve asistencë, kujdes dhe ndihmë mbështetëse psikologjike. Kështu, të miturit (neni 113 Kod Minoril) trajtohen me një kujdes të veçantë nga Shteti duke i vendosur ato në struktura të veçuara nga ato të të parburgosurve apo të dënuarve të rritur.

INTELIGJENCA EMOTIVE DHE SJELLJET KRIMINALE

Inteligjenca emotive është aftësia për të kuptuar dhe menaxhuar emocionet. Autorët e parë që do të jepnin përcaktimin terminologjik të kësaj forme të të menduari do të ishin Mayer dhe Salovey⁷⁸ të cilët e përcaktojnë IE si: “*aftësia për të perceptuar emocionet, integruar ato në mënyrën e të menduarit, kuptimi i emocioneve dhe rregullimi i tyre për të promovuar një personalitet të pjekur dhe të arrirë*”. Sipas këtyre autorëve ka dy zona në të cilën IE zhvillohet: **eksperienca** (aftësia për të përpunuar informacionin emocional që vjen nga jashtë dhe kuptueshmërin e tyre) dhe **strategjia** (aftësia për të menaxhuar emocionet pa patur nevojë që ato të përjetohen në vet të parë). Ndërtimi i personalitetit i bazuar mbi inteligjencën emotive⁷⁹ është i rëndësishëm për mënyrën se si do të përballohet individi me marrdhëniet shoqërore dhe se si ai do ta ndërlihdë atë me inteligjencën konjitive. Njeriu për nga natyra – thotë Gardner⁸⁰ - është i ndërtuar mbi bazën e shumëlloj inteligjencave, si inteligjenca praktike, raportet nderpersonale me të tjerët dhe jashtëpersonale me botën në tërësi. Inteligjenca emotive është thellësisht e lidhur me agresivitetin dhe shkallën e viktimizimit⁸¹. Statistikat tregojnë që njerëzit me nivel të lartë të inteligjencës emotive janë më të moderuar në qasjen ndaj marrdhënieve socio-familjare dhe më pak impulsiv, në të kundërt individët me nivel të ulët të IE janë më të dhënë të kenë sjellje agresive deri në patologji. Këta individ me IE të ulët kanë një kohë të përpunimit të informacionit që vjen nga jashtë më të ngadaltë dhe kanë vështirësi për

78 Mayer JD, Salovey P. *What is emotional intelligence? In: Salovey P, Sluyter D, editors. Emotional Development and Emotional Intelligence: Implications for Educators.* New York: Basic Books; 1997. fq. 3–31

79 Schulze R, Roberts RD, Zeidner M, Matthews G., *Theory, measurement, and applications of emotional intelligence: Frames of reference.* In: Schulze R, Roberts RD, editors. *Emotional Intelligence: An International Handbook.* Cambridge, MA: Hogrefe and Huber Publishers; 2005, fq. 3–30

80 Ciarrochi J, Godsell C. *Mindfulness-based emotional intelligence: A theory and review of the literature.* In: Schulze R, Roberts RD, editors. *Emotional Intelligence: An International Handbook.* Cambridge, MA: Hogrefe and Huber Publishers; 2005, fq. 69–90

81 Hayes JM, O'Reilly G. *Psychiatric disorder, IQ, and emotional intelligence among adolescent detainees: A comparative study.* Leg Criminol Psychol. 2013, fq. 30–47

të kuptuar nivelin emocional të personave që i rrethojnë apo raportohen me to, si pasoj këta subjekte janë më pak empatik. Këta individë, gjithashtu, ndryshe nga ata me IE të lartë⁸², janë të rrëmujtë, agresiv, dhe me tendenca më të spikatura kriminale⁸³. Individët që paraqesin IE të ulët kanë tendencën, po ashtu, të jenë të inatosur, me tendenca seksuale të dhunshme dhe me dëshira realizmi egosit⁸⁴, të cilët çojnë në kryerje të veprave penale si vjedhje, abuzime seksuale, vrasje. Nga studime të kryera në rang botërorrezulton se individët me IE të ulët, si pasoj e deficiencs funksionale empatike me të tjerët, zhvillojnë më shpejtë dhe me doza të larta dhune, krime⁸⁵ nga më të ndryshmit.

INTELIGJENCA EMOTIVE TEK TË MITURIT - ZHVILLIMI EMOTIV NË BËRTHAMËN FAMILJARE

Faktor përcaktues që tregon nivelin e ulët apo të lartë të inteligjencës emotive është konteksti familjarë në të cilën rriten të miturit. Në këtë prizëm tendenca është ajo e vlersimit paraprak të fëmijërisë së hershme të fëmijëve për të analizuar më pas arsyet se pse ata do të shndërrohen nesër në subjekte – objekte të aplikuehsmërisë së ligjit penal. Kështu, studimet tregojnë se fëmijët të cilë keqtrajtohen në moshe të njomë nga 6 muaj deri në 4 vjeç prej familjarëve të ngushtë (prindër kryesisht), me kalimin e moshës do të fillojnë të trajtojnë dhe ata të tjerët me mospërfillje dhe me forma të ngjashme me ato me të cilat ata vet janë trajtuar.

Keqtrajtimi tek kjo grup – moshë, e cila më pas do të shfaq edhe tendenca kriminale, jo domosdoshmërisht qëndron në dhunë fizike, mandje, ajo shpeshherë, manifestohet nga ana e prindërve⁸⁶ me dhune verbale si p.sh. kritika dekostruktive të vazhdueshme, tone zëri të larta kërcënuese dhe të ashpra, aplikim masash ndëshkuese të dhunshme dhe ndrydhëse. Në këtë kuptim, të miturit që pësojnë këto lloj keqtrajtimesh do të zhvillojnë pasivisht emocione negativiste, ku më e shprehur do të jetë ajo e indiferencës ndaj ambientit të shokëve

- 82 Pizarro DA, Salovey P., *On being and becoming a good person: The role of emotional intelligence in moral development and behavior*. In: Aronson J, editor. *Improving Academic Achievement: Impact of Psychological Factors on Education*. San Diego: Academic Press; 2002, fq. 247
- 83 Strüber D, Lück M, Roth G. *Sex, aggression and impulse control: An integrative account*. *Neurocase*. 2008, fq 95 - 121.
- 84 Kirsch LG, Becker JV. *Emotional deficits in psychopathy and sexual sadism: implications for violent and sadistic behavior*. *Clin Psychol Rev*. 2007
- 85 Qualter P, Ireland J, Gardner K., *Exploratory and confirmatory factor analysis of the schutte self-report emotional intelligence scale (SSREI) in a sample of male offenders*. *Br J Forensic Pract*. 2010, fq. 43–51.
- 86 Emery R., *Family Violence*, American Psychologist, shkurt, 1989



dhe shoqeve të kopshtit apo klasës, dhe ashpërsim të toneve të tyre të zërit për të arritur deri në dhunë fizike kur shohin fëmijë të tjerë si ata, të cilët qajnë apo ankohen për dicka në ambjentin social ku ndërveprojnë. Me procesin e rritjes këta individ, probablisht, do të kenë më shumë vështirësi konjitive socializimi, do të jenë më të dhunshëm dhe do të manifestojnë tendenca kriminale parësore. Kjo lloj forme dhune manifestohet shpesh-herë si fenomen genetik i trasmetueshëm gjeneratë pas gjenerate, ku prindër të dhunshëm janë prodhim edhe ata i prindërve të tyre po ashtu të dhunshëm, duke bërë që zinxhiri i dhunës të shndërrohet në një kalim genetik brez pas brezi⁸⁷. Duke parë se si truri formohet dhe plazmohet në fëmijërin e hershme, dhuna ose dashuria që këtyre të miturve do t'i mësohet me anë të komunikimit dhe shëmbujve, do të shënoj jetën e tyre si në fazën para-adoleshencjale, adoleshencjale dhe më pas atë si të rritur, ku inteligjenca emotive e tyre do të jetë e devijuar në rastet e dhunës dhe e përforcuar në rastet e dashurisë. Pra, prindërit modifikojnë me anë të sjelljeve të tyre “tonin vagal⁸⁸” të fëmijëve të tyre, duke influencuar direkt në inteligjencën emotive të këtyre të fundit. Edhe pse truri i njeriut është si plastelina dhe modifikohet në çdo etapë të jetës, mësimet e para të sjelljes, agresivitetin, empatin, dashurinë, kurajon dhe impenjimin, lirinë e të menduarit dhe atë të të shprehurit, si funksione të inteligjencës emotive, i mëson prej prindërve. Këta instalojnë tek fëmija sjelljet tipike që do të formojnë inteligjencën emotive të tyre karshi fenomeneve pozitive dhe atyre negative që do të tregojnë në edukimin e fëmijës dhe në mënyrën se si do t'i mësojnë të raportohen me të tjerët në ambjentin social. Një fëmijë i keqtrajtuar, lënë të mbyllur me vetveten, i pa socializuar dhe verbalisht apo fizikisht i dhunuar ka tendenca më të larta që në shfaqet e para adoleshencjale të ketë tendenca kriminale dhe t'i materjalizojë ato me kryerjen e veprave penale⁸⁹.

LLOJI I VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA TË MITURIT DHE ÇRREGULLIMET E PERSONALITETIT

Në kuadrin e llojit të veprave penale të kryera nga të miturit, në anketimet e kryera pranë instituteve të burgimit minoril në rang europian, fenomeni që vërehet më shpesh është ai i kryerjes së krimeve si: vjedhje, përdorimi dhe

87 Widom C., Child Abuse, Neglect and Adult Behavior. American Journal of Orthopsychiatry, korrik, 1989

88 Gjëndje e eksituar e sistemit nervor parasimpatik

89 Deu N. *Executive function and criminal fantasy in the premeditation of criminal behaviour*. Crim Behav Ment Health. 1998, fq. 41-50.

shpërndarja e lëndëve narkotike, dëmtime të tjera me dashje (rrahja apo vepra të tjera dhune), plagosje e lehtë apo e rëndë me dashje, kanosja⁹⁰. Ekspertët e fushës psikiatrike në bashkëpunim me autoritet e drejtësisë kanë arritur në konkluzionin se fenomeni i kriminalitetit minoril shpesh-herë është i lidhur me çrregullime psikopatologjike⁹¹, kur rol të veçantë luan çrregullimi i personalitetit (ÇP). Studimet e kryera në këtë fushë kanë vënë re se në vëndet perëndimore (ÇP) prek nga 40 deri në 90% të rasteve⁹². Duke u nisur nga kampionet statistikore të mbledhura rezultojnë se krimi tek adoleshentët ka një lidhje dikotomike të fortë me nivelin e ulët të inteligjencës emotive, të cilat pasojnë në (ÇP) me karakter patologjik të theksuar. Elementi karakteristik i pikasur në subjektët minoril, të cilët kryejnë vepra penale lidhet ngushtë me psikopatin, e cila identifikohet si sëmundje mendore⁹³ me efekte kriminale. Shumë autorë theksojnë se duke nisur nga moshja 14 vjeç⁹⁴ është e mundur të kryhet një egzaminim efikas mbi çrregullimet e personalitetit me qëllim vëzhgimin e tendencave që këta subjekte do të zhvillojnë në të ardhmen në lidhje me fenomenet kriminale. Në fushën e studimeve të kriminaliteti minoril është vënë re se adoleshentët që vinë nga kontekste familjare të dhunshme⁹⁵ kanë një tendencë në rritje të ushtrimit të dhunës edhe ata dhe të mungesës së empatisë karshi të tjerëve duke zhvilluar kështu personalitete me tendenca psikopatike, tipike të çrregullimit të personalitetit. Analiza studimore e minorëve që ndodhen në ambjentet e burgjeve ka çuar në përfundimin se ka një frekuencë të lartë të aspekteve psikopatike dhe paranoiake⁹⁶ tek të miturit me tendenca kriminale, ku simptomat shfaqen në dy momente: atë të **inkubimit** të “agresivitetit, nervozizmit dhe dhunës impulsive” dhe hapi i dytë të **shpërthimit** të tyre. Të gjitha këto fenomene, përjashtojnë rastet ku dhuna është pjesë e genezës, janë prodhim i ambientit social ku të miturit

90 Shih nenet 83/a, 84, 89, 90, 91, 92 Kodi Penal

91 Grilo, C.M., McClashan, T.H., Morey, L.C., Gunderson, J.G., Skodol, A.E., Shea, et al. (2001). *Internal consistency, intercriteria overlap and diagnostic efficiency of criteria sets for DSM-IV schizotypal, borderline, avoidant and obsessive-compulsive personality disorders*. Acta Psychiatrica Scandinavica, 2001, fq. 72.

92 Hiscoke, U.L., Langstrom, N., Ottosson, H., & Grann, M. *Self-reported personality traits and disorders (DSM-IV) and risk of criminal recidivism: A prospective study*. Journal of Personality Disorders, 2003, n. 17, fq. 293-305.

93 Mullen, P.E. *Dangerous and severe personality disorder and in need of treatment*. British Journal of Psychiatry, 2007, maj, fq. 3-7.

94 Kasen, S., Cohen, P., Skodol, A.E., Johnson, J.G., & Brook, J.S. *Influence of child and adolescent psychiatric disorders on young adult personality disorder*. American Journal of Psychiatry, fq. 1529-1535.

95 Krischer, M.K., Sevecke, K., Lehmkuhl, G., & Pukrop, R. *Dimensional assessment of personality pathology in female and male juvenile delinquents*. Journal of Personality Disorder. 2007, n. 6, fq. 675-89.

96 Moffitt, T.E., Caspi, A., Harrington, H., & Milne, B. *Males on the life-course persistent and adolescence-limited antisocial pathways: Follow-up at 26 age*. Rivista di Psicologia Clinica, 2010, n.2, fq. 158

rriten, moskujdesja⁹⁷ dhe shëmbujtë negativ – indiferent të ofruar nga prindërit ndaj rritjes së të miturve. Gjithësesi, studimet e kryera shprehen se aspektet biologjiko – genetike⁹⁸ edhe pse primare në vlersimin e tendencës kriminale nuk mjaftojnë për të përcaktuar në mënyrë absolute fenomenin e çrregullimit të personalitetit dhe tendencat psikopatike që shfaqen në moshën adoleshencjale me impakt kriminal.

KONKLUZIONE

Risia e sjell nga Kodi i ri i Drejtësisë minorile është një hap përpara në kujdesin që Shteti paraqet ndaj brezit të ri. Futja në sistemin juridik të garancive procedurale për të miturit është një nivel i ri komunikimi mes të mirës absolute të krijimit të brezave psikologjikisht të shëndetshëm, të cilët pëshkak të gabimeve të adoleshencës nuk mund dhe nuk duhet të emargjinohen dhe mbyllen dyert e një të ardhme të rekuperueshme dhe rehabilituese. Specializmi i strukturave hetimore, të gjykimit dhe figurave ndihmëse si ajo e psikologut dhe stafeve mjekësore bënë që të miturit të mos lihen vetëm dhe të ndëshkohen në një moshë të njomë, ku ka ende hapsirë për rifutjen e tyre në shoqëri, si qytetarë të përgjegjshëm dhe mbartës përgjegjësish për veprimet dhe mos veprimet e tyre. Impakti psiko-social familjarë dhe geneza e të miturve duhet të jenë faktor vlersimi i tërësisë së personalitetit të të miturit me qëllim dhënien ndihmë, panvarsisht nivelit të ndëshkueshmësisë që do të aplikohet ndaj tyre në rast dënimi për kryerjen e veprave penale. Njohja e aspekteve karakterizuese të inteligjencës emotive nga subjektët ndërveprues me të miturit është pikënisje thelbësore për edukimin dhe reintegrimin social të të miturve me probleme me karakter penal. Familja, si bërthama e shoqërisë, duhet të luajë një rol aktiv në mbarëvajtjen e emocioneve dhe krijimin e kushteve për të rritur të mitur të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm. Njohja e teknikave psiko-vlersuese dhe psikoterapeutike janë faktor qëndor në rolin që institucionet që lidhen me të miturit duhet të aplikojnë me rigorozitet dhe përkushtim. Rol primar luan Shteti, që do të duhet të përgatisë, trajnojë dhe specializojë subjektet teknikë që raportohen me të mitur problematik dhe të investojë në rekuperimin e tyre duke krijuar struktura specifike të afta për të ndihmuar dhe risocializuar të miturit të cilë kanë probleme me ligjin. Përkrash ndihmës së Shteti rol parësor do të duhet të luajnë edhe organizmat joqeveritare, të cilat merrem me trajtimin e profile-

97 Verheul, R., *Clinical utility of dimensional models for personality pathology*. Journal of Personality Disorders, 2005, n. 3, fq. 283-302.

98 Livesly, W.J. *Behavioral and molecular genetic contributions to a dimensional classification of personality disorders*. American Psychiatric Association, (2006), Washington, DC, fq. 39-54.

ve problematike që prekin të miturit dhe familjarët e tyre me qëllim relaizmin konkret të frymës së Kodit të Drejtësisë Minorile.

BIBLIOGRAFIA

- Ciarrochi J, Godsell C. *Mindfulness-based emotional intelligence: A theory and review of the literature*. In: Schulze R, Roberts RD, editors. *Emotional Intelligence: An International Handbook*. Cambridge, MA: Hogrefe and Huber Publishers; 2005, fq. 69–90
- Deu N. *Executive function and criminal fantasy in the premeditation of criminal behaviour*. Crim Behav Ment Health. 1998, fq. 41–50.
- Emery R., Family Violence, American Psychologist, shkurt, 1989
- Grilo, C.M., McGlashan, T.H., Morey, L.C., Gunderson, J.G., Skodol, A.E., Shea, et al. (2001). *Internal consistency, intercriterion overlap and diagnostic efficiency of criteria sets for DSM-IV schizotypal, borderline, avoidant and obsessive-compulsive personality disorders*. Acta Psychiatrica Scandinavica, 2001
- Hayes JM, O'Reilly G. *Psychiatric disorder, IQ, and emotional intelligence among adolescent detainees: A comparative study*. Leg Criminol Psychol. 2013, fq. 30–47
- Hiscoke, U.L., Langstrom, N., Ottosson, H., & Grann, M. *Self-reported personality traits and disorders (DSM-IV) and risk of criminal recidivism: A prospective study*. Journal of Personality Disorders, 2003
- Kasen, S., Cohen, P., Skodol, A.E., Johnson, J.G., & Brook, J.S. *Influence of child and adolescent psychiatric disorders on young adult personality disorder*. American Journal of Psychiatry, fq. 1529-1535.
- Kirsch LG, Becker JV. *Emotional deficits in psychopathy and sexual sadism: implications for violent and sadistic behavior*. Clin Psychol Rev. 2007, fq. 27.
- Krischer, M.K., Sevecke, K., Lehmkuhl, G., & Pukrop, R., *Dimensional assessment of personality pathology in female and male juvenile delinquents*. Journal of Personality Disorder. 2007, n. 6, fq. 675-89.
- Livesly, W.J. *Behavioral and molecular genetic contributions to a dimensional classification of personality disorders*. American Psychiatric



Association, (2006), Washington, DC, fq. 39-54.

- Mayer JD, Salovey P. *What is emotional intelligence? Emotional Development and Emotional Intelligence: Implications for Educators*. New York: Basic Books; 1997
- Moffitt, T.E., Caspi, A., Harrington, H., & Milne, B. *Males on the life-course persistent and adolescence-limited antisocial pathways: Follow-up at 26 age*. Rivista di Psicologia Clinica, 2010, n.2, fq. 158
- Mullen, P.E. *Dangerous and severe personality disorder and in need of treatment*. British Journal of Psychiatry, 2007, maj, fq. 3-7.
- Pizarro DA, Salovey P., *On being and becoming a good person: The role of emotional intelligence in moral development and behavior*. In: Aronson J, editor. Improving Academic Achievement: Impact of Psychological Factors on Education. San Diego: Academic Press; 2002, fq. 247
- Qualter P, Ireland J, Gardner K., *Exploratory and confirmatory factor analysis of the schutte self-report emotional intelligence scale (SSREI) in a sample of male offenders*. Br J Forensic Pract. 2010, fq. 43–51.
- Ligj nr. 7531, datë 11.12.1991 “PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËS”
- Schulze R, Roberts RD, *Theory, measurement, and applications of emotional intelligence: An International Handbook*. Cambridge, MA: Hogrefe and Huber Publishers; 2005, fq. 3–30
- Strüber D, Lück M, Roth G. *Sex, aggression and impulse control: An integrative account*. Neurocase. 2008
- Verheul, R., *Clinical utility of dimensional models for personality pathology*. Journal of Personality Disorders, 2005, n. 3, fq. 283-302.
- Widom C., Child Abuse, Neglect and Adult Behavior. American Journal of Orthopsychiatry, korrik, 1989

DREJTËSIA PENALE PËR TË MITUR NË AUSTRI

Mag. iur. Besmir Premalaj

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

besmir.premalaj@umsh.edu.al

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i të drejtës penale dhe i dhënies së dënimeve në rast të shkeljes së dispozitave të parashikuara në kodin penal është nga njëra anë efekti preventiv, ose frikësues në kryerjen e një vepre penale, dhe nga tjetra tjetër rehabilitimi i subjektit të kësaj të drejte. Pikërisht qëllimi i rehabilitimit merr një vlerë të shtuar, nëse subjekt i veprës penale është një i mitur. Rregullimet ligjore në këtë aspekt në formën e një kodifikimi të mirëfilltë janë kryer në Shqipëri së fundmi me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Shumë vende të tjera të Evropës kanë një eksperiencë shumëvjeçare për sa i përket rregullimeve ligjore në këtë drejtim. Për këtë arsye është e nevojshme vështrimi i rregullimeve të ngjashme ligjore në këto vende. Austria është një nga vendet e Evropës, që bën një diferencim të qartë të përgjegjësisë penale të të miturve duke i kategorizuar ato sipas evoluimit psiko-social të tyre. Në të drejtën penale Austriake, subjektet e të drejtës penale kategorizohen, në varësi të moshës, në tre grupe: në të mitur të papjekur, të mitur të pjekur dhe në persona me përgjegjësi të plotë penale. Edhe tek personat me përgjegjësi të plotë penale e drejta austriake bën një dallim në varësi të moshës së tyre. Qëllimi i këtij punimi është nxjerrja në pah e diferencimeve në penalizimin e subjekteve të së drejtës në Austri, që mund të shërbejë më pas në krahasimin e dënueshmërisë të të miturve sipas të drejtës shqiptare dhe asaj austriake.

Fjalët kyçe: *të mitur të papjekur, të mitur të pjekur, rehabilitimi i subjektit të së drejtës.*

DËNIMI PENAL DHE MASAT PARANDALUESE

E drejta penale austriake bazohet në sistemin e dualizmit. Sipas këtij sistemi dhomat penale të gjykatave mund të japin, ose dënim penal, ose masa parandaluese në rast të kryerjes së një vepre penale. Ideatori dhe përfaqësuesi kryesor i sistemit të dualizmit është zviceriani *Carl Stooss*. Ky sistem u zbatua më vonë në Austri me hyrjen në fuqi të kodit penal të 1975 dhe përbën tashmë bazat e legjislacionit penal të vendeve të Evropës dhe Amerikës Latine.⁹⁹

DËNIMI PENAL

Dënimi penal është ndëshkimi i parashikuar në kodin penal dhe i dhënë nga trupi gjykues i gjykatës penale për shkak të një veprimi të palejuar, në varësi të fajit të të dënuarit. Faji është jo vetëm parakusht, por njëkohësisht edhe kufiri në dhënien e dënimit.¹⁰⁰ Për këtë arsye niveli i dënimit nuk duhet të kalojë nivelin e fajit të të dënuarit.

Qëllimi i dhënies së dënimit është, nga njëra anë, shpagimi për kryerjen e një veprimi të parashikuar në dispozitat e kodit penal dhe nga ana tjetër, parandalimi i përgjithshëm dhe ai i veçantë në kryerjen e një vepre penale. Ideja e shpagimit bazohet në idetë filozofike të *Kantit*, sipas të cilës, secili duhet të përballlet me pasojat e veprimeve të tij. Shpagimi njihet ndryshe në terminologjinë e të drejtës edhe si baraspeshimi i drejtë i fajit me dënimin. Sipas *Jescheck* baraspeshimi i drejtë i fajit me dënimin ndihmon në ri-integrimin e të dënuarit në shoqëri.

Qëllimi i parandalimit të përgjithshëm është efekti edukues i dënimit në shoqëri. Sipas këtij nocioni dhënia e dënimeve penale, ose rreziku i dënimit që vjen nga kryerja e një vepre penale, shërben si kundërpeshë dhe si një mjet frikësues për të tjerët në kryerjen e veprimeve që bien ndesh me kodin penal. Doktrina e të drejtës penale bën dallimin midis parandalimit të përgjithshëm negativ dhe parandalimit të përgjithshëm pozitiv. Në parandalimin e përgjithshëm negativ synohet frikësimi i shoqërisë në kryerjen e veprave penale nëpërmjet frikës nga marrja e një dënimi. Ndërsa sipas parandalimit të përgjithshëm pozitiv, ekzistenca e kërcënimit me dënime sipas së drejtës penale dhe veprimtaria e organeve ligj zbatuese, jo vetëm shton bindjen e shoqërisë ndaj normave ligjore, por rrit edhe besimin e saj në zbatimin e barabartë të ligjit dhe në shtetin ligjor. Pra shërben si një mjet bindjeje shoqërore ndaj normave të së drejtës. Në këtë drejtim mund të shihet aspekti i kënaqësisë së shoqërisë dhe qetësisimit të

99 *Jescheck/Weigend, Lehrbuch des Strafrechts, Allgemeiner Teil*⁵ (1996) 84.

100 *Kienapfel/Höpfel, Strafrecht, Allgemeiner Teil*¹⁰ (2003) Z2 RN 1.

ndërgjegjes së saj me dënimin e të pandehurit për shkak të thyerjes së ligjit.¹⁰¹

Mendimi filozofik i parandalimit të veçantë orientohet tek rrezikshmëria e individit në vetvete. Sipas saj dënimet penale jepen në mënyrë që të dekurajojnë të dënuarit që të kryejnë vepra penale në të ardhmen dhe t'i edukojnë ato të sillen në mënyrë ligjore. Ideator i kësaj teorie penale është austriaku *Franz von Liszt*, i cili e ka sjellë këtë teori në qendër të politikave racionale të së drejtës.¹⁰²

Në praktikë të tre këto teori u bashkuan në një, si tre synimet kryesore të së drejtës penale. Kështu synimi i dhënies së dënimit penal është parandalimi i përgjithshëm dhe ai i veçantë, si dhe synimi i shpagimit për shkak të kryerjes së një veprimi të parashikuar në dispozitat e kodit penal. Paragrafët e kodit penal austriak i referohen *expressis verbis* vetëm teorisë së parandalimit të përgjithshëm dhe atij të veçantë. Megjithatë dënimi penal perceptohet si nga i dënuari, ashtu edhe nga shoqëria, si shpagim për kryerjen e veprës penale.

MASAT PARANDALUESE

Masat parandaluese janë sanksionet që jepen pavarësisht fajit të të pandehurit. Dhënia e tyre lidhet më shumë me rrezikshmërinë që mbart vetë i pandehuri në shoqërori.¹⁰³ Këto janë masa që jepen për të pandehur që mbartin rrezikshmëri shoqërore për shkak të prirjeve të tyre ndaj drogërave, prirjeve seksuale ose sëmundjeve mendore. Kryerja e një vepre penale është gjithashtu parakusht për dhënien e masave parandaluese.

Ndryshe nga dënimet penale, synimi i masave parandaluese është luftimi i rrezikshmërisë shoqërore të sjelljes së një të pandehuri të caktuar. Masat parandaluese nuk kanë qëllimin e parandalimit të përgjithshëm, por atë të parandalimit të veçantë të lidhur me veprimin e një të pandehuri me karakteristika të caktuara dhe jepen vetëm për të pandehur me rrezikshmëri të veçantë. Në këtë aspekt duhet të mbahet gjithmonë parasysh parimi i baraspeshimit (proporcionalitetit).¹⁰⁴ Ndërsa dënimi penal ka karakter retrospektiv, masat parandaluese orientohen drejt të ardhmes, konkretisht drejt rrezikshmërisë në të ardhmen të një të pandehuri konkret.

Tre janë llojet e heqjes së lirisë nëpërmjet masave parandaluese në kodin penal austriak:

101 *Roxin*, Strafrecht, Allgemeiner Teil I, Grundlagen, Der Aufbau der Verbrechenslehre³ (1997) § 3 RN 27.

102 *Franz von Liszt*, Marburger Programm (1882).

103 *Kienapfel/Höpfel*, Strafrecht, Z2 RN 12.

104 *Ratz* in Wiener Kommentar zum Strafgesetzbuch², hrsg. Höpfel/Ratz (1999) § 23 RN 6.

1. mbyllja në institucione për persona me çrregullime psikike¹⁰⁵,
2. mbyllja në institucione rehabilituese¹⁰⁶ dhe
3. mbyllja në institucione për shkelës përsëritës¹⁰⁷.

Qëllimi kryesor i masave parandaluese nuk është heqja e lirisë së subjektit të së drejtës, por rehabilitimi i një personi që mbart rrezikshmëri shoqërore. Megjithatë masat parandaluese janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me heqjen, ose kufizimin e lirisë së personit. Qëllimi nuk është heqja e lirisë, por kjo heqje e lirisë është pasojë e pashmangshme e vendosjes së masave parandaluese.¹⁰⁸ Në varësi të veprës penale mund të jepen njëkohësisht dënime penale të shoqëruara me masa parandaluese, nëse në një rast konkret ka një kombinim të fajit me rrezikshmërinë e veçantë shoqërore të të pandehurit. Për shembull një i pandehur që ka varësi nga droga duhet jo vetëm të dënohet me heqje lirie, por të dërgohet edhe në një institucion rehabilitues për personat e varur nga drogërat.

DËNUESHMËRIA PENALE PËR TË MITURIT

E drejta penale austriake e rregullon penalitetin e të miturve në një ligj të veçantë, ligji datë 20.10.1988 “Mbi zbatimin e ligjit për vepra penale nga të mitur” (Jugendgerichtsgesetz). Subjektet e të drejtës penale në të drejtën penale austriake kategorizohen, në varësi të moshës, në tre grupe: në të mitur të papjekur, të mitur të pjekur dhe në persona me përgjegjësi të plotë penale. Të miturit e papjekur janë të mitur që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç. Sipas ligjit datë 20.10.1988 “Mbi zbatimin e ligjit për vepra penale nga të mitur” (Jugendgerichtsgesetz) të miturit e papjekur nuk kanë përgjegjësi penale, si në rast të kryerjes së një krimi, ashtu edhe të kryerjes së një kundërvajtje penale.¹⁰⁹

Të miturit e pjekur janë të mitur që kanë mbushur moshën 14 vjeç, por jo atë 18 vjeç. Ato kanë përgjegjësi penale, si në rast të kryerjes së një krimi, ashtu edhe të kryerjes së një kundërvajtje penale. Megjithatë të miturit e pjekur përjash-tohen nga përgjegjësia penale, nëse ato nuk janë mjaftueshëm të pjekur që të kuptojnë padrejtësinë e veprimit të kryer.¹¹⁰ Po ashtu një i mitur i pjekur nuk

105 § 21 i kodit penal austriak.

106 § 22 i kodit penal austriak.

107 § 23 i kodit penal austriak.

108 *Kienapfel/Höpfel*, Strafrecht, Z2 RN 16.

109 § 4 Abs. 1 Jugendgerichtsgesetz.

110 § 4 Abs. 2 Z 1 Jugendgerichtsgesetz.

ka përgjegjësi penale, nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto tre kushte: i mituri i pjekur ka kryer një kundërvajtje penale pa mbushur moshën 16 vjeç, faji i tij në kryerjen e kundërvajtjes penale nuk është aq i rëndë dhe dënimi i të miturit nuk do të plotësohej qëllimin e parandalimit të veçantë, pra nuk do të kishte efekt edukues për të miturin në moskryerjen në të ardhmen të një vepre penale.¹¹¹

Siç shihet e drejta penale austriake ashtu si ajo shqiptare bën dallimin në përgjegjësinë penale midis krimit dhe kundërvajtjes penale, në rast të kryerjes së saj nga një i mitur. Sipas kodit penal shqiptar një i mitur, që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç, nuk ka përgjegjësi penale, nëse kryen një kundërvajtje penale. Ndërsa e drejta penale austriake i jep përgjegjësi penale edhe një të mituri që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç dhe që ka kryer një kundërvajtje penale, nëse nuk plotësohen në mënyrë kumulative tre kushtet e përmendura më lart.

E drejta penale austriake bën dallim edhe në masën e dënimit penal, në rast të kryerjes së veprës penale nga një i mitur. Kështu në vend të dënimit me burgim të përjetshëm, ose të masës së dënimit me burgim nga 10 deri në 20 vite, një i mitur i pjekur që ka mbushur moshën 16 vjeç dënohet me burgim nga 1 deri në 15 vite. Ndërsa një i mitur që nuk ka mbushur ende moshën 16 vjeç, në vend të dënimit me burgim të përjetshëm, ose të masës së dënimit me burgim nga 10 deri në 20 vite, dënohet me burgim nga 1 deri në 10 vite.¹¹²

Masa e dënimit për një vepër penale, që dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vite, ulet për të miturit në 6 muaj deri në 10 vite burgim.¹¹³ Në të gjitha rastet e tjera masa e dënimit për të miturit përgjysmohet dhe nuk ka një kufi të poshtëm në dhënien e dënimit.¹¹⁴

Nëse një i mitur që ka mbushur moshën 14 vjeç kryen një vepër penale për të cilën masa e dënimit e parashikuar në kodin penal është relativisht e vogël, gjykata duhet të shprehet në vendimin përkatës vetëm mbi fajësinë e të miturit dhe nuk duhet të përfshijë në të dhënien e masës së dënimit. Kjo vetëm, nëse vendimi mbi fajësinë e të miturit mjafton për të arritur qëllimin e parandalimit të veçantë, pra do të kishte efekt edukues për të miturin në moskryerjen në të ardhmen të një vepre penale.¹¹⁵ Nëse masa e dënimit për veprën e kryer nuk është e vogël, atëherë gjykata mund të shprehet me vendim vetëm mbi fajësinë

111 § 4 Abs. 2 Z 2 Jugendgerichtsgesetz.

112 § 5 Abs. 2 Jugendgerichtsgesetz

113 § 5 Abs. 3 Jugendgerichtsgesetz

114 § 5 Abs. 4 Jugendgerichtsgesetz.

115 § 12 Jugendgerichtsgesetz.

e të miturit dhe të kushtëzohet dhënien e masës së dënimit me 1 deri në 3 vite, nëse ky vendim do të kishte efekt edukues për të miturin në moskryerjen në të ardhmen të një veprë penale.¹¹⁶

Për sa i përket çështjeve procedurale, ligji parashikon masa lehtësuese për të miturit, si në përcaktimin e kompetencës territoriale të gjykatës, ashtu edhe në gjykimin e të miturit. Kompetenca territoriale e gjykatës nuk përcaktohet sipas vendit ku është kryer vepra penale, por për të miturit, sipas vendbanimit të tyre të zakonshëm në kohën e fillimit të procedimit penal.¹¹⁷ Po ashtu seanca gjyqësore mund të mbahet vetëm, nëse të miturit, përveç avokatëve, janë të përfaqësuar edhe nga përfaqësuesit e tyre ligjor (prindërit, etj.). Për vuajtjen e dënimit për të miturit ligji detyron mbylljen e tyre në institucione të veçanta të dënimit, ose në ambiente të ndara nga të rriturit.¹¹⁸ Gjithashtu gjatë vuajtjes së dënimit të miturit i nënshtrohen një procesi të veçantë të riedukimit, duke përfshirë edhe dhënien e një profesioni të caktuar, të cilin mund ta ushtrojnë pas vuajtjes së dënimit.¹¹⁹

Edhe tek personat me përgjegjësi të plotë penale e drejta austriake bën një dallim në varësi të moshës së tyre. Në llogaritjen e masës së dënimit, kodi penal austriak konsideron si rrethanë lehtësuese kryerjen e veprës penale kur i riu kishte mbushur moshën 18 vjeç, por jo atë 21 vjeç.¹²⁰

PËRFUNDIME

Qëllimi i të drejtës penale është parandalimi i kryerjes së veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimi, i shoqëruar me ri-integrimin e subjekteve të së drejtës penale në shoqëri. Arritja e këtij synimi është sidomos më i mundur, kur subjekti i veprës penale e kryen atë për herë të parë. Përballja e tij për herë të parë me dënimin ndikon psikologjikisht tek subjekti i të drejtës. Ky është momenti më i mirë për ri-edukimin e tij.

Për shkak të evoluimit të tyre emocional, sidomos në periudhën e adoleshencës, janë pikërisht të miturit ato që përballen në përgjithësi për herë të parë me dënimin penal. Për këtë arsye, dënimi ndaj tyre nuk është i nevojshëm të jetë i ashpër, por i mjaftueshëm për t'i frikësuar dhe detyruar ato të mos kryejnë

116 § 13 Jugendgerichtsgesetz.

117 § 29 Jugendgerichtsgesetz.

118 § 55 Jugendgerichtsgesetz.

119 § 53 Jugendgerichtsgesetz.

120 § 34 Abs. 1 Z 1 i kodit penal austriak.

vepra penale në të ardhmen. Siç e parashikon edhe e drejta penale austriake, në disa raste mjafton vetëm shpallja e fajësisë në vendimin përkatës, të pashoqëruar me dhënien e një dënimi. Kjo shkakton edhe në aspektin psikologjik, vënien në pah të pasojave nga kryerja e një veprimi të ndaluar, pasoja që mund të ishin më të rënda. Frikësimi nga pasojat më të rënda, detyron të miturit të mos kryejnë veprime të palejuara në të ardhmen.

Dhënia e dënimit penal duhet të shoqërohet edhe me masa të tjera rehabilituese. Duke qenë se, një ndër qëllimet kryesore në kryerjen e një vepre penale është përfitimi ekonomik dhe numri më i madh i kryerjes së veprave penale është në ato vende, ku niveli ekonomik është i ulët, dhënia sidomos tek të miturit e një profesioni, që mund ta ushtrojnë në të ardhmen, mund të ndihmojë në mënyrë të qenësishme në rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Për këtë arsye është e këshillueshme, që gjatë vuajtjes së dënimit të miturit, por edhe të rriturit, t'i nënshtrohen një procesi riedukimi, që përfshin edhe dhënien e një profesioni të caktuar, të cilin mund ta ushtrojnë pas vuajtjes së dënimit. Në këtë mënyrë mund të eliminohet një nga motivet kryesore që shtyjnë subjektet e të drejtës penale në kryerjen e veprave penale.

BIBLIOGRAFIA

- Franz von Liszt, Marburger Programm (1882)
- Jescheck/Weigend, Lehrbuch des Strafrechts, Allgemeiner Teil, 5. Auflage (1996)
- Kienapfel/Höpfel, Strafrecht, Allgemeiner Teil, 10. Auflage (2003)
- Roxin, Strafrecht, Allgemeiner Teil I, Grundlagen, Der Aufbau der Verbrechenslehre, 3. Auflage (1997)
- Wiener Kommentar zum Strafgesetzbuch, hrsg. Höpfel/Ratz, 2. Auflage (1999).
- Kodi penal austriak
- Ligji datë 20.10.1988 “Mbi zbatimin e ligjit për vepra penale nga të mitur” (Jugendgerichtsgesetz)

ASPEKTE TË SË DREJTËS PENALE FRANCEZE PËR TË MITURIT

Dr. Diana Skrapari, Dr. Besmir Alushi

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

diana.skrapari@umsh.edu.al besmir.alushi@umsh.edu.al

ABSTRAKT

Regullorja e 2 shkurtit 1945 mbi kriminalitetin e të miturve themeloi gjykatat për fëmijët (ligji i vitit 1912 ka ekzistuar më herët) si dhe gjyqtarin për të mitur dhe përcaktoi qartë përparësinë e arsimit dhe jo dënimin dhe kjo është në perspektivën e riintegritimit social. Urdhëresa e vitit 1960 e bëri gjyqtarin e të miturit zemrën e trajtimit të delikuentës për të mitur, pasi ai kombinon të gjitha funksionet gjatë gjykimit. Gjykata Evropiane e ka refuzuar këtë praktikë me një aktgjykim të 2 marsit 2010, duke i dhënë fund kombinimit të hetimeve dhe gjykimit. Gjykata për të mitur është një gjykatë e shkallës së parë, e cila dënon fëmijët (të mitur në atë kohë) me dyer të mbyllura, (dhunë ose lëndime të lehta ...) ose vepra penale (vjedhje, dhunë të rëndë ...) dhe krime (vrasje, përdhunime ...). Megjithatë, në rastin e krimeve, të miturit mbi moshën 16 vjeç i përkasin Gjykatës së Lartë të të Miturve. Fuqitë e gjyqtarit për të mitur u shtynë më pas me dekretin e 23 dhjetorit 1958 në çështjet civile me qëllim mbrojtjen e të miturve në rrezik. Gjyqtari për të mitur ka përjetuar kështu një krijim dhe evolucion të shpejtë drejt një gjyqtari të specializuar për të mitur. Para vitit 2009, Kodi Penal (neni 122-8) parasheh parimin e përgjegjësisë kriminale të një 13-vjeçari. Kodi i ardhshëm i të miturve parashikon një «regjim të veçantë civil» për fëmijët nën 13 vjeç. Sanksionet e mundshme kundër të miturve nën moshën 13 vjeç do të thjeshtohen nga 18 në 4: paralajmërimi gjyqësor, dhënia e prindërve, ndjekja e arsimit në liri dhe vendosja në një institucion të specializuar. Përveç kësaj, ata mund të dëgjohen, në rast të shkeljes, dhe «të vendosen në paraburgim në kohën e dëgjimit të tyre».

Fjalët kyçe: *Urdhëresat Penale, Përgjegjësia Penale, Gjykatat për të Mitur*

HYRJE

«Delinkuenca e të miturve» është një koncept ligjor, që përcakton të gjitha sjelljet e pahijshme të kryera nga një person që nuk ka arritur mazhorancën penale.

Ky nocion është parë në Francë me ordonancën e 2 shkurtit 1945 për delikuencën e të miturve, dhe është subjekt i dispozitave të policisë dhe gjyqësore të veçanta (në gjykata të veçanta të specializuara: Gjykata për të mitur, Gjykata Penale për të mitur dhe Gjykata e Rrethit për të Miturit).

Ordonanca e 2 shkurtit 1945 mbi delikuencën e të miturve krijoi gjykatat për fëmijët (ligji i 1912 ka ekzistuar më përpara) si dhe gjykatësin për të mitur, dhe e ka përcaktuar qartë përparësinë e edukimit sesa dënimit, dhe kjo në një perspektivë të riintegritimit social. Ordonanca e vitit 1945 e bëri gjyqtarin e të miturit zemrën e trajtimit të delikuencës së të miturve, meqë i kombinon të gjitha funksionet gjatë gjykimit. Gjykata Evropiane e ka kundërshtuar këtë praktikë me një aktgjykim të 2 marsit 2010, duke i dhënë fund kombinimit të hetimit dhe gjykimit. Gjykata e të miturve është gjykatë e shkallës së parë, e cila e gjykon fëmijët (të mitur në atë kohë) me dyer të mbyllura, për veprat e klasit të pestë (dhunë apo dëmtime të lehta ...) ose veprat penale (vjedhje, dhunë e rëndë ...) dhe krimet (vrasjet, përdhunimet ...). Sidoqoftë, në rastin e krimeve, të miturit mbi moshën 16 vjeç i përkasin Gjykatës së Lartë të të Miturve. Kompetencat e gjyqtarit për të mitur u shtrinë më pas me dekretin e 23 dhjetorit 1958 në çështjet civile, me qëllim të mbrojtjes së të miturve në rrezik. Gjykatësi për të mitur ka përjetuar kështu një krijim dhe një evolucion të shpejtë drejt një gjyqtari të specializuar për të mitur. Para vitit 2009, Kodi Penal (neni 122-8) ka përcaktuar parimin e papërgjegjshmërisë kriminale të një 13-vjeçari. Kodi i ardhshëm i të miturve parashikon një «regjim të veçantë civil» për fëmijët nën 13 vjeç. Sanksionet e mundshme kundër të miturve nën moshën 13 vjeçare do të thjeshtohen, nga 18 deri në 4: paralajmërim gjyqësor, dorëzim prindërve, ndjekje e edukimit në liri dhe vendosja në një strukturë të specializuar. Përveç kësaj, ata mund të dëgjohen, në rast të shkeljes, dhe «vendosen në paraburgim në kohën e dëgjimit të tyre»

1. GJYKATA E TË MITURVE

Gjykata e të miturve është pjesë e Gjykatës së shkallës së parë, e cila e konsideron fëmijën (të mitur në atë kohë) me dyer të mbyllura, për veprat e klasit të pestë (sulm apo dëmtime të lehta ...) ose veprat penale (vjedhje, dhunë serioze ...) dhe krimet (vrasjet, përdhunimet ...). Megjithatë, në rastin e krimeve, të miturit mbi moshën 16 vjeç i përkasin Gjykatës së Lartë të të Miturve.

Megjithëse e themeluar nga Urdhëresa e vitit 1945, gjykatat e specializuara ishin themeluar me Aktin e 1912¹²¹.

Në kuadrin penal, gjyqtari për të mitur mbështetet kryesisht në shërbimet e mbrojtjes gjyqësore të të rinjve dhe në institucione, shpesh asociative, të autorizuar dhe të financuara nga shteti.

Juridiksioni i gjyqtarit të miturve u pa më vonë me dekretin e 23 dhjetorit 1958¹²² në çështjet civile, me qëllim të mbrojtjes së të miturve në rrezik. Gjykatësi për të mitur ka përjetuar kështu një krijim dhe një evolucion të shpejtë drejt një gjyqtari të specializuar për të mitur.

2. DREJTËSIA PENALE E TË MITURVE

Ekzistenca e një drejtësisë penale për të mitur është konsideruar si një parim themelor i njohur nga ligjet e Republikës nga jurisprudenca e Këshillit Kushtetues në një ligj me vendim orientimin dhe programimin e drejtësisë të 29 gusht 2002 mbi bazën e ligjit të 12 prillit 1906 mbi përgjegjësinë penale të të miturve, të ligjit të 22 korrikut 1912, gjykatave për të miturit dhe ordonancën e 2 shkurtit 1945 të delikuencës së të miturve. Megjithatë, ky parim, i cili është pjesë e bllokut të kushtetutshmërisë, ka të bëjë vetëm me ekzistencën e juridiksionit të specializuar ose procedurave të përshtatshme për të miturit, por nuk kërkon që ligjvënësi t'i japë përparësi absolute masave edukative: ndalimin e të miturve mbi 13 vjeç konsiderohet të jetë në përputhje me Kushtetutën e 4 tetorit 1958.

Në nivel penal, gjyqtari për të mitur është i lejuar për të gjykuar të mitur që kryejnë krime (është mosha e personit në momentin e fakteve që ruhet) si pjesë e ordonancës së 1945, Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.

3. KATEGORITË E NDRYSHME TË TË MITURVE (NËN 10, 10-13, 13-16, 16-18)

Përveç kësaj, ligji organizon procedimin e rasteve penale për të miturit në moshë prej 10 deri në 18 vjet. Veçanërisht parashikon se burgosja është e mundur vetëm për të miturit mbi 13 vjeç. Në praktikë, kryesisht janë të mitur mbi moshën 15 vjeç të cilët dënohen me burgim (në distriktet e specializuara të burgjeve), të cilat zakonisht vendosen kur masat edukative (në veçanti, largimi i të

121 Ligji mbi Gjykatat e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe mbi lirinë e vëzhguar, Loi sur les tribunaux pour enfants et adolescents et sur la liberté surveillée, 22 korrik 1912

122 Urdhëresa e 23 dhjetorit 1958 në lidhje me mbrojtjen e fëmijve dhe të adoleshentëve në rrezik, Ordonnance du 23 décembre 1958 relative à la protection de l'enfance et de l'adolescence en danger

miturit si pjesë e vendosjes') u gjetën të paefektshme, veçanërisht për shkak të recidivizmit.

Këtu skematikisht kategoritë e të miturve që mund të gjenden në rendin e 2 shkurtit 1945¹²³ sipas masave që ofrohen kundër tyre:

- Të mitur nën moshën 10 vjeçare: papërgjegjshmëria kriminale absolute.
- Të mitur nën moshën 10 deri në 13 vjeç dhe më të pjekur (vlerësimi sovran i gjyqtarit): ai bën vendosjen e masave edukative ¹²⁴. Një dallim duhet të bëhet midis të miturve nën 10 vjeç dhe të miturit e moshës 10 deri 13 që mund të kenë sanksioneve arsimore ¹²⁵ masa të diskutueshme në kufirin midis dënimeve dhe masave edukative, sanksioni i mosrespektimit nuk është asgjë tjetër veç vendosjes në një strukturë të masave edukative.
- Të miturit e moshës 13-16 vjeç: përveç masave edukative dhe sanksioneve, ata përfitojnë nga një shkak ligjor i zbutjes së përgjegjësisë dhe kanë vetëm gjysmën e dënimit me ligj, duke mos tejkaluar 20 vjet burgim ¹²⁶ dhe një gjobë prej 7,500 €¹²⁷.
- Të miturit nga 16-18 vjeç: rasti është më kompleks. Ata përfitojnë nga shkak ligjor i lehtësimit të përgjegjësisë, kjo mund t'ju refuzohet në parim në rast të përsëritjes së dytë të disa krimeve dhe veprave të caktuara të numëruara në mënyrë kufizuese¹²⁸.

Raporti Varinard (2008) dhe projekt-reforma e përgjegjësisë penale të të miturve

Para vitit 2009, Kodi Penal (neni 122-8) tashmë ka përcaktuar parimin e papërgjegjshmërisë kriminale të një 13-vjeçari.

Një komision i ngritur nga Kancelaria dhe i kryesuar nga André Varinard dorë-

123 Website, <http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006>

124 Website, http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do?session-id=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpdjo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495309&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006

125 Website, http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do?session-id=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpdjo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495311&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006

126 Website, http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do?session-id=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpdjo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495329&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006

127 Website, http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do?session-id=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpdjo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495332&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006

128 Website, http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do?session-id=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpdjo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495329&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006

zuan një raport në nëntor 2008. Ai ka përcaktuar një moshë minimale të përgjegjësisë penale dhe ka kërkuar një rregullim të përgjithshëm të ordonancës të 2 shkurt 1945¹²⁹.

Projekti për një Kodit Penal të të Miturve, i propozuar nga ministrja e Drejtësisë Rachida Dati, merr „shumicën“ e 70 propozimeve në raportin Varinard. Komisioni Varinard ka propozuar „të vendosë në 12 vjec moshën nën të cilën një i mitur i shpëton drejtësisë penale“.

Kodi i ardhshëm i të miturve parashikon një „regjim të veçantë civil“ për fëmijët nën 13 vjeç. Sanksionet e mundshme kundër të miturve nën moshën 13 vjeçare do të thjeshtohen, nga 18 deri në 4: paralajmërim gjyqësor, dorëzim tek prindërit, ndjekja e hapur e edukimit dhe vendosja në një strukturë të specializuar. Përveç kësaj, ata mund të dëgjohen, në rast të shkeljes, dhe „vendosen në paraburgim kohën e dëgjimit të tyre“.¹³⁰

4. QENDRAT E MBYLLURA ARSIMORE (CEF)

Të ndara nga institucionet korrektuese të të miturve, qendrat e mbyllura edukative kanë për qëllim të miturit «shumë-përsëritës» të cilët janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor ose hetimi. Ata kanë një alternativë ndaj burgosjes dhe gjithmonë vijnë pas dështimit të masave edukative.

Në këtë kontekst, gjykatësi kombinon masat edukuese (mbështetje arsimore, punësimin) për masat e zbatimit të ligjit (kontroll gjyqësor, paraburgimi, gjoba, burgim me ose pa kusht, shërbime të komunitetit).

Ligji francez nuk përfshin një parim të shkruar të papërgjegjësisë penale për arsye të qenit minore, që do të thotë se nuk ka kufizim moshe për t'u gjetur fajtor për një vepër penale. Megjithatë, minoriteti kriminal mund të lejojë zbutjen e dënimit, ndërkohë që parimi i dallimit mund të çojë në konsiderimin se, nën 10 vjeç, fëmija nuk e ka këtë aftësi. Këto parime ishin të pranishme në Kodin Penal të vitit 1791 dhe në atë të vitit 1810.¹³¹

Për shembull, 13-vjeçari nuk mund të dënohet, por ai është përgjegjës për veprimet e tij. Neni 122-8 i Kodit Penal¹³² thekson se «të miturit e aftë për të gjykuar

129 Website, <http://www.justice.gouv.fr/index.php?rubrique=10016&ssrubrique=10259&article=14454>

130 Rachida Dati abandonne l'idée de la responsabilité pénale avant 13 ans , *Le Monde*, 16 mars 2009

131 Jean-Jacques Yvovet, « Le plus grand danger social, c'est le bandit imberbe ». *La justice des mineurs à la Belle Époque* , *La Vie des idées*, 16 juin 2009

132 Website, <http://www.legifrance.gouv.fr/affichCodeArticle.do?cidTexte=LEGITEX-TOO0006070719&idArticle=LEGIARTI000006417221&dateTexte=20081006>

janë përgjegjës penalisht për krimet, shkeljet ose kundravajtjet për të cilat ata janë dënuar ...»

5. INSTITUCIONET PENALE PËR TË MITURIT

Krijuar nga Ligji i orientimit dhe programimit për Drejtësi e 9 shtator 2002 (Ligji Perben I), institucionet korrektuese të parat për të mitur (EPM), për të miturit 13 deri 18 vjet, janë hapur në vitin 2007 -2008 në Lyon, Valenciennes, Meaux, Toulouse, Mantes-la-Jolie, Nantes dhe Marseille.

OBJEKTIVAT :

Krijuar për të forcuar sistemin e pritjes për të miturit të cilët janë përgjegjës për krime apo vepra penale, këto burgje janë të rezervuara për të mitur dhe janë të parët në Francë.

Ato sigurojnë një mjet shtesë për gjyqatrët, përveç lirimit dhe vendosjes së mbikëqyrur në një qendër të mbyllur arsimore, për t'u marrë me «delikuencën e të miturve»; ata duhet të zëvendësojnë distriktet specifike të burgjeve në të cilat këta të mitur ishin burgosur më parë.

Të vendosura nën përgjegjësinë e administratës së burgjeve, këto institucione duhet të sigurojnë një kornizë më të përshtatshme për burgosjen dhe edukimin e delikuentëve të mitur. Ata punojnë mirë me edukatorët e mbrojtjes gjyqësore të të rinjve dhe janë të dizajnuara për të akomoduar një maksimum prej 60 të miturve në qendër, të moshës 13 deri në 18 vjeç.

BIBLIOGRAFI

1. Jean-Jacques Yvoret, « Le plus grand danger social, c'est le bandit imberbe ». La justice des mineurs à la Belle Époque , *La Vie des idées*, 16 juin 2009
2. Ligji mbi Gjykatat e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe mbi lirinë e vëzhguar, Loi sur les tribunaux pour enfants et adolescents et sur la liberté surveillée, 22 korrik 1912
3. Rachida Dati abandonne l'idée de la responsabilité pénale avant 13 ans, *Le Monde*, 16 mars 2009
4. Urdhëresa e 23 dhjetorit 1958 në lidhje me mbrojtjen e fëmijve dhe të adoleshentëve në rrezik, Ordonnance du 23 décembre 1958 relative à

la protection de l'enfance et de l'adolescence en danger

5. Website,<http://www.legifrance.gouv.fr/affichCodeArticle.do?cidTexte=LEGITEXT000006070719&idArticle=LEGIARTI000006417221&dateTexte=20081006>
6. Website,<http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006>
7. Website,http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do;jsessionid=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpd-jo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495309&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006
8. Website,http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do;jsessionid=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpd-jo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495311&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006
9. Website,http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do;jsessionid=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpd-jo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495329&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006
10. Website,http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do;jsessionid=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpd-jo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495332&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006
11. Website,http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexteArticle.do;jsessionid=2BA05DF366407977DF26A1942BCC51D9.tpd-jo04v_3?idArticle=LEGIARTI000006495329&cidTexte=LEGITEXT000006069158&dateTexte=20081006

Website,<http://www.justice.gouv.fr/index.php?rubrique=10016&ssrubrique=10259&article=14454>

THE PRINCIPLE OF THE BEST INTEREST OF THE CHILD IN THE JUVENILE CRIMINAL CODE

Dr. Arben Shehu

University of Tirana, Law Faculty, Criminal Law Department

arben1shehu@yahoo.it

ABSTRACT

The principle of the best interest of the child is an international standard provided in The Convention on the Rights of the Child of the United Nations entered into force on 2 September 1990. It was ratified by the Republic of Albania in February 1992 and entered into force in March of that year. With the entry into force of the Convention, now it is part of the Albanian domestic legislation and its provisions have priority over the national laws.

The only way for the international and national law to produce positive effects is to be harmonized with each other. Article 3/1 of the Convention on the Rights of the Child establishes the principle of the best interest of the child as it follows:

“In all child-related actions taken by public or private social welfare institutions, courts, administrative authorities or legislative bodies, the best interests of the child should be the primary consideration.”

This principle seems to be well elaborated by the new Albanian Juvenile Criminal Code which entered in force in 1 January of 2018. Now Albanian public institutions and judiciary system have to deal with a difficult challenge which is:

To make efficient these legal provisions and really protect child interests.

Key words: child, legislation, principle, criminal

PARASHIKIMET LIGJORE

Garantimi I të drejtave të fëmijëve konsiderohet si një detyrë e autoriteteve shtetërore në nivel qendror dhe vendor me qëllim garantimin e mirërritjes, stabilitetit fizik, psikik dhe social të secilit prej tyre. Garantimi dhe zbatimi me efektivitet I të drejtave të fëmijëve përbën hapin bazë që një vend të kontribuojë në të ardhmen e tij të sigurtë.

A) PARASHIKIMET LIGJORE NDËRKOMBËTARE

Në kuadrin ligjor ndërkombëtar Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve ratifikuar prej Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, përbën dhe standartin më të lartë të garantimit të të drejtave të tyre. Nëpërmjet kësaj Konvente u parashikuan në mënyrë ekskluzive detyrimet e vendeve anëtare në sigurimin e standardeve jetësore të fëmijëve.

Preambula e Konventës pohon se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë. Po kështu konsiderohet se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi.

B) PARASHIKIMET LIGJORE KOMBËTARE

Vendi ynë ka aderuar në këtë Konventë në 27 shkurt 1992 si edhe ka ratifikuar të tre protokollet shtesë të saj. Në kuadrin ligjor shqiptar gjithmonë është bërë kujdes që të parashikohen standarde dhe garanci të veçanta sidomos në rastet e fëmijëve në raport me procedimin penal.

Kështu në Kodin Penal dhe të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë¹³³ u parashikua krijimi I seksioneve të posacme për gjykimin e të miturve që kryjne vepra apo kundravajtje penale. Në këto kod u parashikuan garancitë e mbrojtjes së detyrueshme ligjore por edhe psiokologjike nëpërmjet pjesëmarrjes së detyrueshme të mbrojtësit dhe kujdestarit ligjor apo psikologut. Rregulla të veçanta u përcaktuan edhe lidhur me masën dhe llojin e dënimit por asgjë specifike në lidhje me përparësinë e aplikimit të masave alternative të dënimit. Pavarësisht kësaj praktika gjyqësore kuptoi drejt qëllimin e ligjëvënësit dhe

133 Neni 13 I LIGJit Nr.7905, datë 21.3.1995 Kodi I Procedurës Penale I Republikës Së Shqipërisë, Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, Ndryshuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, Ndryshuar me ligjin nr.9911, datë 5.5.2008)

praktikisht ka zbatuar masat e sigurimit me kufizim apo heqje lirie vetëm në rastet kur masat e tjera kanë qënë të pamundura për tu zbatuar.

Në vijim Republika e Shqipërisë me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 26 nëntor 2013, ka tërhequr vëmendjen për analizën e thelluar të kuadrit ligjor ekzistues. Kjo për të vlerësuar mangësitë e mundshme, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij, si dhe për të vlerësuar hartimin e politikave të reja sociale që adresojnë shpërndarjen e drejtë të shërbimeve vendore dhe kombëtare në mbrojtje të drejtave të fëmijëve. Në këtë akt Kuvendi është angazhuar të ndër marrë nisma dhe veprime konkrete për hartimin e legjislacionit për drejtësinë për të miturit në Shqipëri ¹³⁴.

Pavarësisht masave në kuadrin ligjor por edhe institucional fatkeqësisht statistikat kanë treguar se numri I të miturve në konflikt me ligjin ka ardhur në rritje dhe se është rritur numri I përsëritësve. Në këto kushte miratimi I Kodit Të Drejtësisë Penale për të Miturit me ligjin 37/2017 I datës 30.03.2017 I cili ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2018 është hap thelbësor në hartimin e një strategjie të veçantë e cila meriton vëmendje maksimale në luftën që të gjitha organet e drejtësisë kanë për të shmangur të gjitha rreziqet në jetën e fëmijëve.

PARIMI I INTERESIT MË TË LARTË TË TË MITURIT

Konventa për të Drejtat e Fëmijës është miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 Nëntor 1989 dhe ka hyrë në fuqi më 2 Shtator 1990. Ajo u ratifikua më pas nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Shkurt të vitit 1992 dhe hyri në fuqi në Mars të po atij viti. Ratifikimi i saj nga Kuvendi u realizua në përputhje me nenin 16 të Dispozitave Kryesore Kushtetuese (1991). Me hyrjen në fuqi të ratifikimit, tashmë Konventa është pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka epërsi mbi ligjet e vendit. Në nenin 3/1 të kësaj Konvente përcaktohet *parimi I interesit me të lartë të fëmijës*.

Sipas kësaj dispozite: ***“Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më***

134 www.parlamenti.al Relacion Per Projektligjin «Kodi I Drejtësisë per te Miturit ne Republikën E Shqiperise, fq 3 Versioni zyrtar

i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore..”

Konventa nuk përcakton mënyrën se si do të zbatohet parimi I interesit më të lartë të fëmijës por vetëm orienton shtetet palë, të angazhohet që t'i sigurojë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe për këtë qëllim, të marrë të gjitha masat legislative dhe administrative përkatëse.

Shtetit Shqiptar i lind si detyrim të sigurojë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

PARIMIT TË INTERESIT MË TË LARTË TË TË MITURIT I REFEROHEK KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

Pikërisht parimit të interesit më të lartë të të miturit I referohet Kodi I Drejtësisë Penale për të Mitur që në parashikimin e qëllimit¹³⁵ të këtij ligji, ndërkohë që ai përsëritet në vazhdimësi në të gjitha rastet e rregullimit të mënyrës së marrjes së vendimit në lidhje me të miturit në konflikt me ligjin.

Realizimi i këtij parimi nga pikëpamja praktike kërkon parashikime të përshtatshme ligjore, infrastrukturën por edhe njerëzit e duhur për tu zbatuar. Kodi I Drejtësisë Penale për të Miturit vë theksin në aplikimin e masave alternative dhe të drejtësisë restauruese lidhur me të miturit ndryshe nga legjislacioni I mëparshëm I cili një gjë të tillë e bënte vetëm në mënyrë indirekte duke sanksionuar se¹³⁶:

“Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete”

135 Neni 2/1 I ligjit 37/2017

“1. Të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit.”

136 Neni 229/3 I Kodit të Procedurës Penale I LIGJit Nr.7905, datë 21.3.1995 Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, Ndryshuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, Ndryshuar me ligjin nr.9911, datë 5.5.2008)

Në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit Parimi I Interesit më lartë të Fëmijës si një parim thelbësor kërkon nga ana e autoriteteve vendimarrëse marrjen në shqyrtim të disa rrethanave të rëndësishme si:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Në çdo rast vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit. E thënë ndryshe në rast të marrjes së një vendimi lidhur me kufizimin ose heqjen e lirisë së një të mituri Prokurorisë e në vijim Gjykatës I duhet të argumentojë se cilat kanë qënë rrethanat të cilat kanë bërë që të aplikohet një kufizim I tillë dhe si I shërben ai interesit më të lartë të fëmijës.

Periudha deri në 18 vjeç është në një moshë të tillë ku shpërthimet psikoemocionale janë të një karakteri të veçantë duke patur parasysh problemet psikosociale dhe zhvillimin hormonal në periudhën e adoleshencës. Në këtë kuptim shoqëria, familja por edhe organet drejtësisë kanë rolin e tyre tepër të rëndësishëm për ti manifestuar të miturit se mënyra e drejtë për të zgjidhur problemet nuk është ajo e zgjedhur prej tij duke u përfshirë në veprimtari kriminale. Kjo lloj përgjegjësie nuk duhet të na shtyjë të jemi më represivë se ç'është e nevojshme në këtë gjykim.

Nocioni i interesit më të lartë të fëmijës të mitur, përfaqëson kriter objektiv, vlerësimi i të cilit nuk mund të realizohet sipas një faktori unik dhe të pandryshueshëm, por vetëm si rezultat i një sistemi faktorësh të cilët u referohen përkatësisht:

Së pari, personalitetit të fëmijës dhe së dyti, personalitetit dhe gjendjes sociale, psikike dhe pasurore të secilit prind. Vlerësimi i faktorëve të secilit prej këtyre subjekteve të marrëdhënies prind-fëmijë, duhet të realizohet në raport krahasimor.

Nga ky përcaktim rezulton se interesi më i lartë i fëmijës, përbën parim dhe kriter me natyrë komplekse, të ndryshueshëm rast pas rasti, ad personam dhe dinamik, nga aplikimi i të cilit, implikohet vlerësimi nga gjykata i një sërë faktorësh apo elementësh që konkurojnë me njëri-tjetrin. Duhet dalluar dhe veçuar pikërisht ato faktorë, të cilët konsiderohen se gëzojnë cilësinë e përcaktimit në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të domosdoshme, e masës më të përshtatshme në mënyrë që të mos pengohet rritja dhe edukimi i fëmijës.

Me tepër rëndësi është “përgjegjësia” që I jepet organeve vendimarrëse të drejtësisë për të vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës edhe në rastin e mbrojtjes së interesave ligjore në **mënyrë kontradiktore**. Ky është një parashikim I guximshëm I cili në fakt I lejon autoritetit procedues të gjithë hapësirën e nevojshme për të siguruar interesin e fëmijës¹³⁷. Kjo sidomos në rastet e dhunës në familje të të cilat fëmija shfaqet akoma më vulnerabel dhe mendimi I tij rrezikon të transmetohet dhe shfaqet I manipuluar në raport me të vërtetën.

Parashikimet ligjore dhe rëndësia që I jepet garantimit të nevojave të fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit është shfaqje vullnetit të mirë që ka për sigurimin e një brezi I cili të ndjejë ndihmën e autoriteteve shtetërore në rastet e konfliktit me ligjin.

Sigurisht që duke qënë në fazat e para të zbatimit të tij fryma e re që sjell ky kod do të dojë kohë që të japë efektet e saj. Zbatimi I tij me efektivitet do të sjellë pasojë pozitive jo vetëm për të miturit në konflikt me ligjin por për të gjithë shoqërinë në dekadat në vijim.

137 Neni 16/7 I ligjit 37/2017:” Në rast se pretendimet e të miturit dhe të përfaqësuesit ligjor/procedural të tij janë kontradiktore, organi kompetent vlerëson pretendimin që i shërben interesit më të lartë të të miturit.”

BIBLIOGRAFI

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
3. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
4. Prof. Dr. Ismet Elezi, Prof. As. Dr. Skender Kaçupi, Dr. Maksim Haxhia, “Komentari I Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, GEER, Tiranë 2001.
5. Prof. dr. Ismet Elezi, Prof. as. dr. Vasilika Hysi, “Politika kriminale”, PEGI, Tiranë, 2006.
6. Prof. Dr. Ismet Elezi “Disa probleme në lidhje me kodin penal”, Jeta juridike, nr.1, tetor 2005.
7. Prof. Dr. Ismet Elezi, “Komentari i shtesave dhe ndryshimeve të reja në Kodin Penal (2003-2004)”, Albino, Tiranë, 2004.
8. Ismet Salihu, “E drejta penale”, Pjesa e përgjithshme, LEOPRINT, Prishtinë 2005.



DHUNA NË FAMILJE, MEKANIZMAT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE KUNDËR SAJ ME THEKS TË VEÇANTË TEK TË MITURIT

Msc.Dardan Ukaj

Dardan Lajçi, Phd- asistent ne Universitetin "Hazhi Zeka" Pejë

daki_l@live.com

ABSTRAKT

Për shkak se dhuna në familje dhe ajo ndaj të miturve është evidente, në hulumtim do të bëhet fjalë për dhunën në familje dhe dhunën ndaj miturve, e cila nuk paraqitet si çështje vetëm në një vend apo shoqëri, por një fenomen me të cilin ballafaqohet mbarë bota. Në aspektin e dhunës ndaj miturve do të flitet për shqetësimin botëror ndaj dhunës tek të miturit.

Hulumtimi do të vazhdojë me shtjellimin e aspekteve të trajtimit ligjor dhe sociologjik të dhunës në familje, definimi i dhunës ndaj të miturve, mbrojtjes së familjes me anë të ligjeve shtetërore dhe konventa ndërkombëtare, aspektin sociologjik të dhunës në familje si dhe shkaktarëve kryesorë të cënimit të vlerave të shoqërisë.

Për më tepër, në hulumtim do të flitet për trajtimin institucional të dhunës në familje – mbrojtjes institucionale të të drejtave në veçanti organi i kujdestarisë. Një vështrim do të hidhet mbi rolin e qendrave sociale, rolin e policisë, rolin e gjykatave, mediave dhe familjes në shoqëri, dhunën në familje, mekanizmat ligjorë dhe institucional për mbrojtje kundër saj me theks të veçantë tek të miturit. Në përfundim, hulumtimi do të ketë pikësynim dhunën në familjet Kosovare, me institucionet përgjegjëse të cilat merren me rastet e dhunës në familje, mekanizmat që merren me parandalimin, trajtimin dhe luftimin e dhunës në familje në zonat rurale poashtu dhe ato urbane, më konkretisht dhunës ndaj të miturve në vendin tonë.

Fjalë kyçe: *Dhuna, familje, institucionet, edukimi, mekanizmat legal, Kosova.*

1. OBJEKTI I PUNIMIT

Interesimi i kësaj temë është mjaft i lartë si në vendin tonë, po ashtu edhe jashtë vendit.

Në këtë punim do të gjeni trajtimin juridik dhe elementet bazë të dhunës në familje, pastaj do të zbërthehen llojet e saj mjaft me rëndësi, duke marrë në analizë ligje, dhe burime të tjera të cilat e rregullojnë mardhëniet familjare apo sensibilizojnë gjeneratat e ardhshme se si duhet luftuar këtë kategori të dëmshme për shoqërinë tonë dhe rrethin ku jetojmë, si për nga përmbajtja, ashtu edhe nga vet forma e tyre.

Kuptimi i dhunës në familje, duke filluar nga definimi i konceptit dhunë, e deri tek Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës, po ashtu organet e drejtësisë që merren drejtëpërdrejte me rastet e dhunës në familje, si dhe disa forma dhe raste që paraqesin dhunën në familje në shoqëritë tona.

2. METODA E PUNIMIT

Me ndihmën e metodës hulumtuese, jam përpjekur që në mënyrë sa më të qartë të përcaktojë kuptimin, format, çasjen apo mënyrat e keqëtrajtimit dhe përdorimin e dhunës, rëndësin e saj që ka në parandalimin e kësaj dukurie negative, si dhe interpretimin e ligjeve përkatëse. Është përdorur metoda përshkruese, gjithashtu për përshkrimin e termeve juridike mbi dhunën në familje, të hasura gjatë analizës dhe interpretimit të materialeve hulumtuese.

Gjatë tekstit në vazhdim kam përdorur edhe metodën kërkimore-shkencore, ku jam munduar të shqyrtojë legjislacionin e së drejtës së penale, të drejtën e procedurës penale, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe deklarata e gjenevës mbi të drejtat e fëmijës dhe deklarata mbi të drejtat e fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara.

Dhuna në familje nuk paraqitet si problem vetëm në një vend apo shoqëri, por paraqet një fenomen me të cilin përballlet e gjithë bota. Pasojat e dhunës në familje nuk bien vetëm ndaj personit që është ushtruar dhunë por prekin të gjithë anëtarët e familjes, e që shpeshherë dalin edhe jashtë saj duke u mani-

festuar me sjellje të ndryshme devijante edhe në shoqëri.

Termi “dhunë” është barazuar shpesh me dhunën fizike, dhuna me bazë gjinore mund të marrë forma të ndryshme, fizike, seksuale dhe psikologjike. Ky term përfshin një sërë praktikash dhe sjelljesh të dëmshme të kryera ndaj vajzave dhe grave, për shkak të seksit të tyre. Përderisa dhuna ndaj gruas nis nga statusi i pabarabartë, tipar ky i shoqërisë patriarkale, gjithnjë e më shumë ajo po trajtohet sipas këndvështrimit “gjinor” (UNICEF & Instituti i Studimeve të Opinioneve Publik, 2003).¹³⁸

Duhet theksuar se nuk ekziston ndonjë përkufizim universal mbi dhunën në familje. Në Kosovë, ajo përkufizohet si çdo veprim i qëllimshëm apo mosveprim që rezulton në keqtrajtim, kur kryhet nga një person i cili është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën, siç janë: keqtrajtimi fizik, keqtrajtimi psikik, keqtrajtimi seksual dhe keqtrajtimi ekonomik¹³⁹. Shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat, ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë.¹⁴⁰

Në Kosovë, sipas Fondacionit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara UNICEF, si dhe organizatave të tjera që merren me të drejtat e fëmijëve, thuhet se mbi 60 për qind e fëmijëve deri në moshën 14 vjeç, kanë deklaruar se kanë pësuar dhunë fizike dhe psikologjike nga prindërit dhe familjarët në familje dhe nga mësimdhënësit në shkolla.

Ata harrojnë se fëmijët janë fëmijë dhe se nuk janë të rritur dhe të pjekur që të mund ta përballojnë dhunën dhe pasojat e dhunës, sidomos anën psikike. Prindërit dhe mësimdhënësit që nuk kanë shpirt ndaj fëmijëve dhe nxënësve të tyre, harrojnë se përdorimi i dhunës ndaj fëmijëve në shoqëritë demokratike është i ndaluar me ligj.

Dhuna ndaj fëmijëve në familje bëhet prej moshës 2 vjeçare të fëmijës deri në moshën 18 vjeçare edhe pse sipas ligjit dhuna ndaj fëmijëve është e ndaluar.¹⁴¹

138 UNICEF & Instituti i Studimeve të Opinioneve Publik, 2003

139 Shih: Katalog Për Këshilla Dhe Ndihmë Për Viktimat E Dhunës Në Familje, OSCE Mission in Kosovo, fq. 2

140 Neni 2 paragrafi 1.2 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, LIGJI Nr. 03/L-182, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, 1 korrik 2010

141 “STOP” dhunës ngaj fëmijëve në familje dhe në shkolla, Ahmet Pllana, Agjensia e Lajmeve Ekonomia 2017.

Të gjitha problemet zgjidhen me këshilla dhe metoda edukative dhe humane dhe jo duke përdorur shkopin. Deri kur do të tolerohet ushtrimi i dhunës ndaj fëmijëve, qoftë në familje, qoftë në shkolla?

Organet e rendit dhe të drejtësisë duhet të ndërmarrin masa adekuate sipas ligjit për të ndaluar dhunën ndaj fëmijëve. Nëse një mësimdhënës ka ushtruar dhunë ndaj nxënësit të tij, drejtori i shkollës dhe Drejtoria Komunale e Arsimit duhet të ndërmarrin masa. Në këtë drejtim edhe më tepër duhet të angazhohet edhe Sindikata e Arsimit.

Tash jemi në kohën e demokracisë, andaj ka kaluar koha e dhunës ndaj fëmijëve.¹⁴²

Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet të punojnë më shumë në drejtim të ndaljes së dhunës në shkolla, duke shkuar nëpër shkolla dhe duke organizuar seminare dhe tribuna për dhunën.

Shprehjet të cilat përdoren në këtë kod për personat fizik në gjininë mashkullore nënkuptojnë shprehje të njejta në gjinin femërore.¹⁴³

TEKNIKA TË KOMUNIKIMIT ME FËMIJËN VIKTIMË

Fëmijët viktima të krimeve si trafikimi, shfrytëzimi seksual ose krime të tjera të rënda nuk duhet të trajtohen si autorë dhe bashkëpunëtorë të krimeve dhe ata nuk duhet t'i nënshtrohen procedurave të ngjashme si hetimi. Në rastet kur autor i veprës penale është një prind, një anëtar i familjes ose një kujdestar, avokati mbrojtës apo gjyqtari duhet të kërkojnë vendosjen e masave parandaluese të veçanta, me qëllim mbrojtjen e fëmijës/të riut. Avokati mbrojtës duhet të garantojë përfaqësim të përshtatshëm të fëmijës/të riut, si dhe përfaqësim të paruarur të fëmijës nga prindërit, veçanërisht në procese gjyqësore kur prindërit, anëtarët e familjes ose kujdestarët janë autorë. Krimet kundër fëmijëve duhet të ndiqen jo vetëm mbi bazë raportimi apo kallëzimi nga fëmija, por ndjekja e tyre duhet të vazhdojë edhe me heqjen dorë nga kallëzimi i fëmijës/të riut. Fëmijët viktima të krimeve të rënda dhe kujdestarët e tyre duhet të informohen, nëse ata dëshirojnë qoftë edhe përkohësisht, që personi, i cili ndiqet penalisht apo i dënuar, të lëshohet.

142 <http://www.ekonomia-ks.com/>

143 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROJEKT_KODI_I_DREJTESISE_PER_TE_MITUR.pdf

Gjatë procesit të intervistimit të fëmijës/të riut si viktimë, avokati mbrojtës duhet të ketë parasysh nevojat e fëmijës/të riut, të cilat përcaktohen gjithashtu bazuar në pikat e mëposhtme: 1. Moshë; 2. Niveli i zhvillimit të fëmijës/të riut; 3. Natyra e krimit të kryer: abuzim, neglizhim, abandonim; 4. Struktura e intervistës që duhet të adoptohet; 5. Niveli i edukimit dhe niveli kulturor i fëmijës/ të riut; 6. Kujtesa dhe sugjestionimi i fëmijës/të riut; 7. Niveli psikologjik i fëmijës/të riut; 8. Vendi ku do të realizohet intervistimi, i cili do të ketë formën e një bisedë private, por që është pjesë e një hetimi formal dhe për pasojë duhet të shmangët konfuzioni dhe shpërqëndrimi. Qëllim duhet të jetë marrja e informacionit mbi sfondin historik të fëmijës duke analizuar: 1. Gjendja mendore e fëmijës/të riut; 2. Gjendja fizike; 3. Moshë dhe zhvillimi mendor, inteligjenca; 4. Aftësia e tij/ e saj për të komunikuar; 5. Vështirësitë në kuptimin e gjërave (nëse ka); 6. Historia sociale dhe mjekësore, etj.¹⁴⁴ Edhe faktorët që do të ndikojnë në risocializim. Hulumtohen vlerat e risocializimit përmes punës në dobi të përgjithshme duke i krahasuar veçoritë e secilit regjion.¹⁴⁵

TRAJTIMI INSTITUCIONAL I DHUNËS NË FAMILJES

Mbrojta Institucionale e të drejtave (1) Punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t'i ushtron organi kompetent i administratës komunale i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale. 2 (2) Organi i Kujdestarisë është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale. Ai përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë. (3) Organi i Kujdestarisë mundet gjithashtu të jetë organ (grup i ekspertëve siç është cekur më lart) i veçantë i institucionit social i themeluar nga Kuvendi Komunal për të kryer detyrat e tilla. (4) Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmerr veprime tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet.¹⁴⁶

144 http://www.oakks.org/repository/docs/doracak_trainimi_p%C3%ABr_avokat%C3%ABt_n%C3%AB__fush%C3%ABn_e_drejt%C3%AB-sis%C3%AB_p%C3%ABr_f%C3%ABmij%C3%AB_945304.pdf

145 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E6D8742B-674B-4423-AFDB-5387D9C8E CDC.pdf>

146 http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_32_al.pdf

ROLI I QENDRËS SOCIALE

Fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata me çrregullime mentale ose fizike të diagnostifikuara, si dhe prindërit të cilët nuk janë të aftë të krijojnë kushtet e domosdoshme jetësore për vete dhe për fëmijët e tyre, janë nën përkrahjen e veçantë financiare dhe shoqërore;

Bashkësia shoqërore përkujdeset për personat e moshuar në rastet kur ata nuk janë në gjendje të sigurojnë kushtet jetësore dhe kur nuk kanë persona tjerë në gjini të cilët sipas ligjit janë të detyruar të kujdesen për ta.¹⁴⁷

ROLI I POLICISË

Duke i vlerësuar veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, për një trajtim ndryshe të tyre, nëpërmjet ligjit, me riorganizimin e strukturave, janë përcaktuar funksione të veçanta në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në Drejtoritë e Policisë në qarqe. Në Departamentin për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë e Luftës Kundër Krimeve të Rënda është krijuar Sektori i mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje. Ky sektor ndjek në dinamikë veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Ky sektor bashkëpunon me sektorë të tjerë që trajtojnë problemet e dhunës në familje, si në Ministrinë e Punës dhe mireqenies sociale, Ministrinë e Shëndetësisë si dhe me OJQ të ndryshme që kanë objekt trajtimin e dhunës në familje dhe të viktimave të tyre. Ky bashkëpunim realizohet në shkallë vendi dhe konsiston në zhvillimin e analizave të përbashkëta, në trajnimin e punonjësve të policisë, etj. për të njëjtin qëllim – parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të kësaj dhune.¹⁴⁸

MEDIAT DHE FAMILJA

Institucionet e Kosovës në përpjekje për të luftuar dhunën në familje përmes mekanizmave institucionale, janë organizuar dhe kanë themeluar strukturën Institucionale Kundër Dhunës në Familje në krye të së cilës kanë emëruar Koordinatorin Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe Grupin Koordinues Ndër-Ministror, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrive dhe Institucioneve tjera relevante të Kosovës. Ky grup është zgjeruar dhe plotësuar edhe me

147 http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_32_al.pdf

148 http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20Policy%20Officers%20in%20Albania.pdf



anëtar të tjerë, si vëzhgues nga shoqëria civile dhe partner ndërkombëtarë, të cilët mbështesin parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje në Kosovë. Bashkarisht ky grup është duke u përpjekur për të koordinuar dhe trajtuar dhunën në familje nga disa aspekte, duke filluar nga parandalimi (përmes ndërgjegjësimit aktivitetëve dhe hetimeve proaktive), duke vazhduar për mbrojtjen, rehabilitimin dhe reintegrimin e viktimave. Kordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje është zëvendësministri i Drejtësisë, i cili është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktivitetëve dhe veprimeve të parapara në Programin Kundër Dhunës në Familje.

FAMILJA E SHËNDOSHË DHE ROLI I SAJ NË SHOQËRI

Gjendja që kemi në Kosovë në pozitën e gruas në kuptimin juridik, besoj që është avancuar jo vetëm në kuptimin e barazisë së saj gjinore, por edhe se garantohet edhe në pozitën e brendshme, po edhe me ato konventa ndërkombëtare që kemi pranuar ne, por edhe për qasjen e saj edhe në politik edhe në biznes edhe në administratë edhe kudo tjetër, por në anën tjetër duhet të bisedojnë në veçanti për pjesën që ajo trajtohet që ne e quajmë “dhuna në familje” që kemi një ligj të veçantë për atë, por ne do ta definojmë jo vetëm dhunën fizike por në veçanti do të thojë dhunën financiare.

Mirëqenia dhe mbrojtja e fëmijëve kërkon që sistemi i drejtësisë për të mitur të ketë një bashkëpunim dhe koordinim shumë të ngushtë me qëllim arritjen e synimeve për parandalimin dhe luftimin e akteve të kundërligjshme të kryera nga të miturit, mbrojtjen e tyre, risocializimin dhe re-integrimin e shëndoshë në familje dhe shoqëri.¹⁴⁹

Institucionet e arsimit që japin dije, që japin shkencë, besojmë se ata duhet të japin edhe edukatën e veçantë që atë dije, atë edukatë të veçantë ta shëndrojnë në edukatë për ata, për familjen dhe për të ardhmen e tyre. Edhe mediat e opinionit publik duhet ta luajnë një rol të veçantë në dy drejtime: e para në rastet e dhunës në familje duhet të jenë të kujdesshme që ata njerëz apo viktimat të tilla të jenë të trajtuara si qytetarë të barabartë dhe trajtimi i tyre, afirmimi i tyre në shoqëri, nuk duhet të jetë me turp, por duhet të kuptohet si pjesë e një incidenti që ka mund të i ndodhë kujtdo prej nesh dhe e dyta mendoj që mediat

149 Përmbajtja e këtij protokoll është vetëm përgjegjësi Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) 2012.

duhet të jenë në kuptimin afirmative për prezantimin e vlerave të familjeve si diçka që ne e kemi të shenjt, apo si diçka që ndikon në trajtimin e tërësishëm të ambientit ku jetojmë.

Por, natyrisht që ka vend që edhe institucionet religjioze ta luajnë rolin e vet në këtë drejtim.

DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

Departamenti për të Mitur vepron në selinë e secilës gjykatë themelore dhe ka kompetencë të gjykoj veprat penale të kryera nga personat e mitur (personat ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjet) si dhe veprat penale të kryera nga personat madhor kur të miturit janë viktimë e veprës penale.

Departamenti për të Miturit përkujdeset për mirëqenien e të miturve; që çdo masë ose ndëshkim ndaj kryerësve të veprave që janë të kësaj grup-moshe të jetë në proporcion me rrethanat e shkelësit dhe veprës dhe që të drejtat e të miturve për privatësi të respektohen në të gjitha fazat për t'iu shmangur çdo dëmtimi nga publiciteti jo i duhur.

Gjyqtarët që gjykojnë në këtë departament janë të specializuar dhe se në trupat gjykues përveç gjyqtarëve profesionistë bëjnë pjesë edhe gjyqtarët porotë, të cilët janë nga radhët profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve. Të gjitha procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit janë konfidenciale.

BIBLIOGRAFIA

- UNICEF & Instituti i Studimeve të Opinionit Publik, 2003
- Katalog Për Këshilla Dhe Ndhmë Për Viktimat E Dhunës Në Familje, OSCE Mission in Kosovo, fq. 2
- Neni 2 paragrafi 1.2 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, LIGJI Nr. 03/L-182, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, 1 korrik 2010
- “STOP” dhunës ngaj fëmijëve në familje dhe në shkolla, Ahmet Pllana, Agjensia e Lajmeve Ekonomia 2017.
- Regjep Gashi, Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj te miturve

(Me Ligjin Penal për të Mitur), Dispensë Prishtinë, 2007, faqe 22.

- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikencës së mitur (Udhëzimet e Riadit) të miratuara dhe të shpallura me rezolutën 45/112 të Asamblesë së Përgjithshme më 14 Dhjetor 1990 sesioni i 68-të plenar, faqe 3, neni 13.
- Ismet Salihu , E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005.
- <http://www.ekonomia-ks.com/>
- http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROJEKT_KODI_I_DREJTESISE_PER_TE_MITUR.pdf
- http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_32_al.pdf
- http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_32_al.pdf
- http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20Policy%20Officers%20in%20Albania.pdf
- [http://www.mdks.net/repository/docs/Final_Albanian_Raporti_Vjetor_i_Progresit_2012\(aktivitetet_Kunder_Dhunes_ne_Familje\).pdf](http://www.mdks.net/repository/docs/Final_Albanian_Raporti_Vjetor_i_Progresit_2012(aktivitetet_Kunder_Dhunes_ne_Familje).pdf)

DHUNA TEK FËMIJËT DHE INFORMIMI LIGJOR I SHOQËRISË RRETH KËTIJ FENOMENI

**Prof Asoc. Dr. Arjana Muçaj,
Dr. Shkëlqim Xeka, Msc. Igli Muçaj**

Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

arjanamucaj@yahoo.it, igli_m@yahoo.it, xeka_al@yahoo.com

ABSTRAKT

Dhuna është një dukuri e dhimbshme e realitetit mbarë botërore dhe shoqërohet me pasoja të viktima. Nga dhuna nuk vuajnë vetëm të moshuarit, gratë, burrat por edhe fëmijët. Situata aktuale në Shqipëri, mund të ndryshojë nëse të gjithë aktorët marrin përsipër të luajnë një rol aktiv kundër dhunës. Kjo kërkon ndërgjegjësimin e publikut, të grupeve të ndryshme sociale të të gjithë moshave dhe profesioneve si dhe zbatimin e ligjit për të drejtat e fëmijëve kundër çdo lloj forme të abuzimit fizik dhe psikologjik. Faktorët që ndikojnë në dhunë janë të shumtë dhe të shumfishtë. Ata mund të klasifikohen të nivelit makro, të familjes ose mikro dhe faktorë individual. Në përpjekje për ta konkretizuar më tej natyrën e faktorëve ndikues mund të përmëndim: situatën ekonomike, politike, kulturën dhe normat e një kulture të lidhur me dhunën, lëvizjet demografike të popullësisë, faktorë që kanë të bëjnë me familjen si: modeli i prindërve, si dhe me faktorët personal të lidhur me personalitetin e dhunuesit.

Ky studim është i fokusuar në evidentimin e faktorëve që çojnë në ushtrimin e dhunës ndaj fëmijëve, efektet psikologjike që shoqërojnë dhunën e ushtruar mbi ta, dhe vërtetimin nëpërmjet pyetësorëve të kryer në terren ku janë marrë mendimet e qytetarëve të thjeshtë në lidhje me informimin ligjor për çështjen e dhunës ndaj fëmijëve. Në realizimin e studimit janë përdorur metodat sasiore

dhe cilësore. Rezultatet e këtij pyetësi tregojnë se njerëzit janë pak të informuar ose aspak se ekziston një ligj për dhunën në familje dhe masat që parashikon ligji.

Fjalë kyçe: *Fëmijë, dhunë psikologjike, ligj, faktor, shoqëri.*

HYRJE

Si vend ballkanik, shqipëria e ka përjetuar dhunën në familje të ligjëruar edhe nga zakonet e trashëguar, të shkruara e të pashkruara të vendit. Shoqëria shqiptare e viteve të tranzicionit ka përjetuar ndryshime të ndjeshme edhe në sistemin e vlerave dhe të moralit sundues në shoqëri. Ndërkohë, mungesa e politikave sociale në favorë të shtresave në nevojë, mungesa e investimeve serioze në arsim dhe shëndetësi, mungesa e projekteve zhvilluese në zonat e prapambetura, malore apo më pak mundësi zhvillimi, kanë ndikuar ndjeshëm në shpeshhtësinë dhe përhapjen e dukurisë së dhunës në familjen shqiptare. Dhuna në familje është një sjellje që: - Mësohet përmes vëzhgimit - Mësohet përmes eksperiencës dhe përforcimit të vazhdueshëm - Mësohet nga kultura - Mësohet nga familja - Mësohet në komunitet, në shkollë, në grupe shoqërore, në vëndet e punës. Efektet e të rriturit me dhunë në familje mund të jetë shkatërrimtare për fëmijët. Fëmijët e grave të keqtrajtuara ka shumë të ngjarë që të keqtrajtohen edhe vetë. Ata jetojnë në frikë të vazhdueshme dhe shpeshherë janë të sflitur fizikisht dhe emocionalisht teksa e ndiejnë veten të ndarë mes dy kujdestarve të rritur: ata mund të shfaqin reagime të forta fizike dhe emocionale ndaj dhunës, përfshirë simptomat e crregullimit funksional nga stresi dhe traumave. Fëmijët që bëhen dëshmitarë të dhunës, në familje mësojnë se dhuna është një mënyrë e përshtatshme për të zgjidhur konfliktet dhe ka të ngjarë që përvojat e dhunës gjatë fëmijërisë së tyre ti përjetijnë në marrëdhëniet e tyre në moshë të rritur dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre.

“Dhuna është cdo llojë sjellje apo qëndrim ndaj fëmijës që dëmton ose rrëzikon mirëqënien e tij/saj emocionale, fizike dhe psikologjike dhe për pasojë shkakton ndërprerje apo vonesa në procesin normal të zhvillimit”.

Bazuar në legjislacionin në shqipëri: “Fëmijë quhet cdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç duke përjashtuar ato raste ku sipas ligjeve në fuqi moshë e pjekuri arrihet më parë. Ndikimi mbi fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në

familje, është i njëjtë më pasojat e abuzimit të fëmijës prej njërit prej prindërve dhe kjo dëshmi dhune ka një ndikimë të madh për të qënë të dhunshëm në moshë të re. Për më tepër , neglizhimi është gjithashtu një formë dhune, pasi prindi i mohon fëmijës të drejtën e ushqyerjes, higjenës, shkollimit, dhe vërteton mungesën e mbikëqyrjes apo edhe braktisjen.

METODOLOGJIA

Kampioni

Ky studim u realizua në qytetin e Durrësit

Popullata e përgjithshme, kampionimi 118 persona

Kampioni rastësor i thjeshtë, ky lloj kampionimi u jep shans të barabarta çdo pjesëtar të populltës për të qënë pjesë e kampionit. Në këtë studim, target grupi që u mor në intervista i përkiste të dyja gjinive si mashkull ashtu dhe femër. Kampionimi ishte 118 persona të shtresave të ndryshme sociale, pra nuk ishin vetëm persona me poste zyrtare të institucioneve por edhe njerëz të thjeshtë. Moshë e tyre varion nga 18- 65 vjec. Arsimimi ishte i ndryshëm duke filluar që nga ata pa arsimin e lartë e deri tek ata me arsim të lartë. Punësimi i tyre është i ndryshëm, ku disa të pyetur ishin të vetëpunësuar, të tjerë të punësuar, të papunë, shtëpiakë., pensionist e nxënës. Hapat e ndjekura në realizimin e këtij studim përfshijnë kombinimin e metodave cilësore dhe sasiore. Metoda cilësore eksploron sjelljet, qëndrimet dhe eksperiencat përmes metodave të tilla si intervistat dhe focus-grupet. Qëllimi i tij është që të mbledhë opinonet e pjesëmarrësve. Metoda sasiore gjeneron statistika përmes përdorimit të anketimeve në shkallë të gjerë, duke përdorur pyetësorët ose intervistat e strukturuar.

Ky studim është bazuar edhe në ligjeslacionin në fuqi për dhunën në familje nga ku ka dhe pikënisjen mbi atë sa të informuar janë qytetarët ndaj këtij fenomeni dhe masat parandaluese ndaj tij. Sipas ligjit;Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREUI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të vecantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Objekti

Ky ligj ka si objekt:

- a. krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- b. orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- c. fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- d. sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të vecanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Dhunë” është cdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. “Dhunë në familje” është cdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.
3. “Pjesëtarë të familjes” janë:
 - a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
 - b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
 - c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;
 - c) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
 - d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;
 - dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.
4. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
5. “Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.
6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.
7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar për kohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrorit të mbrojtjes me vendim gjykate.



Neni 4


Subjektet

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3 pika 3 të këtij ligji.

REZULTATET


Analiza e të dhënave

A/1 Gjinia




Në këtë studim u përfshinë 118 persona nga të dy gjinitë (femra dhe meshkuj) kjo përfshirje ishte në raport gati të njëjta pra u pyetën 60 –gra që përbëjnë 50.8 % dhe 58 burra që përbëjnë 49.1%.

A/2 Grupmosha




Nga 118 persona të pyetur për: Grupmoshën 18-24 vjec u pyetën 40 persona që përbëjnë 33.89%. grupmosha 25-34 vjec u pyetën 25 persona që përbëjnë 21.1%. Grupmosha 35-49 vjec u pyetën 30 persona që përbëjnë 25.4%. Grupmosha 50-64 vjec u pyetën 20 persona që përbëjnë 16.9%. Për grupmoshën mbi 65vjec u pyetën 3 persona që përbëjnë 2.5%.

Sa informacion keni ju në lidhje me çështjet e dhunës në familje në Shqipëri.



Nëse keni informacion në lidhje me këtë çështje, cilat janë mënyrat që ju I keni përfituar ato:



Nga 118 të pyeturit 25 prej tyre (21%) kanë marrë informacion nëpërmjet medias së shkruar, 70 prej tyre (59%) kanë marrë informacion nëpërmjet medias vizive, 5 prej tyre (4.2%) kanë marrë informacion nga trajnimet, 10 persona (8.4%) kanë marrë informacion nëpërmjet fletpalosjeve dhe posterave, asnjë prej tyre ose (0%) nuk kanë marrë informacion nga miq të afërm, 3 prej tyre ose (2.5%) kanë marrë informacion nga fushata sensibilizuese, 5 prej tyre (4.2%) kanë marrë informacion nga interneti.

PËRFUNDIME

Nga përdorimi i pyetësorëve por e dhe nga përshkrimi i rasteve vihet re se dukuria e dhunës është e pranishme në familje shqipëtare. Rezultoni që forma të dhunës që takohen në mjediset shqipëtare janë ato më klasiket: dhunë fizike, psikologjike, seksuale. Rezultatet e këtij pyetësori tregojnë se njerëzit janë pak të informuar se ekziston një ligj për dhunën në familje dhe masat që parashikon ligji. Pyetësorët vërtetuan nivelin e njohurive të femrave dhe të meshkujve mbi çështjet e dhunës në familje si dhe për ligjin që mbrojnë të drejtat e fëmijëve ose e thënë ndryshe njohuri mbi konventë e të drejtave të fëmijëve. Ata mund

të klasifikohen të nivelit makro të familjes ose mikro dhe faktorë individual. Në përpjekje për ta konkretizuar më tej natyrën e faktorëve ndikues mund të përmëndim: situatën ekonomike, politike, kulturën dhe normat e një kulture të lidhur me dhunën, lëvizjet demografike të popullësisë, faktorë që kanë të bëjnë me familjen si: modeli i prindërve, edukata, atmosfera, si dhe me faktorët personal të lidhur me personalitetin e dhunuesit dhe të viktimës.

Nga rezultatet e pyetësorëve delë në pahë mungesa e informimit mbi ligjin kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesa me e madhe e informacionit ngelet media vizive. Po nga ky pyetësor doli në pah se ata që e njihnin më shumë ligjin ishin grupmoshat 25-49 vjec të cilët kanë arsimë të mesëm dhe të lartë por edhe që ishin të punsuar me kohë të plotë dhe që frekuentonin universitetin. Pjesmarrja aktive dhe profesionale e medias në këtë luftë konsiderohet me vlerë dhe efekt të jashtzakonshëm.

BIBLIOGRAFIA

- Bregu M. “Dhuna, kuptimi dhe llojet e saj. Shkaqet e dhunës në familje. Pasojat mbi gruan.
- Dervishi Z, “Gratë në syrin e ciklonit, të sfidave e prespektivave”, Tiranë 2001.
- Haxhiymeri E,&Kulluri E,” Prezantimi i informacionit ekzistues mbi dhunën në familje në Shqipëri”.
- Manual “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje”OSCE, Tiranë 2008.
- Material i GADC (Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim) “Dhuna në familje, paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri” Tiranë 2006.
- Giddens A, “Sociologjia”, Tiranë 2004.

BACKGROUND:

Lack of emotional intelligence (EI) may lead to maladjustment and inability to achieve desired goals. A relationship between low levels of EI and crime has been proposed.

AIM:

The aim was to assess the relationship between EI and criminal behavior.

MATERIALS AND METHODS:

Study sample consisted of 202 subjects, in whom 101 subjects were convicted offenders, and 101 were matched normal controls. Offender group comprised of individuals convicted for different crimes such as murder, rape, and robbery, selected from Birsa Munda Central Jail, Hotwar, Ranchi, Jharkhand, India based on purposive sampling. Sample of the normal control group was taken from Ranchi and nearby areas. All subjects gave informed consent for participating in the study. Both the groups were matched on age, gender, education, occupation, and marital status. All participants were assessed on General Health Questionnaire-12 and Mangal Emotional Intelligence Inventory (MEII). The results were analyzed using statistical package SPSS-version 20.

RESULTS:

The group of convicted offenders obtained significantly lower scores on all the domains of MEII such as intrapersonal awareness (own emotions), interpersonal awareness (others emotions), intrapersonal management (own emotions) and interpersonal management (others emotions), and aggregate emotional quotient in comparison to their normal counterparts.

CONCLUSION:

The convicted offenders group had significantly lower EI compared to normal subjects. Starting EI enhancement program in prison can help the inmates better understand their feelings and emotions.

Keywords: *Criminal behavior, emotional intelligence, emotional quotient*

KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR DHE LLOJET E VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA TË MITURIT NË SHQIPËRI

Dr. (Drejtues) Bajram Ibraj

Drejtori i Sigurisë Fizike të Intesa Sanpaolo Bank Albania

bajramibraja@yahoo.com

ABSTRAKT

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ka si qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve e të miturve, integrimi social i tyre, rehabilitimi i të miturve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve e të miturve dëshmitar dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë. Ky Kod për të miturit viktimë, dëshmitarë dhe autorë të veprave penale ofron garanci juridiko-ligjore e sociale, ndërmjetësim, rishoqërim e rehabilitim, Rregullat e Standartit Mini-mum lidhur me drejtësinë penale dhe të drejtat e shprehura në aktet normative të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë e Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës.

Në këtë kumtesë trajtohen llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në Shqipëri. Nga përpunimi dhe analiza e të dhënave statistikore të kryerjes së veprave penale nga të miturit, si dhe e analizimit të shkaqeve kryesore që i çon fëmijët në konflikt me ligjin, rezulton se, mungesa e masave social-ekonomike në drejtim të familjeve, dhe mungesa e një sistemi referimi kombëtar dhe lokal ka sjellë një situatë problematike në këtë drejtim. Numri i fëmijëve dhe të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri ka ardhur në rritje.

Fjalë kyçe: *i mitur, vepra penale, mbrojtje, drejtësi penale.*

1. HYRJE.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54, pika 1 dhe 3 shprehet: “1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.3.Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal”.⁽¹⁾Sipas nenit 1 të Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, me “fëmijë” kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç kur moshja madhore arrihet më përpara, sipas legjislacionit të cilit ai i nënshtrohet.⁽²⁾Mungesa e masave edukuese, rishoqëruuese e rehabilituese, masave social-ekonomike në drejtim të familjeve dhe mungesa e një sistemi referimi kombëtar dhe lokal, në vendin tonë kanë sjellë një situatë problematike.

2. SIGURIZIMI I FËMIJËVE DHE TË MITURVE.

Sipas Konventes mbi të Drejtat e Fëmijës,⁽³⁾ janë katër parime bazë: e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit, e drejta për mos diskriminim. Ndërsa, sipas Shkollës së Kopenhagës: Siguria e fëmijëve vihet në rrezik edhe nga mungesa e funksionit të institucioneve shtetërore, dhe dilema e pasigurisë së shtetit i ka rrënjët në strukturat themeltare dhe proceset e papërfunduara të krijimit të shtetit.Në këtë kuptim,“Shtetet e dobëta,karakterizohen nga dobësia institucionale, destabiliteti politik,centralizimi i pushtetit, demokracia e pakonsoliduar, krizat ekonomike, ndjeshmëritë e larta të jashtme, ndarjet sociale, mungesa e identitetit kombëtar dhe kriza e vazhdueshme e legjitimitetit”.⁽⁴⁾

Çështja e sigurisë së fëmijëve dhe të miturve, duhet konsideruar një proces sigurizimi, i cili përfshin një akt politik, domethënë në rastin konkret Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, dhe një akt tjetër sigurie për fëmijët e të miturit, të cilët mendoj se janë aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, për garantimin e funksionimit të sistemit penal e të sigurisë në Shqipëri, për fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe ngritjen e funksionimit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve.

3. LLOJET E VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA TË MITURIT NË SHQIPËRI.

Kriminaliteti i të miturve mbart probleme shumë të mëdha për sot dhe veçanërisht për të ardhmen. Problemet krijohen jo vetëm nga dhe ndaj fëmijëve dhe të miturve por edhe ndaj shtetit, shoqërisë e familjes. Sipas Avokatit të Popullit: “Fëmijët, të cilët kanë qenë në konflikt me ligjin, në gjykatë apo burg, nuk trajtohen gjithmonë shumë mirë. Standardet janë rregullat që duhet të ndjekin qeveritë.”⁽⁵⁾ Gjatë punimit, jemi bazuar në të dhënat dhe statistikën zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën katër vjeçare, 2014-2017 dhe për disa tregues të tjerë për periudhën nëntë vjeçare, 2007-2015. Llojet e veprave penale të kryera nga të miturit, 2014-2017, paraqiten në tabelën 1.

Tabela 1. Llojet e veprave penale të kryera nga të miturit, 2014- 2017.

Nr.	Llojet e veprave penale te kryera nga te miturit	Numri i te miturve ne konflikt me ligjin				
		Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Vitet 2014-2017
1	Vrasje (Nenet 76 – 79 K.P)	3	5	4	4	16
2	Vrasje ne Tentative (Nenet 22, 76 -79 K.P)	9	12	9	11	41
3	Plagosje rëndë me dashje (Neni 88 K.P)	19	24	19	12	74
4	Plagosje lehtë me dashje (Neni 89 K.P)	166	153	130	154	603
5	Dëmtime tjera me dashje (Neni 90 K.P)	101	114	125	126	466
6	Krime seksuale (Nenet 100 – 108 K.P)	9	15	15	16	55
7	Kanosja (Neni 84 K.P)	61	46	37	49	193
8	Vjedhje (Neni 134 K.P)	536	712	600	577	2425
9	Vjedhe me dhunë (Neni 139 K.P)	0	19	35	48	102
10	Vjedhje me armë (Neni 140 K.P)	30	6	1	0	37
11	Shkatërrim i pronës (Neni 150 K.P)	9	61	51	63	184
12	Prodhim e mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe municioneve (Neni 278 KP)/arme te ftohta (neni 279 KP)	76	67	48/52	31/34	143
13	Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor (Nenet 290 & 291 K.P)	288	377	323	351	1339
14	Prodhimi dhe shitja e narkotikeve (neni 283 KP)	82	96	122	89	389

Burimi: Shkresa nr S-1/1 prot, datë 25.1.2018. www.asp.gov.al. Përpunim i autorit (shkurt 2018).

Në mënyrë tabelare rezulton se, në Shqipëri, janë evidentuar 14 lloje të veprave penale të kryera nga të miturit, për periudhën 2014-2017, nga të cilët numri i të miturve në konflikt me ligjin, në total është 6.067 të mitur në konflikt me ligjin. Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore zyrtare të Policisë së

Shtetit,⁽⁶⁾rezultun se në konflikt me ligjin, për vjedhje, janë 2.425 të mitur, për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor (neni 290 Kodit Penal),1.339 të mitur, prodhim e shitje e narkotikëve, 389 të mitur, 143, vjedhje me dhunë vjedhje me arme 37, vrasje në tentativë 41 dhe vrasje 16.Llojet e veprave penale sipas tendencave për vitin 2017, paraqiten në tabelën 2.


Tabela 2. Llojet e veprave penale sipas tendencave për vitin 2017.

Nr.	NENI	VEPRAT PENALE SIPAS TENDENCAVE	VEPRA PENALE EVIDENTUAR GJITHSEJ	AUTORE			TE DEMTUAR		
				GJITHSEJ	NEN 14 VJEC	14-18 VJEC	GJITHSEJ	NEN 14 VJEC	14-18 VJEC
1	76-22	Vrasje ne Tentative	69	80	0	7	80	0	6
2	79-22	Tentative vrasje ne rrethana te tjera cilesuese	14	23	0	3	28	1	0
3	79/c-22	Tentative vrasje per shkak te marredhenieve familjare	13	16	0	1	17	0	1
4	76	Vrasje me dashje	14	16	0	2	15	0	1
5	78	Vrasje me paramendim	16	11	0	2	20	0	0
6	84	Kanosja	1292	1430	4	45	1365	8	39
7	88	Plagosje e rende me dashje	117	134	2	10	136	2	6
8	89	Plagosje e lehte me dashje	1165	1576	14	140	1406	19	108
9	90	Demtime te tjera me dashje	1366	1776	7	119	1676	22	124
10	100	Marredhenie seksuale/ Homoseksuale me te mitur	18	17	0	5	18	17	1
11	108	Vepra te turpshme	27	29	4	2	28	22	3
12	108/a	Ngacimi seksual	32	29	1	3	31	2	13
13	121/a	Pemdjekja	173	162	0	3	165	2	22
14	124	Braktisja e femijes se mitur	101	105	1	4	93	30	36
15	124/b	Keqtrajtimi i te miturit	45	59	0	0	46	37	4
16	125	Mosdhenia e mjeteve per jetese	13	15	0	0	10	3	0
17	134-22	Tentative vjedhje	394	300	23	52	345	1	8
18	134/b	Vjedhje lokale tregtie	492	381	59	96	464	0	2
19	134/c	Vjedhje banesa	1145	629	33	91	1153	1	4
20	134/d	Vjedhje makina	329	157	1	3	329	0	0
21	134/e	Vjedhje te tjera	1949	1419	79	214	1747	15	68
22	139/b	Vjedhje me dhune lokale	35	44	0	20	32	0	0
23	139/c	Vjedhje me dhune banesa	24	17	0	1	26	1	0
24	150	Shkaterrimi i prone	852	842	19	44	688	0	2
25	151	Shkaterrim prone me zjarr	387	128	5	7	318	1	0
26	236	Kundershtim i punonjesit te policise rendit publik	250	387	0	8	82	0	0
27	242	Mosbindja ndaj punonjesit te policise	409	511	1	22	61	0	0
28	273	Largim nga vendi i aksidentit	347	212	0	10	63	3	2
29	274	Prishje te rendit e qetesise publike	288	423	3	18	61	0	8
30	275	Perdorimi me keqdashje thirrjeve telefonike	288	232	1	9	247	0	10
31	278	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe municione	666	711	2	29	6	0	0
32	279	Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve te flohta	232	268	3	31	3	0	2
33	283	Prodhimi dhe shitja e narkotikeve	1061	1378	1	88	0	0	0
34	283/a	Trafikimi i narkotikeve	186	229	0	3	0	0	0
35	283 komplet	Prodhimi dhe shitja e narkotikeve (Komisariati)	540	604	1	91	0	0	0
36	284	Kultivimi i bimeve narkotike	283	271	0	3	0	0	0
37	290	Shkelje te rregullave te qarkullimit rrugor	2247	2112	6	56	3077	265	165
38	291	Shkelje te rregullave te qarkullimit rrugor ne gjendje te dehur, pa deshmi	2722	2749	14	275	65	1	10
39	300	Moskallzim krimi	133	233	0	15	2	0	0
40	0	Ngjarje aksidentale qe marrin numer unik	1355	0	0	0	1322	79	41
41	9669	Dhune ne familje	2593	2659	8	18	2338	37	44

Burimi:Shkresa nr S-1/1 prot, datë 25.1.2018. www.asp.gov.al. Përpunim i autorit(shkurt 2018).

Në mënyrë tabelare rezulton se, në Shqipëri për vitin 2017, janë evidentuar 40 lloje të veprave penale të kryera nga fëmijët dhe të miturit në konflikt me ligjin, (autorë) dhe 35 lloje të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve dhe të miturve, (të dëmtuar, viktima). Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore zyrtare të Policisë së Shtetit, rezulton se numri më i lartë i veprave penale të kryera nga fëmijët dhe të miturit, është për tentativë e vjedhje (të ndryshme) 477 autorë të mitur dhe 195 autorë fëmijë, ndërkohë që të dëmtuar ose viktima janë evidentuar 82 të mitur dhe 18 fëmijë të dëmtuar, për shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur e pa dëshmi, 275 autorë të mitur, dhe 14 autorë fëmijë. Nga analizimi e përpunimi i të dhënave statistikore rezulton se vetëm gjatë vitit 2017, janë evidentuar 292 autorë të veprave penale fëmijë të moshës nën 14 vjeç, ose 18.7% e totalit të autorëve të veprave penale nga të miturit dhe 1.560 autorë të mitur të moshës 14-18 vjeç. Të mitur të paraburgosur dhe të dënuar sipas grupmoshave, 2007-2015, paraqiten në grafikun 1.

Grafiku 1. Të mitur të paraburgosur dhe të dënuar sipas grupmoshave, 2007-2015.




Burimi: Shkresa nr S-1/1 prot, datë 25.1.2018. www.asp.gov.al. Përpunim i autorit (shkurt 2018).

Në mënyrë grafike rezulton se, në Shqipëri të mitur të paraburgosur dhe të dënuar sipas grupmoshave, 2007-2015, janë gjithsej 1652, nga të cilët të mitur të moshës 14 vjeç janë 60, të moshës 15 vjeç, 148, të moshës 16 vjeç, 532 dhe të moshës 17-18 vjeç janë 814 të mitur, ose 49.27 %. Ndërsa, Avokati i Popullit shprehet: “Edhe sot në vitin 2016 fëmijëve ju shkelen të drejtat e garantuara nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Pavarësisht përpjekjeve të bëra ndër vite, institucionet shtetërore kanë dështuar në garan-

timin e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin”.⁽⁷⁾Megjithatë, në disa shtete, asnjë fëmijë dhe i mitur nën 18 vjeç nuk dënohet me burgim, por ata mbahen nën kujdestarinë e një agjencie sociale, dhe jo në një vend i cili është pjesë e sistemit të drejtësisë penale.Numri i përsëritjes së krimeve nga të miturit (Recidivizmi),2007-2015,paraqiten në grafikun 2.

Grafiku 2. Numri i përsëritjes së krimeve nga të miturit (Recidivizmi), 2007-2015.



Burimi:Shkresa nr S-1/A prot, datë 25.1.2018. www.asp.gov.al.Përpunim i autorit (shkurt 2018).

Në mënyrë grafike rezulton se, në Shqipëri, për vitet 2007-2015 janë evidentuar 447 autorë përsëritës (recidivistë) të veprave penale të kryera nga të miturit, ndërkohë që në vitet 2007-2009 janë evidentuar 48.5% e përsëritësve në veprat penale të kryera nga të miturit.Kjo argumenton faktin që mosngritja e mosfunktionimi i shërbimeve rehabilituese ka ndikuar ndjeshën edhe në rritjen e numrit të autorëve përsëritës të veprave penale të kryera nga të miturit. Avokati i Popullit shprehet: “I bëj thirrje të gjithë institucioneve shtetërore, por jo vetëm atyre, të ndërmarrin të gjitha përpjekjet e nevojshme për të përmirësuar jetën e të miturve në konflikt me ligjin.Sipas standardeve ndërkombëtare **burgu duhet të përdoret vetëm si masa e fundit dhe për periudhën më të shkurtër kohore.**”⁽⁸⁾ Qëllimi parësor i rregullimit adekuat të pozitës së të miturve në legjislacionin penal është parandalimi dhe risocializimi i tyre dhe jo ndëshkimi për pasojat e shkaktuara ndaj shoqërisë me veprimet inkriminuese të të miturve. Ky qëllim lypet të jetë synimi kryesor i politikës së luftimit të kriminalitetit.

4. PËRFUNDIME, REKOMANDIME.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, për vendin tonë, paraqet një rëndësi dhe vlerë të veçantë, për drejtësinë ndaj të miturve, sepse deri në miratimin e këtij Kodi, mungonte një sistem ligjor i unifikuar, apo një kod gjithëpërfshirës, lidhur me drejtësinë penale për të mitur. Nga ky studim, si zgjidhje më të suksesshme për të ardhmen do të ishte e rekomandueshme:

Së pari, do të duhej që në praktikë të krijohet Drejtësi “miqësore” për fëmijët, të miturit dhe të rinjtë. Për këtë, lypet që institucionet e drejtësisë penale dhe ato sociale e shoqërore të respektojnë e zbatojnë me korrektësi kërkesat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, dhe të respektohen detyrimet ligjore sipas afatëve përkatëse me qëllim implementimin e normave të këtij Kodi.

Së dyti, nga punimi rezulton se për periudhën 2014-2017 nga fëmijët dhe të miturit, janë kryer 14 lloje të veprave penale, duke evidentuar 6.067 të mitur në konflikt me ligjin. Gjithashtu, për periudhën 2014-2017, ndaj të miturve janë kryer 13 lloje të veprat penale, duke evidentuar 50.593 të mitur në konflikt me ligjin. Këto shifra tregojnë për numrin e lartë të veprave penale të kryera nga e ndaj të miturve.

Së treti, të bëhen ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal, lidhur me trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, viktima dhe dëshmitarë të veprave penale, hartimin e dokumentave përkatës të trajtimit të të miturve si viktima dhe dëshmitarë, si dhe përshtatjen e ambienteve të policisë kur intervistohen dhe mbahen të miturit, trajnimi i gjykatësve, prokurorëve, policisë gjyqësore, avokatëve dhe punonjësve sociale. Duke qënë se fëmijët dhe të miturit, përbëjnë afërsisht 40% të popullsisë në vendin tonë, dhe rreth 10% të autorëve të veprave penale, në raport me totalin e ndodhjes së veprave penale, rekomandohet që Institucionet e Drejtësisë Penale, dhe institucionet e shërbimit të tjerë të shoqërisë, të miratojnë dhe të bëjnë eficientë, minimalisht 10% të strukturave dhe punonjësve të tyre, për sigurinë, mbrojtjen ligjore e sociale dhe ri-integrimin e tyre përmes edukimit, trajnimit dhe punësimit të fëmijëve dhe të miturve në Shqipëri.

Së katërti, duhet të merren masa për ndryshimin e mentalitetit të shoqërisë sonë për mospërdorimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe të miturve. Për ta realizuar të këtë lypet që: 1. Niveli i sigurisë së jetës e shëndetit të fëmijëve dhe të miturve

në familje, në shkolla, në ambientet publike, etj, të bëhet realitet në praktikë duke minimizuar në maksimumin e mundshëm të gjitha llojet e pasigurive të tyre, pra, të bëhet sigurizimi i tyre, dhe 2. Të gjitha aktet dhe format e dhunshme të rregjistrohen dhe raportohen pranë një sistemi kombëtar që duhet të ngrihet për këtë qëllim.

Së pesti, të merren masa të shpejta për krijimin dhe mirëfunksionimin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve, duke vendosur në këtë institucion fëmijët nën moshën 14 vjeç, si dhe të miturit në moshën 14-18 vjeç, me qëllim rishoqërimin e të miturve.

Së gjashti, bazuar në të dhënat statistikore të Policisë së Shtetit ku janë evidentuar 292 autorë të veprave penale fëmijë të moshës nën 14 vjeç, ose 18.7% e totalit të autorëve të veprave penale nga të miturit; 1.560 autorë të mitur të moshës 14-18 vjeç, gjatë vitit 2017; 48.5% e përsëritësve në veprat penale të kryera nga të miturit gjatë vitet 2007-2009; problematikat e evidentuara dhe pasojat e pariparueshme ndaj fëmijëve dhe të miturve në konflikt me ligjin, viktimë dhe dëshmitar i veprave penale, si dhe faktit që përderisa, e drejta penale ka lindur si mënyrë dhe mjet për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, dhe detyrat e të drejtës penale janë lufta dhe parandalimi i kriminalitetit, mbrojtja e rendit ekonomiko-shoqëror nga veprat penale, dhe argumentat e trajtuara në këtë punim, propozoj të merren masat e mëposhtme; 1. të merret eksperiencia e 16 shteteve të ndryshme si; Iraku, India, Egjipti, Qipro (7 vjeç); Filipine, Israel, Jordani, Paraguaj, Malta, (9-10 vjeç); Britania e Madhe (10 vjeç), shënim: vetëm për shkelje trafiku, për krime serioze, vetëm masa edukative, mbrojtje e veçantë e fëmijës; Franca (10-13 vjeç), Greqia, Polonia, Panamaja, Irlanda, Portugalia (12-13 vjeç); 2. të ngrihet një grup i studimit shkencor ndërdisiplinor me: kriminologë, sociologë, psikologë, mjekë, biologë, neurologë, edukatorë, jurist-penalistë dhe oficerë të policisë gjyqësore për të provuar tezën: “Nëse ulja e moshës së përgjegjësisë penale në Shqipëri siç është bërë në disa vende të tjera do të ndikonte pozitivisht apo negativisht ndaj fëmijëve nën 14 vjeç dhe ndaj të ardhmes së tyre”; 3. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 12, Moshë për përgjegjësi penale të ndryshojë si vijon: “Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën dymbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundravajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën katërbëdhjetë

vjeç”; dhe 4. fëmijët dhe të miturit që kryejnë vepra penale nga mosha 12 deri 18 vjeç, të mos dënohen me vendime nga gjykata, por të vendosen në Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve, dhe/ose (vetëm për shkelje trafiku, për krime serioze, të merren vetëm masa edukative dhe mbrojtje e veçantë e fëmijës dhe viktimës, pra, të aplikohet modeli i Britanisë së Madhe).

BIBLIOGRAFIA

1. Kodi i Procedurës Penale e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi i Penal i Republikës së Shqipërisë.
3. Ligj nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
4. Collins, Alan “Studime Bashkëkohore të Sigurisë”, botuar nga UET Press, Tiranë, 2010.
5. Herring, Jonathan “E Drejta Penale” - teori, kazuse dhe materiale, botimi V, volume 1, shtëpia botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, tetor 2013.
6. Hysi, Vasilika “Kriminologjia”, Tiranë, 2010.
7. Latifi, Vesel, Elezi, Ismet, Hysi, Vasilika “Politika e Luftimit të Kriminalitetit”, Prishtinë, Kosovë, 2012.
8. Muçi, Shfaqet “E Drejta Penale- pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012.
9. Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.7003, datë 28.10.1985 “Për hapjen e Shkollës së riedukimit të të miturve”.
10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.438, datë 20.12.1986, “Për hapjen e Shkollës së riedukimit të të miturve”.
11. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 54, pika 1 dhe pika 3.
12. Konventa për të Drejtat e Fëmijës është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1989. Konventa për të Drejtat e Fëmijës u ratifikua me ligjin nr.7531, datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës” nga Republika e Shqipërisë në shkurt 1992 dhe ka hyrë në fuqi në mars 1992.
13. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1989, ratifikuar me



ligjin nr.7531, datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”.

14. Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të Sigurisë”, botuar nga UET Press, Tiranë, 2010, faqe 197.
15. Avokati i Popullit “Me zërin e të miturve të privuar nga liria. Raport monitorues i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit”, Tiranë, dhjetor 2016, faqe 7.
16. Përgjigje e shkresës nr.S-1/1 prot.datë 25.1.2018 “Kthim përgjigje-Kërko-hen të dhëna statistikore për të miturit si autorë dhe viktima të krimit, për vitet 2014-2017 dhe tendencat kryesore për këtë periudhë”. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave. www.asp.gov.al.
17. Avokati i Popullit “Me zërin e të miturve të privuar nga liria. Raport monitorues i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit”, Tiranë, dhjetor 2016, faqe 6.
18. Avokati i Popullit “Me zërin e të miturve të privuar nga liria. Raport monitorues i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit”, Tiranë, dhjetor 2016, faqe 6.

TË DREJTAT E FËMIJËVE NË OPTIKËN E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

Dritan Hoti

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

dritanhoti@hotmail.com

ABSTRAKT

Krijimi i Lidhjes së Kombeve pas Luftës së Parë Botërore dhe më pas pasardhëses së saj, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në rolin e organizatave mbikombëtare, të cilat në vetvete kishin dhe kanë dizajnin dhe garancinë e sigurisë kolektive, u diktuan në më shumë se çdo gjë tjetër përveç dimensioneve të kataklizmës që përfshinte të gjithë njerëzimin dhe pasojat e saj në të njëjtën kohë.

Prandaj, si formalizimi i të drejtave të fëmijëve, ndonëse ato mund të jenë diskutuar më herët, është pika fillestare për veprimtarinë e organizatave ndërkombëtare si Lidhja e Kombeve ose OKB, e cila gjithashtu ka hartuar normat ligjore universale, duke garantuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve duke krijuar paralelisht një marrëdhënie ndërmjet statusit dhe të drejtave të fëmijëve me marrëdhënie ndërkombëtare.

Në këtë studim, do të shqyrtojmë se si tërësia e të drejtave të fëmijëve përcaktohet përmes normave që rrjedhin nga Rezolutat e Organizatave Ndërkombëtare. Së dyti, do të shohim se si kanë evoluar problemet e fëmijëve në fazat e njëpasnjëshme të kohës sonë. Në fund, ne do të flasim për një gjendje të përmirësuar të çështjeve dhe të drejtave të fëmijëve.

Fjalë kyçe: *OKB, Organizata ndërkombëtare, Konventa për të drejtat e fëmijëve*

HYRJE

Organizata e Kombeve të Bashkuara lindi jo sipas formulës të imagjinuar nga Immanuel Kant-i në të cilin do të rigrupoheshin shtetet që ndanin, përfaqësonin vlera të përbashkëta që do të kishin mundësuar kështu që kontributi për paqen

e përhershme të rezultonte mëi lehtë¹⁵⁰. (shih Immanuel Kant: “ Zum Ewigen Frieden, Ein philosophischer Entwurf”-“Projet de Paix perpetuelle” Édition bilingue, Paris 2002.

Mirëpo OKB-ja lindi si pasuese e Lidhjes së Kombeve, organizëm që mori shtat e formë sakaq përfundimi i luftës së dytë botërore si një domosdoshmëri me rol e mision fundamental, ruajtjen e paqes së restauruar, me një fjalë ekuilibrat botërore dhe jo konturimin e paqes së përhershme botërore pasi rrethanat nuk e lejonin atë.

Statusi i saj, si nje Organizatë mbi-kombëtare i dhuroi OKB-se tagrin e Institucionit kryesor icili do të përligjte e filtronte normat komplekse të së Drejtës ndërkombëtare që përbënte në një farë mënyre një lloj kushtetute për marrëdhëniet ndërmjet shteteve e kombeve. Ja pra sesi ajo njihet nën termin si “Çështjet e të drejtave të fëmijëve” (Les questions liées à l'enfance¹⁵¹) që nënkupton problematikat e të drejtave të fëmijëve megjithëse nisën të marrin një vend gjithnjë e në rritje në diskutimet ndërkombëtare përgjatë shekullit të kaluar, nuk janë ekskluzivitet veçse i shekullit të XX-të.

Për zanafillat e të drejtave të fëmijëve mund t'i referohemi deklaratave të revolucionit francez mbi të drejtat e njeriut si dhe gjysëm-shekulli më vonë, në momentin kur Perandoria britanike nëpërmjet një akti revolucionarizues e emancipues për njerëzimin, shpalli si të jashtëligjshëm çdo akt ushtrimi të skllavërisë, nje dimension të caktuar në këtë fenomen e zinin fëmijët.

Kjo përben edhe rastin e parë dhe të vetëm kur një shoqëri e cila mbante të drejtën e skllavërisë, të hiqte dorëvullnetarisht nga ushtrimi i këtij akti¹⁵².

Ndërkohë që duhej pritur mbarimi i Luftës së I-rë Botërore, pikërisht viti 1923 kur Shoqëria e Lidhjes së Kombeve përpiloi një Deklaratë mbi të drejtat e fëmijëve. Shtetet-anëtare të Organizatës e ratifikuan në vitin 1924, Deklarata në fjale, e cila mbështetej veçse mbi 5-sështysa, Neni 1- E Drejta për një zhvillim normal për nga pikëpamja materiale dhe shpirtërore. Neni 2- E Drejta e ushqimit duke përfshirë aksesin në shërbimet mjekësore si dhe një ndihmë e garantuar për jetimët e handicapët. Neni 3- Mundësi e garantuar për fëmijët në vështirësi të

150 Immanuel Kant: Zum Ewigen Frieden, Ein philosophischer Entwurf.-Projet de Paix perpetuelle, Edition bilangue, Paris, 2002

151 L'enfant et la communité internationale, p2, humanium.org

152 Yuval Noah Harari: Sapiens, A Brief History of Humankind, p.158, London 2011

papërballueshme. Neni 4-Mbrojtja e fëmijëve përkundrejt çdo shfrytëzimi. Neni 5-Pjesëmarrja në shkollim nëpërmjet mirëpritjes dhe të respektit të të afërmit të tij¹⁵³.

Lufta e II-të botërore si dhe rrethanat tragjike që iu asociuan asaj përbëjnë një pikë-kthesë duke përshpejtuar kësaj krijimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, OKB, ndërkohë që perceptimet e komunitetit ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve nisën të ndryshojnë. Megjithatë investimi në rritje i komunitetit ndërkombëtar matet kryesisht me miratimin e instrumentave që i përkushtohen fëmijërisë. Që të 3-ja Deklaratat e të drejtave të fëmijëve, 1924, 1948 dhe 1959 karakterizohen kështu nga një thjeshtësi stili.

Në rast se Deklarata e Gjenevës e vitit 1924 promovon principet bazike në një sfond ndërkombëtar, teksa ajo përgatiti gjithashtu terrenin e aprovimit progresiv të normave ndërkombëtare gjithnjë e më shumë universale.

Ajo i referohej një konteksti të një lufte shkatërrimtare që kishte shkaktuar vuajtjet në mesin e fëmijëve, bëhej fjalë për mungesë ushqimi, shkollim i ndërprerë, shfrytëzim ekonomik. Pranimi isaj prej Lidhjes së Kombeve në 1924 lejoi legjitimitetin e të Drejtave të fëmijëve.

Si rrjedhojë, fëmija është një krijesë e cila meriton një përkujdesje speciale të shoqëruara me të drejta të posaçme. Projekti i 1948 reflekton ndër të tjera ndodhitë e Luftës së II-të Botërore së bashku me progresin social e shkencor si dhe një rritje të koshicës për garantimin e përkujdesjen ndaj fëmijëve qoftë në kohë lufte apo paqe. Gjithsesi kjo Deklaratë qëndron si një reafirmimi tekstit të vitit 1924 si një nga versionet më të arrira të përpunuara.

Në Deklaratën e vitit 1959 nënvizohet për herë të parë roli i shteteve si një instrument mbrojtjes të së Drejtave të fëmijëve. Këtë radhë teksti në fjalë u elaborua dhe u votua në gjirin e sistemit të Kombeve të Bashkuara duke u mveshur kështu me statusin e një Konvente ndërkombëtare për të Drejtat e fëmijëve¹⁵⁴.

Për nga përmasa e karakteri detyrues si dhe përcaktimi i proceseve të kontrollit që ajo garanton, kjo konventë rinovoi dhe i mundësoi Organizatës së Kombeve të Bashkuara, rastin që të angazhohet vendosmërisht për të Drejtat e fëmijëve.

Mbi të gjitha elaborimi dhe ratifikimi i këtij teksti në mënyrë konsensuale dhe

153 Droit de l'enfant e protection international, p1, humanium.com

154 Idem...

gjithëpërfshirëse e pajisi atë me nje dimension universal të munguar në iniciativa të tilla analoge të mëparshme.

Unicef, si organizmi bazë i OKB-se i mandatuar po nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, aksioni dhe degëzimet e të cilit paraqiten si efikase me peshë dhe pashmangshmërisht për të gjithë atë cilët interesohen për të Drejtat dhe ndihmesën e vazhdueshme ndaj fëmijëve.

Për më tepër në vitet '80-të skicimi i një konvente të re për të Drejtat e fëmijëve të cilës i atribuohet njëvend i përzgjedhur mbarë Organizatave ndërkombëtare jo-qeveritare (ONG) të cilat degëzoheshin për më tepër në formatin e një rrjeti me synim perceptimin e një përkufizimi të plotë dhe të përditësuar të të Drejtave të fëmijëve si dhe shtrirjen e tyre gjithandej. Ndërkohë që çështja e të drejtave të fëmijëve në botën e pas-luftës së ftohtë, pra ajo aktuale, është e shënuar nga tendenca paradoksale, kontradiktore ; ndërsa nga njëra anë periudha në fjalë spikat për nga përsosmëria e normave juridike, në mbrojtjen e garantimin e të drejtave të fëmijëve, me burim nga e Drejta ndërkombëtare.

Konventat e miratuara në vitin 1999 dhe 2000 vënë theksin tek principet e një etike universale, normave ndërkombëtare gjithëpërfshirëse në lidhje gjithnjë me të Drejtat e fëmijëve, nga ana tjetër në botën globale përsosmëri dhe perfeksionimi teknologjik si dhe ndërvarësia që lehtëson kështu shkëmbimet e tkurr rrugët e komunikimit si tipare karakterizuese të globalizimit së bashku me përthellimin e prirjeve për fragmentarizim politik në rajone të caktuara të botës, e ka bere më dramatike e tragjike pasojat e konflikteve ndërmjet shteteve, kombeve e shoqërive, viktimat të të cilit në plan të parë janë fëmijët¹⁵⁵.

Dy janë rajonet në të cilat këto fenomene spikasin më shumë se kudo tjetër, Lindja e Mesme, rajon i botës ku përmbajtja emocionale e konflikteve është e krahasueshme me atë që dominoi Evropën në shekullin e XVII si dhe Afrikën ku modernizimi është i vonuar përkundrajt kontinenteve të tjera.

Në 26-vitet e fundit në atë kontinent, luftërat civile të shoqeruara me genocide si dhe depërtimi në vitet e fundit i terrorizmit islamik kanë rrënuar popullsi e rajone të tëra.

Të paktën rreth 2.milionë është numri i fëmijëve që kanë humbur jetën në luftërat e konfliktet e shpërthyer nga mazhorenët në 15-vitet e fundit anembanë plane-

tit, qoftë duke qenë në rolin e shënjestrës, qoftë në atëtë fëmijës-ushtar¹⁵⁶.

Megjithë protokollin i cili asociohet me Konventën për të Drejtat e fëmijëve e vitit 2000 sa i përket përfshirjes së tyre në konfliktet e armatosura, i cili ndalon pjesëmarrjen e personave nën 18 vjeç nëluftime ; dispozita të cilat i mbulon përfaqësuesi për fëmijët në konfliktet e armatosura¹⁵⁷.

Stopimi i numrit të fëmijëve viktimë te luftërat po rezulton si një sipërmarrje e vështirë.

Problematikat e fëmijëve si viktima të konflikteve të armatosura në tëdy rajonet e tillësi Lindja e Mesme dhe Afrika që kategorizohen edhe si 2-rajonet që mbulojnë numrin më të lartë të fëmijëve-viktima diferencohen edhe nga njëri-tjetri. Në rast se në Lindjen e Mesme këto pasoja i gjen tek fizionomia e praktikat e konflikteve, me një fjalë, manipulimin e fëmijëve për atentate terroriste me anë të mekanizmave vetëshpërthyes, përdorimi pa asnjë kriter i armëve kimike e bakteriologjike apo gabimet e ndodhura, pasi njësi terroristesh përdorin edhe fëmijet si mbulesë njerëzore. Në Afrikë fëmijët janë viktimë e degradimit më shumë të një stadi egërsie primitive në karakterin e luftërave.Shkurt, mungesës së asaj që njihet si rregullat e një beteje, konflikti.

Si rrjedhojë nga 800 mijë viktima të vlerësuara në masakrën e Ruandës, 300. mijë ndërmjet tyre ishin fëmijë¹⁵⁸. Ne Darfur, ku 2. milionë persona kanë qenë të detyruar të braktisin territoret e banura prej tyre për të jetuar si të regrupuar në kampe, më shumë se 1.milionë ndër ta janë të moshës nën 18 vjeç dhe 320.000 janë të paktën nën 5 vjeç¹⁵⁹. Kurse në konfliktin sirian 3,7 milionë fëmijëve ose 1 ndër 3 janë lindur pas shpërthimit të luftës civile që debutoi më 15 mars 2011.

Ndërkohë që 14.700 fëmijë kanë humbur jetën prej asaj date e deri në gusht të vitit 2016¹⁶⁰.

Vetëm 83 është rregjistruar sipas Unicef-it numri i fëmijëve viktima në janarin e 2018 në konfliktet që rrënuan Lindjen e Mesme dhe pjesë të Afrikës veriore¹⁶¹.

156 Enfant dans la guerre, humanium.org Paris 2012

157 Droit de l'enfant et protection international.

158 Children and armed conflict, Report of UN Genneral Assambly, 24 Gusht 2017

159 Proteger les enfants en periode de conflict arme, Fond des natuions Unies pour enfance (Unicef), maj 2016

160 L'Orient le jour.19.08.2016 OLJ-AFP

161 Journal Liberation, AFP, 5.01.2018

Për të përballur sfida të tilla dramatike e të koklavitura Kombet e Bashkuara e organizmat e linjës që fokusohen kryesisht në problematikat në fjalë nuk mund të jenë të suksesshme duke u kufizuar në praktika, metodologjinë e pregorativat që disponojnë. Për të qenë edhe më shumë rezultiv e performant në administrimin e krizave në fjalë, duhet që të drejtat e fëmijës të ngjiten në nivelin e një marrëveshjeje e konsensusi real universal ndërmjet aktorëve vendimtarë.

Përtej disakordeve politike kauza e madhe e të drejtave të fëmijëve është universale, e cila përbashkon drejtues, popuj e kombe.

Respektimi me skrupolozitet e kësaj kauze do të përbente jo vetëm çelësin e zgjidhjes së kësaj drame, por edhe do t'i çelte portën e emancipimit në shumë aspekte të marrëdhënieve njerëzore.

Në të kundërt do të flitej për të meta të pandryshueshme të natyrës njerëzore teksa dinamika e përsosmërisë sociale, sistemike e teknologjike nuk rresht së evoluari.

BIBLIOGRAFI

1. Children and armed conflict-Report of secretary general, UN-Security Council General Assembly, 24 Gusht 2017
2. Droit de l'enfant e protection internationale, humanium.org
3. Haarari, Yuval : Sapiens, A Brief History of Humankind, London 2011
4. Journal Liberation, 05.02.2018
5. Kant, Immanuel : Zum Ewigen Frieden, « Ein philosophischer Entwurf », « Projet de paix perpetuelle », Edition bilingue, Paris 2002
6. L'enfant dans la guerre, humanium.org
7. L'enfant e la communaute internationale, revue de l'Institut Pierre Renouvin, Paris 2007
8. L'Orient le jour, 19.08.2016. OLJ-AFP
9. Droits fondamentaux de l'enfant, website <http://bice.org/fr/droits-de-lenfant/droits-fondamentaux-de-l-enfant/>

10. L'enfant et la communauté internationale, website <https://www.cairn.info/revue-bulletin-de-l-institut-pierre-renouvin1-2007-1-p-43.htm>
11. L'ONU et les droits de l'enfant, website <http://www.un.org/fr/rights/overview/themes/children.shtml>
12. La protection des enfants dans des conflits armés, website <https://www.icrc.org/fre/resources/documents/misc/5fzgaj.htm>
13. Règles des Nations Unies pour la protection des mineurs privés de liberté, website <http://www.ohchr.org/FR/ProfessionalInterest/Pages/JuvenilesDeprivedOfLiberty.aspx>

MASS MEDIA AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET NË RAPORT ME TË MITURIT

Dr. Ilda Kashami

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

ilda.kashami@umsh.edu.al

ABSTRAKT

Delikuenca e të miturve në Shqipëri është një fenomen i njohur në realitetin tonë dhe fatkeqësisht vazhdimisht në rritje, veçanërisht në vitet e fundit.

Në këtë kuadër, duhet të merren masa efektive për të rregulluar dhe parandaluar atë. Duke nënvizuar rolin e familjes, shkollës dhe mjeteve të komunikimit, ekziston nevoja për të ndërhyrë në ato që janë shkaqe direkte dhe indirekte që ndikojnë në promovimin e fenomenit në fjalë.

Përfshirja e të miturve në veprat penale është një situatë që duhet të analizohet në disa dimensione. Pa dashur të harroj problemet e krijuara nga faktorët psiko-socialë që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe përdorimin e substancave të ndryshme narkotike nga të miturit, do të përqendrohesh në rëndësinë e komunikimit masiv në këtë drejtim.

Studimet në këtë fushë tregojnë se fëmijët janë shumë të ndikuar emocionalisht nga lajmet dhe imazhet që transmetohen në TV. Ata asimilojnë informacionin dhe asgjësojnë atë pa e dekoduar atë.

Televizionet dhe mediat në përgjithësi i shkaktojnë fëmijës atë që dijetarët e quajnë «mungesa / zhdukja e fëmijërisë», sepse e hedh poshtë kufizimin e njohurive, duke eliminuar dallimin ndërmjet asaj që një i rritur di dhe një i mitur duhet të dijë duke shkaktuar kështu një transformim të roleve sociale dhe projektimin e një të mituri në situata dhe role të një madhësie shumë më të madhe dhe të pakontrollueshme nga vetë ai.

Mjetet e komunikimit masiv mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në

parandalimin e fenomenit të delikucencës së të miturve, jo vetëm me shfaqjen e programeve arsimore që promovojnë krijimtarinë e fëmijëve, por edhe duke kufizuar shpërndarjen e informacionit në lidhje me shfaqjen e formave të ndryshme të dhunës, përdorimit të drogës dhe imazheve pornografike.

Key words: *media, të miturit, agresiviteti, cartoons, komunikimi*

HYRJA

Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri, është një fenomen i njohur në realitetin tonë dhe fatkeqësisht në rritje të vazhdueshme, sidomos në vitet e fundit.

Në këtë kuadër, duhen marrë masa efektive në trajtimin dhe parandalimin e tij. Duke nënvizuar rolin e familjes, shkollës dhe mjeteve të komunikimit, lind nevojë të ndërhyhet në ato që janë shkaqet direkte dhe indirekte që ndikojnë në nxitjen e fenomenit në fjalë.

Përfshirja e të miturve në vepra penale, është një situatë e cila duhet analizuar në disa dimensione. Pa dashur të anashkalojmë problemet që gjenerojnë faktorët psiko- socialë, të cilët ndërveprojnë midis tyre, si dhe përdorimin e substancave të ndryshme narkotike nga të miturit, unë do të ndalesha në rëndësinë që ka komunikimi masiv dhe *new media*-t në rritjen e këtij fenomeni.

Brezat e rinj kanë lindur dhe janë rritur me Tv dhe kanë qenë dëshmitarë dhe protagonistë të ndryshimeve thelbësore si audiovizive, ashtu edhe të zhvillimit të informatikës dhe të new mediave.

Mediat janë oniprezente në jetën e adoleshentëve. Televizori në veçanti, për aksesin e lehtë që e karakterizon, përbën elementin e parë të ndërveprimit extra familjar për pjesën më të madhe të fëmijëve në vendet e zhvilluara. Për të ndezur televizorin nuk nevojitet një kapacitet i lartë siç nevojitet për të lexuar dhe kuptuar një libër, apo për të përdorur kompjuterin, për këtë arsye, Tv mbetet mjeti i parë i komunikimit për nga rëndësia. Nga disa studime ka rezultuar që vetëm 3% e fëmijëve që i përkasin një shtrese sociale më të lartë, rritet pa Tv në shtëpi.

Pra mund të themi që të rinjtë jetojnë në një botë audiovizive: kompjuter, video-game, tv, kinema, telefoni, radio. Një çështje e hapur dhe e rëndësishme mbetet ndërveprimi i këtyre teknologjive me shkollën dhe familjen, si në përthithjen e

njohurive ashtu edhe në transmetimin e vlerave. Kjo do të thotë që lind nevoja të analizohen jo vetëm efektet e mediave mbi të rinjtë, por mbi të gjitha përdorimin që të rinjtë u bëjnë mediave.

Teoria mbi përdorimin e mediave, bazohet në perspektivën se shikuesit e ndryshëm televiziv e përdorin televizionin po ashtu ndryshe nga njëri-tjetri. Veç kësaj, këtu bëjnë pjesë edhe faktorët e tjerë socialë ndikues afatgjatë, që gjenden jashtë televizionit. Përtej variablave sociologjike klasikë, raporti i të rinjve me mediat, ndryshon edhe në funksion të dinamikave familjare, rolit të fëmijës, marrdhënjet me vëllezërit, si dhe nga morfologia e familjes, përsa i përket modeleve të socializimit dhe prezencës së nënës në shtëpi. Hulumtimet në këtë fushë, tregojnë se fëmijët influencohen shumë emocionalisht nga lajmet apo imazhet që transmetohen në media. Ata e asimilojnë me shumë lehtësi informacionin dhe e përthithin atë pa e deshifruar.

Mediat në përgjithësi dhe televizioni në veçanti, shkaktojnë tek fëmija atë që studiuesit e quajnë “mungesa apo zhdukja e fëmijërisë”, sepse hedhin poshtë kufinj të dijes, duke eliminuar dallimin midis asaj ç’ka një i rritur di dhe një i mitur duhet të dijë, duke shkaktuar kështu një transformim të roleve sociale dhe duke e projektuar të miturin në situata dhe role të një dimensionimi shumë herë më të madh e të pa menxhueshëm nga vetë ai.

Nga një studim paraprak i imi në këtë fushë, është vënë re, që emisionet e transmetuara në atë që quhet “fasha e mbrojtur”, janë krejtësisht të papërshtatshme për një publik të mitur, si nga pikëpamja e tematikave që trajtojnë, nga shqafja e pa kontrolluar e dhunës qoftë ajo fizike, psikologjike apo verbale, si edhe nga vulgariteti që përmbajnë formatet e ndryshme televizive.

Por, nuk është gjithmonë përmbajtja e imazheve ç’ka e bën shfaqjen e dhunës problematike, pasi një imazh mund të perceptohet si tepër i dhunshëm ose si më pak i dhunshëm, pa ushtruar presion në mënyrën tonë të arsytimit. Vrasja e mendimit dhe e aftësisë për të gjykuar dhe reflektuar, është në vetvete një krim që gjeneron krim.

Çensura e dhunës televizive, nuk përbën një zgjidhje të problemit, por është e nevojshme tu mësohet fëmijeve nëpërmjet programeve të *Media Education*¹⁶²,

162 Edukimi mediatic, është shprehje që hyri në përdorim me zhvillimin e teknologjisë së mjeteve të komunikimit masiv dhe i referohet formimit të kapacitetit për të përdorur në mënyrë efektive mjeteve të komunikimit masiv sidomos nga të rinjtë dhe adoleshentët.

si të ushtrojnë sensin kritik, të kultivojnë ironinë dhe të deshifrojnë treguesit, ose siç quhen ndryshe markatorët semiotik, që bëjnë të mundur dallimin midis planit fictional dhe atij realist në paraqitjen e një fenomeni të caktuar.

Kur Mc Luhan afirmon që “media është mesazhi” [Mc Luhan 1967], nënkupton që mënyra me të cilën mesazhi transmetohet, është më e rëndësishme se përmbajtja e mesazhit, pasi mesazhi mund të ketë efekte të ndryshme në varësi të mjetit që e përcjell atë. Por marrja e mesazhit është po aq e rëndësishme sa transmetimi i tij. Është evidente që perceptimi i mesazheve në përgjithësi dhe imazheve në veçanti, varet fort nga konteksti në të cilin realizohen. Me fjalë të tjera, ndikimi i ekranit tek të rinjtë i nënshtrohetdisa variablave psikologjik dhe sociologjik.

Në thelb mund të themi se në kontekstin mediatik, televizioni mbetet mjete dominus për fëmijët dhe të rinjtë pavarësisht ambientit socio-ekonomik dhe moshës së tyre. Për këtë arsye, më shumë se çdo mjet tjetër komunikimi, televizori mer rolin e një “homogjenizuesi kulturor” dhe kontribuon shumë në socializimin e të rinjve.

Mediat, duhet të rekuperojnë rolin e tyre tashmë të zbehur të ndërmjetësit kulturor. T’i rikthejnë vlerën semantike dhunës që reklamohet, duke e kontekstualizuar atë dhe duke e bërë lehtësisht të kuptueshme lidhjen që ekziston në binomin shkak–efekt, me futjen e elementit shpjegues, nëpërmjet të cilit ky publik i ri, do të metabolizonte format e ndryshme të dhunës pa i bërë ato Tabù.

Të gjitha hulumtimet mbi përdorimin e televizionit nga fëmijët dhe të rinjtë, tregojnë që kur ata kanë një aktivitet tjetër, ata e preferojnë nga televizioni, pra konsumi i këtij të fundit është gjithmonë një zgjedhje e dytë.

EFKTET E DREJTPËRDREJTA TË MEDIAS

Dhuna televizive mbetet një nga argumentet më të rëndësishme të opinionit publik. Influenca që televizioni dhe mediat ushtrojnë mbi fëmijët, përbën një nga aspektet më të debatuar të raportit që lidh të rinjtë me mjetet e komunikimit masiv. Ajo kontribuon në predispozicionin e ndjenjave të pasigurisë dhe të cënushmërisë së identitetit të individit, që janë përgjegjësit kryesorë të cilët shkaktojnë varësi dhe nënshtrim. Për Lazarin dhuna televizive nuk qëndron në skenat e dhunës, por në hendekun që kjo e fundit krijon mes botës reale dhe

asaj simbolike të prezantuar në ekrane ku donimon vlera e suksesit, konsumit dhe pasurisë [Lazar 1997]. Në linjë me keto reflektim Lurcat i shton këtyre rezultateve faktin e vetmisë së fëmijës para televizorit, ajo që ai e përkthen si një “braktisje fizike, morale, afektive dhe intelektuale” [Lurcat, 1998].

Raporti i të rinjve me dhunën, si në rastet e skenave fiction, edhe në situata reale varjon në funksion të perceptimeve të ndryshme në varësi të sensibilitetit të secilit. Shpeshherë, dhuna paraqitet totalisht e zhveshur, me imazhe të forta, të gjalla, të cilat kanë si objektiv të vetëm, të lenë shenjë tek publiku, pa patur asnjë qëllim të parashtrajnë dhe argumentojnë një problem të caktuar¹⁶³. Sot, dhuna dhe sadizmi i toleruar në kulturën mediatike, është në rritje të vazhdueshme, por u ofrohet fëmijëve në formën e imazheve tërheqëse si ato që propozohen në kartonat e animuar, të cilat në aparençë duken si një produkt i destinuar fëmijëve, por lehtësisht mund të vemë re se këta të fundit, janë një nga targetet e mundshme të cilëve ky format u drejtohet.

Në fakt animacioni, ka arritur tashmë një pjekuri ekspresive, në gjendje të nxisë interesin e një publiku adult dhe për këtë arsye, në vendet e origjinës SHBA e Japoni, *anime-t*, që janë një lloj më i sofistikuar kartonesh, prodhohen për një publik adult dhe shoqërohen me signalistikën e posaçme (fëmijë i shoqëruar nga i rritur)¹⁶⁴.

Ekspresiviteti i fortë, identifikimi i fëmijes me protagonistin që ndryshe nga *cartoon-at* klasik (*Tom dhe Xherri, Kojota Willie, Bugs bunny*) te *anime* Japoneze (Dragon Ball, Sailor Moon, Naruto) mer gjithmonë e më shumë formë njerëzore, janë ato ç’ka më tepër shqetësojnë mbi efektet negative të tyre ndaj publikut të mitur, i cili, nëpërmjet një procesi “acting out”, ka tendencë të imitojë gjestet e dhunshme, pa qenë i ndërgjegjshëm mbi pasoja dramatike të tyre.

E njëjta gjë ndodh me *videogame*, ku vdekja e protagonistit pasohet nga një ringjallje e menjëhershme dhe ku konkluzioni i një dhune shkatërruese, penalizohet thjesht me një *game out* të përkohshëm.

Natyraliteti me të cilin paraqitet këtu një akt i dhunshëm, përcakton një sjellje natyrale edhe në mënyrën se si përjetohet një akt real dhune. Këto forma të pa-

163 Salzano D., “La spirale della violenza tra realtà e rappresentazione”, in G. Greco (a cura di), *Metamorfosi. Convenzioni su comunicazione e società*, Rubettino, Soveria Mannelli 2000.

164 L. Raffaelli, *Le anime disegnate. Il pensiero nei cartoon dai Disney ai giapponesi e oltre*, Castelvecchi, Roma 1995.

kontekstualizuara, çojnë në humbjen e sensibilitetit të fëmijës ndaj imazheve “të gjalla” dhe në rritjen e agresivitetit të tij¹⁶⁵.

Për këtë arsye është e nevojshme të vendoset një linjë ndarëse midis botës reale dhe botës së *fiction*-it, si dhe përpunimi i një taksonomie të dhunës në kartonat e animuar nëpërmjet indikatorëve që nevojiten për të interpretuar formatet televizive që përmbajnë animacion.

Kur Platoni në librin e V të Republikës, përdorte poetët dhe komedianët për të propozuar heronj dhe imazhe moralisht të nevojshme për rritjen e fëmijës, ai me anë të teorisë së mimezës, nënkuptonte tezën e imitimit. Pra ekspozimi i vazhdueshëm ndaj skena të dhunshme, mund ta çojë fëmijën në një reagim të njëjtë duke imituar.

Hulumtimet të ndryshme tregojnë se nëse dhuna në televizion dënohet dhe gjykohet nga të rriturit, atëherë edhe fuqia e ndikimit tek të rinjtë është më e vogël. Prandaj është e këshillueshme që në skena të tilla, fëmijët të shoqërohen gjithmonë nga një i rritur.

Modeli Platonik, që tenton të nënvizojë proceset imitative të prezantimit simbolik me anë të stimulimit televiziv, është baza e pjesës më të madhe të studimeve. Është në fakt një model behaviorist, pra çdo stimuli i korrespondon një përgjigje, që në versionin më të sofistikuar mer në konsideratë variabla të tjerë subjektivë si seksi, mosha, shtresa sociale, konteksti relacional.

Në të kundërt Aristoteli, me teorinë e katarsit, mbështeste kapacitetin e prezantimit simbolik të realitetit për të ekzorcizuar frikën dhe ankthin, si ndodh në përralla. Mbështetësit e teorisë së katarsit, që është një variant i evoluar dhe i teknologjizuar i i hipotezës aristotelike, në ekspozimin ndaj dhunës shohin një mundësi purifikimi, një sublimim të energjisë agresive. Kjo teori nis nga parimi se duke parë dhunë televizive, pranuesi identifikohet me të dhe në këtë mënyrë ndodh një lloj pastrimi i tij¹⁶⁶. Por, të tjerët e kundërshtojnë këtë teori, duke pohuar se kjo është vetëm një përpjekje e mediave që të arsyetojnë dhe legjitimojnë dhunën e tyre në programet e tyre televizive.

Kjo teori nuk konsideron faktin që proceset perceptive infantile jo gjithmonë respektojnë dikotominë reale/irreale.

165 A. Piromallo Gambardella, “Violenza e media: una mimesi senza catarsi”, in A. Piromallo Gambardella (a cura di), *Violenza e società mediatica*, Carocci, Roma 2004.

166 G.Mekuli, *Fëmija dhe Televizioni – Teoritë e ndikimit televiziv*, Maj 2017.

Teoria e imitimit dhe ajo e katarsit nuk mbajnë parasysh mjaftueshëm rrethin social në të cilin lëviz fëmija: familja , shkolla, rrethi shoqëror. Kur këto të fundit mungojnë, atëherë efektet janë më të dukshme.

Si përfundim mund të themi se një fëmijë I vetmuar, është më tepër i zbuluar dhe i ekspozuar ndaj rrezikut dhe si pasojë lehtësisht i influencueshëm.

Pikërisht në këtë perspektivë, është gjithashtu i nevojshëm sensibilizimi jo vetëm i prindërve dhe familjarëve, por edhe i institucioneve përkatëse, mbi raportin e vështirë që ekziston midis ushtrimit real të dhunës, asaj që paraqitet në media dhe efektet e mundshme mbi të miturit.

BIBLIOGRAFIA

- D. Salzano, “ *La spirale della violenza tra realtà e rappresentazione*”, in G. Greco (a cura di), *Metamorfosi. Convenzioni su comunicazione e società*, Rubettino, Soveria Mannelli 2000.
- L. Raffaelli, *Le anime disegnate. Il pensiero nei cartoon dai Disney ai giapponesi e oltre*, Castelvecchi, Roma 1995.
- Piromallo Gambardella, “ *Violenza e media: una mimesi senza catarsi*”, in A. Piromallo.
- Gambardella (a cura di), *Violenza e società mediatica*, Carocci, Roma 2004.
- G.Mekuli, *Fëmija dhe Televizioni – Teoritë e ndikimit televiziv*, Maj 2017.
- Luke C. *Television and Your Child: A Guide for Concerned Parents*. Toronto: TV Ontario; 1988
- Comstock G, *Strasburger VC. Deceptive appearances: Television violence and aggressive behaviour*. J Adolesc Health Care. 1990.
- McLuhan, M., *Gli strumenti del comunicare*, Il Saggiatore, Milano, 1967.

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË TË MITURVE NË DREJTËSINË SHQIPTARE

Kozeta Ligeja

Phd Candidate, Instituti i Studimeve Europiane, UT

Pedagoge e jashtme në Fakultetin e Shkencave Sociale, UT

k.oz.i2006@hotmail.com

ABSTRAKT

Hipoteza që ngrihet në punim është: Drejtësia shqiptare për të miturit duhet të zbatohet interesin më të lartë të fëmijës, duke respektuar të drejtat e fëmijëve në një proces gjyqësor. Mungesa e infrastrukturës së nevojshme, e bazës nënligjore për zbatimin e alternativave, mungesa e institucioneve për trajtimin e të miturve, mungesa e ambjenteve të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e seancave publike, në disa gjykata, sidomos në gjykatën më të madhe të vendit në atë të Tiranës, mungesa e asistencës psikologjike ndaj të miturve krijon vështirësi për zbatimin e standarteve ndërkombëtare dhe vetë kërkesat e legjislacionit shqiptar lidhur me drejtësinë për të mitur.

Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi është të vërtetojë nëpërmjet provave, kryesisht të analizës teorike, por edhe asaj praktike se Shqipëria si shoqëri vazhdon të ketë problematika për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor në sferën e të drejtave të të miturve në një proces gjyqësor.

Metodologjia: Punimi do të mbështetet mbi disa metoda studimore. Do të përdoret kryesisht metoda induktive, duke kaluar nga fakte të veçanta në përfundime të përgjithshme, por edhe ajo deduktive duke kaluar nga konkluzione të përgjithshme për të nxjerrë përfundime për pasojat e ardhura dhe problemet e veçanta. Nëpërmjet analizës së rasteve të veçanta në Shqipëri, të cilat kanë adresuar çështje specifike me rëndësi për zhvillimin e punimit.

Fjalët Kyce: *Shqipëria, të miturit, drejtësia, të drejtat, Konventat Ndërkombëtare*

HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenet e saj 54-59¹⁶⁷ mbrojtjen dhe përkrahjen e shtetit të së drejtës për kategorinë e fëmijëve, si një nga politikat kryesore shoqërore në vend. Kjo politikë bazohet në bazën e gjërë ligjore si Kushtetuta, Konventat Ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga shteti Shqiptar. Në thelb të këtyre konventave pjesë integrale e legjislacionit shqiptar është zbatueshmëria e interesit më të lartë të fëmijëve, duke respektuar kështu të drejtat e fëmijëve në proces gjyqësor. Arsyeja për këtë është se fëmijët janë kategori që për shkak të moshës, mungesës së rritjes fizike, psikologjike, intelektuale kërkojnë një vëmendje të veçantë nga bashkërendimi i njësisë kryesore në shoqëri siç është familja dhe mekanizmave shtetërorë. Nisur nga ky arsyetim nga politikëbërësit dhe kategoritë e specifikuar me ligj për hartimin e ligjeve është parë e udhës që i duhet dhënë vëmendja fëmijëve që janë në konflikt me ligjin me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të miturit.

VËSHTRIM NË KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MË FOKUS TË MITURIT

Vendi ynë gjatë progresit të shtetit të së drejtës ka ratifikuar një sërë instrumenta ndërkombëtarë që lidhen me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe me të drejtat e fëmijëve në veçanti. Sipas Kushtetutës këto instrumenta quhen legjislacioni i brëndshëm dhe janë të rëndësishme për zbatim.

Aktet ndërkombëtare në lidhje me drejtësinë e të miturve ndahen në këto instrumenta: të Kombëve të Bashkuara, Të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Europian. Mund të përmendim disa prej tyre në një përmbledhje: Konventa e OKB mbi të drejtat e fëmijëve e ratifikuar me date 27 Shkurt 1992; Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut e vitit 1948; Deklarata mbi të drejtat e fëmijës; Rregullat standart minimum të kombëve të Bashkuara për Administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit 1985); Rregullat e Kombëve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjvë që u është hequr Liria (Rregullat e Pekinit) 1990; Udhëzimet e Kombëve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit) 1990; Rregullat standart minimum lidhur me masat e mosarrestimit.

Nga instrumentet e e Këshillit të Evropës mund të përmendim:

Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) Protokollet 1,2,3,4,6,7,11; Karta Sociale e Rishikuar; Konventa Europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve; Konventa Europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore apo degraduese dhe protokoli nr 1 dhe 2; Konventa Europiane mbi të drejtat Sociale;

Shqipëria në vitet e fundit ka bërë hapa progresive drejt Integritimit Europian. Në këtë kontekst ky proces duhet të sigurojë përmbushjen e respektimit të drejtave të njeriut sipas standartëve ndërkombëtare. Pra edhe pse nuk jemi akoma pjesë integrale e BE-së duhet që legjislacioni të jetë në përputhje me hapat e BE-së.

Kështu jurisprudenca e GJEDNJ-së është pothuajse e panjohur nga gjyqtarët shqiptarë e për rrjedhojë e pazbatueshme. Megjithë kujdesin e vazhdueshëm të përkthimit dhe të publikimit të tyre në gjuhën shqipe nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian dhe Qendra Evropiane, përdorimi dhe referimi në të është tepër i kufizuar¹⁶⁸

ANALIZË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR PËR DREJTËSINË E TË MITURVE.

Deri vonë, jurisprudenca shqiptare me fokus drejtësinë për të mitur ka një bazë të gjërë ligjore të cilat janë të shpërndara në ligje të ndryshme në shumë kode dhe në akte ligjore. Pra deri vone nuk ka pasur një kod unifikues për të drejtat e të miturve. Brënda kësaj kornize ligjore janë trajtuar të gjitha rastet për drejtësinë e të miturve.

Shkurtimisht po analizojmë këtë kornizë:

Nisur nga parimi i hierarkisë së normave që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të përcaktuar prej vet Kushtetutës (nenit 116) “Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e RSh janë:

- a) Kushtetuta¹⁶⁹;
- b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) Ligjet;

168 Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Ledi Bianku. Tiranë. 2005

169 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

d) Aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Gjithsesi është për t'u nënvizuar qysh në fillim se nga ana e shtetit shqiptar janë ndërmarrë një sërë reformash legislative me qëllim përputhjen me standardet e Konventës së drejtave të fëmijëve të OKBS. Duket se ligjet me gjithë boshllëqet dhe inkoherenat e tyre janë një anë e problemit. Ana tjetër ka të bëjë me atë ç'ka është konstatuar edhe nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve dhe ka të bëjë me nivelin e ulët të zbatimit të këtyre rregullave si dhe me defekte që vijnë si rrjedhojë e mangësive të sistemit të Drejtësisë penale për të mitur. Për shkak të mungesës së aktorëve të specializuar të tillë si gjyqtarë, prokurorë, policë, avokatë, punonjës social, etj që merren me fëmijë në konflikt me ligjin¹⁷⁰

Ajo që vihet re në Kushtetutën shqiptare¹⁷¹ është përdorimi i përemrave të tillë si: “Të gjithë”, “Kushdo”, “Kujdo”, “secili me qëllim përfshirjen e qytetarëve pa dallim moshe dhe gjinie. Këto dispozita i paraprijnë katalogut të lirive dhe të drejtave të njeriut që janë pozicionuar në pjesën e dytë të Kushtetutës.

Në interes të çështjeve që lidhen me drejtësinë për të miturit dhe kontekstin kushtetues është e rëndësishme të përmendim se: «Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre» (neni 15/1); «jeta e personit mbrohet me ligj» (neni 23); «askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues» (neni 25); «askujt nuk mund t'i hiqet liria ...

Gjithashtu kodet dhe ligjet që janë përdorur për trajtesa për zgjidhjen e konfliktëve ligjore janë të shumtë si:

Kodet dhe ligjet për drejtësinë për të mitur në Shqipëri Kodet dhe ligjet; Kodi Penal (KP) Ligji nr.7885/ 27.01.1995; Kodi i Procedurës Penale (KPP) Ligji nr.7905/ 21.03.1995; “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ; Ligji nr.8328/16.4.1998 ndryshuar me ligjin nr. 9071/ 22.5.2003; “Për ekzekutimin e vendimeve penale” Ligji nr.8331/ 21.4.1998; “Për policinë gjyqësore” ligji 8677/2.11.2000 ndryshuar me

170 Rekomandimet përfundimtare të vëzhgimeve të Komitetit të Drejtave të Fëmijës. Komiteti i të Drejtave të fëmijëve Sesioni i 38

171 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

ligjin 9241/10.6.2004 ; “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve” ligji nr.9397/12.5.2005; “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” ligji nr.8678/ 14.5.2001; “Për Policinë e Shtetit”; ligji nr.8436/ 28.12.1998, ndryshuar me 8546/5.11.1999 dhe 8656/31.7.2000; “Për policinë e Burgjeve” ligji nr.8321,/ 2.4.1998 ndryshuar me ligjin 8757/26.3.2001 dhe ligjin nr.9375/21.4.2005.

Si rrjedhojë e këtij raporti, zhvillimet filluan të merrnin një hov në drejtim të drejtësisë për të miturit.

Kështu me datë 1 janar 2018 u miratua Kodi Penal për drejtësinë e të miturve.

PROBLEMET GJATË VEPRIMTARISË SË GJYQËSORIT DHE JO VETËM

➤ *Ekzistenca e ligjëve të paqarta:*

Nisur nga praktika e aktivitetëve gjyqsore me fokus drejtësinë e të miturve, ekzistojnë disa paqartësi në kuadrin ligjor. Ligji procedural dhe material në një drejtim të caktuar mund të jëtë i mangët jo sipas standartëve të kërkuar. Rastet e praktikës gjyqsore nuk respektohet në mënyrën e duhur dukë respektuar konkretisht etikën, ka një zvarritje të panevojshme të seancave gjyqsore që sjellin një dëmtim në përgjithësi tek i mituri nën petkun e të dënuarit, apo dëshmitar, njëkohësisht mungojnë analiza studime brënda sistemit. Vihet re që gjatë procesit gjyqsor dëgjimi i të miturve nuk bëhet në kushte të posaçme për të evituar përsëritjen e dëshmisë dhe evitimin e problemeve traumatike të procesit.

➤ *Vendimet e gjyqtarëve:*

Pasi përfundon procesi i zgjatur i gjyqit dalin me vendim të formës së prerë vendimet të gjyqtarëve¹⁷². Këto vendime janë të cekta, pa analiza të qarta të faktit kriminal arsyet pse janë kryer këto vepra penale. Të gjitha vendimet duhet të jenë më të argumentuara më në thellësi dhe jo të shkruhet në nivel rutine gjyqsore. Në këtë kuadër është e nevojshme që të zbatohet ligji i trajnimit të gjyqtarëve me qëllim që të jenë profesionist në fushën e gjykimit sepse “Gjykimi i të miturve bëhet nga gjyqtarë të kualifikuar për këtë gjykim, të ngarkuar osaçërisht edhe me këtë detyrë”¹⁷³.

172 Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Ledi Bianku. Tiranë. 2005
173 (Kodi i procedurave penale neni 13/2)



➤ *Mungesa e studimeve:*

Me qëllim efektin e efektivitetit të vendimëve dhe efektin e parandalimëve të dënimeve dhe masave edukuese. Mungesa e ketyre të fundit penalizon konkluzionet e arsyetimeve gjyqësore. Studimet e mirëfillta për dukurinë ndaj gjykimit të të miturve ndihmon palë të treta në marrjen e informacionëve dhe ndikimi i këtyre njohurive i jep mundësi të të interesuarve që të krijojnë lehtësira për mënyrën se si duhet të hallkave të caktuara të procesëve gjyqësore.

➤ *Infrastruktura e dobët:*

Nga praktika vihet re se shërbimet janë të pamajftueshme dhe shfaqet në forma të ndryshme nga një gjykatë në gjykatën tjetër. Zhvillimi i seancave realizohet në kushte të papërshtatshme. Paradoksi është kaq imadhi sa gjyqtarët gati e kanë kthyer në model që i marrin gjykimet e seancës në zyrat e tyre të vogla ku dihet që do ketë ndërprerje të procesit sikur dhe për efekt të hapjes derës nga të tjerë jashtë saj.

➤ *Mungesa e protokollëve apo e procedurave¹⁷⁴:*

Kjo mungesë ka sjellë mos trajtimin e procedurave shumë disiplinore të të miturve konflikt me ligjin. Kryesisht janë të lidhura me policinë, psikologjinë logjore, mjeksinë ligjore, avokatinë, OJF. Në disa procese gjyqësore është parë që ka mangësi sigurinë në gjykatë.

➤ *Mungesa e statistikave gjyqësore për të mitur¹⁷⁵:*

Nga praktika vihet re që mungojnë statistika gjyqësore që pasqyrojnë proceset penale për të rritur. Edhe ato pak statistika apo studime kur krijohen për këtë dukuri vihet re se nuk janë shumë të qarta dhe të hollsishtme, gjithmonë ka vend për diskutim. Nuk ekziston një model unifikues në nivel vendi.

➤ *“Avokatët e Shteti”:*

Një fenomen tjetër tepër shqetësues, që vihet re prej vitesh, janë avokatet e caktuar kryesisht. KPP i garanton mbrojtjen falas në procesin penal çdo individ që nuk ka mundësi ekonomike për të paguar mbrojtjen ligjore. Ndihma ligjore falas e ofruar nga avokatët kryesisht paguhet nga Shteti, në bazë të tarifave të paracaktuara. Ndonëse pagesa është modeste, për shumë avokatë që kanë

174 Te dhenat Prill 2010

175 Instat, Raporti statistikor për të drejtat e femijeve, 2006

mungesë të kualifikimit dhe mungesë të klientelës, kjo është një mundësi e mirë për punë. Avokatet regjistrohen në listën e avokatëve të gatshëm, pranë zyrës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor. Fenomeni që vihet re shpesh është se avokatët kryesisht bien dakord me kërkesat e prokurorëve duke kompromentuar ose mos-mbrojtur klientin e tyre të mitur. Ne besojmë se ky është një aktivitet jo i rregullt ligjor i ndërmarrë nga prokuroret dhe avokatet kryesisht, në mënyrë që të mbarojnë sa më shpejt hetimin dhe gjykimin e të miturve, pa i dhënë mundësi atyre që të marrin pjesë në një proces të rregullt dhe të drejtë ligjor. Kjo mund të shpjegojë njëkohësisht edhe përqindjen e lartë të dënimit me burgim të të miturve nga sistemi gjyqësor në Shqipëri.

➤ Mungesa e shërbimit shëndetësor:

Të gjithë fëmijët e paraburgosur ankohen vazhdimisht për vonesa të mjekëve në dhënien e shërbimit. Ankesa ka gjithashtu lidhur edhe me cilësinë e shërbimit. Të miturit deklaruan se në shumicën e rasteve kur ata janë të sëmurë, mungon asistenca e specializuar mjekësore dhe shpesh në vend të mjekimeve të përshtatshme, i vetmi mjekim që marrin është paracetamoli.

Një ndër shqetësimet kryesore të ngritura prej vjetësh nga ekspertët është mungesa e profesionalizmit dhe e sensitivitetit për respektin ndaj të drejtave të fëmijëve nga stafi mjekësor në komisariate policie dhe dhoma paraburgimi.

➤ Mungesa e ushqimit cilesor dhe servirjes së duhur:

Stafit policor i duhet të kujdeset edhe për ushqimin e të miturve të paraburgosur. Në shumë raste mungojnë elementet bazë të higjienës në transportimin e ushqimit. Në mëse një rast buka është gjendur e vendosur në mjedise të papërshtatshme, e pambështjellë dhe është lënë në mjedise të hapura për orë të tëra. Në paraburgim nuk lejohet përdorimi i pjatave, pirunëve dhe lugëve. Shumica e të miturve mbajnë një tas plastik për ushqimin dhe në vend të lugëve përdorin duart. Ushqimi konsumohet ulur mbi dyshemenë e qelisë, pasi tavolinat nuk janë të lejuara. Ushqimet e dërguara mbahen nga familja në dollapë dhe një dhomë të veçantë. Nuk ka frigoriferë dhe ndjehet era e ushqimeve të skaduara në dhomën ku mbahen ushqimet. Ndërkohe “Çdo mjedis paraburgimi duhet të bëjë të mundur që çdo i ri të marrë ushqimin që është përgatitur në mënyrë të përshtatshme, dhe që jepet në momentin e duhur të vakteve, me një cilësi dhe sasi që kënaq standartet dietike, higjienike dhe shëndetësore...”¹⁷⁶

176 Neni 37, Rregullat e OKB-së për Mbrojtjen e të Rinjve që iu është Kufizuar Liria

MIRATIMI I KODIT PENAL PËR DREJTËSINË E TË MITURVE

Në Janar 2018, Parlamenti i Shqipërisë miratoi kodin e drejtësisë për të miturit, një ligj që synon të adresojë problemet e shumta të fëmijëve në konflikt me ligjin si dhe të minimizojë pasojat që mund të sjellin dënimet me burg. Qëllimi kryesor i ligjit të ri është rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin dhe integrimi social i tyre, megjithatë, ekspertët mendojnë se kjo nuk është e thjeshtë.

Sipas tyre, institucionet, shoqëria dhe komunitetet ku këta të mitur banojnë nuk bëjnë mjaftueshëm për rehabilitimin e të miturve dhe integrimin e tyre. Ata theksojnë gjithashtu se roli i psikologut në trajtimin e këtyre rasteve duhet të jetë më i fortë, në shkollë apo edhe në institucione të tjera të kujdesit.

Praktikisht ngelet për t'u pare zbatueshmëia e tij në përputhje me zbatimin e standartëve ndërkombëtarë duke respektuar kështu të drejtat e të miturve.

PËRFUNDIME

Përfundimisht mund të themi se në vitet 1990 dhe më tej janë bërë ndryshime të rëndësishme në përmirësimin e sistemit të gjyqsor penal. Janë krijuar një kuadër i plotë ligjor duke ratifikuar kështu në jurisprudencën shqiptare instrumenta dhe Konventa Ndërkombëtare. Në thelb të këtyre Konventave Ndërkombëtare është parimi i realizimit të procesit gjyqësor interesi i fëmijës është interesi më i lartë. Në gjykatat shqiptare që janë shtrirë në qytetet e Shqipërisë janë hapur disa sesione të posaçme për të mitur. Në vitet në vijim janë hartuar strategjitë kombëtare për të miturit. Përgjatë viteve të fundit, praktika gjyqsore ka pasur problematika të cilët kanë sjellë dhe pasojat e tyre në drejtim të të miturve. Kështu mund të përmëndim disa prej tyre: Vendimet e gjyqtarëve janë të cekta dhe të pa qarta drejt faktit kriminal. Ka një mungesë të studimeve për të miturit; në gjykatat shqiptare ka një mungesë infrastrukture që do të thote që proceset gjyqsore të të miturve zhvillohen jo në kushte duke respektuar standartet e duhura por duke u zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve; probleme të tjera janë, mungesa e protokollëve apo e procedurave, mungesa e statistikave gjyqsore për të mitur; mungesa e respektimit të parimeve të instrumentëve ndërkombëtare. Korniza ligjore e jurisprudencës të të miturve është plotësuar me një

kod të ri. Kështu në Janar 2018, Parlamenti i Shqipërisë miratoi kodin e drejtësisë për të miturit, një ligj që synon të adresojë problemet e shumta të fëmijëve në konflikt me ligjin si dhe të minimizojë pasojat që mund të sjellin dënimet me burg. Qëllimi kryesor i ligjit të ri është rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin dhe integrimi social i tyre, megjithatë, ekspertët mendojnë se kjo nuk është e thjeshtë.

BIBLIOGRAFIA

- Children in konflikt with the law- Albania ANALYTICAL REPORT. Ministry of Justice Social Research Center - INSTAT October 2006
- Ismet Elezi. E drejta penale. Pjesa e posaçme. Shblu. Tiranë 2002 „ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda Procedura penale. Komentar. Tiranë 2003
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nenet 54-59 datë 21.10.1998
- Materiale të referuara në sesionin trajnues “Zbatimi i masave të sigurimit ndaj të miturve” organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me UNICEF. 22-23 janar 2007.
- Prof.Dr. Ismet Elezi; Arof.AS.Dr.Skënder Kaçupi; Dr Maksim Haxhia “Komentar i Kodit Penal të R.Sh.” SHB. GEER. Tiranë 2001. „
- Strategjia kombëtare e fëmijëve 2005-2010 „
- Strategjia kombëtare për të rinjtë 2007-2013
- Vasilika Hysi “Kriminologjia” Kreu 7, Tiranë, 2005

QËLLIMI DHE RISITË E KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT

Phd. Lorena Musai

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Magjistrat Enkeleda Millonai

Prokurore, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

lorena.musai@yahoo.it

ABSTRAKT

Në kuadër të reformës në Drejtësi, Shqipëria ka ndërmarë hapa të rëndësishme për të ndryshuar legjislacionin e saj të brëndshëm në përputhje me standartet Ndërkombëtare. Janë bërë ndryshime të rëndësishme në Kod.Proç.Pen, Kod.Pen si dhe është miratuar më datë 30.03.2017 ligji Nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë për të mitur”, kod i cili ka hyrë në fuqi më dt.01.01.2018. K.D.M është në përputhje të plotë me Kushtetutën e RSH, OKB-në për të drejtat e fëmijëve dhe standartet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e fëmijëve.

Qëllimi i ligjvënësit është dhënia e një garancie më të madhe procedurale një target grupi tepër vulnerabël, siç janë të miturit duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, integrimin social të tyre, rehabilitimin, mbrojtjen e të drejtave të viktimës të mitur, parandalimine viktizimit, të veprës penale si dhe sigurimin e rendit publik. Fryma që e përshkruan K.D.M është mbrojtja e të drejtave të të miturit në aspektin procedural, rehabilitimin, dhe dëmshpërblimin e tyre kur janë viktima të veprës penale.E rëndësishme është zbatimi në terren i K.D.M i cili kërkon që të gjitha instancat përkatëse të përfshihen dhe të bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, për të krijuar një klimë besueshmërie dhe sigurie si për të miturin në konflikt me ligjin dhe për të miturin viktim e dhunës.

Fjalët Kyç: *K.D.M, i mitur, garanci procedurale, rehabilitim, ri-integrim.*

KODI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NJË DOMOSDOSHMËRI PËR LEGJISLACIONIN VËNDAS

Vitet e fundit në Shqipëri janë hedhur hapa pozitive në përfaqsimin e legjislacionit kombëtar me standartet Ndërkombëtare. Mungesat në instrumentat ligjore për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, ku në fokus duhet të jetë ri-integrimi i tyre përmes edukimit, trajnimit dhe punësimit ka lindur si domosdoshmëri inkorporimin e parimeve dhe garancive procedurale të të miturit në konflikt me ligjin në një kod të posaçëm. Garantimi i një qasje të plotë të drejtësisë për të mitur nënkupton garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjitha të drejtave të fëmijëve në sistemet e drejtësisë. Për realizimin e këtyre garancive është e nevojshme që drejtësia për të miturit të jetë e aksesueshme, e përshtatur sipas moshës, e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve si dhe të jetë e shpejtë, duke përfshirë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për respektimin e jetës private dhe atë familjare si dhe integritetin dhe dinjitetin e figurës së të miturit në konflikt me ligjin apo viktimë e saj. Ligjvënësi shqiptarë i ndërgjegjësuar për një ndërhyrje emergjente për sa i përket target grupit të të miturve, si një nga target grupet më vulnerabël, për shkak të situatës së prezantuar në vënd si dhe numrit të përsëritësve të të miturve në konflikt me ligjin ka paraqitur projekt-ligjin nr. 3944 dt. 28.12.2016, Kodin e Drejtësisë për të mitur, projekt-ligj i miratur nga Kuvëndi i Republikës së Shqipërisë në Ligjin Nr.37 dt.30.03.2017 dhe hyrë në fuqi më dt.01.01.2018. Qëllimi i kodit të drejtësisë për të miturit është garantimi i një kuadri ligjor mbi drejtësinë për të miturit që të jetë në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve dhe standartet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit (neni 2/1 i K.D.M). Gjithashtu, ky kod parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse të cilat do merren me procedurën e administrimit të drejtësisë për të miturin si në konflikt me ligjin ashtu dhe viktimë e saj; norma specifike procedurale të cilat duhet të respektohen në proceset penale që kanë të bëjnë me të miturit e përfshirë si dhe rregulla të posaçme në lidhje me ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera të parashikuara duke patur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Fryma e përshkruar në KDM është ajo e një drejtësie miqësore për këtë target grup kaq vulnerabël si dhe sistemi penal të shikohet në mënyrë integrale dhe multidisiplinore. Kjo do të thotë bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet aktorëve pjesmarrës në realizimin

e drejtësisë për të mitur si Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës e prokuroria. Të gjithë këto aktorë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin jo vetëm për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për të miturin në konflikt me ligjin duke patur si qëllim final rehabilitim dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. KDM parashikon parime të përgjithshme si: Heqja e lirisë si alternativ e fundit e dënimit; e drejta e pjesmarrjes së të miturit në procesin që zhvillohet ndaj tij apo ku ai është viktimë duke i siguruar të drejtën e privatësisë si dhe përfundimin e gjykimit në ngarkim të tij sa më shpejtë të jetë e mundur si dhe i ofrohet një sërë të drejtash të tjera procedurale. Për herë të parë është parashikuar nga legjvënësi e drejta e përjashtimit nga përgjegjësia penale si dhe nga procedurat paragjyqësore për të miturin në konflikt me ligjin.

PARIMET DHE GARANCITË PROCEDURALE TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

KDM parashikon parime të rëndësishme si: **Parimi i prezumimit të pafajsisë:** “1. çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim të formës së prerë.2.çdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij (*principio in dubio pro reo*).Parimi i prezumimit të pafajsisë është edhe një parim kushtetues¹⁷⁷, i cili përbën një ndër elementët thelbësor të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës të të Drejtave të Njeriut¹⁷⁸. Qëllimi i legjislatorit ka qenë tutelimi i të miturit nga akuzat që mund ti ngrihen në rastet që nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e tij. Pra, çdo dyshim duhe të shkoj në favor të të mitur dhe ky parim do të konsiderohej i cënuar nëse barra e provës do të kalonte nga akuza tek i pandehuri. Detyrë e gjykatës së zakonshme është që ti krijojë mundësin të pandehurit ose nëpërmjet mbrojtësit të mbrohet dhe ajo të japë vendimin e saj të bazuar mbi provat direkte dhe indirekte, të cilat duhet të provohen nga akuza dhe që administrohen në dosje¹⁷⁹.” **Parimi i interesit më të lartë të fëmijës; Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi; E drejta për zhvillim harmonik të të miturit; Parimi i proporcionalitetit; Përparësia e masave alternative të shmangies; Pjesmarrja e detyrueshme e psikologut.**

177 Neni 30 kushtetutes “

178 Neni 6/1 Koventa e të Drejtave të Njeriut “

179 Gjykata Kushtetuese vendim Nr.4, dt.27.02.2004

Në çdo fazë të procedimit që kanë të bëjnë me të miturit është e detyrueshme prania e psikologut si garanci për mbështetjen psikologjike të të miturit i cili vleron thëniet e tij në bazë të zhvillimit të tij kognitiv, i cili luan rolin mbështetës emocional të fëmijës. Pra, sipas legjislacionit shqiptarë, Kodi i drejtësisë për të mitur siguron dhe garanton mbrojtjen ligjore dhe psikologjike falas si për të miturin në konflikt me ligjin ashtu edhe për të miturin viktimë. Në rast të mosparaqitjes së mbrojtësit apo të psikologut marrja në pyetje të të miturit në konflikt me ligjin ndërpritet pasi deklarimet e marra nga i mituri pa prezencën e mbrojtësit dhe psikologut bën që procedura dhe aktet të jenë të pavlefshme¹⁸⁰. Prania e detyrueshme e psikologut i cili duhet të jetë prezent në të gjithë procedurën penale që zhvillohet ndaj të miturit në konflikt me ligjin është një risi pasi Kodi i proç. Penale parashikon prezencën e mbrojtësit të detyrueshëm kur i pandehuri është nën 18 vjeç, mungesa e ndihmës juridike prej një mbrojtësi sjell pavlefshmëri të akteve dhe procedurës së ndjekur, ndërsa përsa i përket asistencës psikologjike për të miturin K.P.P nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim, kjo do të thotë që mund të neglizhohet pjesëmarrja e tij në proces sepse siç rezulton nga leximi i dispozitave të K.P.P dhe aplikimit të tyre në praktik, nuk shkakton pavlefsahëri të aktit ose të veprimit.

I MITURI VIKTIMË DHE DËSHMITARË I VEPRËS PENALE

Në K.D.M janë specifikuar parimet e përgjithshme të cilat duhet të respektohen kur kemi të bëjmë me të mitur viktimë/dëshmitar i veprës penale. Ndër to mund të përmëndim (Neni 33): trajtimi i tyre me përkujdesje, në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme; të mbrohet jeta e tij private; të ruhet konfidencialiteti; me leje të gjykatës mund të bëhet i ditur identiteti i të miturit viktimë/dëshmitar i veprës penale. I mituri viktimë e veprës penale ka të drejtë të informohet mbi procedurat që kanë të bëjnë me të, me rolin e tij, kohën e dëshmisë, si dhe me mënyrën sesi do procedohet me marrjen e tij në pyetje, me mekanizmat mbështetëse për bërjen e ankesës; mundësinë për të patur në dispozicion ndihmë ligjore falas; ndihmë psikologjike dhe mjeksore; mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin që i është shkaktuar nga autori i veprës penale. Gjithashtu, i mituri viktimë/dëshmitar i veprës penale mund të mbështet tek Njësitë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e cila ka për detyrë që, t'i ofrojë të miturit mbështetje

180 Neni 49 I KDM "Prania e detyrueshme në veprimet procedurale me të mitur"

emocionale si dhe mbështetje gjatë gjithë procesit; të këshillojë sipas rastit ndjekjen e ndonjë terapie apo të këshillimit profesional; të informojë të miturin për rëndësinë që ka dhënia e dëshmisë, vendin dhe kohën e marrjes në pyetje; të drejtën e tij për të patur mbështetje ligjore, psikologjike dhe shëndetësore falas; sipas rastit, të shmangë kontaktet e padëshiruara apo të papërshtatshme për të miturin, ose të ndër marrë masa të tjera që i shikon si të nevojshme për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit. Në rast se përfaqësuesi i NJ.M.D.F është caktuar në cilësinë e përfaqësuesit proçedural, kur i mituri viktimë/dëshmitar është nën 14 vjeç, jep pëlqimin për dhënien e dëshmisë nga ana e të miturit. Si masa mbrojtëse për të miturin viktimë/dëshmitar i veprës penale K.D.M ka parashikuar se në çdo fazë të procesit penale, kur siguria e të mitur viktimë ose dëshmitar është në rrezik, sipas rastit, prokurori, policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, marrin masa mbrojtëse (neni 37) si shmangien e drejtpërdrejtë midis viktimës/dëshmitarit dhe të akuzuarit në çdo fazë të procesit; paraqitja e një kërkesë për nxjerrjen e një urdhër kufizimi paraqitjen e një kërkesë ku kërkohet vendosja e masës së sigurimit 'arrest me burg' ose 'arrest shtëpie' për të akuzuarin me qëllim ndalimin e kontaktit me të miturin; ruajtjen e sekretit të vendodhjes së të miturit. I mituri viktimë/dëshmitar duhet të njoftohet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë sa më i përshtatshëm për të duke marrë parasysh zhvillimin e tij kognitiv në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij. I mituri viktimë/dëshmitar në rast se dëshmia e tij mund ta vendos atë në rrezik serioz për jetën atëherë gjyqtari mund të vendosi që t'i ndryshohet pamja dhe/ose zërin, marrjen në pyetje të tij nëpërmjet një ekrani jotransparent, ose në distancë; pyetjen e dëshmitarit përpara seancës me pjesëmarrjen e mbrojtësit të të miturit dhe video-rregjistrimit të pyetjes së të miturit; pyetja e tyre duhet të bëhet në mjedise miqësore si dhe jashtë mjedisit të gjykatës; mos rimarrjen në pyetje në shkallët e tjera të gjykimit për të shmangur riviktizimin e të miturit, me përjashtim të rasteve të caktuara me ligj. Në raste me të mitur viktimë/dëshmitarë zhvillimi i seancës gjyqësore bëhet vetëm me dyer të mbyllura. Kur kemi të bëjmë me të mitur viktimë/dëshmitar të shfrytëzimit seksual ose të dhunës seksuale, marrja në pyetje e tyre rregjistrohet audio dhe video i cili është i detyrueshëm si dhe dëshmia e tyre mund të shfaqet gjatë seancës pa qënë i pranishëm vetë i mituri nëpërmjet teknologjive të nevojshme të komunikimit. Kur i mituri është dëshmitar/viktimë e dhunës në familje ai ndalohet të merret në pyetje në praninë e prindit ose të afërmit abuzues. Kur i mituri është nën 14 vjeç pyetja e tij mund të bëhet vetëm

me pëlqimin dhe me praninë e përfaqësuesit ligjor/proçedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij.

NDJEKJA PENALE DHE MASAT ALTERNATIVE PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN

Fryma e përshkruar nga K.D.M është ajo e një drejtësie miqësore për të miturin në konflikt me ligjin. Ligjvënësi ka parashikuar që para se të miturin në konflikt me ligjin ta përballë me kalvarin e një proçesi gjyqësor i cili do të ndikojë negativisht në psikologjin dhe në drejtimin që do marri jeta tij, ti japë një mundësi të miturit në konflikt me ligjin për të riparuar dëmin që i ka shkaktuar viktimës duke marrë në kosiderat interesin më të lartë të fëmijës, në respekt edhe të viktimës. K.D.M parashikon dispozita të posaçme përsa i përket shmangies nga ndjekja penale si një alternativ e ndjekjes penale nga organi i prokurorisë. Masat e shmangies, zbatohen nëse:ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një veprë penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një veprë penale ose nuk është përsëritës;i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies; i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korrigjimit të sjelljes së tij;duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit, shihet nëse nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar.I mituri duhet të japë pëlqimin për masën e shmangies.Subjektet që mund të vendosin zbatimin e masës së shmangies janë:Prokurori, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve, punonjësit social ose psikologut, mund të vendosë kthimin e çështjes prokurorit për të proçeduar me zbatimin e masës së shmangies. Para marrjes së këtij vendimi, gjykata dëgjon të miturin dhe merr pëlqimin e tij. Gjykata mund të zbatojë masën e shmangies në fazën e gjykimit deri para marrjes së vendimit përfundimtar.Në rastet e mësipërme vendoset mosfillimi ose pushimi i çështjes penale. Masa e shmangies bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të të miturit dhe kur është e përshtatshme edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor. I mituri ka të drejtë të heqë dorë nga në çdo fazë nga kjo masë shmangie. Ndërmjetësimi është një moment tjetër shumë i rëndësishëm i prekur në KDM.

Ajo është një procedurë jashtëgjyqësore, zhvillohet nga ndërmjetësi, vetëm me pëlqimin e lirë të shprehur nga i akuzuari i mitur dhe pala e dëmtuar. Dhënia e pëlqimit shënohet në proces verbal.

PROÇESI I HETIMIT DHE GJYKIMIT TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Në momentin që organi proçedues kryen arrestimin e të miturit, e informon këtë të fundit me të drejtën për të njoftuar prindin apo një person të rritur të treguar dhe pranuar prej tij, i shpjegon arsyet e arrestimit dhe i vë në dispozicion një kopje të Letrës së të Drejtave. Në rast se të miturit nuk i gjëndet përfaqësuesi ligjor apo ka dyshime me paanshmërinë e këtij të fundit organi proçedues njofton menjëher Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës duke caktuar një person i cili është pjesë e Njësisë e që do të kryejë përfaqësimin proçedural të të miturit. Gjatë pyetjes së të miturit në konflikt me ligjin, organi proçedues garanton zbatimin e të drejtave të miturit, duke garantuar trajtimin me dinjitet dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe fëmijës. Gjuha e përdorur ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë sa më miqësore dhe komunikimi me të të jetë në formë sa më të kuptueshme. I mituri, përfaqësuesi ligjor/proçedural ose psikologu kanë të drejtë të kërkojnë pushimin në çdo kohë të pyetjes së të miturit. Një ndër rrishtë që sjell ky kod është se ndalohet marrja në pyetje e të miturit gjatë natës, nga ora 22.00 - 08.00. Kontrolli intim i të miturit mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatës, përveç rasteve urgjente. Kontrolli dhe veprime të tjera proçeduriale të cilat kanë të bëjnë me heqjen pjesërisht ose plotësisht të veshjeve të të miturit, ndërmerren vetëm bazuar në një vendim gjyqësor që merret pasi është marrë mendimi i të miturit dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor dhe të mbrojtësit. Gjykata për këto raste vendos brenda 12 orëve nga paraqitja e kërkesës, pa pjesmarrjen e palëve. Prania e mbrojtësi dhe psikologut është gjithmonë e detyrueshme. Çështja e një të mituri dërgohet në gjykatë jo më vonë se 3 muaj nga dita e rregjistrimit të emrit në rregjistër. Gjykata e shkallës së parë e përfundon gjykimin jo më vonë se 6 muaj nga dita e depozitimit të akteve në gjykatë. Gjykata e apelit përfundon shqyrtimin jo më vonë se 2 muaj nga data e dërgimit të akteve në gjykatë. Gjykimi i të miturit zhvillohet në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura dhe nuk mund të zhvillohet në mungesë të tij.

QËLLIMI DHE LLOJET E DËNIMIT

Sipas K.D.M qëllimi i dënimit të të miturit në konflikt me ligjin nuk është ndëshkimi por rishoqërimi, ri-integrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale, duke i ofruar të miturit në konflikt me ligjin kujdes, asistencë dhe mbikqyrje¹⁸¹ të posaçme nga aktorët pjesmarrës të drejtësisë penale për të mitur.

Sipas K.P.P masat e sigurimit për të mitur nuk kanë ndonjë ndryshim thelbësor ndaj masave në rastin e të rriturve. Nëse do të referohemi përmbajtjes së nenit 251/1 i K.P.P lidhur me kushtet për arrestin në flagrancë¹⁸² dhe nenin 253/1 të K.P.P mbi ndalimin e të dyshuarit për një krim¹⁸³ do të vëmë re se nuk ka një paragraf në të cilët të parashikohen aplikimet e këtyre masave ndaj të miturve. Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka parashikuar në nenin 82 se masat e sigurimit ku përveç atyre të parashikuara në K.Pr.Penale, janë vlerësuar si masa që mund të vendosen ndaj të miturit vendosja në mbikqyrje dhe vendosja në një shërbim të specializuar.

Në K.P.P dispozitat që e trajtojnë ndryshe të miturin janë përkatësisht nenet 229/3¹⁸⁴; 230/3¹⁸⁵ dhe neni 255/4¹⁸⁶. Me hyrjen në fuqi të K.D.M, legjislatori shqiptarë ka parashikuar në nenin 97 të kodit kriteret e mëposhtme për vendosjen e masës së sigurimit “*arrest në burg*” ku sanksioni i parashikuar për veprën penale është më burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet si dhe kjo masë është e domosdoshme pasi i mituri, përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër dhe përpiqet t'i shmanget drejtësisë. Pra siç vihet re, ligjvënësi ka parashikuar heqjen e lirisë si alternativ e fundit e dënimit, duke marrë në konsiderat interesin më të lartë të fëmijës duke e shtrirë masën e dënimit nga dy vjet e parashikuar nga K.P.P në 7 vjet, pra jo vetëm për kundravajtjet. Gjykata, me kalimin e çdo muaji, nga caktimi i masës së sigurimit arrest me burg, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin,

181 Neni 93 i K.D.M

182 Vepra penale të cilat ligji parashikon dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

183 Për veprat penale të cilat ligji parashikon dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjetë.

184 Neni 229/3 i K.P.P: “kur l pandehuri është l mitur Gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete”.

185 Neni 230/4 i K.P.P: “ të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundravajtje penale”

186 Neni 255/4 i K.P.P: “Policia Gjyqësore, kur l arrestuari ose l ndaluar është l mitur, lajmërohet detyrimisht prindit ose kujdestari”.

zëvendësimin ose revokimin e saj. I mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se gjysma e kohës së paraburgimit për të rriturin. Dënimi është mjeti i fundit i mundshëm i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies janë të papapërshtatshme.

a) Dënimet kryesore janë: Burgimi, kufizimi i lirisë dhe gjoha. K.D.M i favorizon të miturit në konflikt me ligjin përsa i përket dënimit maksimal të tyre duke vënë një tavan për masën e dënimit që i jepet të mitur panvarsisht parashikimit të masës së dënimit të kryerjes se veprës penale, me qëllim ri-edukimin dhe ri-integrimin e këtij të fundit në shoqëri. Nëse gjykata jep dënim me burgim deri në pesë vjet dhe i mituri nuk është dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale me dashje, ajo mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

b) Dënime plotësuese janë: Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; Kryerja e një pune me interes publik; Përmëshja e detyrimeve të caktuara; Qëndrimi në shtëpi.

REHABILITIMI

Veprimtaria rehabilituese në vendin e vuajtjes së dënimit për të miturin ka për qëllim kryesor të përgatisë të miturin për lirinë e tij, me qëllim rehabilitimin e tij dhe kthimin në jetën shoqërore.

Administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur merr masa që, qysh në fillim dhe duke e përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, të hartojë një plan të posaçëm së bashku me të miturin, familjen e tij dhe në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së të miturit.

Administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur siguron që i mituri të kuptojë përmbajtjen e planit. Për të mbështetur procesin e riintegritimit organet e qeverisjes vendore në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, bëjnë të mundur, sipas legjislacionit në fuqi, strehimin e përshtatshëm për të miturin që nuk ka strehim. Pas lirim-it, i mituri, sipas rastit, rivendoset pranë prindit ose kujdestarit të tij dhe i garantohet mbrojtja, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e fëmijëve do të koordinojë dhe do të zbatojë planin e rehabilitimit dhe të rishoqërizimit për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirimit me kusht dhe do të mbikëqyrë ecurinë e zbatimit të planit për rishoqërizimin e të miturit.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për implementimi dhe zbatimimi i K.D.M është e nevojshme jo vetëm bashkëpunimi i aktorëve pjesmarrës por edhe nxjerrja e menjëhershme e akteve nënligjore, si domosdoshmëri për zbatim të menjëhershëm të kodit; Mbështetja e rolit të familjes dhe komunitetit me qëllim eliminimin e kushteve shoqërore që sjellin problemet e kriminalitetit, krimin dhe varësinë nga drogat; Trajnim i vazhdueshëm jo vetëm i prokurorëve, gjyqtarëve, avokatëve por edhe i psikologëve lidhur me njohjen e drejtpërdrejtë të konventave të ratifikuara nga Shqipëria dhe zbatimimi i tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë; Mbledhja dhe analizimi duke krijuar një data-base bashkëkohore ku të përfshihen të gjitha fushat që mbulon legjislacioni mbi drejtësinë penale për të miturit, ku të përfshihen të miturit në konflikt me ligjin si dhe i mituri viktimë e veprës penale; Parashikimi i burimeve financiare të mjaftueshme si dhe një shpërndarje sa më ekuo e tyre, duke u përqëndruar më tepër në sektorët që paraqiten më problematik; Të kryehen studime të thelluar për sa i përket kriminalitetit tek të miturin në mënyrë të tillë që të individualizohen shkaqet e një sjellje delinvente nga ana e të miturit, për të përpiluar më pas strategjitë që duhen ndjekur për parandalimin e kryerjes së veprës penale nga i mituri në konflikt me ligjin.

BIBLIOGRAFIA

- Konventa Evropiane për të drejtat e Njeriut
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr.7895/1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr.7905/1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr.37/2017, Kodi i Drejtësisë për të mitur



GARANCITË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTËN PËR LIRI DHE SIGURI PËR TË MITURIT

Msc. Lulëzim Barjamemaj

Studio Legale Çerekja

lulzimmema@yahoo.com

ABSTRAKTI

Ky punim synon të pasqyrojë dhe të analizojë të drejtën për Liri dhe Siguri të të miturit në rregullimin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, vlen të analizohet kuadri i ri ligjor për të parë risitë dhe problematikat që do të ketë në zbatimin praktik të tij. Kjo e parë në optikën e standarteve të konsoliduara ndërkombëtare, poashtu në qartësinë dhe zbatueshërinë praktike të këtyre procedurave të reja. I gjithë kuadri ligjor i rikonceptuar i drejtësisë penale për të mitur, vlen të studiohet dhe analizohet për të arritur një zbatueshmëri sa më ideale në procedurat dhe vendimet gjyqësore. Në veçanti, do të mundohemi të analizojmë në detaje rregullimin e ri për kontaktin e parë të të miturit në konflikt me ligjin, siç është arresti, dhe më pas për “fatin” e tij procedural, nëse do të nënshtrohet masës së fundit të sigurisë, atë të arrestit në burg, apo do të vendoset në masa sigurimi të reja bashkëkohore. Analizimi dhe “kritika” do të vlejë për përmirësime dhe interpretime sa më të unifikuara në zbatimin praktik të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Fjalët kyçe: *I mitur, legjislacion ndërkombëtar, arrest në burg, masa të veçanta, Kodi i Drejtësisë për të Mitur.*

HYRJE

E drejta për Liri dhe Siguri është një e drejtë themelore e njeriut.¹⁸⁷ Kjo e drejtë bëhet akoma edhe më shumë e ndjeshme kur bëhet fjalë për subjekte siç janë të miturit. Por në kushte dhe kritere të caktuara kjo liri mund të kufizohet. Në

bazë të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore janë të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik¹⁸⁸. Por këto të drejta nuk mund të përdoren për arritjen e qëllimeve kriminale ose në dëm të të tjerëve, prandaj mund të kufizohen me ligj duke u mbështetur në nenin 17 të Kushtetutës, në të cilin thuhet: *Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Dhe është pikërisht ligji procedural penal ai ligj që kufizon të drejtën për Liri dhe Siguri për një interes publik, që në këtë rast është interesi i drejtësisë penale. Një dispozitë e tillë nuk mjafton, prandaj Kushtetuta në nenin 27¹⁸⁹ ka përcaktuar edhe rastet kur mund të kufizohet kjo e drejtë. Rasti i pikës c) dhe pikës ç) janë rastet e trajtuara nga ky punim. Legjislacioni ndërkombëtar ka vendosur disa standarde bazë për t'u zbatuar në kufizimin e kësaj të drejte dhe disa garanci më shumë kur subjekt i këtij kufizimi janë të miturit. Poashtu legjislacioni ynë ka bërë hapa përpara për respektimin e këtyre standardeve. Ndryshimet e fundit legjislative sollën ndryshime thelbësore pozitive në gjithë drejtësinë penale për të mitur, duke u materializuar me miratimin e ligjit 37/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datë 1 janar 2018.*

1. AKTET NDËRKOMBËTARE QË RREGULLOJNË TË DREJTËN PËR LIRI DHE SIGURI PËR TË MITURIT.

Bazuar në parime ndërkombëtare tashmë të konsoliduara dhe të gjithëpranuar nga pjesa më e madhe e shteteve, e drejta për Liri dhe Siguri është një e drejtë themelore¹⁹⁰ e cila duhet të respektohet pa ekuivok nga autoritetet përgjegjëse në vendet respektive. Në veçanti, i kushtohet një vëmendje e veçantë kësaj të drejte për subjekte të caktuara, siç janë të miturit. Konventa Europiane e të

188 Artan Hoxha, Ilir Panda, 2012, E drejta e Procedurës Penale

189 1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit. 3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

190 Neni 5 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Drejtave të Njeriut në nenin 5 të saj, veçon të miturit për më shumë garanci në kufizimin e së drejtës për Liri dhe Siguri¹⁹¹. Kufizimin e kësaj të drejte, konventa e lidh me qëllimin final për ta vendosur të miturin nën mbikëqyrje për edukimin e tij. Pra, konventa në frymën e dispozitës së sipërpërmendur, mishëron mbi të gjitha edhe qëllimin e kufizimit të lirisë personale të të miturit. Padyshim që i mituri mund të arrestohet/ndalohet edhe për qëllimin final për ta dërguar përpara një autoriteti gjyqësor, që në një kohë sa më të shkurtër të vlerësojë masën e marrë ndaj tij¹⁹². Garancia në këtë rast është që masa e arrestit e vendosur nga organet e hetimit, duhet të vlerësohet në një kohë sa më të shkurtër nga një gjyqtar, duke e dëgjuar personalisht të arrestuarin.

Konventa e të Drejtave të Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuarave më 20.12.1989, e ratifikuar nga vendi ynë ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991, përpara së gjithash, përcakton edhe moshën minimale të termit “fëmijë”. Në nenin 1 të saj, përcaktohet se: *Në këtë konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshëm 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.*

Në nenin 37 pika b) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës përcaktohet se, asnjë të mituri nuk duhet t'i privohet liria në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare. Kjo dispozitë në themel të saj përcakton se kufizimi i lirisë duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë. Pra, pikësëpari duhet që një kufizim i tillë i lirisë personale duhet të parashikohet qartë në procedurat e legjislacionit procedural-penal. Ky parim vlen përgjithsisht për çdo lloj procedure ligjore, por në legjislacionin material penal dhe procedural penal ka një vlerë themelore. Pa një parashikim të qartë, të saktë dhe të drejtë të kufizimit të një të drejte themelore, nuk mund të pretendojmë që jemi duke zbatuar këto parime. Prandaj Konventa udhëzon që arrestimi/ndalimi të bëhen në përputhje me procedura të qarta dhe të drejta, duke mos përdoruar arbitraritet në aplikimin e tyre.

Një element tjetër i po së njëjtës pikë¹⁹³ përcakton se përveç ligjshmërisë formale, duhet vlerësohet dhe të respektohet me rigozitet që kjo masë arresti/ndalimi, të aplikohet vetëm si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. Kjo do të thotë që organet e hetimit duhet të vlerësojnë dhe arsyetojnë që kjo

191 Pika 1, gërma d) e po këtij neni.

192 Pika 4 e nenit 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

193 Pika b) e nenit 37 e Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

masë është masa e fundit dhe nuk mund të aplikohet një masë më të lehtë në kushtet konkrete. Këto organe duhet të vlerësojnë si fillim aplikimin e një mase më të lehtë, duke u përpjekur që qëllimi i tyre, sigurimi i procedimit, të realizohet me një masë sa më të lehtë. Dhe nëse pas aplikimit të kësaj mase, nuk ka rezultat dhe është absolutisht e nevojshme zbatimi i masës së arrestit, atëherë procedohet me këtë masë. Por edhe pas kësaj faze vlerësimi ka nevojë për një fazë të dytë, test të dytë, që është elementi kohë në zbatim. Kjo do të thotë që zbatimi i masës së arrestit duhet të jetë për një kohë sa më të shkurtër. Një kohë sa më e shkurtër është minimalisht më e shkurtër sesa koha e aplikimit të masës së arrestit tek të rriturit. Por kjo nuk do të thotë që automatikisht është zbatuar kjo dispozitë, duke përcaktuar një kohë relativisht më e shkurtër sesa koha e përcaktuar për një të rritur. Koha duhet të jetë sa më e shkurtër, prandaj prokurori detyrohet të procedojë me përparësi çështjet me të mitur, që ky parim të mos ngelet vetëm në ligj, por ky parim të zbatohet me fanatizëm rast pas rasti.

Me kalimin e fazës procedurale të sqaruar më sipër, neni 37, pika c) dhe d) e Konventës për të Drejtat e Fëmijës përcakton se çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë sa më njerëzore, duke respektuar dinjitetin dhe duke mbajtur parasysh nevojat specifike për shkak të moshës së tij. Detyrimit duhet të veçohet nga të rriturit dhe t'i lejohen vizita të shpeshta me familjen e tij.¹⁹⁴

Aspekt tjetër i përcaktuar në këtë nen është e drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike, ndihmë e cila është shumë e nevojshme për shkak edhe të moshës së tij. E nevojshme sepse kjo passjell të drejta të tjera, siç është e drejta e ankimit ndaj masës së arrestit. Kjo e drejtë është themelore e sanksionuar edhe në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, por pa një ndihmë juridike në këtë fazë nuk mund të realizohet. Prandaj Konventa e të Drejtave të Njeriut e ngre në nivel superior, duke dashur që shtetet palë në Konventë të përcaktojnë në mënyrë eksplicite në legjislacionet e tyre procedural-penal këtë të drejtë. E drejta e ankimit në këtë rast do të sjell një garanci thelbësore. Sepse pas një ankimi të tillë do të mund të gjykohet dhe analizohet nga ana e gjytarit të pavarur dhe të paanshëm nëse një masë e tillë është e nevojshme dhe në interesin më të lartë të të miturit apo jo.

Gjatë kohës së arrestit, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut përcakton

194 Pika c) dhe d) e nenit 37 e Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

se ndaj të miturit duhet të merren masa edukative nën mbikqyrje. Në vendimin Ichin me të tjerë kundër Ukrainës¹⁹⁵ *përcaktohet se: Edukimi nën mbikëqyrje duhet të përfshijë aspekte të shumta të ushtrimit të disa të drejtave prindërore nga ana e autoritetit kompetent në të mirën e të miturit të interesuar dhe për mbrojtjen e tij.*

Rregulli numër 10 i Rregullave Standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur¹⁹⁶ përcakton se, menjëherë pas arrestimit/ndalimit të të miturit, organet ligjzbatuese detyrohen të njoftojnë prindin ose kujdestarin e të miturit. Në këtë mënyrë i mituri arrin të marrë kontakt me një person të besuar dhe që do të mund të kujdeset për të, si nga ana psikologjike, ashtu edhe përsa i përket garancisë që më pas të ketë një mbrojtje efektive të zgjedhur nga prindi ose kujdestari. Gjithashtu në këtë rregull përcaktohet se, kontaktet procedurale të të miturit me organet ligjzbatuese duhet të jenë në atë formë që të respektohet statusi ligjor i të miturit dhe të nxitet mirëedukimi i tij në tërësi.

2. KUFIZIMET E LIRISË PERSONALE TË TË MITURIT SIPAS LEGJISLACIONIT TË BRENDSHËM

Krahas Kodit të Procedurës Penale, legjislacioni shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm për garantimin e të drejtës për liri dhe siguri. Një vëmendje të veçantë i është kushtuar kategorisë të të miturve. Me ligjin 37/2017¹⁹⁷ është miratur Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i cili krahas të gjitha aspekteve të tjera materiale dhe procedurale penale ka bërë dhe një rregullim specifik për kriteret dhe garancitë e duhura për caktimin e masave të sigurisë ndaj të miturve. Termi “I mitur” sipas këtij Kodi është i njëjti në përkufizim edhe me përkufizimin që i bën Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Neni 3 i ligjit 37/2017 përkufizon që:

“I mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Pra ky rregullim ligjor ka për subjekt të gjithë personat në konflikt me ligjin nën moshën 18 vjeç.

2.1 Kriteret e përgjithshme të caktimit të masës së sigurimit ndaj të miturit.

Kriteri i parë i caktimit të masës së sigurisë ndaj të miturit është një kriter shumë i rëndësishëm, pasi gjykata duhet të vlerësojë me objektivitet rëndësinë

195 Vendim i Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, Ichin me të tjerë kundër Ukrainës.

196 Miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 e datës 29 nëntor 1985

197 Kodi i Drejtësisë për të Mitur

dhe qëllimin saj. Ndaj të miturit nuk mund të caktohet një masë sigurimi më e rëndë, nëse i njëjti qëllim mund të realizohet me një masë më të lehtë. Vlen të theksohet se gjyqtari në këtë rast duhet të vlerësoj se cila masë do të ishte më e përshtatshme dhe më e lehta njëkohësisht.

Kritere shumë të rëndësishme kumulative janë: mbajtja parasysht dhe arsyetimi i interesit më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesa për të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri. Të gjitha këto kushte vijnë nga një përqsasje pozitive e legjislacionit tonë me të drejtën përparimtare botërore të kësaj fushe.¹⁹⁸

Gjyqtari në seancën e masës së sigurimit duhet që ta dëgjoj personalisht të miturin dhe në një kohë të shpejtë të vendos në lidhje me kërkesën e prokurorisë. Kjo garanci procedurale e bën gjyqtarin më të përgjegjshëm në caktimin e masës së sigurimit, pasi duke e dëgjuar vet personalisht arrin të kuptojë edhe më shumë për rrethanat e kryerjes së veprës penale, poashtu arrin edhe të kuptojë më mirë nevojat specifike të të miturit.

Në aplikimin e masës së arrestit në burg, Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar) përcakton se, kur aplikohet kjo masë gjyqtari është i detyruar arsyetojë me argumenta faktik dhe juridik përse masat e tjera më të lehta nuk janë të përshtatshme, dhe pse masa e fundit, ajo e arrestit në burg është e domosdoshme.¹⁹⁹ Moszbatimi i këtij detyrimi ka pasojë pavlefshmërie vendimi për caktimin e masës së sigurimit. Aplikimi i kësaj dispozite vlen të studiohet në një periudhë të mëvonshme, pasi këto ndryshime janë të datës 1.8.2017 (pra shumë herët për një praktikë të konsoliduar). Por në harmoni edhe me ndryshimet e fundit ligjore²⁰⁰, ky akt (vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit) është i pavlefshëm duke e interpretuar edhe në harmoni me nenin 128 të Kodit të Procedurës Penale, i cili shprehimisht përcakton: *Aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara nga ky kod.* Dhe rast konkret është neni 245, pika 1, gërma ç, në të cilin përcaktohet se mosargumentimi nga ana e gjykatës se përse masat e tjera janë të papërshtatshme, dhe masa e arrestit është absolutisht e nevojshme, e bën aktin (vendimin) e pavlefshëm. Kjo dispozitë do të vendos përgjegjësi të reja për gjyqtarët, kjo në raport edhe me arsyetimin e vendimit si një aspekt i procesit të rregullt ligjor.

198 Neni 81 i Ligjit 37/2017

199 Neni 245, pika 1, gërma ç) I Kodit të Procedurës Penale

200 Ligji 35/2017

Një aspekt pozitiv që në mendimin tim duhej ndryshuar, është përcaktimi me pasojë pavlefshmërie të vendimit mos argumentimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin që gjykata merr për caktimin e masës së arrestit. Mënyra sesi është ndërtuar dispozita, neni 81 i ligjit 35/2017, nuk e ngarkon me një sanksion pavlefshërie mosrespektimin e kësaj dispozite. Nga teknika legjislative kuptojmë që është një dispozitë përshkruese pa një sanksion të caktuar. Kjo e kufizuar edhe me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht me neni 128 të sipërpërmendur. Këto ndryshime përcaktojnë në mënyrë taksative që aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm nëse dispozita përkatëse e ngarkon me pasojën e pavlefshërisë nëse nuk kryhet në mënyrën e përshkruar në dispozitë.

2.2 Masat e veçanta të sigurimit për të miturit

Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa:

- a. vendosja e të miturit në mbikëqyrje;
- b. vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.²⁰¹

2.2.1 Vendosja e të miturit në mbikëqyrje²⁰²

Vendosja e të miturit në mbikëqyrje synon garantimin e paraqitjes së të miturit, sa herë kërkohet, përpara oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit ose gjykatës. Për realizimin e kësaj masë nevojitet marrja përsipër nga ana e prindit, të afërmit, institucionit ose personit të specializuar që të garantojë sjelljen e të miturit dhe të mbikëqyrë nëse sjellja është e përshtatshme. Në mënyrë alternative përgjegjësia për ta marrë përsipër garantimin e zbatimit të kësaj mase janë: prindi, i afërmi ose institucioni i specializuar. Pra, nëse prindi nuk e garanton kryerjen e kësaj përgjegjësie, i ngarohet një të afërmi dhe nëse edhe i afërmi nuk është në gjendje për ta garantuar zbatimin e kësaj mase, kjo përgjegjësi i kalon institucionit të specializuar. Kjo masë është pothuajse e njëjtë me masën shtrënguese personale, atë të detyrimit për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Por në frymën e garantimit të një zhvillimi të një procesi të rregullt dhe në interesin më të lartë të të miturit,

201 Neni 82 i ligjit 37/2017

202 Neni 83 i ligjit 37/2017

është parashikuar që kjo masë sigurimi do të garantohet dhe shoqërohet me përgjegjesinë e prindit, të afërmit ose institucionit të specializuar. Kusht themelor për zbatimin e kësaj mase pëlqimi i të miturit dhe të personit që do ta mbikëqyrë atë. Pa këto dy komponentë nuk mund të realizohet kjo masë.

Por personi mbikëqyrës mund të tërhiqet nga ushtrimi i mbikëqyrjes së të miturit në çdo kohë, në rast se çmon se nuk mund të garantojë paraqitjen e të miturit sa herë kërkohet nga organi kompetent dhe nuk garanton sjelljen dinjitoze të të miturit. Për të garantuar sa më mirë këtë procedurë, personi mbikëqyrës, për këtë duhet të njoftojë menjëherë gjykatën kompetente. Për këtë qëllim ligji ka përcaktuar që personi mbikëqyrës mund të zëvendësohet në rast se ai tërhiqet nga detyra e ngarkuar. Gjithsesi fryma e dipozitës në tërësi kërkon që personi përgjegjës të bëjë përkpjekjet maksimale për të garantuar mbarëvajtjen e këtij procesi.

2.2.2 Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar²⁰³

Nëse nuk realizohet dhe është e pamundur të realizohet mbikëqyrja nga një person përgjegjës, që përgjithsisht është prindi, atëherë gjykata urdhëron vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar ndaj të miturit. Kjo për shkak se interesat e tij kërkojnë një vëmendje dhe mbikëqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit ose personave të afërm. Ky shërbimi i specializuar mundësohet nga institucionet ose persona juridikë të licencuar për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

2.3 Kriteret e arrestit dhe vazhdimet të masës “arrest në burg”

2.3.1 Arresti dhe seanca e vleftësimit

I mituri mund të arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit për Drejtësisë për të Mitur. Pra Kodi i Drejtësisë për të Mitur gjen zbatim në të gjitha aspektet që ai normon, dhe kur nuk është e rregulluar një procedurë e caktuar në këtë kod vlen natyrisht Kodi i Procedurës Penale në tërësinë e tij.²⁰⁴

203 Neni 84 i ligjit 37/2017

204 Neni 5 i ligjit 37/2017

Prokurori pas arrestit ose ndalimit është i detyruar që brenda 48 orëve të kërkoj në gjykatën kompetente vleftësimin e arrestit dhe të kërkojë caktimin e një mase sigurimi nëse janë kushtet përkatëse.²⁰⁵ Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë dhe i mituri të lirohet menjëherë, përveç kur gjykata i vleftëson ato dhe cakton masë sigurimi. Kjo procedurë nisur edhe nga dispozita duhet të bëhet në kohën sa më të shpejtë të mundshme, në të kundërt, çdo shkelje e këtij afati do të përbënte shkelje të rëndë të lirisë të të miturit. Nga ana tjetër mosrespektimi i këtij afati bën që masa të humbas fuqinë, pra ligjëvënësi në këtë rast ka vendosur që mosrespektimit të këtij afati t'i ngarkojë një pasojë positive për të arrestuarin e mitur. Por nga ana e ndëtitimit të dispozitës nuk kemi asnjë ndryshim thelbësor në krahasim me rregullimin e përgjithshëm që i bën Kodi i Procedurës Penale. Edhe nenet 258, 259 të Kodit të Procedurës Penale e rregullojnë në të njëjtën mënyrë këtë fazë procedurale. Prokurori duhet që brenda 48 orëve të kërkojë në gjykatën kompetentë marrjen e një mase sigurimi dhe nga ana tjetër gjykata ka afat 48 orë të tjera të vendos në lidhje me arrestin dhe më pasm për caktimin e masës së sigurisë. Duke qenë se në nenin 85 të ligjit 35/2017 nuk përcaktohet një afat limit se kur duhet ta shqyrtojë gjykata kërkesën e prokurorit, nga neni 15 i ligjit 35/2017 dalim në përfundimin se kur Kodi i Drejtësisë për të Mitur nuk ka parashikuar ndryshe një aspekt të veçantë vlen për zbatim Kodi i Procedurës Penale. Dhe në këtë rast duke qenë se nuk ka një rregullim nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur, zbatohet neni 259 në lidhje më afatin limit se kur duhet ta shqyrtojë dhe të jap vendim gjykata për kërkesën për caktim mase sigurimi të prokurorit. Po sipas nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se gjykata brenda 48 orëve të ardhshme duhet të vendos në lidhje me ligjshmërinë e arrestit dhe më pas në lidhje me caktimin e masës së sigurimit. Nëse nuk respektohet ky afat, pika 5 e nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale përcakton që arresti humbet fuqinë. Praktikisht, *de facto* personi/i mituri nuk lirohet, sepse për këtë duhet të shpreh gjykata me vendim. Pra nuk është përcaktuar në mënyrë taksative mënyra e lirimit, gjë që do ta bënte më të përgjegjshme gjykatën për respektimin rigoroz të këtij afati.

2.3.2 Kushtet për vendosjen dhe vazhdimin e arrestit në burg për të miturit²⁰⁶

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka sjell një reformim rrënjësor përse i përket caktimit të masës së sigurisë arrest në burg ndaj të miturve. Duke qenë se praktika shpesh herë vendoste këtë masë sigurimi ndaj të miturit si masë të parë dhe jo të fundit, këto ndryshime do t'i japin një standart të ri drejtësisë. Përveç parashikimeve të nenit 228, 229 të Kodit të Procedurës Penale, masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston edhe ndonjë nga kriteret e mëposhtme:

a) sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet; b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri: i) përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër; ii) përpiket t'i shmanget drejtësisë.

Ligjvënësi ka dashur të ndryshojë edhe mendësinë e gjykatës në aplikimin e masës së sigurimit arrest në burg. Por nga mënyra e ndërtimit vërehet që gjykata ka po të njëjta "hapësira ligjore" duke e interpretuar shumë ngushtë dispozitën, në mënyrë që të aplikojë masën e fundit, atë të arrestit në burg. Pikat a) dhe b) të nenit të sipërcituar mjafton të qëndrojnë në mënyrë alternative, pra ose njëra ose tjetra, dhe gjykata mund të aplikojë masën e arrestit në burg. Pika a) e nenit të mësipërm është e qartë dhe e prerë për nga interpretimi që mund t'i bëjmë. Mjafton që ndaj të miturit të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e një vepre penale që në minimum dënohet me 7 vite burgim, gjykata mund të caktojë masën e sigurisë arrest në burg.

Dhe duke qenë se në nenin 86 të ligjit 37/2017 përcaktohet se, përveç parashikimeve të nenit 228 të Kodi të Procedurës Penale duhen plotësuar edhe një nga kushtet e tjera (kushtet e pikave a) dhe b) të nenit 87 të ligjit 37/2017) dhe jo përveç parashikimeve të nenit 230 i cili përcakton kriteret e veçanta të arrestit në burg, arrijmë në përfundimin që edhe pse nuk ekzistojnë kriteret e veçanta të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale mund të vendoset masa e sigurisë arrest në burg kur vepra për të cilën i mituri dyshohet dënohet në minimum deri në 7 vite. Pra duket sikur ka regres në garanci procedurale. Natyrisht që nëse e interpretojmë në mënyrë të zgjeruar, arrijmë në përfundimin që du-

206 Neni 85 i ligjit 37/2017

hen plotësuar edhe kushtet e veçanata të nenit 230 (rrezikshmëria e veprës dhe rrezikshmëria e personit). Por ndërtimi sa më i qartë i dispozitës përkatëse do ta bënte më frytdhënëse në zbatim sepse nuk do të linte shteg për interpretim.

Pika b) e nenit 87 përcakton se gjykata mund të vendos masën e sigurisë arrest në burg ndaj të miturit kur masa është e domosdoshme sepse i mituri:

i) përbën rrezik serioz për të dhe/ose të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër;

ii) përpiqet t'i shmanget drejtësisë.

Njëri nga kushtet mjafton të jetë prezent dhe gjykata mund të caktojë masën e arrestit në burg. Kushti i parë duhet të analizohet me kujdes nga gjykata, sepse ajo s'mund të prezumojë që i mituri përbën rrezik serioz për veten ose të tjerët duke qenë se ndaj tij ekziston një dyshim i arsyeshëm. Pra në vlerësim të saj gjykata duhet të argumentojë qartë përse i mituri përbën serioz. Mendoj se nëse do ishte shtuar fjalia: Gjykata duhet të argumentojë rrezikun në rrethana fakti, do të ishte më e qartë dispozita në zbatim.

Kushti i dytë do të jetë më i lehtë për t'u argumentuar dhe zbatuar. Kjo sepse Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata kushtetuese²⁰⁷ kanë thënë qartë që shmangia nga drejtësia nuk mund të prezumohet, por është detyrë e shtetit që të marrë të gjitha masat për të zhvilluar një procedim duke i mundësuar të pandehurit të marrë pjesë në të dhe fakti që i pandehuri po i shmanget drejtësisë duhet të provohet me prova konkrete. Pra gjykata në këtë rast duhet të kërkojë prova nga organ i prokurorisë që vërtetë e mituri po i shmanget drejtësisë, poashtu gjykata duhet të argumentojë që kjo shmangje nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë/masë tjetër.

Garanci tjetër shtesë që bën Kodi i Drejtësisë për të mitur është fakti që është vendosur një afat më i shkurtër për rishikimin periodik të masës së arrestit. Ndryshe nga parashikimi i nenit 246 pika 6 e tij i cili përcakton se: Çdo dy muaj nga zbatimi i masës gjykata edhe kryesisht vendos për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës, në rastin e zbatimit të masës arrest në burg ndaj një të mituri ky afat është më i shkurtër. Gjykata çdo 1 muaj edhe kryesisht vendos për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurisë. Kjo dispozitë është një garanci më shumë, por mendoj që nuk është zgjidhja më e mirë. Edhe

207 Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 10.2.2012

Gjykatae Lartë në vendimin e unifikues numër 1 të datës 08.01.2009²⁰⁸ shprehet se: *Gjykata nuk vihet në lëvizje kryesisht për të kërkuar nga prokurori kompetent permbushjen e detyrimit të informimit dy mujor, sipas dispozitës procedurale të lartpërmendur. Detyrimin për vënien në lëvizje të gjykatës, nëpërmjet paraqitjes së informacionit mbi të arrestuarin dhe gjendjen e procedimit, ligjvënësi ia ngarkon prokurorit. Nëse ky i fundit nuk permbush detyrimin në afat, i arrestuari legjitimohet të kërkojë rishqyrtimin e masës së sigurimit.* Pra gjykata nuk kontrollon kryesisht nëse ekzistojnë ende kushtet dhe kriteret e masës së sigurisë, por detyrohet prokurori ta bëj këtë detyrë dhe nëse prokurori se bën, atëherë legjitimohet i pandehuri të bëj kërkesë për ndyshimin e masës së marrë ndaj tij. Zgjidhja më garantuese do të ishte duke përcaktuar se gjykata çdo muaj të detyrohej të kontrollonte nëse masa e arrestit ishte më e nevojshme apo jo. Të paktën kjo zgjidhje do të ishte më e drejtë dhe garantuese për të miturin.

BIBLIOGRAFIA

- Artan Hoxha, Halim Islami, Ilir Panda, 2012, E Drejta e Procedurës Penale;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës;
- Rregullat Standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur;
- Kodi i Procedurës Penale;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- Vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Ichin me të tjerë kundër Ukrainës;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 10.02.2012;
- Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendim nr.1 i datës 08.01.2009.

208 Vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 1 i datës 08.01.2009

RREGULLIMI LEGJISLATIV I LLOJEVE TË DENIMEVE DHE MASAVE PËR TË MITUR NE VENDET E RAJONIT

Prof.ass.Dr.Majlinda Belegu

Kolegji AAB, Prishtinë

majlinda.belegu@universitetiaab.com

ABSTRAKT

Të miturit kryejnë vepra penale sikurse edhe të rriturit dhe ndaj tyre zhvillohen procedura gjyqësore penale. Qëllimi i punimit është analiza e normave të vendeve të rajonit për dënimet dhe masat për të mitur duke analizuar ngjashmëritë dhe dallimet e këtyre dispozitave.

Gjatë analizës do përdoren metoda analitike, sistematike dhe krahasimore. Masat ndahen në të diversitetit dhe edukative, dhe shqiptohen vetëm për të miturit që ende nuk e kanë mbushur moshën 16 vjeç. Punimi do të analizoj edhe dënimet që u shqiptohen vetëm personave që kanë mbushur moshën mbi 16 vjeç. Poashtu do të trajtohen edhe dënimet si dënim me gjobë, urdhëri për punë të detyrueshme në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.

Kodi Penal për të Mitur, i Shqipërisë dënimet poashtu i ndanë në dënime kryesore dhe dënime plotësuese, ndërkaq si masa për të mitur shqiptohen nga gjykata: vendosja e të miturit në mbikqyrje dhe vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.

Do të trajtohen edhe dispozitat për të drejtën e të miturve si masa edukuese për të miturit e vegjël ndërkaq për të miturit e mëdhenj shqiptohen masat edukuese, dënimet dhe masa alternative e kjo gjithmonë sipas dispozitave në Maqedoni.

Për shkak se Kroacia është anëtare e BE-së dhe të gjitha vendet e rajonit synojnë anëtarësim në BE, do të analizohen edhe normat për dënime dhe masa që rregullohen me ligjin për të mitur në Kroaci.

Fjalë kyçe: *ligj, vepra penale, të mitur, dënime, masa ndëshkuese*

HYRJE

Personat madhor gjatë jetës mund të kryejnë vepra penale, por në disa raste këto vepra mund të kryhen edhe nga të miturit. Me këtë rast ndaj të miturit do të zhvillohet procedurë gjyqësore për ndëshkimin dhe sanksionimin e tij. Mbajtja e dënimeve dhe masave do të ndikojnë në rehabilitimin e të miturit dhe do të ndikojnë drejtpërdrejtë në mos përsëritjen e veprave të njejta penale nga ana e tij.

Çdo i mitur i cili dyshohet se ka kryer vepra penale me ligj prezumohet të jetë i pafajshëm. Kjo ndodhë deri në momentin kur vërtetohet fajësia e tij me vendim të formës së prerë. Gjatë gjithë procedurës sipas ligjit do të duhej të respektohen parimet bazë pa të cilat edhe procedura do të koniderohej e kundërligjshme dhe e pavlerë. Në çdo kohë duhet pasur parasysh interesin e lartë të cilin e ka shteti për fëmijët, mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtën për zhvillim harmonik për të miturin, proporcionalitetin, përparësinë e masave në raport me dënimet e rënda, si dhe, dënimin me heqjes të lirisë duhet të shqiptohet si masë e fundit për të miturin. Ky dënim duhet shqiptuar vetëm për veprat e rënda penale, në rastet kur i mituri ka kaluar moshën 16 vjeç. I mituri që dyshohet se ka kryer vepra penale, ka të drejtë në gjykim të shpejtë dhe pa vonesa, me patjetër ai duhet të jetë prezent gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në seanca dhe gjatë procedurës penale pjesëmarrja e psikologut është e domosdoshme, ligji e normon si të detyrueshme për të miturit e sidomos për ata që ende nuk kanë arritur moshën 14 vjeç respektivisht 16 vjeç.

Sipas ligjit në të gjitha vendet e rajonit zotësia e veprimit fitohet në moshën 18 vjeç, dhe në këtë rast procedura zhvillohet sipas Kodit të Procedurës Penale. Por veprat penale mund të kryhen edhe nga të miturit para fitimit të zotësisë së veprimit dhe në këtë rast procedura e shqyrtimit gjyqësor duhet të plotësoj disa kushte tjera në krahasim me procedurën për të rriturit.

Në rast se dyshohet për kryereje të këtyre veprave dhe në rast se konfirmohet kjo nga gjyata me vendim të formës së prerë, nuk mund të shqiptohen dënime të njejta për personat nën moshën 16 vjeç dhe për ata mbi 16 vjeç, por dënimet duhet shqiptuar gjithmonë duke u bazuar në peshën e veprës së kryer penale. Disa dënime janë më të buta e disa edhe më të rënda. Por duhet theksuar se dënimet e rënda nuk është e mundur t'iu shqiptohen personave nën moshën 16 vjeç edhe pse ata kanë kryer vepra më të rënda penale.

Dënimet të cilat ju shqiptohen të miturve të ri në Kosovë janë masat e diversitetit dhe masat edukative, qëshqiptohen për të evituar mundësinë e kryerjes së veprave të tjera penale. Dënimet sipas ligjit në Kosovë që mund të shqiptohen janë: dënimi me burgim, dënimi me gjobë dhe urdhëri për punë të detyrueshme në dobi të përgjithshme..

I gjithë punimi do të analizoj normat e vendeve të rajonit duke filluar nga Kosova, Serbia, Maqedonia, Kroacia si anëtare e BE-së si dhe Shqipëria si vend i cili tashmë ka Kodin e ri që sapo ka filluar të zbatohet nga fillimi i këtij viti. Gjatë analizës së normave do të bëhen dallimet dhe ngjashmëritë në mes të këtyre normave.

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Zotësia e veprimit fitohet në të gjitha vendet e rajonit në moshën 18 vjeç. Mirëpo ka raste kur duhet të zhvillohet procedurë edhe për personat nën moshën 18 vjeç. Të gjitha legjislacionet, të papërgjegjshëm e konsiderojnë personin deri në moshën 7 vjeç. Prej kësaj moshe e deri në moshën 14 respektivisht 16 vjeç i mituri, përgjigjet për veprime të veta. Madje personat mund të lidhin kontratë pune edhe para moshës 16 vjeç. Për qëllime të përgjegjshëm penale për krimet, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 14 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit. Për qëllime të përgjegjshëm për kundërvajtjet penale, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 16 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale.²⁰⁹

Personat që kryejnë vepra penale patjetër duhet të ndëshkohen dhe me këtë rast ndaj tyre zhvillohet procedurë e veçantë gjyqësore, ndryshe nga procedurat që zhvillohen për njerëzit madhor. Gjatë procedurës gjyqësore për të mitur mund të shqiptohen masat dhe dënimet.

Sipas Ligjit në Kosovë masat ndahen në masa të diversitetit dhe masat edukative. Këto masa u shqiptohen personave që kanë kryer vepër penale, për të eliminuar mundësinë e rikryerjes së veprës penale nga ana e tyre. Përveç masave ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe dënime. Dënimet ndahen në: dënimin me gjobë, urdhëri për punë të detyrueshme në dobi të përgjithshme dhe dënimi

209 Kodi penal i drejtësisë për të mitur, i Shqipërisë, neni 7, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2018.

me burgim si dënim më i rëndë për të miturit.

Sipas Kodit Penal për të mitur, në Shqipëri të miturit mund ti caktohen masat e sigurimit. Këto masa të sigurimit ndahen në: vendosjen e të miturit në mbikqyrje si dhe vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.

Vendosja e të miturit në mbikqyrje synohet sigurimi i të miturit sa herë i nevojitet prokurorit ose gjykatës, i mituri, gjatë procedurës. Vendosja e të miturit në një institucion të specializuar bëhet kur kujdestari ose prindi nuk mund të ofroj mbikqyrje të të miturit dhe në të njëjtën kohë i ofrohet ndihma dhe mbrojtja e të miturit sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Sipas po këtij kodi i mituri mund edhe të burgoset por vetëm në rastet e përcaktuara me këtë kod të cilat do të sqarohen më poshtë në punim.

Sipas Ligjit për të drejtën e të miturve në Maqedoni, ndaj të miturit mund të shqiptohen vetëm masa edukuese, dënime me burgim dhe masa alternative.²¹⁰

Në Shqipëri dënimet mund të ndaj të miturit ndahen në masa alternative përmes së cilave i mituri shmanget nga ndjekja penale dhe dënimet, masat e sigurimit dhe dënimi me burgim.

Sipas Ligjit në Serbi, ndaj të miturit mund të shqiptohet masë edukuese, dënimi me gjobë, ose dënimi me burg deri në pesë vjet.²¹¹

Sipas Ligjit në Kroaci të miturit mund ti shqiptohen masat edukative, dënimi me burgim dhe masat e sigurisë.²¹²

Nga e gjithë kjo vërehet se dënimi me burgim aplikohet dhe zbatohet në të gjitha vendet e rajonit dhe aplikohet për të gjithë personat që kanë kryer vepra penale mbi moshën 16 vjet. Poashtu të gjitha vendet e rajonit i kanë të numruara taksativisht masat edukative. Por në vendet e rajonit zbatohen edhe masat e sigurimit dhe masat alternative përveç Kosovës dhe Kroacisë që nuk i kanë këto masat e fundit.

210 Ligji për të drejtën e të miturve, i Maqedonisë, neni 28, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Shkup, 1 Shtator 2008.

211 Zakon o maloletnim uciniocima krivicnih dela i krivicnopravnoj zastiti maloletnih lica Srbije, neni 6, SI Glasnik, 2006

212 Zakon o sudovima za mladež, Hrvatske, neni 5, Zagreb, 30.05.2015.

MASAT E DIVERSITETIT

Pa marrë parasysh peshën e veprës penale të miturit të cilët ende nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç u shqiptohen masat e diversitetit. Masat e diversitetit sipas Kodit Penal për të mitur në Kosovë ndahen në lloje të veçanta të cilat numërohen në nenin 18 të këtij Kodi. Si masëeparë e diversiteti mund të shqiptohet pajtimi në mes të kryrësit të mitur dhe palës së dëmtuar duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar. Pas kësaj numërohen pajtimi ndërrmjet të miturit dhe familjes së tij, kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmejt të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit, vijimi i rregullt në shkollë, pranimi i punësimit apo aftësimin në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij, kryerja e punëve pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryrësit të mitur për kryerjen e punës së tillë, edukimi në rregullat e trafikut dhe këshillimi psikologjik.²¹³

Ligji i Maqedonisë në dispozitat e veta nuk përmbanë masa të diversitetit. Ligji i Serbisëi parasheh këto masa nënenin 14, ky nen masat e diversiteti i parasheh qartë duke i numëruar llojet e këtyre masave. Sipas këtij neni kërkohet nga gjykata që kryrësi i veprës penale të kërkoj falje nga i dëmtuari, të kompenzohet dëmi i shkaktuar, më pastaj në pikën c, vazhdon, me vazhdimin e rregullt të shkollës, dhe i mituri që e kryer veprën penale të mos mungoj në punë, në rast se punon kuptohet. Për dallim nga Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës nga gjykata mund të kërkohet që i mituri që ka shkaktuar vepër penale të angazhohet në çështje humanitare, në organizata për çështje humanitare dhe të angazhohet në çështje sociale lokale ose ekologjike. Gjykata nga i mituri kërkon të anghazhohet në aktivitete sportive, si dhe, të kryej kurse dhe trajnime shtesë duke u testuar për tu vlerësuar aftësia e tij në çështje të caktuara. Të gjitha masat e diversitetit në Serbi gjatë ekzekutimit monitorohet e edhe shqiptohen nga gjykata, dhe në të gjitha rastet kërkohet edhe mendim i Organit të Kujdestarisë. Poashtu gjykata mund ta paralajmëroj të miturin e dënuar se nëse nuk zbatohet masa, atij mund t'i shqiptohen edhe masa dhe dënime më të rënda.

Në Republikën e Kroacisë masat e diversitetit quhen detyrime të veçanta të cilat janë të njëjta me ato të Kodit të drejtësisë për të mitur, të Kosovës. Të miturit në

213 Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 18, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

Kroaci mund t'i shqiptohen nga Gjykata masat e veçanta siç janë: kërkim faljeje, kompensimi i dëmit, ndjekja e procesit mësimor, i mituri të mos mungoj në vendin e punës, të angazhohet nëçështje humanitare ose në punët komunale dhe ekologjike.²¹⁴

Sipas Kodit të drejtësisë për të mitur, në Kosovë masat e diversitetit mund të shqiptohen ndaj të miturit që ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo dënim me burgim deri në tre vjet ose për vepër penale të shkaktuar nga pakujdesia deri në 5 vjet burgim, me përjashtim të cilat sjellin si pasojë vdekjen.²¹⁵

MASAT EDUKATIVE

Masat edukative kanë të njëjtin qëllim sikurse masat e diversitetit. Qëllimi kryesor i tyre është pengimi i rikryrjes së veprës penale nga ana e të miturit. Qëllimi arrihet me rehabilitim dhe edukim adekuat të të miturit, duke i ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikqyrje, duke i siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësitë e tij personale dhe duke ndaluar sjelljen recediviste²¹⁶

Në Kosovë Gjykata mund të shqiptoj masa të lojit të caktuar e ato janë: masat disiplinore, masat e mbikqyrjes së shtuar dhe masat institucionale. Masat disiplinore janë qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Të gjitha këto shqiptohen nëse vepra penale është shkaktuar nga pamaturia ose pakujdesia në një afat të shkurtër. Masat e mbikqyrjes së shtuar janë mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, ngaprindi adoptues ose kujdestarit të të miturit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhembikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa shqiptohen ndaj të mituritinteresat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen memasë afatgjate që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit.Masat institucionale edukative janë dërgimi i të miturit në institucion edukues,dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe dërgimi i kryerësit të miturnë institucionin e kujdesit të posaçëm.²¹⁷

214 <https://www.zakon.hr/z/180/Zakon-o-sudovima-za-mlade%C5%BE>, neni 10.

215 Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 17, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

216 Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 19, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

217 Po aty, neni 20.

Ligji për gjykatat e të miturve, i Kroacisë sikurse dispozitat në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni qëllimin e masave edukuese e sqaron të njëjtë sikurse Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës dhe numëron në mënyrë taksative llojet e masave edukative.

Llojet e masave edukative janë: Qortimi gjyqësor, detyrime të veçanta, kontrolli dhe kujdesi i shtuar, kujdesi në institucione të posaçme, dërgimi në qendër disiplinore, si dhe dërgimi në institucione të veçanta disiplinore.²¹⁸ Llojet e masave edukative poashtu janë të parapara me Ligjin për të drejtën e të miturve, i Maqedonisë. Në nenin 31 të këtij ligji ato numërohen taksativisht dhe ndahen në: masa disiplinore (qortim ose udhëzim në qendrën disiplinuese për të mitur. Masat e mbikqyrjes së përforcuar: nga ana e prindërve ose kujdestarit, familjes që përkujdesjet ose nga ana e qendrës. Masat e entit: udhëzim në entinedukues ose në shtëpinë edukuese dhe korrektuese.²¹⁹ Poashtu si në Kosovë dhe Kroaci këto masa shqiptohen kur i mituri ka kryer vepër penale nga pakujdesia ose mendjehhtësia. Masat e mbikqyrjes së përforcuar dhe ato të entit shqiptohen për kryrësit e mitur kur ekziston nevoja për masat afatgjate të edukimit, riedukimit oseshërimit nën mbikqyrje reprovativisht ndarjes së plotë të tij nga ambienti i mëparshëm.

Ligji i Serbisë për të mitur masat edukative i ndanë poashtu në mënyrë taksative e ato ndahen në: masa paralajmëruese dhe udhëzuese ku përfshihen qortimi gjyqësor dhe detyrimet e veçanta. Masat e kontrollit të shtuar ku përfshihen kontrolli i shtuar nga prindërit, kujdesi i shtuar nga ana e familjes tjetër, organi i kujdesarisë si dhe qëndrimi ditor në insitucione përktëse për rritje dhe edukim të të miturve. Dhe si masë e tretë normohen masat institucionale.²²⁰

Në Shqipëri, Gjykata mund të urdhërojë që i mituri në konflikt me ligjin penal të përmbushë një ose më shumë detyrime të caktuara, të tilla si: a) të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program arsimimi; b) të ndjekë një program të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional; c) të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit; ç) të riparojë dëmin civil të shkaktuar; d) të ndjekë një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas

218 Zakon o sudovima za mladez, i Kroacisë neni 7. Zagreb, 30.05.2015.

219 Ligji për të drejtën e të miturve, i Maqedonisë, neni 31, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Shkup, 1 Shtator 2008.

220 Më gjërësisht, Zakon o maloletnim uciniocima krivicnih dela i krivicnopravnoj zastiti maloletnih lica Srbije. neni 11, SI Glasnik, 2006.

rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës; dh) të mos frekuentojë vende të caktuara; e) të mos shoqërohet me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij.²²¹

GJOBA DHE URDHËRI NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Sipas ligjit të punës në Kosovë një prej kushteve themelore për lidhjen e kontratës së punës nevojitet mosha madhore. Por ka raste kur puna mund të ushtrohet me orar jo të plotë edhe nga personat që ende nuk e kanë mbushur moshën madhore. (...) ²²²

Nga kjo mund të nisemi se të miturit nuk janë persona të punësuar dhe ata shumë rrallë mund të kanë të ardhura personale për të bërë kompensimin ose pagesën e gjobave të ndryshme të shqiptuara nga ana e gjykatës. Andaj dispozitat e kodit penal për të mitur në Shqipëri për gjobën theksojnë se: Masa e gjobës mund të zbatohet për një të mitur nëse ka të ardhura monetare nga një burim i ligjshëm. ²²³

Gjykata mund të shqiptoj dënime brenda kufinjëve të caktuar ligjor dhe në këtë rast gjykata mund të shqiptoj edhe dënime për të miturit. Për të miturit, denimi me gjobë, nuk mund të jetë me pak se 25 dhe as ose më shumë se 5.000 euro. ²²⁴ Lartësia e dënimit me gjobë për të miturit, varet nga gjendja e tyre financiare, nga lartësia e të ardhurave personale, të ardhurave të tjera, pasuria e tyre dhe obligimet që kanë. Të miturit nuk mund t'i shqiptohet denimi me gjobë më i lartë se mjetet që ai posedon. ²²⁵ Dënimi me gjobë mund të paguhet brenda disa afateve të ndryshme që përcaktohen me ligj. Dënimi me gjobë duhet të paguhet në afat jo më të shkurtër se 15 ditë dhe jo më të gjatë se tre muaj. Ka raste kur i mituri nuk e paguan gjobën por edhe e refuzon pagesën e saj as në afatet e përcaktuara, atëherë me pelqimin e tij dënimi me gjobë mund të zëvendësohet me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. ²²⁶ Kjo ndodhë pasi vendimi për dënimin me gjobë merr formën e prerë. Me pajtimin e të miturit, gjykata mund

221 Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 102. Paragrafi 1, nënparagrafët, a, b, c, ç d, dh, e

222

223 Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 99.

224 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i Kosovës, neni 30, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

225 Komentari fq.3.

226 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i Kosovës, neni 30, paragrafi 4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre (3) vjet, burgimin e të miturit deri në dy (2) vjet ose gjorbënme urdhër për punë në dobi të përgjithshme.²²⁷ kjo masë shqiptohet duke e urdhëruar të miturin e dënuar të punoj nga 30 deri në 120 orë pune në dobi të përgjithshme, poashtu caktohet institucioni se ku personi i dënuar duhet ta kryej dënimin. Caktohen edhe ditët e javës kur duhet të kryhet dënimi si dhe puna do nëçdo rast do të mbikqyret nga personat madje institucionet derisa ajo të kryhet.

Në Shqipëri sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, kryerja e një pune me interes publik për të miturit mund të jetë nga 40 deri në 300 orë. Kohëzgjatja ditore e punës me interes publik nuk mund të jetë më shumë se 4 orë në ditë.²²⁸ Madje këto orë edhe mund të shtohen në rast se burgimi kovertohet në punë për interes publik. Por edhe mund të zvogëlohen. Sipas kësaj del se Shqipëria ka më shumë orë të punës për të miturit, në raport me Kosovën dhe me vendet e tejsa të rajonit. Në dënimet plotësuese parashihet kryerja e një pune në inters publik dhe numërohet si ospion i dënimeve në nenin 62 të Kodit të drjetësisë penale për të mitur në Shqipëri.

Njësoj sikurse në të gjitha vendet e rajonit edhe në Shqipëri, puna me interes publik zbatohet në mënyrë të tillë që të mos pengojë procesin e edukimit dhe mund të shoqërohet me detyrimin për ndjekjen e një kursi profesional.²²⁹ I mituri mund të ndalohet të kryejë një veprimtari të caktuar për një periudhë kohore nga një deri në tre vjet, nëse kjo çmohet si e papërshtatshme nga gjykata për rehabilitimin e të miturit dhe parandalimin e kryerjes prej tij të veprave penale të tjera.²³⁰

Nëse pas kalimit të periudhës së caktuar i mituri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose punën e tillë në dobi të përgjithshme e kryen vetëm pjesërisht, gjykata urdhëron ekzekutimin e masës institucionale edukative ose burgimin për të mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer. Në rastin e gjorbës, gjykata urdhëron pagesën e gjorbësnë përpjesëtim me kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme e cila nuk është kryer.²³¹

227 Po aty, neni 31, paragrafi 1.

228 Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 101.

229 Po aty neni 101, paragrafi 4.

230 Po aty neni 100, paragrafi 1.

231 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i Kosovës, neni 31, paragrafi 5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

Ligji i Maqedonisë e përcakton dënimin me gjobë me nenin 60 dhe gjobën e konsideron si sanksion për kundërvajtje. Po ashtu edhe ligji i Serbisë nuk e përcakton një dënim të tillë. Ligji i Kroacisë nuk e parasheh gjobën si dënim që mund të paguhet nga ana e kryësve të mitur të veprave penale.

DËNIMI ME BURGIM

Gjykata mund të shqiptoj dënimin me burg vetëm për të miturit të cilët e kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe ai ka kryer vepër penale të dënueshme mbi 5 vjet burg. Qëllimi kryesor i dënimit me burgim për të miturit është kontribut për rehabilitimin dhe zhvillimin e kryesisht të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e spacializuar, aftësinë profesionale dhe në zhvillimin e duhur profesional. Përveç kësaj burgimi për të mitur duhet të ndikoj pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikqyrjes për ta parandaluar recidivizmin.²³² Madje sipas kësaj dënimet mund të ndikojnë edhe tek personat e tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla. Në shumicën e rasteve dënimet e arrijnë qëllimin për çka edhe janë shqiptuar.

Qëllimi i dënimit të të miturit është rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikqyrje.²³³ Në raste të tjera dënimi ndikon edhe tek të tjerët duke arritur satisfaksion për të dëmtuarin nga vepra e kryer penale.

Në Republikën e Kosovës, burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se 6 muaj as më shumë se 5 vjet, dhe dënimi shqiptohet me muaj dhe vite të plota. Maksimumi për burgim për të mitur në Kosovë, është 10 vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë (...) ²³⁴ që dallon nga Republika e Shqipërisë që kalon mbi 10 vjet.

Sipas Ligjit për të drejtën e të miturve, në Maqedoni, dënimi me burg mund t'i shqiptohet të miturit nga ana e gjykatës vetëm si dënim kryesor. Poashtu parashihet se dënimi me burgim mund t'i shqiptohet të miturit të madh për përgjegjësi penale qëka kryer veprën penale për të cilën është përcaktuar

232 Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 32, paragrafi 5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

233 Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 93.

234 Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 34, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010..

dënim me burg prej 5 vjetësh ose dënim më të rëndë nëse vepra është kryer në rrethana veçanërisht të rënda dhe gjatë shkallës së lartë të përgjegjësisë penale të kryrësit dhe me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohej masa edukative.²³⁵ Vuajtja me burg nuk mund të jetë më e shkurtër se një vjet e as më e gjatë se 10 vjet. Dallon nga Kosova ku pragu më i ultështë më pak se 6 muaj por nuk kalon më shumë se 5 vjet. Ndërsa në Shqipëri, për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.²³⁶

Masa e arrestit me burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston edhe ndonjë nga këto kritere: sanksioni i parashikuar për veprën penale për të cilën akuzohet është me burgim dhe ka dënimi e dënimit mbi 7 vjet. b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri: i) përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër; ii) përpriqet t'i shmanget drejtësisë.²³⁷

Të njëjtën çështje e ka të rregulluar edhe Ligji i Serbisë sikurse edhe i Kodi i drejtësisë për të mitur, i Republikës së Kosovës.²³⁸ Republika e Kroacisë në disozitat e ligjit për gjykimet e të miturve, e përcakton taksativisht se dënimi me burg mund t'i shqiptohet të miturit të vjetër i cili ka mbushur tashmë moshën 16 vjeç dhëmund të dënohet për vepra penale të cilat janë të dënueshme me mbi 3 vjet burgim ose dënim më të rëndë, duke parë parasysh peshën e veprës penale dhe në rastet kur nuk mund të shqiptohet masa edukative por është e nevojshme dënimi.²³⁹ Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 6 muaj dhe jo më i gjatë se 5 vjet. Në të gjitha vendet e rajonit dënimet shqiptohet me vjet dhe muaj të plotë. Nëse i mituri ka kryer veprë të rëndë penale dhe dënimi me burgim për këtë veprë sipas ligjit parashihet të jetë 10 vjet, atëherë edhe dënimi me burgim mund të jetë 10 vjet.

Afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit me burgim për të mitur, janë të veçanta dhe dallojnë nga afatet për parashkrimin e ekzekutimit të denimeve me burgim të shqiptuar madhorëve. Këto afate, janë shumë më të shkurtëra,

235 Ligji për të drejtën e të miturve, i Maqedonisë, neni 44, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Shkup, 1 Shtator 2008.

236 Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 97.

237 Kodi i Drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 86, paragrafi 1, pika a, dhe b, dhe nënparagrafet i, ii.

238 Zakon o maloletnim uciniocima krivicnih dela i krivicnopravnoj zastiti maloletnih lica Srbije, neni 29, Sl Glasnik, 2006.

239 Zakon-o-sudovima-za-mladez, i Kroacisë neni 25, Zagreb, 30.05.2015.

sepse denimi me burgim për të mitur, ka qëllime tjera nga denimi me burgim i madhorëve dhe ekzekutimi i tij pas kalimit të kohës së caktuar nuk ka më efekt. Për ekzekutimin e dënimit me burgim për të mitur, nuk ka parashkrim relativ.²⁴⁰Afatet për parashkrim i parashohin të gjitha legjislacionet si ai i Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe poashtu edhe i Serbisë dhe në mënyrë taksave janë të përcatuara afatet e parashkrimit. Për veprat penale në bashkim mund të shqiptohet vetëm masë edukative ose vetëm dënimi me burgim.

MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM DHE DËNIMET PLOTËSUESE

Edhe këto masa shqiptohen për të evituar recidivizmin dhe të kontribuojë në rehabilitimin e të miturit. Gjykata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj të miturit në pajtim me ligjin për kryrësit me çrregullime mendore.²⁴¹ Masa për trajtim të detyrueshëm shqiptohet vetëm pas konsultimit me shërbimin sprovues, organin e kujdestarisë dhe ekspertët përkatës.²⁴²Kur gjykata e konsideron të arsyeshme mund të shqiptojë dënimin plotësues në pajtim me nenet 54-62 të Kodit Penal të Kosovës.²⁴³

Masat e trajtimit të detyrueshmesipas Kodit të drejtësisëpër të mitur në Kosovë quhen masa të sigurisë ndaj të miturit të papërgjegjshëm. Nën kushte të përcaktuara me Kodin Penal mund të kumtohet masë e sigurisë a). mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe b). ruajtje në institucion shëndetësor dhe mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri.

Sipas ligji në Shqipëri bëhet vendosja e të miturit nën institucionet përkatëse dhe vendosja e të miturit nën mbikqyrje. Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar bëhet ndaj të miturit, interesat e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikëqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund tërealizohet nga ana e prindit ose personave të afërm.²⁴⁴

Masa mjekim i detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve mund të kumto-

240 Më gjërësisht, Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 36, paragrafi 5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010

241 Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, neni 38, paragrafi 5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.

242 Po aty, neni 38.

243 Po aty neni 39

244 Kodi i Drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë neni 84. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 1.01.2018.

het edhe pa kumtimin e masës edukuese ose dënimit.²⁴⁵

Poashtu edhe në Serbi ligji parasheh masat e sigurisë. Këto masa të sigurisë rregullohen me nenin 39 të këtij ligji. Masat e sigurisë mund t'i shqiptohen të miturit nëse të miturit i është shqiptuar masa e sigurisë ose dënimi me burgim për të miturin.²⁴⁶

Edhe ligji për gjykimet e të miturve, i Kroacisë parasheh masat e sigurisë të cilat ndahen në: masa për trajtim të detyrueshëm psikiatrik dhe ndalimi i afrimit. Këto masa mund të shqiptohen vetëm me këshillim të entit respektivisht Organit të Kujdestarisë dhe mund të shqiptohet personave nën moshën 16 vjeç, ndërkaq të miturit të vjetër mund t'i shqiptohen edhe masat e ndalimit të përdorimit të mjeteve motorike. Masat e sigurisë për trajtim të detyrueshëm psikiatrik dhe mjekimit të detyrueshëm sipas ligjit nuk mund të zgjasin më shumë se tre vjet.

Në Maqedoni zbatohen masa të trajtimit të detyrueshëm, por zbatohen dënime alternative të cilat rregullohen me ligjin penal për të mitur me nenin 53 dhe ndahen në këto lloje: gjykim ikushtëzuar me mbikëqyrje të mbrojtur, ndërprerje e kushtëzuar e mbajtjes së procedurës ndaj të miturit, dhe punë në dobi të përgjithshme.

Në bazë të të gjithë asaj që u theksua më lartë vlenë të theksohet se në të gjitha vendet e rajonit zbatohen masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet e shënuara më lartë. Mirëpo përveç dënit me burgim ndaj të miturit të vjetër zbatohen dënimet plotësuese si në Kosovë. Dënimet alternative zbatohen në Maqedoni dhe Shqipëri. Për të vazhduar me masa siguruese në Shqipëri, Serbi dhe Kroaci.

Kodi i drejtësisë penale për të mitur në Shqipëri, masat alternative i rregullon me nenin 62 dhe në këto masa mund të përfshihen a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi; b) këshillimin për të miturin dhe familjen; c) paralajmërimin me gojë; ç) paralajmërimin me shkrim; d) masat detyruese; dh) vendosjen nën kujdes.²⁴⁷

245 Ligji për të drejtën e të miturve, i Maqedonisë, neni 58, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Shkup, 1 Shtator 2008.

246 Zakon o maloletnim uciniocima krivicnih dela i krivicnopravnoj zastiti maloletnih lica Srbije, neni 39, SI Glasnik, 2006.

247 Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë, neni 62.

Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i Shqipërisë dënimet plotëse i numëron taksativisht e ato janë: a) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; b) kryerja e një pune me interes publik; c) përmbushja e detyrimeve të caktuara; ç) qëndrimi në shtëpi.²⁴⁸

PËRFUNDIME

Gjatë analizës të gjitha vendet e rajonit të cilat janë të përfshira në analizë me dispozita klasifikohen fëmijët dhe të miturit. Sipas kësaj në të gjitha dispozitat thuhet se fëmijë sipas ligjit konsiderohen të gjithë ata persona të cilët nuk e kanë mbushur moshën 18 vjet. Personi i cili ka mbushur moshën 14 vjet por ende nuk e ka mbushur moshën 18 vjet konsiderohet person i mitur. I mitur i ri konsiderohet personi i cili ka mbushur moshën 14 vjet dhe 16 vjet. I mituri i rritur konsiderohen të gjithë ata persona të cilët kanë mbushur moshën 16 vjet dhe deri në moshën 18.

Personat të cilët kryejnë vepra penale i nënshtrohen procedurave penale pa marrë parasysh moshën e tyre. Të papërgjegjshëm konsiderohen vetëm fëmijët të cilët ende nuk e kanë mbushur moshën 14 vjet. Pas kësaj moshe procedura zhvillohet sipas ligjeve të drejtësisë për të mitur. Pas një procedure duke zbatuar parimet dhe procedurat në përpikmëri të ligjeve penale për të mitur ndaj personave të mitur që kanë kryer vepra penale mund t'iu shpctohen masa dhe dënime.

Sipas analizës në punim masat i shqiptohen të gjithë të miturve të cilët ende nuk e kanë mbushur moshën 16 vjet. Varësisht prej vendit në vend por ato ndahen në masa të diversitetit dhe edukative. Masat e diversitetit janë të normuara në Kosovë ndërsa masat edukative janë të përfshira në ligje edhe në Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Kroaci si anëtare e BE-së.

Masat edukative mund ti shqiptohen edhe të miturve të rritur që kanë kaluar moshën 16 vjet, por për vepra penale më të lehta.

Masat edukative janë prezente në të gjitha vendet dhe zakonisht janë masa të qortimit dhe masa të mbikqyrjes qoftë nga prindërit, kujdestarët ose prindërit adoptues, si dhe masa edukative që zbatohet në institucionin edukativ, eduka-

248 Po aty neni 96.

tivo korrektues dhe dërgimi në ndonjë institucion tjetër ku ofrohet shërbim i posaçëm.

Dënimi me gjobë është prezent në disa vende dhe ai mund të shqiptohet ndaj të miturve vetëm nëse ata janë të punësuar. Madje nëse janë të punësuar në një inatitucon të ligjshëm siç e përcakton Kodi i drejtësisë penale për të mitur i Shqipërisë.

Urdhëri për punë në dobi të përgjithshme është dënim të cilin e posedojnë të gjitha ligjet për të mitur në rajon dhe aplikohet në rast se dënimi me gjobë ose edhe ai me burgim nuk paguhet, respektivisht nuk zbatohet. Ky dënim mund të shqiptohet vetëm më pelqimin e të miturit. Dënimi zabtohet kur të miturit i urdhërohet që të punoj disa orë në ditë, dhe kjo ndrron prej vendit në vend. Në Kosovë është prej 30 -120 ditë, ndërsa sipas Kodit në Shqipëri ky dënim fillon prej 40 deri në 300 ditë pune.

Me rëndësi është të ceket se dënimet me burgim nuk shqiptohen asnjëherë ndaj të miturve të ri të cilët ende nuk e kanë mbushur moshën 16 vjet. Dënimi me burgim është dënim i cili u shqiptohet personave që kanë kryer vepra të rënda penale, vepra penale të cilat do të kalonin dënimin me mbi 5 vjet dhe shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte në përputhje me peshën e veprës së kryer penale.

Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet më pak se gjashtë muaj por jo më gjatë se 5 vjet. Kur i mituri ka kryer shumë vepra, të rënda penale mund të shqiptohet dënim deri në dhjetë vjet. E njëjta gjë është edhe në Maqedoni, por dënimi, ose mëmire, pragu i dënimit me burg, nuk mund të shqiptohet më pak se një vjet për dallim nga Kosova që është 6 muaj dhe maksimumi i dënimit nuk mund zgjatë më shumë se 10 vjet. Ndërsa në Shqipëri pragu minimal për shqiptimin e dënimeve penale për të mitur është sa gjysma e dënimit për personat madhor që kryejnë po të njëjtën vepër, por asnjëherë nuk kalon mbi 12 vjet pa marrë parasysh peshën e veprës penale.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Kodi i drejtësisë për të mitur, i Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 8. Korrik 2010.
- 2) Kodi penal i drejtësisë për të mitur, i Shqipërisë, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2018.
- 3) Ligji për të drejtën e të miturve, i Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Shkup, 1 Shtator 2008.
- 4) Zakon o maloletnim uciniocima krivicnih dela i krivicnopravnoj zastiti maloletnih lica Srbije, Sl Glasnik, 2006
- 5) Zakon o sudovima za mladež, Hrvatske, Javni Glasnik Republike Hrvatske, Zagreb, 30.05.2015.



MASAT E SIGURIMIT PËR TË MITUR

Dr. Mirela Fana

mirela_fana@yahoo.com

ABSTRAKT

Caktimi i masave të sigurimit është një moment shumë i rëndësishëm për fatet e procesit penal, e veçanërisht për të miturit që kanë kryer vepra penale e ndaj të cilëve do të merren ato. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka sjellë përparësi në krahasim me Kodin e Procedurës Penale ekzistuese duke pasur në qendër të vëmëndjes interesin më të lartë të të miturit.

Gjykata si organi që garanton të drejtat themelore të të miturit në procesin penal, kujdeset veçanërisht që të garantojë pa hezitim të drejtat e të miturit, të kontrollojë përshtatshmërinë e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit dhe të caktojë vetë masat më të përshtatshme në favor të interesit më të lartë të të miturit.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka parashikuar dy masa që nuk kanë ekzistuar më parë në K.Pr.Penale, siç janë vendosja e të miturit në mbikqyrje dhe vendosja e të miturit në shërbim të specializuar.

Të dy këto masa janë risi dhe synojnë të garantohet paraqitja e të miturit para organave proceduese sa herë që kërkohet për nevojat e hetimit duke përcaktuar dhe personat dhe institucionet që marrin përsipër dhe garantojnë këtë veprimtari.

Ky ligj parashikon kushte dhe kritere të veçanta nga neni 228 i K.Pr.Penale që janë specifikisht për të miturit dhe që trajtohen me mjaft hollësi në këtë ligj.

Nga pikëpamja metodologjike, punimi shfrytëzon analizën e dispozitave ligjore në fuqi, interpretimin kritik si dhe literaturën bashkëkohore mbi këtë çështje.

Fjalët kyçe: *i mitur, masë sigurimi, mbikqyrje, shërbim i specializuar.*

Në zbatim të nenit 54 të Kushtetutës së Shqipërisë, sipas të cilës “Fëmijët kanë një mbrojtje të veçantë nga shteti”, të rekomandimeve të Komisionit Evropjan

për nevojën për të ngritur një sistem të veçantë të drejtësisë për të mitur në përputhje me standartet ndërkombëtare, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Legjislatori në hartimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, jo vetëm realizoi përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/93 të UE dhe përputhjes së tij me standartet e rregullat për Drejtësinë për të Mitur në nivel të OKB-së dhe KE-së, por përcaktoi një standart të lartë në fushën e legjislacionit shqiptar. KDPM është një ligj me përmbajtje njëkohësisht materjale dhe procedurale, por është edhe një ligj që përafron ligjet e tjera ekzistuese në fushën e së drejtës shqiptare me të.

Nëpërmjet këtij Kodi, ligjvënësi vendosi rregulla të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë apo dëshmitar të veprës penale.

Kodi Drejtësia Penale për të Mitur vuri theksin në detyrimin e organeve të procedimit penal dhe gjykatës, që në marrjen dhe caktimin e masave të sigurimit personal ndaj të miturit në konflikt me ligjin, të aplikojë standarte më të larta në favor të interesit më të lartë të fëmijës, duke siguruar që aplikimi i tyre të bëhet vetëm atëherë kur çdo masë tjetër më e favorshme për të miturin të jetë e papërshtatshme për të dhe për procesin.

Gjithashtu në këtë Kod janë vendosur edhe disa rregulla procedurale detyruese të zbatueshme në lidhje me masat e sigurimit që merren apo aplikohen për të miturit, duke kufizuar zbatimin e masës arrest në burg apo masave të tjera shtrënguese.

Ligjvënësi në këtë Kod është kujdesur që këto dispozita kufizuese të lirisë së të miturit në konflikt me ligjin, të jenë nëpërputhje të plotë me dispozitat kushtetuese, e konkretisht me nenet 17 e 27 të saj.

Ashtu si dhe për personat e rritur, masat e sigurimit personal për të miturit në konflikt me ligjin, nuk janë gjë tjetër veçse veprime dhe akte procedurale e ligjore, që kufizojnë ose heqin përkohësisht lirinë ose të drejta të tjera të të miturit, me qëllim parandalimin ose ndalimin e menjëhershëm ose të vazhdueshëm të të miturit nga aktiviteti kriminal, të ndalimit të tij nga veprimet që synojnë fshe-

hjen, vërtetësinë ose zhdukjen e provave që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen e veprës penale, vendosjen e të miturit para përgjegjësisë penale dhe ndërprejën e çdo veprimi të mundshëm të tij për t'ju fshehur hetimit dhe gjykimit, si dhe garantimin e shlyerjes së detyrimeve që burojnë nga ligji dhe vendimet gjyqësore.

Në kundërshtim me standartin ndërkombëtar se *“arrest në burg”* për të mitur duhet të përdoret vetëm si masa e fundit dhe për periudhën më të shkurtër kohore, në Shqipëri aplikimi i masave të sigurimit *“arrest në burg”* për të miturit ka qenë mjaft i lartë. Nga statistikat e 10 viteve të fundit rezultoi se Shqipëria zë vendin e parë në renditje në krahasim me të gjitha vendet e tjera të rajonit për sa i përket aplikimit dhe kohëzgjatjes së masës së sigurimit *“arrest në burg”* ndaj të miturve.

Në nenin 230 të K.Pr.Penale janë përcaktuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg për të rritur sipas të cilave *“Arrest në burg”* mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Për të miturit që kryejnë kundravajtje penale nuk lejohet arrestimi me burg.

Siç shihet, legjislacioni ynë kërkon që nga ana e prokurorit dhe gjykatës t'i kushtohet një rëndësi e veçantë dhe vëmendje e posaçme kërkesave dhe vendimeve të tilla, që lidhen drejtpërdrejtë jo vetëm me heqjen e lirisë së personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, por edhe me kufizimin e të drejtave të personave të tjerë të lidhur me fatet e tij, siç mund të jetë bashkëshortë dhe fëmijët, persona të moshuar apo të mitur në ngarkim të personit që kërkohet të arrestohet e të cilët kanë nevojë për praninë e kontributin e tij, punëmarrës apo bashkëpunëtorë në biznesin e tij, etj.

Ndryshimet e fundit në K.Pr.Penale, me qëllim rritjen e posaçme të përgjegjësisë së prokurorit dhe gjykatës në këto çështje, kërkojnë standarte shumë më të larta gjykimi, aq sa neni 245 K.Pr.Penale, ka parashikuar pavlefshmërinë e vendimit të arrestit në burg, në rast se gjykata nuk arsyeton në hollësi dhe nuk argumenton arsyet pro dhe kundër caktimit të masës së sigurimit arrest në burg.

Por në KDPM, standartet janë akoma më të larta, të cilat konsistojnë në faktin se përveç parashikimeve të mësipërme, për të miturit, masa e arrestit në burg mund të vendoset vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston

edhe ndonjë nga kriteret e mëposhtme:

- a. sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet;
- b. masa është e domosdoshme, sepse i mituri përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër si dhe kur ai përpiqet t'i shmanget drejtësisë.(neni 86 KDPM).

Kjo do të thotë se si prokurori që përgatit kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, ashtu edhe gjyqtari, në vendimin për caktimin e masës së sigurimit, duhet patjetër qëpërveç verifikimit të përcaktimit të saktë të veprës penale për të cilën dyshohet i mituri, me qëllim përputhjen ose jo të sanksionit minimal prej 7 vjetësh të dënimit të parashikuar në këtë dispozitë, të mund të verifikojnë edhe faktin nëse lënia e lirë e të miturit a përbën rrezik për atë vetë ose për persona të tjerë dhe nëse ky rrezik mund të mënjanohet në mënyra të tjera apo mënjanohet vetëm duke e arrestuar. Po kështu, duhet verifikuar nëse i mituri përpiqet realisht t'i shmanget drejtësisë.

Sa më sipër, vihet re qartësisht se ndodhemi në kushtet kur gjykata nuk zbaton parimin e vazhdimit dhe mos ndërprerjes së procesit edukativ dhe arsimor të të miturit në konflikt me ligjin. Në këtë rast, mendoj se gjykata çmon se interesi më i lartë i të miturit është që ai të kufizohet në lirinë e tij dhe në mundësinë që disa të drejta themelore t'i ushtrojë në liri. Për këtë arsye se gjykata çmon se ky kufizim e mbron jetën e tij apo të afërmit e tij apo të personave të tjerë nga faktorë të jashtëm kriminalë. Po kështu ky kufizim merret kur gjykata çmon se ky rrezik nuk mund të mënjanohet në një mënyrë tjetër të favorshme për të miturin. Prevalon gjithashtu interesi i drejtësisë dhe shoqërisë në rastet kur i mituri që dyshohet se ka kryer një vepër penale të rëndë, përpiqet t'i shmanget drejtësisë, pra, hetimit dhe gjykimit. Vendimi i gjykatës për arrestimin e të miturit në kushtet e nenit 86 të KDPM, është i justifikuar.

Kuptimin e masave shtrënguese të sigurimit e jep K.Pr. Penale, por KDPM, në nenin 82 të tij ka përcaktuar dy masa të reja të sigurimit, specifike për të miturit në konflikt me ligjin penal, si më poshtë:

1. vendosjen e të miturit në mbikqyrje;
2. vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar.

Me vendosjen e të miturit në mbikqyrje, sipas nenit 83 tëKDPM, synohet të garantohet paraqitja e të miturit, sa herë kërkohet, para oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit dhe gjykatës. Sipas kësaj dispozite, kjo masë realizohet përmes marrjes përsipër nga ana e prindit, të afërmit, institucionit ose personit të specializuar që të garantojë sjelljen e të miturit dhe të mbikqyrë nëse sjellja është e përshtatshme.

Nëpërmjet kësaj mase, oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori garantojnë paraqitjen e të miturit përpara tyre për të dhënë shpjegime në lidhje me ngjarjen apo akuzat në ngarkim të tij, paraqitjen e të miturit për të marrë pjesë në pyetjen e dëshmitarëve apo në ballafaqimet e mundëshme, në kryerjen e ekspertimeve apo eksperimentit hetimor,etj.Nëpërmjet kësaj mase gjykata siguron paraqitjen e të miturit në seancën e sigurimittë provës apo në çdo rast tjetër, prania e të cilit është e domozdoshme. Sigurisht, personi i parë që mund të sigurojë mbikqyrjen e të miturit dhe të garantojë paraqitjen e tij sa herë kërkohet, është prindi, i cili presupozohet që jeton me të miturin dhe kujdeset për të. Në rast se i mituri nuk ka prindër apo nëse i mituri nuk jep pëlqimin që mbikqyrësi i tij të jetë prindi, për shkak të mardhënieve jo të mira që ka me të, atëherë si mbikqyrës caktohet një person i afërm i tij, që nënkupton një person që ka lidhje të afërt familjare, gjinie ose krushqije me të miturin. Kur nuk ka të tillë, i mituri vendoset në mbikqyrjen e një institucioni ose personi të specializuar që të garantojë sjelljen e të miturit si dhe të mbikqyrë nëse sjellja e tij është e përshtatshme ose jo. Sigurisht, vendosja në mbikqyrje bëhet vetëm me pëlqimin e të miturit dhe të personit që do ta mbikqyrë atë.

Ligji parashikon edhe rastet kur pesoni i caktuar për të mbikqyrur të miturin mund të tërhiqet atëherë kur ai çmon se nuk mund të garantojë paraqitjen e të miturit sa herë që kërkohet nga organi kompetent, si dhe në rastet kur ai vlerëson se nuk është në gjëndje të garantojë një sjellje dinjitoze të të miturit. Në të tilla raste, mbikqyrësi njofton gjykatën lidhur me arsyet e tërheqjes me qëllim që gjykata të caktojë një mbikqyrës tjetër. Sigurisht që gjykata ka të drejtën që të verifikojë nëse dështimi i mbikqyrësit të tërhequr ka ardhur si rezultat i veprimeve e mosveprimeve të tij apo për arsye objektive. Gjykata ka të drejtë të dënojë me gjobë deri në 20.000 lekë mbikqyrësin e tërhequr kur vlerëson se dështimi ka ardhur për faj të tij. Me largimin e mbikqyrësit të tërhequr gjykata zëvendëson mbikqyrësin me një tjetër dhe në rast se vlerëson se kjo masë është

e papërshtatëshme ose personat e rinj kandidatë nuk marrin përsipër mbikqyrjen, gjykata mund të caktojë një masë tjetër sigurimi.

Siç shihet, kjo masë është e ngjashme me masën shtrënguese detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe dalton prej saj nga prania e mbikqyrësit, i cili është garantuesi i paraqitjes dhe i sjelljes së të miturit përpara organeve kompetente.

Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar, sipas nenit 84 të KDPM, bëhet ndaj të miturit, interesat e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohen nga ana e prindit ose personave të afërm.

Shërbimi i specializuar mundësohet nga institucionet ose persona juridikë të licensuar edhe për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kodi Drejtësia Penale për të Mitur, në nenin 81, me titull “Caktimi i Masave të Sigurimit”, ka përcaktuar disa kushte apo kritere specifike që duhen mbajtur parasysh nga prokurori e gjykata në rastet e caktimit të masave të sigurimit ndaj tyre, gjithnjë në interesin më të lartë të të miturit.

Vihet re që nga legjislatori, shumë nga dispozitat e KDPM, nuk janë në harmoni me dispozitat e K.Pr. Penale dhe sjellin konfuzion, e këtë konfuzion mund ta sjellin edhe në momentin e aplikimit në praktikë. Caktimi i masave të sigurimit sipas nenit 259 të K.Pr. Penale, realizohet atëherë kur prokurori dërgon në gjykatë kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë apo ndalimit dhe së bashku me të kërkon që ndaj të arrestuarit të caktohet një masë sigurimi. Në rastin e të arrestuarit të mitur sipas kësaj dispozite, realizohet edhe kërkesa e nenit 81/3 të KDPM, sipas së cilit, gjyqtari në caktimin e masës së sigurimit dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin menjëherë.

Ndryshe është situata kur prokurori kërkon caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” sipas nenit 244 të K.Pr. Penale, që zakonisht bëhet jo në kushte flagrante, por kur gjatë hetimit lind e nevojshme marrja e të tilla masave, pasi ka rezultuar gjatë hetimeve se i mituri dyshohet të ketë kryer një vepër penale të rëndë që dënohet në minimum më shumë se 7 vjet burgim dhe i është shmangur drejtësisë, pra hetimit dhe gjykimit.

Kjo do të thotë se këto masa si për të rriturit ashtu edhe për të miturit, merren në

mungesë të personit të dyshuar dhe në kushte sekreti të plotë deri në ekzekutimin e vendimit, pas të cilit personi i arrestuar del para gjykatës dhe mban qëndrimin e tij rreth vendimit dhe akuzave. Duke qenë kështu, në një rast eventual kur prokurori i kërkon gjykatës caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” për një të mitur, gjykata nuk është në gjëndje të realizojë detyrimin e saj që buron nga neni 81/3 i KDPM, që është detyrimi i gjyqtarit të dëgjojë personalisht të miturin para se të japë vendimin, si një nga risitë që ka sjellë ky Kod.

Ky veprim procedural, a është i diskutueshëm po të kemi parasysh edhe kërkesën e nenit 90/1 të KDPM, sipas së cilit gjykimi i të miturit nuk mund të zhvillohet në mungesë të tij?

Kam mendimin se në këtë rast kemi të bëjmë me dy faza të ndryshme gjykimi: njëra që zhvillohet gjatë hetimeve paraprake dhe tjetra gjatë gjykimit në themel. Por edhe në rastin e gjykimit në themel, pjesmarja e të miturit në gjykim parashikohet ndryshe nga dy dispozita të KDPM. Në nenin 16/3, parashikohet se i mituri nuk mund të detyrohet të marrë pjesë personalisht në proces dhe mospjesmarja e tij, nuk mund të rëndojë pozitën e tij, ose të përdoret në disfavorin e tij. Ndryshe parashikon neni 90/1, kur përcakton se gjykimi i të miturit nuk mund të zhvillohet në mungesë të tij.

Në rastin e gjykimit në themel të çështjes, gjykata është e detyruar që gjykimin ta zhvillojë në prani të të pandehurit të mitur, i cili nuk mundet të shfrytëzohet të drejtat që i njeh neni 351 i K.Pr.Penaletë pandehurit për praninë e tij ose jo në seancën gjyqësore. Sipas kësaj dispozite, kur i pandehuri i pranishëm në seancë heq dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, gjykimi vazhdon pa pjesmarjen e tij. I njëjti rregullim zbatohet edhe kur i pandehuri ikën në çdo moment të shqyrtimit gjyqësor ose gjatë intervaleve të tij. Në të tilla raste i pandehuri konsiderohet i pranishëm, me kusht që gjykimi të zhvillohet në prani të mbrojtësit të tij.

Kjo situatë nuk mund të zhvillohet kështu në rastin e gjykimit të të pandehurit të mitur, prania e të cilit është e detyrueshme. Ky kushtëzim i ligjvënësit është bërë me qëllim që të miturit t'i realizohet e drejta e tij për t'u dëgjuar në proces dhe për të shprehur pikpamjet e tij në lidhje me vepren penale që akuzohet, proces që zhvillohet gjithnjë në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij. Në çdo rast kur i mituri kërkon të dëgjohet, gjykata është e detyruar ta dëgjojë dhe kur ai nuk mundet ta ushtrojë vetë këtë të drejtë, e realizon nëpërmjet prindit,

si përfaqësues ligjor i tij. Po kështu i mituri në konflikt me ligjin, duhet të marrë pjesë në çdo proces vendimtarje lidhur me të. Prokurori dhe gjykata janë të detyruar që të krijojnë të gjitha kushtet dhe të marrin çdo masë që i mituri të marrë pjesë në proces, gjithnjë nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit. Kjo kontraditë që vihet re në dy dispozitat e mësipërme shpreh pasiguri juridike të legjislatorit në rregullimin e këtyre insituteve (e drejta e të miturit për të marrë pjesë në proces dhe detyrimi), por ne duhet ta zbatojmë në interesin më të lartë të të miturit të drejtën e tij për të marrë pjesë personalisht në proces dhe detyrimin e gjykatës për të mos zhvilluar gjykim në mungesë të të miturit.

Ky parim, pra detyrimi i gjykatës që gjykimin e të miturit nuk mund ta zhvilloi në mungesë të tij, nuk mund të aplikohet në seancën gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 244 të K.Pr. Penale. Në këtë rast, masa e sigurimit caktohet në mungesë të të miturit ndaj të cilit kërkohet të merret një masë sigurimi.

Detyra e gjykatës në këtë rast është që pas ekzekutimit të vendimit ta thërrasë të miturin sa më shpejt para saj dhe ta dëgjojë personalisht duke i shpjeguar me hollësi, gjithnjë në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij, arsyet e caktimit të masës së sigurimit, provat mbi të cilat është marrë, nevojat e sigurimit dhe njëkohësisht të kërkojë të dëgjojë prej të miturit konsiderat e tij në lidhje me këtë vendim. Në rastet e arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të të miturit sipas nenit 251 të K.Pr. Penale, pjesëmarrja e të miturit në proces dhe dëgjimi i tij drejtëpërdrejtë nga gjyqtari, është e garantuar.

BIBLIOGRAFI

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Drejtësia Penale për të Mitur i vitit 2017.
- Kodi Procedurës Penale, Republika e Shqipërisë.
- Direktiva 2011/ 93 European Union.

RISITË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË KUADËR TË HARMONIZIMIT ME STANDARDET E KONVENTËS SË OKB-SË MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

PhD. Oljana Hoxhaj

Pedagoge e Departamentit të Drejtësisë, Universiteti “Ismail Qemali Vlora”

oljana.hoxhaj@gmail.com

ABSTRAKTI

Kuadri ligjor shqiptar, tashmë prej një viti është plotësuar me një akt të ri ligjor në fushën e të drejtave të fëmijëve. Miratimi më 23.02.2017 i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ishte i domosdoshëm, sepse ligji i mëparshëm reflektonte një karakter kryesisht deklarativ. Disa prej përparësive të aktit të ri konsistojnë në përcaktimin në mënyrë të qartë të institucioneve, strukturave dhe detyrave respektive të tyre. Ligji i ri është më i plotë në përmbajtje dhe më konkret në ndarjen e përgjegjësive. Në këtë këndvështrim, vlen të përmendim detyrimin për të raportuar rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Ligji ngarkon një rreth të gjerë subjektsh me përgjegjësinë për të raportuar në organet kompetente situatat abuzive ndaj fëmijëve. Çështja e të drejtave të fëmijëve ka qenë një prej prioriteteve të legjislatorit shqiptar vitin e fundit, pasi për herë të parë u miratua dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, duke krijuar premisat për një drejtësi penale miqësore dhe humane me subjektet e mitur. Punimi ynë do të përqëndrohet në analizën e risive të ligjit të ri të fëmijëve, duke evidencuar përfaqshen me standardet e mishëruara në Konventën e OKB-së Mbi të Drejtat e Fëmijëve. Përmes analizës së legjislacionit synojmë të përshkruajmë progresin që ka bërë shteti shqiptar në funksion të kompletimit të legjislacionit për fëmijët.

Fjalë kyçe: *fëmijë, përgjegjësi, risi, niveli i përfaqshes*

1. Një Vështrim Kritik mbi Ligjin nr.10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” – Evidentimi i Mangësive

Të drejtat e fëmijëve janë shtylla themelore që paraprijnë ndërtimin e një sistemi efektiv të të drejtave të njeriut në përgjithësi. Një indikator që përcakton nivelin e konsolidimit të demokracisë së një shoqërie, konsiston në aftësinë e saj për të prodhuar hapësirën e duhur legislative përmes së cilës aktorët social-politikë mund të ofrojnë garancitë e nevojshme për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Përgjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje konkrete për të kompletuar legjislacionin në këtë fushë. Në vitin 2010 u hodh hapi i parë, në sajë të miratimit të ligjit “Për të drejtat e fëmijës”²⁴⁹. Kryesisht, rëndësia e këtij ligji u shpërfaq më tepër në planin teorik, pasi në përmbajtjen e tij, reflektohej një nivel i lartë harmonizimi me dispozitat kushtetuese dhe nenet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Në këtë kontekst, jo rrallë herë ligji ka qenë objekt i kritikave, duke u cilësuar i paplotë dhe joefektiv. Në shumicën dërrmuese, nenet e tij paraqesnin një përsëritje të parashikimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, ose të Kushtetutës Shqiptare, por pa sjellë ndonjë risi në kuadrin ligjor. Një situatë e tillë e ka vështirësuar procesin e zbatimit konkret dhe përparimit të shumë të drejtave të fëmijëve, duke mos krijuar premisat për të realizuar mbrojtjen e veçantë që duhet të kenë fëmijët në përputhje me frymën kushtetuese²⁵⁰.

Analiza e ligjit të vitit 2010 pasqyron disa problematika në praktikë. Së pari, ligji reflekton një qasje më tepër deklarative sesa mbrojtëse. Parashikimi i të drejtave nuk vijohet nga parashikimi i mekanizmave dhe institucioneve përkatëse. Kështu, një e drejtë e fëmijës thjesht garantohet në aspektin formal, por kjo nuk shoqërohet me detyrimin ligjor të një organi konkret për të kontrolluar zbatimin dhe respektimin e të drejtës së mbrojtur. Së dyti, ndërveprimi institucional ka qenë i pjesshëm, pasi në terren janë evidentuar një tërësi mangësish ligjore, të cilat do të mundësonin një koordinim mes institucioneve si në nivelin vendor edhe në atë qendror. Së treti, fushatat informuese dhe ndërgjegjësuese për njohjen dhe respektimin e dispozitave të ligjit nuk kanë patur vëmendjen e duhur. Në këtë aspekt, ka munguar ndjeshmëria e aktorëve për të nxitur bashkërendimin mes tyre në funksion të respektimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Nga tërësia e faktorëve që parashtruan gjatë trajtimit të më-

249 Ligji Nr.10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” është miratuar në datë 04.11.2010
250 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 54/1

sipërm, u vlerësua e arsyeshme që ligji të ndryshonte thelbësisht në aspektin përmbajtësor të tij.

Përballë nevojës për të hartuar një ligj të ri, sfida për legjislatorin shqiptar konsistonte në përfshirjen e sa më shumë grupeve të interesit, në mënyrë që çdo problematikë e identifikuar në praktikë të gjente mbrojtje nga ligji i ri. Ky i fundit, si objektiv themelor ka patur koherencën dhe efektivitetin në funksion të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Përafrimi me standardet e KDF-së është pasqyruar dhe në dispozitat e ligjit të ri, por dispozitat e Konventës shkrihen në përmbajtje, me qëllim përshtatjen e tyre me zhvillimet më të fundit të legjislacionit shqiptar. Të drejtat e fëmijëve në sajë të parashikimeve të ligjit të ri specifikojnë qatësisht mekanizmat efikasë dhe organet përgjegjëse e kompetente për çdo rast kur shtrohet nevoja për ndërhyrje me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijës²⁵¹. Interesi më i lartë i fëmijës duhet çmuar si konsiderata parësore e shtetit në tërësi dhe e çdo organi në veçanti, ndaj shteti ynë nuk duhet të reshtë së përmirësuar në vazhdimësi legjislacionin e të drejtave të fëmijëve. Pavarësisht vullnetit të mirë dhe ambicies së legjislatorit për të parashikuar juridikisht çdo situatë që mund të përbëjë në të ardhmen rrezik për cënimin e të drejtave të fëmijës, vlen të nënvizohet fakti se fëmijët në vazhdimësi janë të ekspozuar ndaj zhvillimeve të gjithanëshme, kësajsoj edhe legjislacioni duhet të hartohet dhe orientohet në sinkron me ndryshimet themelore që influencojnë në realizimin e të drejtave të tyre.

2. Ligji i ri “Për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve” - Shprehje e Nevojës së Fëmijëve për Mbrojtje Efektive

Të drejtat e fëmijëve, për vetë rëndësinë që mbartin, janë gjithmonë në vëmendjen e ligjvënësit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, me qëllim hartimin e një kuadri ligjor sa më të kompletuar dhe efikas. Në këtë drejtim, viti 2010 solli një risi në sferën e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve. Kështu, për herë të parë dolën në plan të parë të drejtat e fëmijëve, në sajë të miratimit të një ligji që mbronte specifikisht vetëm këtë kategori subjektsh. Është e qartë se, thjesht parashikimi i dispozitave ligjore që garantojnë të drejtat e fëmijëve në planin teorik, do të rezultonte i pamjaftueshëm dhe joefektiv, si rezultat i mosparashikimit paralelisht me to, përgjegjësia dhe detyrimet që do

251 Relacion Për Projektligjin “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, faqe 7-8 <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2016/09/RELACION-TE-DREJTAT-E-FEMIJE.S.pdf>

të ushtronin organet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet të cilëve fëmijët mund të referojnë shkeljen e të drejtave të tyre. Ndaj, vlen të nënvizojmë impaktin që do të prodhojë ligji i ri, risitë e së cilit lidhen drejtpërdrejtë me vendosjen e themeleve për ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm institucionalë, që do të garantojnë dhe do të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve. Ligji siguron të gjitha masat e nevojshme për garantimin e jetës, mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijës nëpërmjet një qasje të koordinuar mes aktorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës²⁵².

Ligji “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, është produkt i konsultimeve me bazë të gjerë, duke përfshirë këtu jo vetëm aktorët institucionalë, por dhe aktorët e tjerë socialë. Domosdoshmëria e miratimit të një ligji të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, u projektua si ide e profesionistëve të fushës, pas konstatimit të një sërë boshllëqeve ligjore dhe mosfunksionimit të ligjit të mëparshëm në përputhje me qëllimet e tij. Ligji i vitit 2010 nuk solli përmirësime të ndjeshme dhe as nuk ndryshoi thelbësisht situatën e fëmijëve shqiptarë, kryesisht të fëmijëve të cilët ishin më vulnerabël dhe të ekspozuar ndaj formave të dhunës në familje ose në institucione arsimore, diskriminimit, abuzimit seksual dhe psikologjik. Shpesh herë institucionet në nivelin vendor dhe qendror kanë qenë të paqarta në lidhje me kompetencat e tyre konkrete dhe për rrjedhojë nuk e kanë ofruar ndihmën e duhur ndaj problematikave specifike të adresuara nga fëmijët ose punonjësit të cilët punojnë me ta. Në këto kushte, pas propozimeve dhe presionit të vazhdueshëm të shoqatave joqeveritare, shoqërisë civile dhe medias, u hartua një projektligj, i konsultuar gjerësisht në komisionin parlamentar nga grupet e interesit, duke u shndërruar më tej në ligj, pas miratimit në parlament. Kështu, kuadri legjislativ i fëmijëve, u pasurua me një akt të ri ligjor, ligjin e vitit 2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”²⁵³.

3. Të Drejtat e Fëmijëve sipas Qasjes së Ligjit të ri – Përafrimi me Standardet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës

Ligji i ri, përveç strukturës, rezulton më i plotë në përmbajtje dhe njëherazi reflekton një qasje të lartë përafruese me Konventën e të Drejtave të Fëmijës. Në

252 Hoxhaj O, Punim Doktorature “Vështrim Krahasues i Legjislativitetit Shqiptar dhe Ndërkombëtar mbi të Drejtat e Fëmijëve”, Tiranë 2017, fq. 242-244

253 Ligj nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në datën 23.2.2017, botuar në Fletoren Zyrtare të RSH-së, viti 2017, numri 43

këtë kontekst, vlen të theksojmë faktin se ligji nuk ka si qëllim të drejtpërdrejtë të pasqyrohet në trajtën e një materiali të derivuar, ose të huazuar nga një shtet i caktuar . Ai vjen si një produkt i debateve të gjata në qendër të të cilave ka qenë shkelja e të drejtave të fëmijëve. Analizuar në këtë dimension, synimi i të gjithëaktorëve të këtij procesi, ka qenë hartimi i një akti që do t'i përgjigjet problematikave të fëmijëve në terrenin shqiptar. Gjithsesi, kjo nuk zbeh rolin dhe rëndësinë që legjislatori shqiptar i ka dedikuar përqasjes së legjislacionit në fushën e të drejtave të fëmijës me standardet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës. Në harmoni me frymën e Konventës²⁵⁴, ligji parashikon zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës, i cili nuk duhet përmendur thjesht si një parim teorik, por duhet të jetë në konsideratën e të gjitha organeve ligjzbatuese me qëllim që çdo veprim dhe vendim që ndërmerret në lidhje me fëmijën t'i garantojë këtij të fundit një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe t'i mundësojë të drejtën për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për të²⁵⁵.

Interesi më i lartë i fëmijës, përveç sanksionimit në ligjin e analizuar më sipër, pasqyrohet si një parim kyç edhe në dispozitatat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit²⁵⁶, ku legjislatori reflekton një qëndrim të unifikuar mbi rëndësinë dhe vlerën e garantimit të këtij parimi për të gjithë subjektet e mitur në konflikt me ligjin. Në sinkron me parimin e mësipërm, ligji parashikon edhe shumë parime të tjera, të frymëzuara nga nenet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës. Të tilla konsiderohen e drejta e fëmijëve për të gëzuar mundësi dhe akses të barabartë, duke u mbrojtur nga çdo kriter diskriminues. Krijimi i kushteve të jetesës që garantojnë mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijës, janë përgjegjësi parësore e prindit ose kujdestarit. Ligji parashikon një grup subjektësh me detyrimin për të mbrojtur të drejtat e fëmijës, duke nisur me prindërit ose kujdestarin, autoritetet shtetërore dhe duke përfunduar me shoqërinë. Rëndësia e mjedisit familjar është thelbësor, ndaj në këtë kuptim çdo vendim me objekt ndarjen e fëmijës nga familja, duhet argumentuar dhe duhet parë si zgjidhja e fundit. Në të gjitha rrethanat fëmijës duhet t'i respektohet i dinjiteti, nderi dhe personaliteti. Ai duhet të dëgjohet dhe t'i respektohet men-

254 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 , neni 3

255 Ligj nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në datën 23.2.2017, neni 6

256 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datë 30.3.2017, neni 3/9

dimi, në varësi të moshës, aftësisë për të kuptuar dhe interesit më të lartë²⁵⁷.

Një tjetër risi e ligjit konsiderohet dispozita që garanton të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar. Në dallim nga ligji i mëparshëm, ligji i ri parashikon krahas të drejtës edhe mekanizmat që do t'a jetësojnë ushtrimin e kësaj të drejte në praktikë. Në këtë kuadër, ligji lehtëson procedurat e regjistrimit të fëmijës në institucionet arsimore, pavarësisht se ai mund të rezultojë i pargjistruar në zyrat e gjendjes civile. Ndër të tjera, ligji ngarkon prindërit me detyrimin për të garantuar frekuentimin e rregullt të shkollës nga fëmijët e tyre, ndërsa mbi ministrinë përgjegjëse për arsimin parauniversitar vendos një sërë detyrimesh për t'u përmbushur në funksion të arsimit cilësor dhe gjithpërfshirës²⁵⁸. Një zhvillim i rëndësishëm në optikën e ligjit të ri ka të bëjë me rikonceptimin e sistemit të përkujdesjes alternative, duke ofruar akses të gjerë për fëmijët e dhunuar, të shfrytëzuar dhe pa kujdes prindëror. Ligji i jep përparësi këtij target grupi, duke konsideruar në plan të dytë akomodimin e fëmijëve, prindërit e të cilëve nuk kanë mundësi ekonomike të garantojnë mirërritjen e tyre. Qasja e ligjit të ri në raport me ligjin e mëparshëm për garantimin e të drejtës së fëmijës për të kontaktuar me prindin që nuk bashkëjeton, ose me të afërm të tjerë, ka disa dallime esenciale. Si më të rëndësishëm përmendim faktin se dispozita aktuale nuk ka më një karakter deklarativ, pasi në përmbajtjen e saj detajohen kriteret specifike dhe masat konkrete që ndërmer gjykata në funksion të sigurimit të mbarëvajtjes së marrëdhënieve personale të fëmijës me prindërit ose me persona të tjerë, me të cilët ai gëzon një jetë familjare²⁵⁹.

Në kuadrin e plotësimit të legjislacionit për të drejtat e fëmijëve, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Rezolutën "Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri". Kjo rezolutë shënon një hap përpara në aspektin e inkurajimit të politikave qeveritare, për sa i përket akordimit të zërit të posaçëm në buxhet në funksion të ofrimit të shërbimeve që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në përmbajtjen e saj, Rezoluta parashikon krijimin e një fondi të veçantë për fëmijët, nga i cili do të financohen të gjitha institucionet, shërbimet dhe programet për fëmijët në Shqipëri²⁶⁰. Në komplementaritet me në këtë qasje, dëshmohet dhe qëndrimi i legjislatorit shqiptar në sferën e shër-

257 Ligj nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në datën 23.2.2017, neni 5
258 Ligj nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në datën 23.2.2017, neni 18
259 Ligj nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në datën 23.2. 2017, neni 9
260 Rezolutë, Nr.1, datë 26.11.2013, data e miratimit, 26.11.2013, Fletore Zyrtare nr.188, fq. 7864

bimeve sociale, duke parashikuar ofrimin e shërbimeve sa më efektive për kategoritë e fëmijëve vulnerabël, për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore përkatëse ose moskuptimit si duhet të detyrimeve ligjore. Si një risi, e cila do të jetë gjerësisht e prekshme, është parashikuar sistemi gjithpërfshirës i mbrojtjes së fëmijëve. Domosdoshmëria për të bërë ndryshime rrënjësore në këtë sektor ka ardhur edhe si një produkt i ndikimit të ekspertizës ndërkombëtare, në sajë të së cilës janë evidentuar mangësitë dhe nevojat për përmirësime të mëtejshme²⁶¹. Ligji i ri synon të projektojë një sistem të efektshëm, duke ripërcaktuar përgjegjësitë e mekanizmave institucionalë dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në të gjitha nivelet. Ky objektivi është koordinuar edhe me akte të tjera ligjore në aspektin përfitimt të fëmijëve nga skema e shërbimeve sociale²⁶² ose në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të tyre pas formatimit të ndarjes administrative territoriale të vendit²⁶³.

4. Konkluzione

Përmes miratimit të ligjit të ri që mbron të drejtat e fëmijëve, vendi ynë ka vijuar rrugëtimin e nisur shtatë vjet më parë, në funksion të plotësimit të kornizës ligjore si dhe nëpërmbyshjen e një sërë standardeve me karakter demokratik, të frymëzuara nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve. Duke konsideruar kohën e shkurtër të hyrjes së ligjit në fuqi, shoqëria shqiptare dhe veçanërisht fëmijët ende nuk i kanë prekur ndryshimet e parashikuara në përmbajtjen e ligjit, pavarësisht faktit se tashmë kuadri ligjor është përmirësuar ndjeshëm, duke reflektuar jo më një qasje deklarative, por një dimension urdhërues dhe konkret në evidentimin e problematikave dhe rivendosjen e të drejtave të shkeluara. Fill pas miratimit të këtij ligji, një tjetër akt po kaq i rëndësishëm, iu shtua korpusit të ligjeve të fëmijëve. Disa muaj më vonë u miratua dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, i cili harmonizohej më së miri me standardet e Konventës. Elementët e përbashkët mes dy akteve ndërliidhen me sanksionimin e detyrimit të një kategorie të gjerë subjektsh për të raportuar jo vetëm në rastet kur konstatohet dhunë ndaj fëmijës e vërtetuar si e tillë, por edhe në raste të dyshuara të ushtrimit të dhunës ose abuzimit apo neglizhimit të fëmijës. Ligji i vitit 2017

261 Anniki Lai, E Ardhmja e Sistemit të Integruar për Mbrojtjen e Fëmijës në Shqipëri - Vizioni për përmirësimin e rezultateve të fëmijëve në Shqipëri përmes një sistemi të efektshëm të integruar për mbrojtjen e fëmijës, Këshilli i Europës, qershor 2016, fq. 8-9

262 Ligj nr. 121/2016 Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë, neni 6

263 Shih: Ligji nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore

synon të ridimensionojë raportin mes fëmijëve dhe organeve të administratës në të gjitha nivelet. Përmes tij marrin zgjidhje ligjore një numër i lartë rastesh të paqarta të evidentuara gjatë kohës së veprimit të ligjit të mëparshëm. Një garanci mbi suksesin e ligjit të ri është padiskutim hartimi i tij në përputhje të plotë me dispozitat e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989
- Ligji nr.10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” është miratuar në datë 04.11.2010
- Ligj nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në datën 23.2.2017, botuar në Fletoren Zyrtare të RSH-së, viti 2017, numri 43
- Ligj nr. 121/2016 Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë
- Ligji nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datë 30.3.2017
- Rezolutë, Nr.1, datë 26.11.2013, data e miratimit, 26.11.2013, Fletore Zyrtare nr.188
- Relacion për Projektligjin “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/09/RELACION-TE-DREJTAT-E-FEMIJES.pdf>
- Anniki Lai, E Ardhmja e Sistemit të Integruar për Mbrojtjen e Fëmijës në Shqipëri - Vizioni për përmirësimin e rezultateve të fëmijëve në Shqipëri përmes një sistemi të efektshëm të integruar për mbrojtjen e fëmijës, Këshilli i Europës, qershor 2016
- Hoxhaj O, Punim Doktorature “Vështrim Krahasues i Legjislacionit Shqiptar dhe Ndërkombëtar mbi të Drejtat e Fëmijëve”, Tiranë 2017

GARANCITË EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE TË MBROJTJES TË TË DREJTAVE TË TË MITURIT SI AUTOR DHE VIKTIMA TE VEPRAVE PENALE!

MSc. INGRIDA MUSTAFA

Avokate, Lektore UAMD

ingridamustafa92@gmail.com

ABSTRAKT

Është shumë e rëndësishme që të miturit të takohen me një sistem që kupton dhe respekton të drejtat e tyre dhe cënueshmërinë e tyre unike. Kujdesi i veçantë me fëmijët - është shtylla kurrizore e drejtësisë penale ndaj të miturve. Sistemi European por dhe ai i OKB kanë krijuar kuadrin ligjor dhe institucional të cilët formësojnë garancitë europiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të miturve si viktima dhe si shkelës. Ky është dhe objekti i kësaj teme. Në këtë temë përmes shqyrtimit të burimeve shkencore ndërkombëtare dhe analizës krahasuese dhe shtjelluese synoj të paraqes këto garanci që ofrojnë disa ndër instrumentet kryesore europiane dhe ndërkombëtare. Këto instrumentete janë si vijon: Protokollin Fakultativ për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve, Komitetin për të Drejtat e Fëmijëve i Komitetit të Përgjithshëm Nr. 10 mbi të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për të Mitur, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës), Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë fëmijët si viktima dhe Dëshmitarët e Krimin, etj. Ndër garancitë kryesore për të miturit në procesin penal janë: prania e psikologut, e drejta e dëgjimit të fëmijëve, e drejta e mbrojtjes nga një avokat pa pagesë, kontaktin më prindin, informimi për akuzën, sigurimi i shërbimeve të përshtatshme mbështetëse për fëmijët viktimë, mbrojtja e privatësisë dhe identitetit të fëmijëve viktimë dhe marrja e masave, sigurimi i sigurisë fëmijëve viktimë, etj.

Përmes garancive të sigurura mund t'u ofrohet drejtësia e drejtë dhe e përshtatshme të miturve!

Fjalë kyçe: *i mitur, instrumente, penale, garanci, sigurim, shkelës, viktimë.*

HYRJE

“Njerëzimi ka yjet në të ardhmen e tij dhe e ardhmja është shumë e rëndësishme për t’u humbur nën barrën e marrëzisë së të miturve dhe supersticionit injorant”! (Isaac Asimov, Writer and Biochemist. 1920-1992)

Ndaj shoqëritë moderne dhe shtetet që funksionojnë nën normat e shtetit të së drejtës kanë elaboruar rregulla të cilat normojnë sjelljen dhe pozitën e të miturve në shoqëri. Shoqëria do të ishte në kaos nëse të miturit do të kryenin vepra penale dhe s’do të penalizoheshin për to sikundër shoqëria do të vuante thellësisht nëse të miturit do të dhunoheshin, vriteshin, do të ishin objekt krimesh seksuale dhe s’do të merrej asnjë masë për autorët e tyre dhe për rehabilitimin e të miturve.

Për sa më sipër shtetet në saj të bashkëpunimit mes tyre dhe organizmave ndërkombëtare kanë krijuar sisteme me akte të mirfillta juridike që mbrojnë, promovojnë dhe garantojnë të drejtat e të miturve qoftë si autor e qoftë si viktima të veprave penale, si dhe kanë ngritur institucione të përshtatshme për ekzekutimin dhe rehabilitimin e masave përkatëse që sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave.

Në këtë kontekst Sistemi Evropian dhe i Kombeve të Bashkuara kanë punuar së tepërmi për garancitë në mbrojtje të të drejtave të të miturve si autor dhe viktima të veprave penale.

Konventa e Kombeve të Bashkuara (në vijim KDF) përbën një ndër aktet themelore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të miturve. Fakti që të gjitha vendet anëtare të BE dhe KE janë palë në KDF, i jep KDF një rol të rëndësishme në nivel evropian. Ajo në mënyrë efektive imponon ligjin e përbashkët në shtetet evropiane me një ndikim në mënyrën se si institucionet evropiane zhvillojnë dhe zbatojnë të drejtat e të miturve. Në këtë mënyrë KDF-ja është shndërruar në gurthemelin për zhvillimin e ligjit evropian për të drejtat e të miturve. Në veçanti, integrimi i parimeve dhe dispozitave të KDF-së në instrumente detyruese dhe jurisprudencën në nivel evropian i jep KDF-së më shumë forcë dhe hap kanale më efektive të zbatimit për ata që kërkojnë të tërheqin të drejtat e të miturve në Evropë.²⁶⁴

264 Handbook on European law relating to the rights of the child, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015, fq 127.

1.1. GARANCITË NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË TË MITURVE SI AUTORË TË VEPRAVE PENALE

Të drejtat e të miturve në kontekstin e procedurës së drejtësisë për të mitur kanë të bëjnë me fëmijët e akuzuar, të ndjekur penalisht ose të dënuar për kryerjen e veprave penale, si dhe fëmijët që marrin pjesë në drejtësi ose në procedurat e ndërlidhura si viktima dhe / ose dëshmitarë. Pozita e fëmijëve në kontekstin e drejtësisë për të mitur rregullohet nga dispozita të përgjithshme të të drejtave të njeriut që lidhen me të rriturit dhe fëmijët. Ndër garancitë themelore për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në drejtësinë penale në sistemin evropian janë rrjedhim i dispozitave të Kartës Themelore të Drejtave të Njeriut. Në vijim po parashtroj disa nga garancitë kryesore:

Garanci Për Gjykim Të Drejtë

Garancitë e gjykimit të drejtë duhet të aplikohen që nga nisja e procedimit ndaj të miturit dhe duhet të mbijetojnë gjatë gjithë gjykimit. Por ndryshe nga procedimet në tërësi, të miturit janë veçanërisht të prekshëm dhe për këtë arsye kanë nevojë për një mbrojtje më të veçantë. Organet evropiane kanë zhvilluar kërkesa specifike për të siguruar që nevojat e këtyre fëmijëve të përmbushen në mënyrë efektive. Neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-s trajton në mënyrë specifike të drejtën për një zgjidhje efektive dhe për gjykim të drejtë, duke përcaktuar kërkesat e një rëndësie të veçantë për të miturit, të tilla si arsyeshmëria e kohës në dëgjimin e drejtë dhe publik dhe të drejtat për t'u mbrojtur, përfaqësuar dhe këshilluar për ndihmën juridike. Po kështu dhe neni 49 mbi parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të veprave penale dhe dënimeve të përcaktuara kanë një rëndësi të veçantë në gjykimin e të miturve.²⁶⁵

Neni 6 (1) i KEDNJ-së përfshin disa garanci të procesit të drejtë gjyqësor:

- të drejtën për një degjim të drejtë publik (përveçse nëse është në kundërshtim, ndër të tjera, me interesat e të miturve); e drejta për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme; e drejta për një gjykim nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; të drejtën për një gjykim nga një gjykatë e themeluar me ligj.

Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka këto të drejta minimale:

265 Handbook on European law relating to the rights of the child, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015, fq 198.

- të drejtën për t'u informuar menjëherë për akuzat në një gjuhë që ai / ajo kupton (neni 6 (3) (a) i KEDNJ); e drejta për të pasur kohë dhe lehtësira të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes së saj (neni 6 (3) (b) i KEDNJ-së); e drejta për të pasur ndihmë juridike (Neni 6 (3) (c) i KEDNJ-së); të drejtën për të shqyrtuar ose për të shqyrtuar dëshmitarët (Neni 6 (3) (d) i KEDNJ); drejta për të pasur ndihmën e një përkthyesi (neni 6 (3) (e) i KEDNJ).

Garancitë e mësipërme janë garanci që gjejnë zbatim si për të rriturit dhe miturit.

Pjesëmarrje Efektive

Direktiva e propozuar për garancitë procedurale për të miturit e dyshuar ose të akuzuar penalisht përfshin të drejtën për pjesëmarrje efektive, si dhe të drejtën për përfaqësim ligjor.

GJEDNJ ka përpunuar sipas nenit 6 kërkesat specifike për sigurimin e pjesëmarrjes efektive të të miturve në gjykimet penale. Si rregull i përgjithshëm, procedurat duhet të sigurojnë që të merret parasysh moshja e të miturit, niveli i pjekurisë dhe kapacitetet emocionale. Shembuj konkretë të kërkesave të pjesëmarrjes efektive përfshijnë praninë e fëmijës gjatë seancave, mbajtjen e seancave dëgjimore, publicitetin e kufizuar, sigurimin që fëmija të kuptojë atë që është në rrezik dhe formalitetin e kufizuar të seancave gjyqësore. Deri tani, GJEDNJ nuk ka konsideruar se përcaktimi i moshës së përgjegjësisë penale shumë të ulët përbën në vetvete një shkelje të nenit 6 të KEDNJ. Kur vlerësohet nëse një fëmijë është në gjendje të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurat kombëtare, GJEDNJ shqyrton rrethanat konkrete të secilit rast.²⁶⁶

Qasja Në Një Avokat

Në sistemin evropian zbatohet *Direktiva e Qasjes së Avokatit 2013/48 / EU522*. Kështu nëse një i mitur është i privuar nga liria, mbajtësi i përgjegjës së prindërore duhet të njoftohet dhe t'i jepet arsye për këtë, përveç nëse kjo do të ishte në kundërshtim me interesat më të mira të të miturit. Direktiva zbatohet nga momenti kur të dyshuarit ose të akuzuarit janë njoftuar për kryerjen e një vepre penale deri në përfundimin e procedurës me përcaktimin përfundimtar të

266 Handbook on European law relating to the rights of the child, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015, fq 202.

fajit apo të pafajësisë. Sipas ligjit të Këshillit të Evropës, GJEDNJ-ja konsideron se qasja në një avokat është një nga elementët thelbësorë të së drejtës për një gjykim të drejtë. Individit i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën e qasjes në avokat që nga fazat e hershme të një hetimi të policisë. Vëzhgimi i GJEDNJ-së nëse një aplikant ka pasur qasje efektive në një avokat është më i rreptë në rastet që përfshijnë fëmijët.²⁶⁷ Me rëndësi të madhe për të dyshuarit / të akuzuarit janë udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore me të miturit. Një garanci tjetër e rëndësishme vjen nga sistemi i Kombeve të Bashkuara dhe që lidhet me moshën e të miturit. Sipas nenit 40 të KDF-së, pranohet se çdo i mitur i dyshuar si i akuzuar për shkelje të ligjit penal ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe në atë mënyrë që të merret parasysh moshja e tij. Kjo pasi objektivi kryesor i drejtësisë për të mitur sipas nenit 40 të KDF është të riintegrojë të miturin në shoqëri, në të cilën ata mund të luajnë një rol konstruktiv. Ky parim duhet të zbatohet, respektohet gjatë gjithë procesit të trajtimit me fëmijën, nga kontakti i parë me agjencitë e zbatimit të ligjit deri në zbatimin e të gjitha masave për trajtimin e fëmijës. Ai kërkon që të gjithë profesionistët e përfshirë në administrimin e drejtësisë për të mitur të jenë të pranueshëm në lidhje me zhvillimin e fëmijës, rritjen dinamike dhe të vazhdueshme të fëmijës, ato që janë të përshtatshme për mirëqenien e tyre dhe format e përhapura të dhunës kundër fëmijëve ... «

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës)

Rregullat e Havanës japin standarde referimi për profesionistët e përfshirë në menaxhimin e sistemit të drejtësisë për të mitur nga arrestimi deri tek lirimi. Ato përpiqen të mbrojnë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve në konflikt me ligjin, duke theksuar në veçanti se heqja e lirisë duhet të jetë një mjet i fundit në raste të jashtëzakonshme dhe për kohën më minimale të nevojshme. Kushtet dhe rrethanat e paraburgimit duhet të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe secili fëmijë duhet të vlerësohet dhe të kujdeset individualisht në përputhje me nevojat, statusin dhe kërkesat e veçanta. Rregullat më tej adresojnë të drejtat e fëmijëve për arsim, rekreacion, religjion, kujdes shëndetësor dhe për të kontaktuar me komunitetin më të gjerë, dhe do t'u kërkonin shteteve të ofrojnë mjete efektive nëse këto ose të drejta të tjera janë shkelur.

267 Handbook on European law relating to the rights of the child, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015, po aty.

1.2. GARANCITË NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË TË MITURVE SI VIKTIMA TË VEPRAVE PENALE

Të miturit jo vetëm janë në pozitën e autorit të veprave penale, por më së shumti në pozitën e viktimës së veprës penale. I mituri si viktimë dhe dëshmitarë ka të drejtën e mbrojtjes kundër viktimizimit të mëtejshëm, në shërim dhe riintegrim dhe për pjesëmarrje efektive në procedurat kriminale.

Në sistemin evropian është **Direktiva e të Drejtave të Viktimave 2012/29/BE** që e njeh qartë pozitën e të miturit si viktimë. Ai parashikon që kur viktimat është i mitur, interesi më i mirë i tij ose saj është një konsideratë parësore dhe duhet të vlerësohet në baza individuale. Për më tepër, një qasje e ndjeshme ndaj të miturve duhet të mbizotërojë, që do të thotë që duhet të merren parasysh mosha, pjekuria, pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e të miturit. Direktiva synon të sigurojë që i mituri dhe mbajtësi i përgjegjësishë prindërore (ose ndonjë përfaqësuesi tjetër ligjor) të informohen për çdo masë ose të drejtë të fokusuar në mënyrë specifike për të miturin. Të miturit viktimat gjithashtu kanë të drejtë të dëgjohen gjatë procedurave penale, dhe Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ata të mund të ofrojnë dëshmi. Me rëndësi është fakti që direktiva synon të mbrojë privatësinë dhe identitetin e të miturit viktimë gjatë procedurës penale, për të parandaluar viktimizimin dytësor, ndër arsytet e tjera.²⁶⁸

Direktiva përcakton një dispozitë të posaçme për të drejtën e mbrojtjes së të miturve viktimat gjatë procedurës penale (neni 24), i cili trajton regjistrimin audiovizual të intervistave me fëmijët viktimat dhe përdorimin e tij si dëshmi në procedurat penale, emërimin e përfaqësuesve të posaçëm, dhe të drejtën e përfaqësimit ligjor në emër të të miturit nëse ekziston një konflikt interesi ndërmjet të miturit dhe bartësve të përgjegjësishë prindërore.

Sipas ligjit të Këshillit të Evropës, GJEDNJ vendosi se ekziston një detyrë e shtetit për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave.

Kjo vlen dhe për viktimat që marrin pjesë si dëshmitarë në procedurën penale. Interesat e tyre sipas dispozitave të GJEDNJ-së, si p.sh. neni 2 dhe neni 8, duhet të jenë të balancuara kundrejt interesave të mbrojtjes.

Neni 31 i **Konventës së Lansarotë** tregon se cilat janë masat e përgjithshme mbrojtëse që Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin për të mbrojtur të drejtat dhe

268 Direktiva e të Drejtave të Viktimave 2012/29 / BE.

interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve penale (neni 31 (1)). Këto masa përfshijnë informacionin për të drejtat e tyre si viktimat, disponueshmërinë e shërbimeve dhe ecurinë e përgjithshme të hetimeve ose procedurave, mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së tyre (duke përfshirë informacionin mbi lirimimin e personit të ndjekur ose të dënuar) dhe shmangien e kontaktit ndërmjet viktimës dhe autorët e krimit në gjykata dhe në agjencitë e zbatimit të ligjit.

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore të fëmijëve gjithashtu i kushtojnë vëmendje pozitive të miturve si viktimë dhe dëshmitar, veçanërisht kur ai ose ajo jep prova në procedurat gjyqësore. Udhëzimet u bëjnë thirrje shteteve anëtare që të bëjnë «shumë përpjekje për fëmijët që të japin dëshmi në mjediset më të favorshme dhe nën kushtet më të përshtatshme, duke pasur parasysh moshën, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit dhe vështirësitë e komunikimit ata mund të kenë.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se OKB-ja ka miratuar Udhëzimet mbi Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Viktimat e fëmijëve dhe Dëshmitarët e Krimit. Këto udhëzime kërkojnë që viktimat dhe dëshmitarët fëmijë të trajtohen në një mënyrë «të ndjeshme ndaj fëmijëve», e cila «nënkupton një qasje që balancon të drejtën e fëmijës për mbrojtje dhe që merr parasysh nevojat dhe pikëpamjet individuale të fëmijës».

Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Viktimat dhe Dëshmitarët e Krimit të Fëmijëve

Në përgjithësi, këto Udhëzime synojnë të ndihmojnë shtetet në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, politikave, programeve dhe praktikave për të siguruar respekt të plotë për viktimat dhe dëshmitarët të mitur. Ata pranojnë se fëmijët janë veçanërisht të prekshëm dhe kërkojnë mbrojtje të veçantë në ndërveprimet e tyre me sistemin e drejtësisë dhe ripohojnë parimet e përgjithshme të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës. Sipas udhëzimeve, fëmijët viktimat dhe dëshmitarë kanë të drejtë të trajtohen me dinjitet dhe dhembshuri, të informohen, të dëgohen, të marrin ndihmë efektive dhe të përfitojnë nga masat e posaçme mbrojtëse, të sigurojnë sigurinë e tyre private dhe të sigurisë dhe të kërkojnë dëmshpërblim. Një qasje holistike gjithashtu nxitet fuqimisht.

Protokolli Opsional mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve:

Ky protokoll parashikon në nenin 8 dhe 9 të tij se shtetet pale të tij duhet të miratojnë masat e duhura për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijëve viktime në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale, në veçanti duke:

- Duke njohur dobësinë e fëmijëve viktime dhe duke përshtatur procedurat për të njohur nevojat e tyre të veçanta, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë; Informimi i fëmijëve viktime mbi të drejtat e tyre, rolin e tyre dhe fushëveprimin, koha dhe progresi i procedurave dhe i disponimit të rasteve të tyre; Lejimi i pikëpamjeve, nevojave dhe shqetësimeve të fëmijëve viktime për t'u paraqitur dhe shqyrtuar në procedurat ku preken interesat e tyre personal; Sigurimi i shërbimeve të përshtatshme mbështetëse për fëmijët viktime gjatë tërë procesit ligjor; Mbrojtjen, sipas rastit, të privatësisë dhe identitetit të fëmijëve viktime dhe marrjen e masave për të shmangur shpërndarjen e papërshtatshme të informacionit që mund të çojë në identifikimin e fëmijëve viktime; Sigurimi për sigurinë e fëmijëve viktime, si dhe të familjeve të tyre dhe dëshmitarëve në emër të tyre, nga kërcënimi dhe hakmarrja. Shmangia e vonesave të panevojshme në disponimin e rasteve dhe ekzekutimin e urdhërave ose dekreteve që u japin kompensim fëmijëve viktime ... “

Po kështu parashikohet dhe rëndësia e pjesëmarrjes në proces të psikologut, në interesin më të mirë të fëmijës dhe marrjen e të gjitha masave të mundshme me qëllim që të sigurojnë të gjitha ndihmat e duhura për viktimat, duke përfshirë riintegrimin e të plotë social dhe rimëkëmbjen e plotë fizike dhe psikologjike të të miturve.

Rregullat Minimale të Standardeve të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit)

Rregullat e Pekinit u bëjnë thirrje Shteteve të krijojnë mbrojtje ligjore që e bëjnë më mirë mirëqenien e fëmijëve në konflikt me ligjin. Rregullat mbulojnë bashkëveprimin e fëmijëve me sistemin ligjor nga kontakti i parë me zbatimin e ligjit deri në gjykimin dhe disponimin, duke i drejtuar shtetet të krijojnë sisteme të ndara të drejtësisë për të mitur me ligje, rregullore dhe politika që mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe plotësojnë nevojat e tyre individuale. Në mënyrë të

veçantë, shtetet inkurajohen që të sigurojnë fleksibilitet dhe diskrecion në kryerjen e procedurave të drejtësisë për të miturit, ndërsa në të njëjtën kohë garantojnë mbrojtje themelore procedurale të fëmijëve.

PËRFUNDIME

Në përfundim të kësaj teme konstatojmë se drejtësia penale për të miturit në tërësinë e saj parashikon një sërë garancish për mbrojtjen e të drejtave të të miturit si viktime dhe autorë veprë penale. Këto garanci synojnë që i mituri në drejtësinë penale të ketë mundësinë e informimit, mbrojtjes nga një avokat, praninë e psikologut, mbrojtjes së privatësisë dhe zhvillimin e një gjykimi të drejtë. Vetëm përmes zbatimit të garancive ndërkombëtare dhe evropiane mund të sigurohet zhvillimi normal dhe i drejtë i të drejtave të të miturve.

BIBLIOGRAFIA

1. Konvencioni E OKB Mbi Të Drejtat E Fëmijëve
2. Karta Themelore e të drejtave të Njeriut e BE.
3. http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-636_en.htm
4. <https://www.loc.gov/law/help/child-rights/international-law.php>
5. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX-3A32012L0029>
6. https://www.stjornarradid.is/media/innanrikisraduneyti-media/media/frettir-2012/Islan-Turkovic_20.02.12.pdf
7. http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Data_ENG.pdf
8. https://ec.europa.eu/info/law/law-topic/data-protection_en
9. https://ec.europa.eu/info/strategy/justice-and-fundamental-rights/criminal-justice/victims-rights_en
10. http://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_rights_child_ENG.PDF

QËLLIMI DHE RISITË E KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT

Sonila Qerolla, Avokate

Albina Kola, Asistent Avokate

sonila.qerolla@gmail.com

ABSTRAKT

Në një shoqëri si Shqipëria, ku fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullsisë është e nevojshme të investohet si subjekt i sistemit të drejtësisë. Krijimi i Kodit Penal për të miturit si një nga arrijtet më të mëdha garanton realizimin e interesave prioritare, mbrojtjen e të miturve viktimë e kriminalitetit, dhunës, ç'do formë e rrezikimit të të drejtave dhe lirive të tyre. Mbrojtja e të miturve si autor i veprimeve që me ligj cilësohen si vepra penale apo kundërvajtje të përsëritura, socializmi, edukimi dhe riintegrimi i tyre, ndihma dhe përkujdesja, mbrojtjen në procedurat para gjyqësore dhe gjyqësore apo para organeve të tjera të përmbushen në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit. Ky studim ka për synim të evidentojë qëllimin dhe risitë e Kodit të Drejtësisë Penale krejtësisht i ri dhe i paprovuar si pjesë e reformimit të sistemit të drejtësisë. Një kod i cili përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin si dhe një të mitur viktimë ose/dhe dëshmitar të veprës penale.

Fjalët kyçe: *I mitur, interesi më i lartë, mbrojtje, parandalim, riintegrim*

1. HYRJE

Pas viteve 90' i gjithë legjislacioni shqiptar dhe sistemi i drejtësisë iu "nënshtrua" një procesi reformimi të pandërprerë. Pas ratifikimit të KDF, KEDNJ dhe pas miratimit të Kushtetutës në 1998 reforma në sistemin ligjor dhe në drejtësisë pati përmasa jovetëm sasiore por edhe cilësore. Kjo reformë në të vërtetë nuk ka reshtur, janë hedhur hapa pozitive në përjasjen e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare të garantuara në aktet ndërkombëtare, një nga këto është krijimi i Kodit Penal për të Mitur. Kriminaliteti i të miturve mbart probleme shumë më tepër për të ardhmen. Sa të mitur arrestohen në vit? Sa prej tyre shkojnë në gjyq apo vuajnë dënimin me burg? Sa të mitur keq trajtohen nga sistemi i drejtësisë penale? A ka recidivistë të mitur? Sa i sigurt dhe i mjaftueshëm është sistemi aktual në efektet parandaluese dhe rehabilituese që vet-përmban? Cilat janë ndryshimet që po bëhen? A do të funksionojë ashtu siç duhet legjislacioni penal për të mitur? Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve janë indikatorë të standardeve ku kemi mbërritur. Sfidat e shtruar janë një proces i pafund. E rëndësishme është që sistemi në çdo fazë të përgjigjet sa më mirë, sa më shpejt, me kosto të ulët, kërkesave të tanishme dhe perspektivave të së ardhmes në mënyrë që në çdo nen të ligjit, në çdo procedurë, në çdo institucion, strukturë e nënstrukturë të tij, tek çdo individ, të mbizotërojë interesi më i lartë i të miturve.

2. QËLLIMI I KODIT PENAL PËR TË MITUR

Qëllimi i "Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit" është mbrojtja e interesit më të lartë të të miturit, integrimi social i tyre, rehabilitimi i të miturit në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të miturve dëshmitar dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë, profesionalizmi i organeve kompetente²⁶⁹. Në të gjitha veprimet ku fëmijët janë drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë ose të prekur nga sistemi i drejtësisë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë një konsideratë primare, në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare. Prandaj, në çdo veprim të

269 Shih neni 2 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

ndërmarrë, duhet menduar se si veprimi do të ndikojë tek një fëmijë ose grupe fëmijësh, për të siguruar që interesat e tyre më të mira të përmbushen. Përderisa interesat më të mira të fëmijës janë me rëndësi parësore, ato gjithashtu duhet të konsiderohen dhe të balancohen me çdo të drejtë konflikti të të drejtave të fëmijëve të tjerë, grupeve të fëmijëve apo të rriturve. Ne shohim një Kod i cili e sanksionon këtë parim të rëndësishëm dhe ndryshe nga më parë ofrohet një mbrojtje më e gjërë.

Parimi i mbrojtjes së mirëqenies dhe zhvillimit të fëmijës ndërthuret me atë të interesit më të lartë të tyre. Ajo përsërit nevojën për masa dhe mbrojtje shtesë për shkak të cenueshmërisë së fëmijës dhe detyrës së shtetit për të siguruar këtë mbrojtje. Mbrojtja e mirëqenies së fëmijës nuk përfshin vetëm mbrojtjen e një fëmije nga dëmtimi fizik, për shembull, duke kontrolluar vendet ku fëmijët mbahen gjatë procedimit penal apo më tej ose duke vendosur ligje kundër përdorimit të dhunës nga organet proçeduese. Një qasje dhe mjete më aktive në zbatimin e veprimeve për të mundësuar zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës duke nënkuptuar ofrimin e trajnimeve profesionale dhe edukative në qendrat e paraburgimit të fëmijëve dhe vendosjen e masave mbrojtëse për të kufizuar çdo gjë që mund të pengojë zhvillimin e tillë. Qëllimi i dënimit të të miturit është rishoqërimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.²⁷⁰ Parandalimi i kriminalitetit të të miturve është pjesë themelore e parandalimit të krimit në përgjithësi. Angazhimi në aktivitete të ligjshme, duke adoptuar një orientim humanist ndaj shoqërisë dhe perspektivë mbi jetën, të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo-kriminalistik. Planet gjithëpërfshirëse të parandalimit duhet të krijohen në çdo nivel të qeverisjes duke përfshirë analizë të thellë të problemit, përgjegjësi të përcaktuara mirë për agjencitë e kualifikuara, institucionet dhe personelin e përfshirë midis agjencive qeveritare dhe joqeveritare, politikat, programe dhe strategjitë e bazuara në studimet të vazhdueshme, pjesëmarrjen e të rinjve në politikat dhe proçeset e parandalimit, duke përfshirë kompensimin e viktimeve dhe programet e ndihmës.

Me ²⁷¹iintegrimi kuptojmë ri-hyrjen efektive të një fëmije në komunitet pas vua-

270 Penal Reform International, Protecting children's rights in criminal justice systems, Chapter.

271 Goldson, B., Dictionary of Youth Justice, 2008.

jtjes së një dënimi me burgim. Shpjegimi i termit është paksa i gabuar për shkak se procesi është gjithëpërfshirës fillon menjëherë pas dënimit, vazhdon me periudhën e burgimit dhe pas vuajtjes së dënimit, kontakti përsëri me komunitetin. Me qasjen e re të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, nuk lidhet domosdoshmërisht me dënimin penal, por duhet synuar që kur fëmija bie në kontakt/konflikt me ligjin. Kjo kërkon krijimin e një sistemi të gjere rrjetesh kontrolli formal dhe joformal, si dhe krijimin e një vazhdimësie shërbimesh komunitare për të parandaluar rikthimin e sjelljeve anti-shoqërore. Institucionet kujdestare dhe komuniteti duhet të punojnë së bashku për të siguruar që gjatë vuajtjes së dënimit fëmijët marrin mësimetë cilat përfshijnë komunikimin dhe zgjidhjen e konflikteve, aftësitë për profesion dhe kurse, mënyrën se si të jetojnë të pavarur, si të rritur. Përveç kësaj, strategjitë e ndërhyrjes (p.sh. këshillime, programe të sjelljes, provës, punësim, programe akademike) që trajtojnë faktorët individual të rrezikut të secilit fëmijë janë një parakusht thelbësor për riintegrimin. Veprimtaria rehabilituese në vendin e vuajtjes së dënimit për të miturin ka për qëllim kryesor të përgatisë të miturin për lirin e tij, me qëllim rehabilitimin e tij dhe kthimin në jetën shoqërore.

²⁷²Aksesi i fëmijëve në drejtësi në Shqipëri, nuk është akoma i mjaftueshëm. Fëmijët viktimë apo dëshmitarë të krimit rrezikojnë të viktimizohen për së dyti, shërbimet sociale janë shumë të dobëta dhe nuk kanë ndonjë rol në trajtimin dhe mbështetjen e të miturve nën moshën e përgjegjësisë penale në kontakt me ligjin. Për të parandaluar rrezikun e riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë kodi parashikon në veprimet procedurale, në të cilat i mituri është viktimë, merr pjesë përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi dhe psikologu, si dhe, sipas rastit, nëse është e mundshme, edhe personi i besuar i të miturit. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon ngritjen dhe vënien në funksionim të qendrave edukuese/disciplinore që të ofrojnë shërbim të specializuar për të mitur në konflikt me ligjin. Për të mbështetur procesin e integritimit krijohet Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve e cila ka për qëllim mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit. Pas lirit, i mituri, sipas rastit, rivendoset pranë prindit ose kujdestarit të tij dhe i garantohet mbrojtja, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e

fëmijëve koordinon dhe zbaton planin e rehabilitimit dhe të rishoqërizimit për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirimit me kusht dhe mbikëqyrje ecurinë e zbatimit të planit për rishoqërizimin e të miturit.

3. RISITË E KODIT PENAL PËR TË MITUR

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

3.1 Përgjegjësia penale e të miturve

Kodi Penal për të Mitur përcakton se moshaminimale e përgjegjësisë penale është moshë 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe moshë 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal, kufi i cili nuk ka ndryshuar. Një fëmijë nën moshën e ndjekjes penale nuk ka kapacitet për të kryer një krim. Kjo do të thotë se ata janë të imunizuar nga ndjekja penale, ata nuk mund të akuzohen zyrtarisht nga autoritetet për një veprë penale dhe as t'i nënshtrohen ndonjë procedure ose masave penale. Moshë minimale e përgjegjësisë penale nënkupton një fëmijë i cili ka arritur një nivel emocional, mendor dhe psikologjik intelektual për të mbajtur përgjegjësi për veprimet e tyre. Sipas nenit 40 (3) të KDF, shtetet inkurajohen të vendosin një moshë minimale nën të cilën fëmijët supozohet të mos kenë aftësi për të shkelur ligjin penal. Ka shumë polemika rreth asaj se cila duhet të jetë moshë më e përshtatshme e përgjegjësisë penale dhe nuk ka standarde kategorike ndërkombëtare në këtë drejtim. Në përgjithësi Komiteti nr. 10, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës konkludon se “mosha minimale e përgjegjësisë penale nën moshën 12 vjeçare konsiderohet nga Komiteti që të mos jetë i pranueshëm ndërkombëtarisht”. Në të njëjtën kohë, ai thekson që shtetet duhet mos e ulin moshën e përgjegjësisë penale në 12 inkurajon fuqimisht shtetet për të futur një moshë minimale më të lartë të përgjegjësisë penale, për shembull 14 ose 16 vjeç.

Kodi Penal për të Mitur ka parashikuar kufirin e moshës deri kur një madhor, i cili e ka kryer veprën penale kur ka qënë i mitur të gjykohej nga seksioni për

të mitur i gjykatës përkatëse kompetente. Kodi i Procedurës Penale në nenin 81 nuk e përcakton një kufi të tillë. Prima face mund të interpretohet se çdo madhor në çfarëdolloj moshe madhore, kur e ka kryer veprën penale kur ka qënë i mitur do të gjykohet nga seksioni për të miturit. Por Kodi i të miturve i ka dhënë një përgjigje kufizuese këtij problemi ligjor. Ai ka vënë si kufi moshor moshën 23 vjec. Kështu në nenin 27 pika 6 i Kodit të Miturit përcaktohet se *juridiksioni i seksionit për të mitur të gjykatave të rretheve gjyqësore mbaron kur i mituri arrin moshën 23 vjeç*. Kodi i të Miturve përcakton një mënyrë të re të individualizimit të dënimit. Kjo përfshin vlerësimin individual të parashikuar në nenin 26 dhe 47 pika 1 të tij ku parashikohet se “ *Prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit mbështetet në nivelin e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta*”. Këto parashikime ekzistojnë bashkë me parimet e individualizimit të dënimit në nenin 47 të Kodit Penal.

3.2 Evitimi i ndjekjes penale dhe dënimit për shkak të masave të shmangies

Kodi i të Miturve parashikon disa masa të reja të evitimit të dënimit dhe ndjekjes penale të quajtura masa të shmangies. Këto masa përbëjnë një arritje të madhe në drejtim të rehabilitimit dhe riintegrit të të miturit në shoqëri. Sipas nenit 70 pika 3 “ *I mituri që ka përmbushur një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale nuk do të konsiderohet si i dënuar për një veprë penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale*”. Pra, do të ketë mundësi të rikthehet në shoqëri pa kufizime sic janë përshembull afatet rehabilitimit që nuk zbatohen në këtë rast. Organi kompetent që mund të jetë prokurori ose gjykata, në marrjen e vendimit për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale vlerëson interesin më të lartë të të miturit, rëndësinë e veprës penale të kryer dhe dënimin eparashikuar për atë veprë, moshën e të miturit, shkallën e fajësisë, dëmin e shkaktuar, efektin frikësues të ndjekjes penale. Në nenin 55 pika 2, ligjvënësi ka vendosur disa kushte specifike si indikatorë për aplikimin e këtyre masave sepse thuhet *në mënyrë të veçantë*. Kjo nënkupton se i lihet një diskrecion i gjërë organit kompetent që gjykon nëse dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korrigjimit të sjelljes së tij, si dheshihet nëse nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të

filluar. Por një kusht sine qua no është që marrja e masës së shmangies nga ndjekja penale bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të të miturit dhe, kur është e përshtatshme, edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor.

3.3 Elemente të procesit të hetimit dhe gjykimit të të miturve në konflikt me ligjin.

Kodi i Ri parashikon që organi proçedues, që në momentin e arrestimit të të miturit, e informon atë lidhur me të drejtën për të njoftuar prindin dhe në mungesë të tij, një person tjetër të rritur të treguar dhe pranuar prej tij. I mituri mund të arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal për të Mitur.²⁷³Në shqyrtimin për vleftësimin e arrestit ose të ndalimit në kuadër të parimit të shqyrtimit pa vonesë dhe me përparësi, që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kryhen në mënyrë të shpejtë, pa vonesa tëpajustificuara mbi bazën e interesit më të lartë të të miturit dhe duke respektuar të drejtat e tij. Duke u mbështetur në këtë parim, gjyqtari dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin *menjëherë*. Ndërsa në Kodin e Procedurës Penale parashikohet se gjykata cakton seancën e vlerësimit *sa më shpejt*.

Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa: a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje; b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.Vendosja e të miturit në mbikëqyrje synon garantimin e paraqitjes së të miturit, sa herë kërkohet, përpara oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit ose gjykatës.Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar bëhet ndaj të miturit, interesat e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikëqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit ose personave të afërm. Masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet, masa është e domosdoshme, sepse i mituri përbën rrezik dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër apo përpiket t'i shmanget drejtësisë.I mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se gjysma e kohës

273 Direktiva 2011/93 EU datë 13.12.2011, Fletore Zyrtare nr.335, datë 17.12.2011, si dhe standartet dhe rregullat për drejtësinë për të mitur në nivelin e OKB-së dhe Këshillit të Evropës.

së paraburgimit të caktuar për të rriturin, sipas Kodit të Procedurës Penale.

Një risi tjetër është parashikimi i rregullave të posaçme për pyetjen e të miturit 14 vjeç-18 vjeç. Përveç rregullave të parashikuara në nenin 361/a të Kodit të Procedurës Penale për të miturin mbi 14 vjeç dhënia e dëshmisë bëhet pa praninë e të pandehurit. Gjatë gjithë procesit së hetimit dhe gjyqimit i sigurohet ndihma juridike dhe psikologjike falas. Kodi i Ri shprehet se gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore apo çdo profesionistë që punojnë me fëmijët të jenë të specializuar dhe trajnuar në drejtësinë penale për të mitur. Sipas Kodit të Miturve çështja e një të mituri në konflikt me ligjin dërgohet në gjykatë jo më vonë se 3 muaj nga dita e regjistrimit të emrit në regjistër, me përjashtim të rasteve kur gjatë kësaj periudhe ai është akuzuar për një vepër tjetër penale ose në rastet e veprave penale që gjykohen nga Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Kodi Penal i të Miturve parashikon afate kohore specifike, për shqyrtimin e çështjes. Gjykata e shkallës së parë përfundon shqyrtimin e çështjes në një kohë sa më të shpejtë, por jo më vonë se 6 muaj nga data e depozitimit të akteve në gjykatë, gjykata e apelit jo më vonë se 2 muaj nga data e dërgimit të akteve në gjykatë. Gjykata e Lartë shqyrton pranueshmërinë e rekursit, si dhe gjykon çështjen sa më shpejt të jetë e mundur.

4. LLOJET E DËNIMIT

Një risi e rëndësishme janë llojet e dënimeve për të miturit që janë dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim. Dënimet ndaj të miturit klasifikohen në dënime kryesore dhe plotësuese. Janë dënime kryesore: a) burgimi; b) kufizimi i lirisë; c) gjoha. Janë dënime plotësuese: a) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; b) kryerja e një pune me interes publik; c) përmbushja e detyrimeve të caktuara; ç) qëndrimi në shtëpi. Në Kodin e të Miturve parashikohen rregulla me favorizuese se Kodi i Procedurës Penale duke vendosur kufi të vogël për dënimin me burgim. Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet. Vendosen rregulla më favorizu-

ese në lidhje me lirimin me kusht. Kështu në nenin 129 i mituri i dënuar mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm nëse ka kryer jo më pak se një të tretën e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim deri në 3vjet, jo më pak se një të dytën e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim deri në 8vjet, jo më pak se dy të tretat e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim mbi 8 vjet. Kufizimi i lirisë është një lloj dënimi i ri që parashikohet ekskluzivisht në Kodin e të Miturve. Ai konsiston në vendosjen e të miturit në një institucion/qendër të caktuar nën mbikëqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme. Në dallim me Kodin Penal që rregullon gjobën për të rriturit, masa e gjobës për të miturit mund të zbatohet për një të mitur nëse ka të ardhura monetare nga një burim i ligjshëm.

5. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE.

Në ekzekutimin e vendimeve merren parasysh dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Përcaktohen dispozita specifike sidomos për dënimet jo me burgim. Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim të parashikuar nga Kodi i të Miturve, zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Në rast të shkëljes së regjimit të përcaktuar për ekzekutimin e vendimit të dënimit jo me burgim nga një i mitur, Shërbimi i Provës harton një procesverbal paralajmërimi, i cili, sipas rastit, i dorëzohet ose i dërgohet me postë të dënuarit kundrejt vërtetimit të marrjes. Nëse i mituri i shmanget vuajtjes së dënimit jo me burgim, dënimit me kusht ose kryerjes së një detyrimi, Shërbimi i Provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, i raporton prokurorit dhe, sipas rastit, i propozon ndryshimin e vendimit. Prokurori, sipas rastit, mund t'i kërkojë gjykatës ndryshimin e vendimit. Me kërkesë të palës/ve, gjykata mund të shqyrtojë edhe prova të tjera. Në këtë rast gjykata shprehet brenda një jave nga paraqitja e kërkesës. Këtu Kodi vendos përsëri kufizim të afateve për një drejtësi sa më efektive.

KONKLUZIONE

Administrimi i Sistemit të Drejtësisë për të Miturit dhe përputhshmëria e tij me standardet ndërkombëtare e vendos në qendër përdorimin e masave të burgimit si mjet i fundit dhe ri-integrimin si synim i sistemit të drejtësisë. Drejtësia e

tillë duhet të jetë, e butë me fëmijët dhe të jetë në krahë të tyre. Në Shqipëri është bërë progres në administrimin e drejtësisë për të miturit për ta bërë sistemin sa më njerëzor duke ofruar garanci ligjore dhe procedurale, dhe duke kaluar nga një sistem ndëshkues në një sistem me një qasje të drejtësisë që edukon dhe ri-integron. Masat e ndryshme si pajtimi midis viktimës dhe shkelësit të ligjit, praktikave dëmshpërbluese, dhe dënimet alternative për të miturit, ndihma ligjore dhe psikologjike falas, krijimi mekanizmave dhe institucioneve të reja-kontribuojnë në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Numri i femijeve recidiviste të rritur 40% tregon masat e dënimit të zbatuara nuk kanë qenë të duhura dhe si rrjedhojë nuk kanë sjelle pasojë “korrektuese” tek fëmijet. Se dyti, nxjerr në pah mungesën e ndërveprimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes sociale dhe punës që ata duhet të bëjnë me fëmijet që kanë qenë në konflikt me ligjin. Pra, kërkohet një ndërlidhje më e mire mes sistemit të drejtësisë me atë të arsimit e mbrojtjes sociale, si për parandalimin, ashtu edhe për ri-integrimin e të miturve në konflikt me ligjin.

BIBLIOGRAFIA

- Ligji nr.37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit
- Kodi Penal i RSH
- Kodi i Proçedurës penale
- Konventa “Mbi të drejtat e fëmijëve” miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
- Ligji për ratifikimin e Konventën e Këshillit Europës “ Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve
- Relacion për projektligjin „Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur në Republikën e Shqipërisë
- Strategjia e drejtësisë për të mitur 2017-2020
- Filippou, F Child Protection System Under Construction.Mission in Albania 2015
- Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 (2009)

E DREJTA E QASJES DHE PAJTUESHMËRISË PËR KUJDES SPECIAL, KUJDES SHËNDETËSOR DHE ASISTENCË PËR TË MITURIT JETIMË ME AFTËSI NDRYSHE: DIREKTIVA UDHËZUESE

MSc.Suela Ndoja

*Lektore, University "Luigj Gurakuqi", Departamenti i Psikologjisë dhe Punës
Sociale*

sundoprospe@gmail.com

ABSTRAKT

I Mituri jetim ka të drejtën e qasjes dhe pajtueshmërisë për kujdes special, kujdesi shëndetësor dhe asistencëtë përshtatur për gjendjen e tij / saj. Shteti ka njohur se duhet t'i garantojë fëmijës me aftësi ndryshe një jetë të plotë e të denjë dhe kushte jetese që garantojnë dinjitetin, nxisin autonomi dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive në jetën komunitare duke patur si qëllim zhvillimine plotë të fëmijës, rehabilitimin dhe integrimin social. Për të arritur këtë qëllim, duhet tu sigurohet kujdes i vazhdueshëm special, kujdes shëndetësor dhe asistencë që synon rehabilitimin e tyre dhe integrimin social. Nga ana tjetër, procesi për të siguruar qasjen e duhur mund të jetë kompleks kur ka të bëjë me të miturit jetimë me aftësi ndryshe. Ofruesit e kujdesit socio-shëndetësor po përpiqen të gjejnë mënyrën e duhur bazuar në planin e kujdesit individual të hartuar për interesin më të mirë të fëmijës dhe legjislacionin në fuqi. Ligjet dhe rregulloret e shtetit ofrojnë një larmi të ndërlikuar të kërkesave që shpesh nuk përshtaten me kujdes dhe mund të jenë sfiduese për tu interpretuar dhe zbatuar. Si rrjedhojë, asnjë rregull i vetëm nuk mund të zbatohet në të gjitha situatat. Megjithatë, një vend i mirë për të filluar është me këto direktiva udhëzuese që hartojnë një përgjigje të përgjithshme. Sugjerohet që të gjithë ata që merren me këto çështje ta përdorin këtë dokument si pikënisje, duke krijuar një proces që do të inkurajojë të miturit me aftësi ndryshe që të kërkojnë kujdes duke maksimizuar konfidencialitetin dhe privatësinë e tyre.

Fjalët kyçe: *qasja në kujdes special, qasja në kujdesin dhe ndihmën shëndetësore, i mitur me aftësi ndryshe, direktiva udhëzuese.*

HYRJE

Në të gjithë botën, njerëzit me aftësi ndryshe, duke përfshirë Shqipërinë, duke iu referuar veçanërisht të miturve me aftësi ndryshe, kanë nevoja të paplotësuara për mbështetje (Mulheir, 2012). Shërbimet mbështetëse ende nuk janë një komponent thelbësor i politikave të aftësisë ndryshe në shumë vende dhe ekzistojnë mangësi në shërbimet kudo. Asnjë model i shërbimeve mbështetëse nuk do të funksionojë në të gjitha kontekstet dhe do të plotësojë të gjitha nevojat. Kërko-het një shumëllojshmëri e ofruesve dhe modeleve. Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe ka deklaruar se qeveritë „duhet të shqyrtojnë ligjet e tyre për të siguruar që vullneti dhe preferencat e fëmijëve me aftësi ndryshe të respektohen në baza të barabarta me fëmijët e tjerë“. Për shkak të çështjes në fjalë, në këtë dorëshkrim, ne i referohemi posaçërisht të miturve jetimë me aftësi ndryshe. Bazuar në Kodin e Drejtësisë Penale (2017) të miturit janë të gjithë fëmijët deri në moshën 16 vjeç.

Bazuar në përvojat dhe dëshmitë e mia praktike, shumë MJAN (të mitur jetimë me aftësi ndryshe) kanë nevojë për kujdes special, kujdes shëndetësor, ndihmë dhe mbështetje për të arritur një cilësi të mirë jetese dhe për të qenë në gjendje të marrin pjesë në jetën socio- ekonomike në baza të barabarta me të tjerët. Kështu, MJAN ka të drejtën e qasjes dhe pajtueshmërisë për këto shërbime të përshtatura për gjendjen vetjake ku qëllimi është zhvillimi më i plotë individual i fëmijës, rehabilitimi dhe integrimi social. (Ginnerup S, 2009 & FSHDPAK, 2010b).

Për të arritur qëllimin e përmendur, MJAN duhet ti sigurohet kujdes i vazhdueshëm special, kujdes shëndetësor dhe asistencë që synon rehabilitimin e tyre dhe integrimin social. Nga ana tjetër, procesi për të siguruar qasjen e duhur, konfidencialitetin dhe privatësinë mund të jetë mjaft kompleks kur ka të bëjë me të miturit jetimë me aftësi ndryshe. Përditë, duke iu referuar përvojës sime profesionale, ofruesit e kujdesit socio-shëndetësor po përpiqen të gjejnë mënyrën e duhur në bazë të planit të kujdesit individual ose planit të rehabilitimit të hartuar për të miturit me aftësi ndryshe në interesin më të mirë dhe legis-

lacionit në fuqi. Por ligjet dhe rregulloret e shtetit ofrojnë një larmi të ndërlikuar të kërkesave që shpesh nuk përshtaten mirë dhe mund të jenë sfiduese për tu interpretuar dhe zbatuar. Si rrjedhojë, asnjë rregull i vetëm nuk mund të zbatohet në të gjitha situatat. Prandaj, në këtë punim, i referohemi tre çështjeve të rëndësishme për të miturit jetimë me aftësi ndryshe: drejta e qasjes dhe pajtueshmërisë për kujdes special, kujdes shëndetësor dhe asistencë shoqëruar me shembuj dhe analiza. Së fundi, jependirektiva udhëzuese për tu ardhur në ndihmë të gjithë aktorëve të përfshirë në çështjet e mësipërme.

1. KUJDESI SOCIAL PËR TË MITURIT JETIMË ME AFTËSI NDRYSHE

Praktikisht, çdo i mitur me aftësi ndryshe kërkon trajtim ose pajisje speciale, kujdes special dhe burime shtesë prindërore për të plotësuar nevojat e veçanta. Sot ekziston një konsensus në rritje se kujdesi institucional thjesht nuk është në përputhje me një qasje të drejtave të njeriut (Kosta, 2006, UN, 2009) dhe një shoqëri moderne (Brown, 2002). Huluntimet kanë treguar në masë të konsiderueshme se kujdesi institucional është i dëmshëm për të gjithë individët, por në veçanti për fëmijët që shkaktojnë efekte afatgjata në shëndetin e tyre dhe zhvillimin psikosocial (Johnson, 2006). Fëmijët që rriten në institucione janë të privuar nga mundësia për të zhvilluar një lidhje të vazhdueshme me një kujdestar kryesor, për shkak të ngurtësisë dhe impersonalitetit tipik të kësaj forme të kujdesit, raportit të pamjaftueshëm të fëmijëve dhe personelit, disponueshmërisë së kufizuar të profesionistëve të kualifikuar dhe natyrës së natyrshme së ndërrimit të punës (Mansell, 2006 & Mansell et al, 1996). Vende të ndryshme kanë filluar të çmontojnë sistemet e tyre të kujdesit institucional duke i riintegruar fëmijët në familje dhe komunitetet e tyre, por procesi është ende larg përfundimit (Browe, 2016). Deinstitutionalizimi është një sistem i sugjeruar alternativ i kujdesit. Një model i këtij lloji është shtëpi familje në të cilën mund të sigurohet kujdes social special një fëmije jetim me aftësi ndryshe.

Shembull – Shtëpitë familje për personat jetimë me aftësi ndryshe

Shoqata “Projekti Shpresa” u themelua në qytetin e Shkodrës, Shqipëri në tetor të vitit 1995 nga një punonjëse sociale italiane në pension, Dr. Silvana Vignali, e cili erdhi vullnetare në Shqipëri pas një eksperience 33 vjeçare në shërbimet e punës sociale në Itali. Projekti fokusohet në ndihmën ndaj kategorive më të

prekshme të personave jetimë me aftësi të kufizuara, me probleme socio-ekonomike dhe atyre që vijnë nga Jetimoret apo Institucionet Psikiatrike. “Përfituesit” e saj janë të mirëpritur në Shtëpitë- Familje e ku trajtohen në bazë të një qasjeje tërësisht të re; jo si thjesht pacientë të patologjisë, por si njerëz me të gjitha nevojat e tyre shoqërore, psikologjike dhe shpirtërore që merren në konsideratë dhe qëpërbushen.

Gjatë 22 viteve të aktivitetit të saj, “Projekti Shpresa” është përpjekur të vërë në lëvizje të gjitha mekanizmat shoqërore dhe institucionale (kombëtare dhe rajonale) me qëllim dhe të sjellë një qasje të re në kulturën shqiptare mbi atë se si njerëzit “ ndryshe” perceptohen bazuar në respektin për diversitetin.

Analiza: E drejta për qasje dhe pajtueshmërinë për kujdes special.

Një katalizator për lëvizjen nga institucionet në jetesën e pavarur dhe në komunitet ishte miratimi në vitin 1993 i Rregullave Standarde të Kombeve të Bashkuara për Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara, e cila promovonte të drejta dhe mundësi të barabarta, (Brown, 2002) ka pasur një ndryshim të dukshëm në shumë vende dhe ato në tranzicion me të ardhura të larta, nga institucionet e mëdha rezidenciale dhe shtëpitë përkujdesëse në mjedisë më të vogla brenda komunitetit (Mansell & Ericson, 1996, Braddock et al, 2016).Vende të tilla si Norvegjia dhe Suedia kanë eliminuar të gjitha vendosjet institucionale. Diku tjetër - duke përfshirë Australinë, Belgjikën, Gjermaninë, Greqinë, Holandën dhe Spanjën - kujdesi institucional ekziston së bashku me rregullimet alternative të jetesës në komunitet. Ndërsa në Shqipëri, ende ekzistojnë institucione me MJAN të cilët nuk kanë zgjidhje të tjera.Por aktualisht ekziston edhe mundësia e kujdesit special duke u vendosur në shtëpi-familje në të cilën ata mund të gjejnë një përgjigje globale për nevojat e tyre duke përfshirë kujdestarinë si zgjidhjen më të mirë për të ardhmen e tyre, e cila ndër të tjera i parandalon ata nga problemet ligjore si delikuenca.

2. KUJDESI SHËNDETSOR PËR TË MITURIT JETIMË ME AFTËSI NDRYSHE

Jo të gjithë përdoruesit e sistemit shëndetësor janë në gjendje të jenë në gjendje të ushtrojnë lehtësisht të drejtat e tyre shëndetësore.Disa dobësi, të tilla si të pa-turit e një paaftësie, shtojnë pengesa shtesë në mënyrën e qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor.Karta Evropiane e të Drejtave të Pacientëve (2002), thotë

se duhet të ketë dispozita për nevojat e veçanta të grupeve vulnerabël, siç janë foshnjat, fëmijët, gratë shtatzëna, të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe. Përkundër kësaj, një rishikim sistematik për qasjen në kujdesin shëndetësor tregoi se "... njerëzit me paaftësi janë të kufizuar në qasjen në kujdesin shëndetësor dhe raportojnë më pak kënaqësi me kujdesin e tyre mjekësor" (Gibson, J., & O'Connor, R (2010) me probleme, duke përfshirë mungesën e transportit, mungesa e rampeve, trajnimet jo të përshtatshme të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, nevoja të cilat nuk kuptohen dhe ndjenja e prioritetit të ulët për shkak të kushteve ekzistuese. Pabarazi të tilla mund të shoqërohen më tej nga përjashtimi sistematik që njerëzit me aftësi ndryshe shpesh përballen, (Beresford, 1996, Beresford, P. (1996). Po ashtu, bazuar nëpërvoën e deritanishmej, persona me aftësi ndryshe përfitojnë nga skema mjekësore vetëm KEMPIN, por kjo nuk është e mjaftueshme për ti aftësuar ata që të përfitojnë të drejta në të njëjtën masë si personat e tjerë.

Shembull: Gjuha e shenjave në Gjykatën për të miturit jetimë me aftësi ndryshe

Në gjykatën shqiptare, ku gjykatësi jep vendimin për dhënien e një fëmije me aftësi ndryshenë kujdestari tënë një pale të tretë që strehon fëmijët e braktisur me aftësi ndryshe, merr parasysh raportin mjekësor të dhënë nga një psikiatër ose nga Komisioni i Shërbimeve Mjekësore, ka raste kur fëmija të jetë i shurdhër dhe memec. Për këtë nevojitet komunikuar me të në gjuhën e shenjave por ndodh të mos ofrohet ky shërbim. A mundemi atëherë të argumentojmë se dështimi i shërbimeve shëndetësore të financuara nga qeveria për të siguruar përkthyes të gjuhës së shenjave pengon aftësinë e tyre për të komunikuar dhe për të rritur rrezikun e diagnozës së gabuar dhe trajtimit joefektiv? Gjykata në këtë rast, duhet të mbajë parasyh që përkthyesit e gjuhës së shenjave janë të nevojshëm për komunikim efektiv në ofrimin e shërbimeve mjekësore. Dështimi për t'u siguruar atyre një përkthyes përbën një mohim të së drejtës për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë përpara ligjit.

Analiza: E drejta për qasje në kujdesin shëndetësor

Të gjithë fëmijët kanë të drejtën e shërbimeve bazë të kujdesit shëndetësor. Megjithatë, Kushtetuta e Shqipërisë duhet të përcaktojë qartë se çfarë përmban "ofrimi i shërbimeve shëndetësore "bazë". Për shkak të kësaj, krijuesit e politikave, krijuesit e ligjeve dhe ofruesit e shërbimeve shpesh nuk janë të qarta në

lidhje me shërbimet shëndetësore që duhet t'i ofrohen MJAN për të përmbushur këtë standard kushtetues në praktikë.

Problemi ngatërrohet më tej nga fakti se të drejtat e shëndetit të miturve janë shpërndarë nëpër një numër të ndryshëm të legjislacionit, duke çuar në fragmentimin dhe boshllëqe, si në formulimin e politikave dhe në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

3. ASISTENCË DHE MBËSHTETJE PËR TË MITURIT JETIMË ME AFTËSI NDRYSHE

MJANKanë të drejtën për të njëjtën kujdes dhe mbështetje si fëmijët e tjerë pa aftësi ndryshe, të cilat përfshijnë vëmendjen, kujdesin, stimulimin dhe mbështetjen nga një kujdestar social dhe ligjor. Përveç kësaj, ata mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë dhe akomodim të nevojave të tyre të veçanta. Psikologjikisht, suksesi i procesit të lidhjes lehtëson zhvillimin e identitetit dhe sigurisë. Megjithatë, MJAN mund të përballet me rrezikun e marrjes së mbështetjes jo të përshtatshme emocionale dhe sociale nga ata që i rrethojnë. (OBSH, 2012).

Disa nga kushtet shëndetësore, por edhe kufizimet e pjesëmarrjes mund të mbajnë një të mitur jetim për periudha të gjata në shtëpitë e kujdesit, duke rezultuar në më pak stimuj dhe mundësi zhvillimi. Përveç kësaj, ata mund të përballet me sfida të tjera, për shembull, pengesat ndaj qasjes fizike në shërbime, neglizhencës dhe qëndrimeve negative nga bashkëmoshatarët dhe të rriturit. Kjo e fundit mund të jetë e lidhur me keqinterpretime, mit, stigmën dhe besimet tradicionale që lidhen me aftësinë ndryshe. Këta faktorë kanë potencial për të çuar në rritjen e nivelit të stresit dhe vetëvlerësimin më të ulët të MJAN. (UNICEF, 2005, 2013).

Shembull – Vetë-vetëvlerësimi dhe Mbrojtja e të miturit jetim me aftësi ndryshe që shkon në shkollë.

Një MJAN që shkon në shkollë ka më shumë gjasa të ngacmohet dhe të provokohet, mund të ketë një numër të kufizuar shokësh dhe të përfshihet në më pak aktivitete jashtëshkollore sesa bashkëmoshatarët e tyre (REEPSI, 2009), të cilat ndikojnë në zhvillimin e tyre psikosocial. Përvoja e aftësisë ndryshe mund të çojë në imazhin negativ dhe vetëvlerësimin e ulët, ndjenjën se është më pak kompetent se të tjerët (Hills, 2007). Pa aftësia ka efekte se si një individ ka të bëjë

me botën dhe planet e ardhshme për karrierë, arsim dhe martesë. Fatkeqësisht, MJAN mund të përballet me përjashtimin social dhe të përjetojë stereotipe shoqërore negative. Duke iu referuar një rasti bazuar në përvojën time ndërsa punoj për personat me aftësi ndryshe rezultoi qënjë MJAN u përjashtua nga shkolla për shkak të refuzimit të shokëve. Prandaj, një MJAN mund të ketë vështirësi në vet-mbrojtje për shkak të aftësisë ndryshe dhe faktorëve të tjerë socialë dhe juridikë që nuk u mundësojnë atyre të vetë-ushtrojnë të drejtat e tyre.

Analiza: e drejta për qasje dhe pajtueshmëri për ndihmë dhe mbështetje

Në përgjithësi, “Asistenca dhe *mbështetja* “ referohet në këtë punim si një kategori e gjerë e cila përfshin edhe advokimin, mbështetjen e komunikimit dhe ndërhyrjet e tjera jo-terapeutike.

Si pjesë e së drejtës për barazi, Kushtetuta dhe Akti i Barazisë (Herr & Gostin, 2003) ndalojnë diskriminimin e padrejtë në bazë të aftësisë ndryshe. Kjo përfshin mohimin ose heqjen e çdo personi që ka aftësi ndryshe nga çdo institucion që i ndihmon ata të funksionojnë në shoqëri. Qeveria shqiptare nxorri Strategjinë Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar (2006), duke mbrojtur një qasje ndaj aftësisë ndryshe, e cila njih nevojën që personat me aftësi ndryshe të marrin pjesë në zhvillimet politike dhe legjislativë mbi çështjet që i prekin ato. Por ende, ka shumë për t'u bërë meqë është vërejtur:

- ***Mungesa ose pamjaftueshmëria e financimit*** - Qeveria nuk mbështet ose financon pjesërisht organizatat për personat me aftësi ndryshe (Lu, 2003). Në vend të kësaj, shërbimet mbështeten në tarifata e paguara nga familjet ose nga donacionet apo ndihmat ndërkombëtare (Laragy, 2002).
- ***Mungesa e burimeve njerëzore të përshtatshme*** - Ofruesit e kujdesit socio-shëndetsor luajnë një rol jetësor në sistemet e shërbimeve të bazuara në komunitet, por ka mungesë ose shkurtim të punonjësve të tillë për shkak të rrethanave ekonomike.
- ***Ndërgjegjësimi dhe qëndrimet*** - MJAN shpesh nuk kanë informacion rreth shërbimeve në dispozicion dhe bëhen më të prekshëm për shkak të qëndrimeve negative. Ndodh që MJAN nganjëherë i nënshtrohen mbajtjes arbitrare në institucionet e qëndrimit të gjatë pa të drejtë ankese, në kundërshtim me të drejtat e njeriut (Adams 2008 & Agnetti 2008).

PËRFUNDIME

Të miturit jetimë me aftësi ndryshe janë një nga grupet më të prekshme në shoqëri. Çështja e të drejtave të tyre për të pasur qasje dhe pajtueshmëri në shërbime nuk është vetëm një çështje sociale, por edhe e një drejtësie sociale. Nuk bazohet në bamirësi apo vullnet të mirë, por është një element integral i shprehjes dhe realizimit të të drejtave universale të njeriut. MJAN duhet të mbështetet tek të rriturit për ti mbrojtur dhe promovuar të drejtat e tyre dhe për ti ndihmuar ata kur të drejtat e tyre janë shkelur.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke u bazuar në dispozitat ekzistuese të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, hap një epokë të re në sigurimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi ndryshe. Së bashku me Axhendën e Mijëvjeçarit dhe iniciativat e tjera ndërkombëtare, këto standarde ndërkombëtare paraqesin themelin për çdo vend që përfshin Shqipërinë për të ndërmarrë një rishikim themelor të situatës së MJAN dhe për të ndërmarrë hapa specifikë për të promovuar përfshirjen e tyre në shoqëri dhe të drejtat e tyre. Ka shumë mënyra për ta bërë këtë pasi që asnjë rregull i vetëm nuk mund të aplikohet në të gjitha situatat. Përderisa ka arsye për optimizëm, ne jemi ende larg pamjes së të gjithë MJAN në Shqipëri apo në botë të gëzojnë qasje efektive dhe të barabartë në shërbimet themelore sociale dhe pjesëmarrjen kuptimplote në shoqëri.

Megjithatë, një vend i mirë për të filluar është metë tilla direktiva udhëzuese që hartojnë një përgjigje të përgjithshme. Sugjerohet që të gjithë ata që merren me këto çështje ta përdorin këtë dokument si pikënisje, duke krijuar një proces që do të inkurajojë të miturit me aftësi ndryshe që të kërkojnë kujdes duke maksimizuar konfidencialitetin dhe privatësinë e tyre. Prandaj, mund të konkludohet se MJAN mund të ketë mundësi të zotërojë të drejtën e qasjes dhe pajtueshmërisë për kujdes special, kujdes shëndetësor dhe asistencë nëse merren parasysh udhëzimet e sugjeruara:

1. E drejta për qasje dhe pëlqimin për kujdes të veçantë

- Mbyllja e Institucionalizmit dhe zëvendësimi me shtëpitë familjare për MJAN janë vendi i duhur i cili siguron një përgjigje globale ndaj nevojave të tyre të veçanta. Vendimarrja për kujdesin alternativ është në interesin më të lartë të fëmijës dhe duhet të bëhet përmes një procedure gjyqësore,

administrative, me mbrojtje ligjore së bashku me praninë e MJAN.

- Vendosja në një kujdes të veçantë duhet të bazohet në vlerësimin, planifikimin dhe rishikimin rigoroz, dhe duhet të kryhet rast pas rasti, nga profesionistë të kualifikuar në një ekip multidisiplinar.
- Shteti duhet të bëjë çdo përpjekje për të siguruar burime dhe kanale të përshatshme për trajnimin dhe njohjen e profesionistëve përgjegjës për përcaktimin e formës më të mirë të kujdesit.

2. E drejta për qasje dhe pajtueshmëri për kujdesin shëndetësor

- Qeveria ka për detyrë që të sigurojë që të gjitha ligjet, politikat dhe programet e saj të jenë në përputhje me dispozitat e interesave më të larta të MJAN. Ky standard njihet gjithashtu në të drejtën ndërkombëtare si provë që do të përdoret në të gjitha vendimet që prekin fëmijët. Shteti duhet të sigurojë që asnjë MJAN të mos i lihet qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Aty ku është e mundur, këto shërbime duhet të ofrohen pa pagesë duke marrë parasysh situatat socio-ekonomike.
- Zhvillimi i normave dhe standardeve kombëtare për ndërtimin e objekteve shëndetësore për të siguruar qasje pa pengesa;
- Skemat mjekësore duhet gjithashtu të jenë në dijeni të rregullave të cilat në mënyrë indirekte mund të ndikojnë tek të miturit me aftësi ndryshe.
- Komisioni Mjekësor që vlerëson kapacitetin e gjendjes mendore të personave me aftësi ndryshetw jetw njw Komision Psikologjik-Mjekësor-Pedagogjik që përbëhet nga një sërë profesionistësh për të ekzaminuar aspekte psiko-shëndetsore, për të identifikuar vonesat në zhvillim dhe të formulojë një plan të strukturuar për edukimin dhe rritjen e mëtejshëm të MJAN.

3. E drejta për qasje dhe pajtueshmëri për ndihmë dhe përkrahje

- Asnjë fëmijë nuk duhet të jetë pa mbështetjen dhe mbrojtjen e një kujdestari ligjor, të ndonjë personi tjetër kompetent ose të autorizuar publik të përgjegjshëm në çdo kohë. (UN, 2010)
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare duhet të ndiqet në linjat e vënies së tij në terma konkretë. Qeveria duhet të formojë një Këshill të Koordinuar për të mbikëqyrur realizimin e strategjisë dhe të rekomandojë miratimin e pro-

grameve se si ta zbatojnë atë.

- Shteti duhet të sigurojë forma financiare dhe forma të tjera të mbështetjes dhe asistencës drejt familjeve familjare të MJAN.
- Zhvillimi i programeve të trajnimit për kujdestarët dhe stafin profesional në përputhje me idetë e shprehura në Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe interesin e tyre më të lartë.

BIBLIOGRAFIA

- Active Citizenship Network, “The European Patients’ Rights Charter”, Brussel, 2002.
- Adams L. *The right to live in the community: making it happen for people with intellectual disabilities in Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Serbia and Kosovo*. Sarajevo, Disability Monitor Initiative for South East Europe, Handicap International Regional Office for South East Europe, 2008.
- Agnetti G. The consumer movement and compulsory treatment: a professional outlook. *International Journal of Mental Health*, 2008,37:33-45. doi:10.2753/IMH0020-7411370403
- Beresford, P. Poverty and Disabled People: Challenging dominant debates and policies. *Disability & Society*, 11, 553–568. doi:10.1080/09687599627598/Taylor & Francis Online, [Web of Science®]/(1996).
- Browne Kevin, “The risk of harm to young children in institutional care,” 2009, www.crin.org/en/docs/The_Risk_of_Harm.pdf (accessed April 30, 2016).
- Braddock D, Emerson E, Felce D, Stancliffe RJ. Living circumstances of children and adults with mental retardation or developmental disabilities in the United States, Canada, England and Wales, and Australia. *Mental Retardation and Developmental Disabilities Research Reviews*, 2001,7:115-121. doi:10.1002/mrdd.1016 PMID:11389566105.
- Braithwaite, J., & Mont, D. Disability and poverty: A survey of World Bank Poverty Assessments and implications. *ALTER, European Journal*

of Disability Research, 3, 219–232. doi:10.1016/j.alter.2008.10.002(2009).

- Brown H. *Safeguarding adults and children with disabilities against abuse*. Strasbourg, Council of Europe, 2002.
- Code of Penal Justice for Minors, Republic of Albania, 2017
- Costa M, “De-institutionalization and quality alternative care for children in Europe”: Lessons learned and the way forward. Eurochild Working Paper. 2006, http://www.eurochild.org/fileadmin/public/05_Library/Thematic_priorities/06_Children_in_Alternative_Care/Eurochild/DI_Lessons_Learned_web_use.pdf;
- FSHDPAK, «Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, FSHDPAK, Tirana, 2010b,
- Ginnerup S, “Achieving full participation through Universal Design.” Council of Europe Publishing, .2009, retrieved on September 2017
- Gibson, J., & O’Connor, R. Access to health care for disabled people: A systematic review. *Social Care and Neurodisability*, 1, 21–31. doi:10.1080/09687599627598/*Taylor & Francis Online*, (2010).
- Hills MD, The psychological and social impact of epilepsy. Department of Psychology, University of Waikato, Hamilton, New Zealand. *Neurology Asia*;2007
- Johnson R. et al, Young children in institutional care at risk of harm, Evidence from child development literature and neuroscience, 2006.
- Laragy C, “Individualised funding in disability services”. In: Eardley T, Bradbury B, eds. *Competing visions: refereed proceedings of the National Social Policy Conference 2001*. Sydney, Social Policy Research Center, University of New South Wales, 2002:263–278.
- Lu Y. *The limitations of NGOs: a preliminary study of non-governmental social welfare organisations in China*. London, Center for Civil Society, London School of Economics and Political Science, 2003 (CCS International Working Paper No. 13) (<http://www.lse.ac.uk/collections/CCS/pdf/IWP/IWP13LuYiyi.pdf>, accessed 25 November 2008).
- Mansell J. Deinstitutionalisation and community living: progress,

problems and priorities. *Journal of Intellectual & Developmental Disability*, 2006,31:65-76.

- doi:10.1080/13668250600686726 PMID:16782591
- Mansell J, Ericsson K, eds. *Deinstitutionalisation and community living: intellectual disability services in Britain, Scandinavia and the USA*. London, Chapman and Hall, 1996.
- Ministry of Labor, Social Affairs, and equal opportunities, “National Strategy on People with Disabilities”, (2006). Tirana, Albania
- Mulheir Georgette, “Deinstitutionalisation: a human rights priority for children with disabilities,” September 2012, http://www.equalrightstrust.org/ertdocumentbank/err9_mulheir.pdf (accessed April 30, 2016);
- Herr, S., L. Gostin, and H. Koh(eds), *The Human Rights of Persons with Intellectual Disabilities: Different but equal*, Oxford University Press, Oxford, 2003.
- United Nations, General Assembly, “Resolution adopted by the General Assembly”, 24 February 2010.
- REEPSI, “Psychosocial Support for Children with Disability and their Carers” Discussion paper. Health Economics and HIV/AIDS Research Division (HEARD) University of KwaZulu-Natal
- UNICEF, “Promoting the rights of children with disabilities,” UNICEF Innocenti Digest 13, New York, 2009.
- UNICEF, Young People with Disabilities Fact Sheet, May, 2013
- UN Guidelines for the Alternative Care of Children, June, 2009 http://www.eurochild.org/fileadmin/public/05_Library/Thematic_priorities/06_Children_in_Alternative_Care/Eurochild/DI_Lessons_Learned_web_use.pdf
- United Nations, Disability Fact Sheet, International Convention on the Rights of Persons with Disabilities, United Nations, New York, 2006.
- WHO, “Early childhood development and disability: discussion paper”. ISBN 978 92 4 150406 5, 2012

BURGU - RRUGA MË E LEHTË PËR KORREKTIMIN E TË MITURVE, POR ME REZULTATE AFATSHKURTRA

Msc. Valbona Omeri

valbonaomeri@gmail.com

ABSTRAKT

Në këtë punim synohet të silltet në mënyrë të sintetizuar ndikimi i edukimit tek të miturit, në tentativën e tyre drejt devijancës. Përballë efektit negativ, që prodhon mungesa e edukimit, qëndron mënyra se si e ofrojnë atë institucionet edukuese dhe arsimore. Burokracia është një element që i vë këto institucione përballë sfidave. Risocializimi i fëmijëve që vuajnë dënim në izolim, është sfidë tjetër, me të cilën përballen organet edukuese, qofshin ato izoluese apo jo. Gjithashtu një analizë e thelluar e shkaqeve, nëse aplikohet, është mjeti që mund të japë zgjidhje për fenomenin e kriminalitetit ndër të mitur dhe gjithashtu ndihmon për të nxjerrë në dritë alternativat e dënimit. Ekonomia dhe shtresëzimi klasor janë faktorë të dukshëm dhe nuk paraqesin vështirësi në përcaktimin e “fajit të shoqërisë”, por, nëse e lëmë vetëm me kaq, nuk arrihet kurrkund. Duke rënë në “kthetrat” e klisheve, rrezikojmë të hulumtojmë atje ku nuk duhet. Një i mitur nuk devijon vetëm se është i varfër. Devijanca ka shumë arsye dhe kjo ka veprim të dyanshëm, d.m.th. lehtëson dhe vështirëson gjetjen e alternativave të aplikueshme si “mjekim”. Në fund mund të themi se nuk duhet të synohet edukimi me frikën nga burgosja, por me frikën nga devijanca, kjo vështirësisht e arritshme, pasi kërkon metoda edukimi që në shoqërinë tonë aplikohen si dogma dhe bëjnë të vdesin sapo i mituri del në rrugë.

Fjalë kyçe: *I mitur, shtresëzim, devijancë, burgosje, risocializim.*

HYRJE

Në përkufizimin e tij për risocializimin, Goffman e përshkroi atë si një proces, ku roli i individit dhe kuptimi për veten rindërtohen në çdo rast. Është ky një proces social, intens dhe i paramenduar, i cili na jep nocionin e rolit si një diçka që mund të mësohet dhe të çmësohet. Pra, risocializimi mund të thuhet se është një proces që synon të mësojë tek individit vlera të reja, sjellje, qëndrime, aftësi, të cilat janë në pajtim me normat dominante të shoqërisë (Crossman, A. 2016).

Risocializimi ka dy faza, që duhen konsideruar, thotë Crossman, (2016). Njëra paraqet stafin e një institucioni, të cilët synojnë të thyejnë apo të shkatërrojnë identitetin dhe pavarësinë e personit të izoluar. Prerja e flokëve, dorëzimi i sendeve personale, veshja standarde etj. Faza e dytë e risocializimit është synimi për të krijuar një sens të ri për veten tek të burgosurit. Një sistem ndëshkim-shpërblim është i duhuri në realizimin e këtij synimi.

Në fund, thotë Crossman, arrihet të përftohet një gjendje konformizmi, ndryshim i sjelljes në përputhshmëri me pritshmëritë që ka autoriteti (Po aty). Kjo mund të ndodhë dhe në marrëdhënie ndërmjet grupeve. Pra, grupe individësh më të dobët konformohen sipas pritshmërive të më të fortëve. Kjo sjellje e mësuar në burgje mund të vazhdojë dhe jashtë, por mund edhe të çmësohet. Përsëri sistemi i shpërblimit do të funksiononte. Përfshihen në këtë sistem puna, shkollimi, përkrahja, aktivizimi etj.

Përse shkon drejt krimi?

Save the children në vitin 2015 udhëhoqi një studim: “*Të miturit në kontakt me ligjin dhe efektet e zbatimit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit*”, në të cilin midis të tjerash u arrit në konkluzionin: “Të miturit ose të rinjtë që përfshihen në situata konfliktuese më të rënda, si vepra ose kundërvajtje penale, vijnë kryesisht nga shtresa të marginalizuara shoqërore, nga grupe të varfra ose dhe nga familje me status socio-ekonomik më të ulët në krahasim me të tjerët që morën pjesë në studim”. Në burgun e të miturve, krimi kryesor, për të cilin mbahen të dënuar, është “vjedhja”. Të dënuar për vjedhje, ata nxjerrin si shkak mospasjen e mundësive ekonomike. Dyzohen midis shkakut që solli veprimin dhe justifikimit për një veprim të tillë. Nuk e justifikojnë në parim si veprim, por fakti që e kanë kryer për të disatën herë radhazi nxjerr fitues shkakun.

Sipas Dierkhising et al., (2013); Fox et al., (2014); Loeber & Farrington, (2000), një nga gjetjet më domethënëse dhe të përsëritura në literaturë është se SVC-të (serious, violent, chronic juvenile offenders), janë viktima të traumës, abuzimit, neglizhimit dhe keqtrajtimit gjatë fëmijërisë, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë jo devijante. Studimet në shoqërinë amerikane sipas Dierkhising et al., (2013) tregojnë se 90% e të rinjve në Shtetet e Bashkuara përjetojnë një ngjarje traumatike në fëmijëri, dhe deri në 30% të të rinjve amerikanë të përfshirë në konflikt me drejtësinë në të vërtetë përmbushin kriteret për t'u përcaktuar si persona me çrregullime të stresit post-traumatik (Fox, B. H., et al., 2015). Dodge, Bates, & Pettit, (1990); Maxfield & Widom, (1996); Widom, (1989), tregojnë se individët që janë keqtrajtuar ose lënë pas dore gjatë fëmijërisë janë shumë më të prirur për të kryer një veprim të dhunshëm sesa ata që nuk kanë përjetuar abuzim dhe neglizhencë (po aty).

Ndryshe nga shoqëria amerikane, në shoqërinë tone dhuna ndaj fëmijës ka qenë deri diku e "legjitime" nga shoqëria dhe e "paprekshme" nga ligji. Nuk ka pasur deri vonë në këtë shoqëri dyshim apo bindje që një fëmijë i dhunuar nga prindi, bëhet "dajaku" i shoqërisë. Por nëse do ti hyjmë më thellë fenomenit, do shohim se një individ i dhunuar në fëmijëri, vërtet nuk mund të jetë kthyer në kriminel, ai vetë, por pasardhësit e tij padyshim që do të ndienin trysninë e një dhune të fshehur. Pra, dhuna e ushtruar mund ti kapërcejë brezat, por efektin e ka njësoj të rrezikshëm.

Dejong (1997), sugjeron se vetëm disa grupe/klasa dhunuesish të rendit mund të jenë të frenueshëm, p.sh., ata që kanë lidhje të forta me shoqërinë dhe rreziku që gjeneron nga vepra e tyre është i ulët (shih: Handbook of Basic Principles and Promising Practices on Alternatives to Imprisonment, New York, 2007). Në këtë kontekst, të miturit pikërisht në moshën që forcojnë lidhjet shkëputen nga grupi shoqëror forcërisht duke e futur në një tjetër që me gjasë nuk e ndikon pozitivisht. Ky fëmijë merret nga mjedisi i tij, të cilin për hir të së vërtetës e ka "dhunuar", dhe futet në një mjedis të ri edukues, por që nuk garanton mospërsëritjen dhe si rrjedhim uljen e rrezikut të veprave që fëmija mund të kryejë në vazhdim.

Sipas Hirsch (1969), parimi ynë i përgjithshëm organizues konsiston në rritjen e probabilitetit për deviance kur lidhjet e një individit me shoqërinë janë të dobëta ose të këputura. Me fjalë të tjera, kur fjet që e lidhin një individ me institucio-

ne sociale kyçe janë këputur, rreziku për krim rritet. Ndryshe nga sanksionet formale, të cilat rrjedhin nga përpjekje të qëllimshme për të kontrolluar krimin, thotë Kornhauser, (1978), kontrolli social informal vjen si nënprodukt I marrëdhënies së roleve të vendosura për të tjera qëllime dhe janë pjesë përbërëse e reciprocitetit të roleve (Sampson, Laub, 1994).

Shkolla

Shkollimi është një rrugë e prerë në mes dhe arsyt apo fajtorët për këtë zor se emërohen, një për një. Shkollimi i vazhduar tashmë në mjedise burgu sigurisht nuk vjen si diçka natyrale tek ata. Shkollat e mendimit sociologjik shprehen në kundërvënien të njëra-tjetrës në fakt. Shkolla funksionaliste sheh si rrugë kryesore ngjitëse në mobilitetin social edukimin formal, e parë kjo dhe si një ekuilibër në terrenin e pabarabartë social. I kundërvihet të parës strukturalizmi i Bourdieu dhe Passeron, (1977) me teorinë e tyre të riprodhimit kulturor, teori që sjell në vëmendjen tonë faktin, sipas tyre, sipas të cilit shkolla dhe institucionet e tjera sociale ndihmojnë në ngurtësimin e pabarazive sociale dhe ekonomike. (shih: Zenelaga, B., Cenaj, E., 2012).

Adler shprehet kundër besimit në kufizimet e trashëgimisë së zhvillimit. “Nëse mësuesit janë vërtetë të përkushtuar ndaj idesë se i tërë zhvillimi i karakterit dhe i inteligjencës i përket trashëgimisë, do të shohim se ata s’do të mund të shpresojnë të përmbushin ndonjë gjë nga qëllimet e profesionit të tyre” (Adler, A., 2003).

Për sa i takon edukimit në kuadrin e shkollës, mund të thuhet se “prodhon” krimin, nga njëra anë, dhe e lufton atë, nga ana tjetër. Tompson dhe Binam kanë hulumtuar mbi krimin e gjeneruar në shkollë, bazuar dhe mbi studime të shumta të kryer nga të tjerë socio-psikologë. Një formë e krimit që buron direkt nga shkolla, citojnë ata Bejkerin dhe Reid, është ikja nga orët e mësimit. Nisur nga kjo, ata pohojnë se të rinjtë që braktisin orët e mësimit kanë probabilitet të lartë të prirjen drejt alkoolit dhe drogës. Gjasat më të mëdha i kanë fëmijët që kanë problem në shkollë. Shkolla në këtë rast vepron si një kontrollor që tek këta nxënës shkakton frustracion. Në këtë rast kemi një veprim indirekt të shkollës. Pra, nuk ka asnjë gjasë të zbutjes së fenomenit.

Glaser e trajton problemin në kahun tjetër. Ai i referohet zgjedhjes së nxënësit, e cila konsiston ose në kthimin në shkollë ose në luftën me të. I referohemi

përsëri Mertonit këtu duke kujtuar argumentimin e tij se personat e frustruar janë ata të cilët nuk mund të realizojnë qëllimet e paracaktuara nga kultura dhe janë këta persona që shpesh zhvillojnë strategji të devijimit duke iu përshtatur situatës (shih: Tompson, W., Binam, J., 2014). Format e ashpra të edukimit, mungesa e fleksibilitetit në komunikim, zbatimi me “përpikmëri” i protokollit të komunikimit në procesin e edukimit shkaktajnë frustracion dhe çojnë në delinkuencë.

Polk, (1975; 1984), prezanton si një nga elementet më të rëndësishëm në parandalimin dhe kontrollin e delinkuencës, shkollën. Argumenti i tij fokusohet në faktin se rritja në numër e njerëzve të rinj të marginalizuar vjen jo vetëm si shkak i mospërshtatjes së tyre në shkollë, por dhe pse ambiciet e tyre për karrierë në të ardhmen si rezultat i këtij mospërshtatjes, reduktohen, kufizohen dhe pse jo, zhduken (Tompson, Binam, 2014). Shumë autorë bien në në të njëjtin mendim që shkollat duhet të jenë efektive, produktive në termat e njerëzve profesionistë apo që aspirojnë profesione dhe nisur nga këto, duhet të marrin në dorë rolin e parandalueses së delinkuencës (po aty).

Kemi një situatë ku mund të ushtrojmë një kontroll të moderuar, të jemi fleksibël, të krijojmë kushte për një akomodim të rinjve në shoqëri, që t’u japë atyre siguri dhe konformitet, por në realitet shpeshherë me pushtetin e të rriturit dhe “të diturit” e shkatërrojmë këtë duke i shtyrë në devijancë. Do të ishte e pandershme nga ana jonë të refuzonim përgjegjësitë. Gjithashtu është fakt se, ndërsa këta të rinj rendin drejt krimin, në këtë mënyrë përfundojnë përsëri në “kthetrat” e edukimit, por që aplikohet ndryshe tashmë. Edukimi pas hekurave nuk është i detyrueshëm, por kushtet ku jeton tashmë individit që ka kryer krim, janë detyruese në shumë mënyra.

Në fakt, nuk mund të thuhet se sistemi arsimor krijon delinkuencën, pasi burimet e saj janë në shoqëri, por ai mund të ndikojë si përkeqësues i situatës apo zvogëlues i dëmit. Mënyrat e aplikuara të mësimdhënies vërtet janë të prirura drejt modernizimit dhe përshtatjes së tyre me botën jashtë kufijve tanë, por specifikat e çdo shoqërie kërkojnë përjashtime. Shkollat janë arena të socializimit. Nëse ato dështojnë, në shumë raste rekuperimin e merr përsipër sistemi penitenciar dhe kjo nuk kalon më nëpër të njëjtat shtigje. Nga ana tjetër, nëse do të krijoheshin hapësira për aplikime alternative të ndëshkimeve, “shkollat e riedukimit” mbase janë një zgjidhje shumë më e butë për të rinjtë e adoleshentët e burgosur.

Hygo argumentonte se legjislacioni penal nuk bën gjë tjetër, veçse mbush boshllëqet e atij të punës dhe të edukimit; prej këndej del se ky legjislacion është i mirë për aq sa përmban dy të tjerët. Penaliteti duhet të përbëhet nga edukimi dhe puna (Hygo, V., 2002).

Frika nga burgu

Sipas Nagin (1998), i cili i referohet literaturës që trajton parandalimin e burgimit, në përgjithësi vihet re se ajo është bindëse, por përsëri është dëshpërues fakti që, nëse shkalla e burgosjes vazhdon të rritet, burgjet do të shihen si më pak stigmatizuese dhe do të neutralizojnë çdo efekt të mundshëm të parandalimit (Handbook of Basic Principles and Promising Practices on Alternatives to Imprisonment, New York, 2007).

Natyrisht nëse aplikohet një ndërhyrje që konsiderohet e efektshme, mund të ketë përfitime të mundshme nga rehabilitimi i të miturve në konflikt me ligjin. Gjithsesi, për studiuesit mbetet e diskutueshme çështja që dallon efektivitetin e ndërhyrjes në rastet në përgjithësi apo ndërhyrjes në rastet specifike. Ata deklarojnë se rezultatet nuk kanë qenë bindëse dhe pse kërkimet dhe hulumtimet kanë zgjatuar dekada (Lipsey, 1992). Po ashtu Lipsey në metaanalizën e tij duke iu referuar studimeve e hulumtimeve të tjera na prezanton pohimin e nxjerrë nga autorë si Lipton, Martinson dhe Wilks. Këta autorë, pasi ekzaminuan në mënyrë të detajuar 231 studime të veçanta në të cilat përfshiheshin ndërhyrjet si për të rriturit ashtu dhe për të miturit dolën në një përfundim, gjerësisht të cituar, i cili prezanton faktin se me disa përjashtime të izoluara, përpjekjet rehabilituese që janë raportuar deri tani nuk kanë pasur efekte të dukshme tek recidivizmin (1974). Po ashtu autori i referohet dhe Greenberg (1977), i cili ka përditësuar Lipton e të tjerët dhe thekson se, pohimi i përgjithshëm që “asgjë nuk funksionon” është një ekzagjerim, por jo shumë (Lipsey, 1992).

Liria

I vetmi dënim alternativ që përfitohet nga të miturit është “lirimi me kusht”. Po në rast se kjo refuzohet? Çfarë mund të ndodhë kur një personi i refuzohet liria me kusht apo pezullimi i dënimit, dhe pse ai është brenda kushteve për ta përfituar atë? I përfshirë në masën që popullon burgun, ai bind veten se i përket asaj kulture tashmë. Fromm e konsideron këtë “fshehje”, të cilën e bëjmë më mirë në masën e kulturës sonë. Këta persona konsiderohen si “kameleonë

shoqërorë”, pikërisht sepse i nënshtrohen konformitetit automat. Ata marrin ngjyrën e mjedisit ku gjallojnë dhe përshtaten e brendësojnë mënyrat e grupit (shih: Boeree, G., C., 2004). Fromm ka folur për “izolim dhe ndjenjë e pafuqisë” që kthehet në neurozë. Vetmia, frika dhe tronditja mbeten; njerëzit nuk mund ta përballojnë pafundësisht. Individu i Frommpërmes përpjekjeve për t’i shpëtuar vetmisë dhe pafuqisë, shkon drejt shkatërrimit të unit të tij. Këtë e bën midis të tjerash dhe përmes konformizmit obsesiv ndaj modeleve ekzistuese.

I ndikuar nga Mead, George Kelly, (1955), sjell interpretimin e procesit strukturë të “tjetrit”, duke na treguar se dy persona, dhe pse aspak të ngjashëm, mund të lidhen. Në fakt “mund të interpretojnë siç interpreton tjetri”, “të hyjnë brenda mendimit të tij”, me një fjalë të lënë mënjanë një pjesë të vetes për të qenë “dikush tjetër” (shih: Boeree, G., C., 2004). E kalojmë këtë përfytyrim mbi individë të izoluar e për më tepër fëmijë. Burgjet kanë treguar se janë jo pak herë arena të shkëmbimit të roleve. Kelly e ka shpjeguar këtë me konkluzionin e copëzimit (po aty). Rolet nuk përputhen me rrethanat. Një individ që ka kryer një krim, serioziteti i të cilit konsiderohet i ulët, i gjendur në grupe individësh, ku udhëheqin kriminelë të mirëfilltë, ka gjasa të pëlqejë atë rol dhe nuk jepen më garanci, kur ai del nga burgu. Nuk mund të mohohet fakti që në mjaft raste, në emër të riintegritimit, ne i bëjmë një rifreskim kriminalitetit.

KONKLUZIONE

Duke analizuar teoritë e shumta sociologjike, Giddens thekson se asnjëra nuk jep një shpjegim të qartë, nëse sjellja kriminale është reagim apo veprim i mirë-logarit. Në fakt më shumë përipiqen ta konsiderojnë kriminalitetin si reagim, si rezultat i ndikimeve të jashtme, ndërkohë që mund të jetë një sjellje, ku individ është përfshirë qëllimisht për përfitime dhe ka synime të mirëpërcaktuara. Në lidhje me të miturit, shumëkush do mendonte që veprimet kriminale nuk janë të paramenduara. Kjo do tëvinte në punë një makineri arsytimi, e cila mbase nuk do kishte efektin e dëshiruar.

Faktorët që e çojnë një të mitur drejt rrugës së krimit, janë kaq kompleksë dhe i përcjellin tek njëri-tjetri efektet. Faktori familje përcjell efektin status socio-ekonomik, i cili kundërshton pranimin nga të tjerët, përfitimin dhe shkollimin tek fëmija. Ky i fundit gjendet para sfidës së përfitimit të asaj që “i ta-

kon".Në mes këtyre përplasjeve ai zgjedh rrugën e shkurtër për të arritur çfarë ai mendon se i mungon, zgjedh të marrë me forcë, zgjedh të kryejë krim. Nuk është krejt i pamenduar veprimi kriminal i tyre. Ai përdor logjikën e rrugës së shkurtër, sepse kështu ia diktojnë kushtet, por dhe sepse mendja apo ndërgjegjja e tij është e parrahur me "ç'ndodh më pas".

Kur përsërit, themi se veprimi është i ndërgjegjshëm dhe sfida e të rriturve merr tjetër rëndësi dhe shkallë vështirësie. Nëse burgu nuk do t'i trembë më, fenomeni i recidivizmit do të vazhdojë. Nga ana tjetër, duke qenë recidivistë, ata humbin përgjithmonë të drejtën e zbatimit për dënim alternativ dhe do të humbin shansin të përfitojnë nga kjo procedurë ndëshkuese me dorë të butë. Kjo dalëngadalë do të krijojë bindjen tek ata se i përkasin një kontigjenti dhe që tashmë e kanë të përcaktuar rrugën e tyre. Që të gjithë bien në një mendje kur thonë që statusi socio-ekonomik është në bazë të një shumice krimesh dhe mbështetja psiko-sociale, punësimi, përpjekjet reale për riintegrim janë leva, të cilat ndihmojnë në çrrënjosjen e fenomenit të recidivizmit.Gjithashtu, burgu vërtet është një mjedis që tek të miturit mundohen ta sjellin në termat e një mjedisit edukues, por ndryshimi është vetëm në termat gjeografikë, personat, me të cilët ai shoqërohet në burg, janë të dënuar rishtas apo përsëritës.

Merret si i mirëqenë fakti që një fëmijë me një prejardhje të ulët socio-ekonomike nuk mund të shkollohet dhe krimi që këta fëmijë kryejnë, vjen si rezultat i kësaj. Aplikohet politika e shkollimit, vetëm kur këta fëmijë apo adoleshentë janë në burg dhe lihen në harresë, kur janë jashtë në shoqëri. Për këtë fakt ata rrezikojnë të mbeten gjithmonë në pritje të korrektimit, të përjashtuar nga grupet, ku duan të integrohen.Ky perceptim është rezultat i politikës në përgjithësi dhe i një realiteti social të polarizuar.

BIBLIOGRAFI

1. Adler, Alfred, (2003), Ç'kuptim mund të ketë jeta, (f. 133-134),Tiranë, Shtëpia Botuese "Plejad"
2. Balili-Mandro, A., Xhaferllari, M., Hoxha, G., Belishta, A., (2010), *Manuali për zbatimin e metodave të dënimit me burgim*, Tiranë, Shtëpia Botuese "Pegi"

3. Boeree, George, (2004), *Teoritë e personalitetit*, Tiranë Shtëpia Botuese “Plejad”,
4. Crossman, Ashley, (2016), *Understanding Resocialization in Sociology*, <https://www.thoughtco.com/resocialization-3026522>
5. Fox, B. H., Perez, N., Cass, E., Baglivio, T., M., Epps, N., (2015), *Trauma changes everything: Examining the relationship between adverse childhood experiences and serious, violent and chronic juvenile offenders*, *Child Abuse & Neglect*, Florida, USA
6. Fromm, Erich, (2011), *Arratisje nga liria*, Tiranë, Shtëpia Botuese “Plejad”
7. Giddens, Anthony, (2002), *Sociologjia*, Tiranë Shtëpia Botuese “Çabej”
8. Handbook of Basic Principles and Promising Practices on Alternatives to Imprisonment, (2007), New York, United Nations Publication.
9. Hygo, Viktor, (2002), *Klod Fukarai, shkrime rreth dënimit me vdekje*, (f. 113-114), Tiranë, Shtëpia Botuese “Sokol”
10. Lipsey, W., M., (1992), *Meta-Analysis for Explanation: Juvenile Delinquency Treatment: A Meta-Analytic Inquiry into the Variability of Effects*, (f. 83-85), New York, Russell Sage Foundation
11. Sampson, J., R., Laub, H., J., (Apr., 1994), *Urban Poverty and the family Context of Delinquency: A New Look at Structure and Process in a Classic Study*, *Child Development*, Vol. 65, No. 2, Children and Poverty, f. 523-540
12. Tompson, William; Binam, Xhek, (2014), *Delinkuenca e të Miturve. Qasja Sociologjike*, Shkup, Shtëpia Botuese Ars Lamina
13. Zenelaga, Brunilda; Cenaj, Enkelejda, (2012), *Manual për kursin Sociologji Edukimi*, (f. 127-129), Tiranë, “Mirgeeralb”
14. Zenelaga, B., Kadaifçiu, O., Agolli, I., (2015), *Të miturit në kontakt me ligjin dhe efektet e zbatimit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit*, Tiranë, Save the children

TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE SIGURIA E TYRE NË INTERNET.

MSc. Marsi Abdi

marsiabdi1994@gmail.com

ABSTRAKT

Ndërsa gjithnjë e më shumë kërkues nga e gjithë bota po interesohen për mënyrën se si fëmijët e përdorin internetin dhe teknologjitë celulare, dëshmitë globale për mundësitë që sjell interneti, por edhe rreziqet që i shoqërojnë këto mundësi po rriten. Pavarësisht përmirësimeve të sigurisë që ka kryer vetë interneti, siguria në internet e fëmijëve mbetet një sfidë e cila nuk duhet të bazohet vetëm në sigurinë e web-it, por edhe në legjislacionet e çdo vendi.

Ndërkohë që bota po zhvillon shumë mënyra për mbrojtjen e fëmijëve nga bullizmi kibernetik dhe nga ekspozimi ndaj materialeve të papërshtatshme, Shqipëria po mbetet shumë pas. Siguria mungon madje dhe në institucionet e edukimit si shkollat, ku laboratorët e informatikës nuk kanë asnjë lloj filtri që të pengojnë fëmijët që të aksesojnë materiale të ndaluara. Gjithashtu, vlen të theksohet se interneti është bërë shumë herë në botë arsyeja pas vetëvrasjes apo problemeve psikologjike të fëmijëve ndaj siguria në internet është një çështje ligjore dhe sociale.

Për të trajtuar këtë çështje, ky dokument synon:

1. të sigurojë një pasqyrë të sigurisë ekzistuese në internet në lidhje me të miturit
2. të identifikojë rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët dhe
3. të rekomandojë përmirësime në politika administrative dhe legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të miturve nga rreziqet e internetit.

Në këtë punim do trajtojmë legjislacionin shqiptar por do i referohemi praktikave europiane për sigurinë e të miturve në internet.

Fjalë kyçe: *Të miturit, Interneti, Bullizmi kibernetik, Siguria, Politikat administrative*

HYRJE

Pothuajse të gjithë fëmijët tani kanë akses në internet. Interneti u siguron fëmijëve akses në sasi të mëdha informacioni dhe përmban burime të pafundme argëtimi për ta. Megjithatë, ai gjithashtu i ekspozon fëmijët ndaj rreziqeve të caktuara. Për shembull, fëmijët mund të kenë kontakt me informacione me notacione raciste, të dhunshme, me urrejtje ose informacione të rreme. Ata gjithashtu mund të shikojnë faqe pornografike apo email-e në formën e spam²⁷⁴-eve që përmbajnë materiale të pahijshme, skedar të papërshtatshëm dhe lloje të tjera të materialeve potencialisht të papërshtatshme përnjë fëmijë. Më shqetësuese, fëmijët mund të ndeshen me grabitqarët aktualë që përdorin internetin për të identifikuar dhe joshur viktimat përmes chatroom²⁷⁵-eve dhe faqeve të rrjeteve sociale.

Si rezultat i efekteve negative që mund të ketë interneti, disa prindër mund t'i eliminojnë këto rreziqe duke ua ndaluar fëmijëve të tyre të përdorin internetin. Megjithatë, ky vendim do t'i privonte fëmijët nga aksesimi në një burim të mahnitshëm për informacion dhe komunikim. Përveç kësaj, fëmijët dhe adoleshentët mund të anashkalojnë ndalimin e prindërve të tyre duke aksesuar materialet në internet në institucionet publike me qasje në internet siç janë shkollat ose duke përdorur pajisje mobile. Për këto arsye, është e rëndësishme që prindërit, sistemi i edukimit dhe shteti të krijojnë një ekuilibër midis përfitimeve dhe rreziqeve që interneti u paraqet fëmijëve dhe të përcaktojnë filtrat përkatës.

Fëmijët e sotëm rriten me akses në kompjuter dhe jo vetëm në kompjutera të parvarur, por kompjutera në njerrjet me pjesën tjetër të botës nëpërmjet internetit. Shumë prej tyre duan të eksplorojnë dhe të eksperimentojnë, siç bëjnë gjithmonë fëmijët. Për fat të keq, eksplorimi mund t'i çojë ata në hapësira virtuale që janë ligjërish jashtë kufijve dhe i kthejnë ata në kriminelë (ose delikuent të mitur) edhe pa vetëdijen e tyre. Të paturit miq që angazhohen në cybercrime, është një nga përcaktuesit më të mëdhenj të faktit nëse të miturit kryejnë cybercrime, sipas një studimi nga tre universitete amerikane.²⁷⁶

274 Email i padëshiruar që dërgohet në mënyre automatike

275 Një zonë në internet ose rrjet tjetër kompjuterik ku përdoruesit mund të komunikojnë, zakonisht për një temë të veçantë.

276 (Atwal, 2011) Universitetin Shtetëror të Miçiganit, Universitetin Jugor të Gjeorgjisë dhe Universitetin Lindja Kentucky

KRIMET KIBERNETIKE

Sistemi i drejtësisë për të mitur

Trajtimi i të rinjve që shkelin ligjin ndryshon nga një shtet në tjetrin, dhe kështu përcaktohet se kush është “i mitur” sipas legjislacionit të çdo vendi. Në Shqipëri një i mitur është dikush që është të paktën 14 vjeç, por nën 18 vjeç në kohën kur ai / ajo ka kryer një veprim të paligjshëm. “Moshë minimale e përgjegjësisë penale” është mosha 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe mosha 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal.²⁷⁷ Veprimet që mund të kryejnë fëmijët janë dy lloje . E para është “sjellja delikuede”, sjellje që nëse do e kryente një i rritur do rezultonte në burgim dhe “kundravajtje” dhe e dyta është një sjellje që nëse do e kryente një i rritur do të rezultonte në gjobë apo shërbim komunitar. Vetëm 44% e fëmijëve marrin informacion për sigurinë në internet nga prindërit ose nga degët e ndryshme për raportimin në internet të incidenteve.²⁷⁸

Krimet kibernetike më të shpeshta tek të miturit

Përveç bullizmit kibernetik, një nga veprat më të zakonshme online të kryera nga të miturit është “pirateria dixhitale” – shpërndarja dhe / ose shkarkimi i software-it, muzikës dhe filmave pa lejen embajtësit të së drejtës së autorit. Fëmijët që kurrë nuk do të vidhnin nga një dyqan CD/DVD, mund të “vjedhin” mijëra këngë pa u lodhur.

Natyra e paprekshme e “mallrave” dixhitale është e ndryshme nga ajo e mallrave të prekshme. Tradicionalisht, krimi i vjedhjes përfshin “posedimin në mënyrë të paligjshme të një prone pa pëlqimin e pronarit, me qëllim privimin e pronarit nga përdorimi i pronës”. Një tjetër krim kibernetik për të mitur është shikimi ose shkëmbimi i materialeve pornografike. Aksesi i paautorizuar është një tjetër nga krimet kibernetike më të zakonshme të të miturve. Hakeri stereotipik është një adoleshent i ri, i cili thyen sisteme të largëta jo për qëllime vjedhjeje dhe përdorimi të informacionit, dhe shpesh as për qëllimin e krijimit të kërcënimeve, por thjesht për të provuar veten dhe të tjerët se ai ka aftësitë për ta bërë atë. Në disa raste, megjithatë, ky adoleshent mund të ndiqet sipas të njëjtit ligj (dhe dënohet

277 (KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT, 2017) neni 3/11

278 (A Study on Child Online Safety in Albania)

me të njëjtat dënime) si një terrorist që hyn në sistem për të prishur komunikimet jetësore me qëllim që të shkaktojë lëndime serioze dhe vdekje.

Një çështje delikate është tema e vetë-inkriminimit.²⁷⁹ Në rastin e të miturve, rastet e Gjykatës Supreme kanë konstatuar se të miturit kanë disa, por jo të gjitha, të drejta kushtetuese si të rriturit. Të miturit nën 14 vjeç mund të heqin dorë nga e drejta e tyre e vetë-deklarimit, vetëm nëse është prezent një prind, kujdestar ose avokat.

Raportimet e fëmijëve në Shqipëri

Fëmijët në Shqipëri si në gjithë botën janë të ekspozuar ndaj shumë rreziqeve online. Gjatë 2016 në një raport janë publikuar arsyet pse fëmijët raportonin problematika të sigurisë online ishin si më poshtë:

- Materialet me përmbajtje të papërshtatshme dhe me përmbajtje pornografike
- Format e ndryshme të abuzimit psikologjik gjatë aktivitetit online të fëmijëve (Cyberbullying)
- Lojrat Online - Viruset dhe spam-et
- Njohjet me njerëzit e panjohur
- Shtytja e fëmijës për të kryer marrëdhënie seksuale (Grooming)

Këto problematika ishin si në raport me fëmijët e tjerë ashtu edhe midis fëmijëve.

Ligjet ndërkombëtare

Për të parë ligjet ndërkombëtare do bazohemi fillimisht në publikimet e Komisionit Europian. BE nuk bën dallim në përcaktimin e një vepre në kontekstin e teknologjisë. Pra kërcënimi është kërcënim si verbalisht ashtu edhe elektronikisht, si offline edhe online, legjislacioni mbetet njësoj. Për sa i përket përmbajtjes së paligjshme dhe të dëmshme, është thelbësore që të bëjmë një dallim mes përmbajtjes e cila është e paligjshme dhe përmbajtjes së dëmshme. Këto kategori të ndryshme të përmbajtjes paraqesin çështje rrënjësisht të ndryshme në parim dhe kërkojnë legjislacion dhe përshtatje teknologjike të ndryshme. Prioritetet duhet të vendosen në mënyrë të qartë dhe burimet duhet të mobilizohen për të trajtuar çështjet më të rëndësishme, që është lufta kundër përmbajtjeve

279 Vetë-inkriminimi është akti i ekspozimit (në përgjithësi, duke dhënë një deklaratë) "për një akuzë për krime, për të perfshirjen e vetes ose të një personi tjetër në një ndjekje penale"

të tilla si pornografia e fëmijëve, ose përdorimi i internetit si një teknologji e re për kriminelët.²⁸⁰

Është shumë e vështirë për agjensitë e zbatimit të ligjit të kryejnë kontrole efektive për zbulimin e përmbytjeve të paligjshme në kohë pasi kjo nënkupton që ato duhet të aksesojnë serverat në një shtresë rrjeti para publikimit të tyre. Është gjithashtu e vështirë që t'ia kalosh përgjegjësinë ISP-ve që nuk kanë kontrolluar direkt ofruesin e përmbytjes. Po si i trajtojnë shtete të ndryshme përmbytjet e paligjshme në internet?

Suedia, sipas Kodit të saj Penal, ia cakton përgjegjësinë e përmbytjen online çdo operatori që vepron në internet dhe ka të drejtën t'i detyrojë ata që ta heqin një përmbytje të paligjshme. Lituania dhe Polonia kërkojnë që autoritet gjyqësore dhe policia të informohen për përmbytjen e paligjshme (pa specifikuar individ, shtet apo agjensitë private). Në Luksemburg dhe Islandë, nga praktika dhe jo nga ligji, operatorët duhet të heqin përmbytjen e paligjshme nëse e zbulojnë atë. Greqia dhe Franca detyrojnë ISP-të të mbajnë të dhëna për të ndihmuar agjensitë e zbatimit të ligjeve. Shtetet e tjera si Hungaria, Polonia, Portugalia, Islanda dhe Norvegjia ia kanë lënë Direktivës së Tregtisë Elektronike (Direktiva 2000/31) për të vendosur rregulla për t'u marrë me këtë çështje. Në Gjermani, ISP-ve u kërkohet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar të miturit nga aksesin në materiale të dëmshme.

Britania e Madhe, Holanda dhe Polonia kanë një tjetër praktikë, ato ia kalojnë përgjegjësinë një shoqate të vetme ICRA që rendit website-t sipas përmbytjes së tyre. Prindërit mundin pastaj t'i referohen këtij vlerësimi, i cili bazohet në përmbytjen e website-ve dhe kufizon aksesin e fëmijëve në to. Norvegjia e sheh arsimin dhe ngritjen e vetëdijes së fëmijëve dhe prindërve si mjet më efektiv.

Një politikë e dobishme e zbatueshme në BE është përdorimi i linjave telefonike ku të gjithë mund të telefonojnë dhe të raportojnë përmbytje të paligjshme në website të ndryshme.

Krahas Europës, të drejtat e privatësisë për të miturit në Kaliforni janë disi më ndryshe dhe i japin më shumë të drejta fëmijëve. Në Aktin Botëror Dixhital ²⁸¹, gjithashtu i quajtur ligji i „fshirëses“, të miturit kanë të drejtën të heqin, ose të kërkojnë heqjen e përmbytjes ose informacionit të postuar në një website, shërbim online, aplikim online apo aplikacion mobil. Gjithashtu, ky akt ndalon

280 (Illegal and harmful content on internet, 1996)

281 Term i pershtatur nga anglishtja per Digital World Act

operatorët e një website-i ose shërbimet e marketingut online që nëpërmjet reklamave ti drejtohen të miturve. Delaware ndalon operatorët e faqeve të internetit, shërbimet online, shërbimet e cloud computing, aplikacionet në internet dhe aplikacionet celulare ti drejtohen fëmijëve për arsye marketingu të produkteve të ndryshme të ndaluara për fëmijët siç janë : alkooli, duhani, armët e zjarrit ose pornografia.²⁸²

Drejtësia për të mitur dhe teknologjia në Shqipëri

Shqipëria ka bërë hapa drejt dixhitalizimit të sistemit gjyqësor dhe sigurimit të drejtave të të miturve online. Dokumenti kryesor është Strategjia Ndërsektoriale e Shoqërisë së Informacionit (2008-2013), e cila u bazua në disa politika rajonale dhe ndërkombëtare.²⁸³

Në parashikimet e sistemit të drejtësisë në Shqipëri do të merren disa masa për përshtatjen e sistemit tonë me ndryshimet teknologjike. Nevojitet një strukturë për luftën kundër abuzimit me të mitur ose pedopornografisë si dhe shërbim për të gjitha strukturat e hetimit të krimit në Policinë e Shtetit, që do të zhvillojnë hetime dhe ekzaminime lidhur me krimet kompjuterike dhe Internet-in.²⁸⁴ Kjo do të kryhet sepse supozohet që numri i hetimeve për mashtrimet kompjuterike dhe në internet do të rriten në 7% deri në vitin 2020 . Gjithashtu numri i hetimeve për abuzimin e të miturve në internet do të rritet së bashku me numrin e provave dixhitale të sekuestruara në funksion të hetimit.²⁸⁵ Për shkak të masivizimit të përdorimit të internetit, vështirësive dhe kostos së vënies para përgjegjësive të autorëve, bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore të përfshira në Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike për një qasje parandaluese ndaj krimit kibernetik, do të jetë gjithashtu një synim në të ardhmen.²⁸⁶

Bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet ALO 116 111 në 2016, numri i telefonatave në lidhje me sigurinë në internet ka qënë i konsiderueshëm.²⁸⁷ Kjo edhe si rrjedhojë e ndikimit që ka pasur fushata informuese dhe edukuese për interne-

282 (STATE LAWS RELATED TO INTERNET PRIVACY, 2017)

283 (A Study on Child Online Safety in Albania)

284 (PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE TË PALIGJSHME DHE TERRORIZMIT, 2013-2020 DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITET 2013-2016, 2013) faqe 18

285 Po aty faqe 26

286 (RAPORT I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2015, 2016)

287 (SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET NE SHQIPERI, 2016)

tin e sigurt dhe Platforma Kombëtare mbi Sigurinë Online -iSIGURT.AL²⁸⁸

Në vitin 2013, kompanitë më të mëdha të komunikimeve elektronike si dhe Shoqata AITA në përgjigje të iniciativës për zhvillimin e praktikave të vetë-rregullimit për një internet të sigurt nënshkruan një kod të sjelljes për komunikime të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë. Me këtë kod, këto kompani angazhohen të zhvillojnë instrumente dhe mekanizma mbrojtjeje nga aksesit në përmbajtje të dëmshme ose të papërshtatshme për fëmijët dhe të rinjtë. Gjithashtu këto kompani janë angazhuar të ndërmarrin hapa për ndërgjegjësimin e përdoruesve dhe prindërve në këtë drejtim.²⁸⁹

Një institucion tjetër kyç i përfshirë në mënyrë aktive në çështjet e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në internet është Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Brenda MASH ka një drejtori të fokusuar në E-learning e cila synon të mbikëqyrë zbatimin e strategjive të TIK në sistemin arsimor shqiptar.²⁹⁰

Regullat, teknologjitë e filtrimit dhe ligjet

Shumë prindër e gjejnë të dobishme të vendosin rregulla për fëmijët e tyre. Shembujt e rregullave përfshijnë: Moszbulimin e informacioneve private online si numri i telefonit apo adresa, mbajtja private e fotove dhe shmangia e bisedave me të huaj.

Teknologjia e filtrimit të informacionit në internet përbëhet nga software-i që filtron disa përmbajtje duke lejuar kalimin e materialeve të tjera në destinacionin e synuar. Prindërit mund të krijojnë filtra të ndryshëm për të bllokuar materialin sipas prioriteteve dhe preferencave të familjeve të tyre. Teknologjia nuk është e përsosur - disa materiale të dëshirueshme mund të bllokohen aksidentalisht dhe disa materiale të pakëndshme mund të kalojnë përmes plasaritjeve, por programet e filtrimit në përgjithësi i shërbejnë qëllimit të filtrimit të materialeve të dëmshme. Çfarë duhet të bëni nëse shfaqet një problem? Agjentët e zbatimit të ligjit kombëtar dhe lokal hetojnë aktivitete kriminale që mund të lindin nga

288 Isigurt është një platforme Kombëtare për Internetin e Sigurtë për Fëmijët në Shqipëri. Misioni i Isigurt.al është të fuqizojë fëmijët, prindërit, mësuesit dhe të gjithë qytetarët që të përdorin internetin dhe mënyrat e tjera të komunikimit teknologjik pozitivisht, të sigurtë dhe në mënyrë efektive. Platforma Isigurt.al synon të nxisë raportimin e faqeve të paligjshme dhe përmbajtjet e padëshiruara. Kjo platformë ka në qëndër të vëmendjes së saj përgjegjësinë e përbashkët për mbrotjen e të drejtave dhe nevojave të fëmijëve online nga institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, mësuesit, prindërit, media dhe nga industria e komunikimit teknologjik.

289 Interviste e Irena Milolli, përfaqësuesja e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit për gazetën Shekulli

290 Permbledhje e "A Study on Child Online Safety in Albania", faqe 40

përdorimi i internetit. Prindërit që gjejnë materiale fyese ose dëgjojnë rreth grabitësve online, duhet t'i dokumentojnë dhe t'i raportojnë të gjitha aktivitetet direkt tek zbatuesit e ligjit lokal. Prindërit gjithashtu mund të duan t'u tregojnë fëmijëve të tyre se si të raportojnë materiale fyese. Në këtë mënyrë, fëmijët kanë një mënyrë konstruktive për të reaguar ndaj materialeve të turpshme ose shqetësuese të zbuluara në internet.

REKOMANDIME NË LEGJISLACION

Te Ligji nr. 9902, 2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” duhet të shtohet edhe detyrimi i kompanive që të informojnë të miturit për rreziqet e produkteve dhe shërbimeve të tyre elektronike dhe në rastet kur këto kompani përmbajnë produkte ilegale për fëmijët, mos të mund të dërgojnë reklama tek ata. Autoriteti EPCA duhet të jetë më proaktive në mbikëqyrjen e shërbimit të ISP-ve që mund të kenë përmbajtje të paligjshme. Legjislacioni për krimin kibernetik duhet gjithashtu të ndryshohet. Duhet të japë një përkufizim të “pornografisë së fëmijëve në internet” dhe veprave të tjera në internet që përfshijnë fëmijët. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” duhet të rishikohet, sidomos përkufizimi i “përmbajtjes së dëmshme” duhet të përshtatet sipas kulturës dhe moralit shqiptar.

Gjithashtu gjithë procedurat për drejtësinë me të miturit duhet të jenë me inovative duke përfshirë elemente teknologjike si biometrika. Të miturit duhet të kenë mundësinë që të mbrohen nga materialet që vetë ata kanë hedhur në internet. Duhet të ketë një ligj që ri mbrojtë ata nga vete-inkriminimi online. Kjo mund të bëhet dukë i dhënë atyre të drejtën që të fshijnë cdo material që ata kanë hedhur në rrjet brenda moshës 18 vjec. Në rastet kur fëmijët duhet të aksesojnë të dhëna ilegale për qëllime studimi apo për ethical hacking ²⁹¹ duhet të egzistojë një ligj që t'ia mundësojë atyre pa u denuar për këto fakt.

Rekomandimi i radhës vlen si për të miturit ashtu edhe për legjislacionin shqiptar në përgjithësi. Duhet që të ketë ligje që ndalojnë shkarkimin e materialeve apo programeve dhe përdorimin e tyre pa të drejtën e autorit pasi ky fakt po ndikon negativisht te brezi i ri i cili nuk mund ta kuptojë se çfarë ai mundet të kryejë apo jo online. Në një përballje më drejtësinë ndërkombëtare, nëse një fëmijë do shkar-konte dhe do shpëndante programe pa licence atëherë ai do të dënohej.

291 Ethical hacking synon testimin e sistemeve dhe jo shkatërrimin e tyre

PËRFUNDIME

Ndoshta problemi i të miturve në fushën e krimit kibernetik do të na shtyjë që më në fund të rishikojmë të gjithë sistemin tonë të drejtësisë penale. Personalisht, më duket e frikshme kur imagjinoj se sa ndryshe mund të ishte jeta ime nëse çdo gjë e gabuar që kam bërë ose thënë si adoleshent është regjistruar, duke iu nënshtruar zbulimeve të mëvonshme nga punëdhënësit potencial. Sigurisht, shumë prej nesh mbanin ditar ose revista, ku rrëfenim të gjitha mendimet dhe veprat tona mëkatore - por kur ishim mjaft të rritur për të kuptuar kotësinë e kësaj, gjithçka që duhej të bënim ishte djegja e gjërave.

Të rinjtë e sotëm vendosin jetën e tyre në Facebook dhe Instagram, bëjnë komente pa kuptim në profilet e tyre ose komente në faqet e internetit të të tjerëve, bashkohen me grupe të dyshimta, vendosin fotot e tyre në pozita më pak profesionale (ose, edhe nëse janë mjaft të zgjuar për të mos ta bërë këtë, ata nuk kanë kontroll mbi fotot që miqtë e tyre postojnë online me ta). Legjislacioni i BE-së ofron një përkufizim për “përmbajtjen e paligjshme”, por ia lë shteteve anëtare për të përcaktuar “përmbajtjen e dëmshme” të kontekstualizuar në kulturën e tyre. Prandaj Shqipëria mund ta implementojë në legjislacionin e saj këtë përkufizim duke shtuar edhe elementë të tjerë sipas kulturës tonë dhe moralit për të përcaktuar çfarë do ishte “përmbajtje të dëmshme” për fëmijët. Nga ana gjyqësore, barazia mes lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së moralit publik mbetet sfidë për agjensitë dhe gjykatat e zbatimit të ligjit. Çdo shtet është i lirë të përcaktojë “moralin publik” sipas vlerave dhe kulturës së tij. Në këtë kontekst, duhet të ketë një vendim të Gjykatës Kushtetuese për “moralin publik” që duhet të përcaktohet në Shqipëri.

Në përgjithësi politikat dhe legjislacioni i BE-së janë përpjekur të mbrojnë fëmijët duke u fokusuar në rregullimin e llojeve të mediave dhe teknologjisë në përgjithësi. BE ka inkurajuar vetërregullimin dhe kodin e sjelljes. Kjo politikë gjithashtu u jep më shumë hapësirë kompanive që t’u përgjigjen ndryshimeve të shpejta teknologjike. Sidoqoftë, shumëllojshmëria e strategjive midis shteteve mund të pengojë bashkëpunimin ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit. Shqipëria po mundohet që të bëjë sa me shumë hapa drejt metodave inovative të aplikimit të drejtësisë duke përqafuar teknologjinë por këto duhet të pasqyrohen edhe në legjislacion sidomos kur bëhet fjalë për të miturit. Ata mund dhe duhet të mbrohen nga teknologjia dhe nga rreziqet nga ajo duke forcuar si institucionet e edukimit që janë shkollat për t’i informuar fëmijet ashtu edhe legjislacionin shqiptar. Thonë që ligji është aq i fortë sa është aplikimi dhe forcimi i tij prandaj vetëm nëpërmjet forcimit të legjislacionit shqiptar mbi sigurinë e fëmijëve nga teknologjia mund të arrihen rezultate sa më të mira.

BIBLIOGRAFIA

- (n.d.). A Study on Child Online Safety in Albania. World vision.
- Atwal, A. (2011). NEWSYouth Cybercrime Influenced by Peers. Youth Today.
- Elgbadon E. Gregory, Adejuwon A. Grace . (2015). Psychodemographic Factors Predicting Internet Fraud Tendency among Youths in Southwestern, Nigeria . Journal of Educational and Social Research.
- Gallagher, K. (2016, Korrik 20). Modernisation of justice through technology and innovation. HM Courts & Tribunals Service.
- (1996). Green paper on the protection of minors and human dignity in audiovisual and information services. Brussels: Commission of the european communities.
- (1996). Illegal and harmful content on internet. Commision of the european communities.
- Kodi i drejtësisë penale për të miturit. (2017).
- Malolli, I. (2014). Në treg, paketat për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe pornografia. (L. Myftari.)
- Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016. (2013, Korrik 17). Ministria e Brendshme.
- Platforma kombetare per sigurine e femijeve ne internet . (n.d.). Marrënga <http://www.isigurt.al/>
- (2016). Raport i prokurorit të përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2015. Tiranë:
- Shinder, D. (2012). Juvenile cyber-delinquency: Laws that are turning kids into criminals. IT Security.
- (2016). Siguria e fëmijëve në internet në Shqipëri. Qendra per te drejtat e femijeve ne Shqiperi.
- State laws related to internet privacy. (2017). NCSL.

UNACCOMPANIED MINORS IN EUROPE

Msc. Ejona XHEMALAJ

ejona.xhemalaj@umsh.edu.al

Msc. Era BUÇPAPAJ

era.bucpapaj@umsh.edu.al

ABSTRACT

Nowadays the protection of the rights of migrating minors is one of the most important challenges on the international level. Because of their physical and mental immaturity, minors need special attention from their families and institutions. An unaccompanied minor means a minor located in the territory of a state, other than the state of origin, for whatever reason, without the assistance and representation of the parent or an adult legally responsible for him. The authorities of the EU countries, unprepared for the recent developments related to the large migratory movements in Europe and beyond, have identified deficiencies in the administrative and legal means for the protection of the minors who fall in the category of the most unprotected immigrants. Experts point out that the failure of the reception system, that is, a slow system of assessing asylum claims or family reunions, lack of social instruments and special institutions, lead the minors to voluntary withdrawal from registration to the relevant authorities. Survival without parental care, a major representative or the support of the state, puts the minors at the risk of ending up in the hands of organized crime, which takes advantage of the authorities' inability to manage the phenomenon. In this regard, it is worth mentioning the importance of improving the current legal framework for the minors, the work of social institutions, as well as the coordination and cooperation among States to prevent this phenomenon. This article addresses the current position of unaccompanied minors in Europe, the necessary legal and social instruments, and more specifically, the legal framework of the Italian State as a successful attempt to solve the problem under discussion.

Key words: *unaccompanied minor, legal representative, social instruments, legal framework, criminality.*

I MITURI I PASHOQËRUAR NË EUROPEË

Mbrojtja e të drejtave të të miturve përbën një nga çështjet më të rëndësishme të parashikuara në legjislacionin ndërkombëtar dhe legjislacionin e brendshëm të secilit shtet. Ndonëse të gjithë të miturit duhet të mbrohen, azilkërkuesit dhe refugjatët e mitur ose “të miturit e pashoqëruar”, janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve, ndaj për këtë kategori kërkohet një mbrotje e veçantë.

I mituri i pashoqëruar, nënkupton një të mitur që ndodhet në territorin e një shteti të ndryshëm nga shteti i origjinës, për çfarëdo arsye, pa ndihmë dhe përfaqësim nga prindërit apo madhor ligjërisht përgjegjës për të.

Të miturit e pashoqëruar janë subjekt i mbrojtjes së posaçme nga legjislacioni ndërkombëtar. Më konkretisht, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve parashikon në nenin 2 të saj parimin e mosdriskriminimit i cili sanksionon se të drejtat e parashikuara nga konventa do të zbatohen për çdo fëmijë në juridiksionin e Shteteve Palë, pa diskriminim të ndonjë lloji, pavarësisht racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, origjinës sociale, etnike apo shtetërore, pasurisë, lindjes apo ndonjë statusi tjetër të fëmijës, prindërve apo përfaqësuesëve të tij ligjor.²⁹²

Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6 “Trajtimi i fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë jashtë kufijëve të vendit të origjinës”, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, sqaroi nenin 2 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, duke u shprehur se detyrimet e shteteve në kuadër të kësaj konvente zbatohen brenda kufijëve të Shtetit, duke përfshirë edhe ata fëmijë që vijnë në juridiksionin e shtetit duke u përpjekur të hyjnë në territorin e atij shteti. Për pasojë, gëzimi i të drejtave të parashikuara në Konventë nuk kufizohet vetëm për të miturit që janë shtetas të shtetit anëtar, dhe për pasojë duhet të jenë të zbatueshme për të gjithë të miturit përfshirë azilkërkuesit, refugjatët, migrantët – pavarësisht shtetësisë, shtetit të tyre migrator apo pashtetësisë.²⁹³

Vitet e fundit, numri i të miturve që kanë qarkulluar në Bashkimin Evropian, shumë prej të cilëve të pashoqëruar, është rritur në mënyrë dramatike. Në vitin 2015 dhe 2016, rreth tridhjetë për qind e aplikantëve për azil në Bashkimin Evropian ishin fëmijë.²⁹⁴ Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, vendet evropiane

292 Shih neni 2 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

293 Luljeta Ikononi, “E drejta e migracionit”, Tiranë, 2011.

294 European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament and the Council “The protection of children in migration”, Brussels, 2017.

regjistruan 96.882 kërkesa për azil që përfshinin edhe të mitur, të cilët përbënin një të tretën e të gjithë kërkesave për azil. Pjesa më e madhe e të miturve që kërkonin azil në vitin 2017 kishin mbërritur nga vetëm katër vende: Republika Arabe Siriane (26%), Afganistani (12%), Iraku (9%) dhe Eritrea (5%). Në vitin 2017, ashtu si dhe në vitin 2016, pothuajse gjysma e të gjithë të miturve (44,283) kërkonin mbrojtje ndërkombëtare në Gjermani.

Vende të tjera që rezultuan me një numër të madh të azilkërkuesve fëmijë në vitin 2017 ishin: Greqia (8,113), Franca (7,600), Italia (7,530), Austria (6,215), Suedia (3,912), Zvicra (3,280) dhe Spanja (3,200).²⁹⁵

Arsyet kryesore të zhvendosjes së të miturve të pashoqëruar në BE konsiderohen: luftërat, konfliktet, katastrofat natyrore, diskriminimi ose rreziku serioz, kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare (azil); varfëria - arsye ekonomike; për t'u bashkuar me anëtarët e familjes; si viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të destinuara për shfrytëzim, të tilla si shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar ose shërbimeve.²⁹⁶

Sipas statistikave këta të mitur kalojnë një sër përvojash të lidhura me migracionin, shumë prej të cilave traumatike. Këto përvoja ndikohen më së shumti nga papjekuria fizike dhe mendore e të miturit, largësia nga vendi i origjinës, vështirësia në përshtatjen me ndyrshimet dhe më së shumti mungesa e prindërit ose kujdestarit.

Shpesh trajtimi i të miturve të pashoqëruar në Europë shoqërohet me shkelje të të drejtave ndërkombëtare të të miturve, të parashikuara në disa direktiva të BE. Një rast tipik është mosbalancimi i aplikimeve për azil, ku shpesh nuk i jepet rëndësia e nevojshme trajtimit të aplikimit të një të mituri, duke rezultuar në strategji joefektive të pritjes nga shumë vende të Europës.

Ekspertët theksojnë se dështimi i sistemit të pritjes, sistemi i ngadalësuar i vlerësimit të kërkesave për azil ose ribashkim familjar, si dhe mungesa e instrumentave social dhe institucioneve speciale, i drejton gjithnjë e më shumë të këta të rinj drejt tërheqjes vullnetare nga regjistrimi në autoritetet përkatëse. Mbijetesa pa përkujdesjen e prindit, një përfaqësuesi madhor dhe vetë shtetit në tërësi i hap rrugë rrezikut për shfrytëzimin e të miturve në duart e krim-

295 UNHCR, UNICEF and IOM - "Refugee and Migrant Children in Europe Accompanied, Unaccompanied and Separated", Mid year Overview of Trends, January - June 2017, pg 4.

296 Unaccompanied minors in the EU, EU Agency for Fundamental Rights, 2010.

it të organizuar - i cili përfiton nga paaftësia e autoriteteve për të menaxhuar fenomenin.

LEGJISLACIONI ITALIAN

Në fillim të vitit 2017 rezultonin të pranishme në territorin italian 15,458 të mitur të huaj të pashoqëruar, nga të cilët 92.9% meshkuj kryesisht të ardhur nga Egjipti (14.8%), Gambia (13.9%), Shqipëria 10.8%), Nigeria (8.5%) etj. Të miturat e pashoqëruara femra, përbënin vetëm 7.1%, nga të cilat pothuajse gjysma (48.4%) të ardhura nga Nigera, në rrezik trafikimi dhe shfrytëzimi.²⁹⁷

Sipas statistikave, 5,226 prej të miturve të pashoqëruar në Itali, nuk janë më pjesë e sistemit të pritjes dhe tashmë rezultojnë të zhdukur.²⁹⁸ Këta të mitur kanë tendencë t'i shmangen autoriteteve shtetërore kur kërkesat e tyre për azil refuzohen, dhe si pasojë pa përkrahjen dhe përkujdesjen e nevojshme bëhen preh e shfrytëzimit seksual dhe ekonomik.

Të miturit e huaj edhe pse mund të kenë hyrë në mënyrë klandestine në Itali, gëzojnë të gjitha të drejtat e garantuara nga Konventa e New Yorkut Mbi të Drejtat e Fëmijëve (1989), ku ndër të tjera theksohet se në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me të miturin duhet të mbahet parasysh si fakt prioritar “interesi i të miturit”.

Komiteti për të Miturit e Huaj, i ngritur pranë Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale, për vite me rradhë ka mbikëqyrur mënyrën e qëndrimit të të miturve të huaj të pranuar përkohësisht në territorin e shtetit italian, si dhe ka koordinuar aktivitetin me institucionet bashkëpunuese. Që prej vitit 2013, funksionet e Komitetit për të Miturit e Huaj i janë transferuar Drejtorisë së Përgjithshme për Imigracionin dhe Politikën e Integritimit të Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale.

Legjislacioni italian ka treguar kujdes në evidentimin e disa të drejtave thelbësore që duhet t'i sigurohen çdo të mituri të vendosur në një shtet të huaj. Vëmendje e veçantë i është kushtuar sigurimit të së drejtës për arsimim, kujdesit shëndetësor dhe punësimit.

297 Report Ministero del Lavoro e della Politiche sociali. MSNA <http://www.lavoro.gov.it/temi-epriorita/immigrazione/focus-on/minori-stranieri/Documents/Report-MS-NA-31032017.pdf>

298 UNHCR, UNICEF and IOM - “Refugee and Migrant Children in Europe Accompanied, Unaccompanied and Separated”, Mid year Overview of Trends, January - June 2017, pg 3.



Arsimimi: Të gjithë të miturit e huaj edhe pse të privuar nga leja e qëndrimit, kanë të drejtë të regjistrohen në shkolla të çdo kategorie dhe shkalle (jo vetëm në atë të detyrueshme). Regjistrimi i të miturve të huaj bëhet në të njëjtën mënyrë dhe sipas kushteve të parashikuara për të miturit italian, dhe mund të kërkohet në çdo periudhë të vitit.

Shërbimi shëndetësor: Të miturit e huaj mbajtës të një leje qëndrimi për moshë të mitur duhet të regjistrohen më detyrim, nga personat që ushtrojnë kujdestarinë mbi ta në Shërbimin Kombëtar Shëndetësor (SSN) dhe kanë të drejtë për të përfituar nga të gjitha shërbimet e sistemit shëndetësor. Ndërkohë të miturit e huaj që nuk kanë leje qëndrimi, nuk mund të regjistrohen në SSN, por kanë gjithësesi të drejtë për përkujdesje ambulatorore dhe spitalore në rast sëmundje apo fatkeqësie.

Punësimi: Për të miturit e huaj në fushën e punës aplikohen të njëjtat rregulla që zbatohen edhe ndaj të miturve italian (pranimi në punë vetëm pas mbushjes së moshës 15 vjeç, dhe duke përmbushur kërkesën e arsimit të detyrueshëm).

Për një kategori më të veçantë, si të miturit e huaj të pashoqëruar, ndër të tjera i njihen edhe disa të drejta shtesë: për mbrojtje dhe asistencë; për të mos u përjashtuar përveç se për motive të rendit publik dhe sigurinë e Shtetit; për të mos u përjashtuar përveç rastit të së drejtës për tu bashkuar me prindin apo kujdestarin e përjashtuar; për leje qëndrimi për moshë të mitur që mund të kthehet në leje për studime ose punë me mbushjen e moshës 18 vjeç.²⁹⁹

Trajtimi i të miturve të pashoqëruar në Itali, kategorisë së emigrantëve absolutisht më të pambrojtur, shpesh është vlerësuar me mungesa të instrumenteve ligjor dhe administrativ. Deri në vitin 2017 kuadri ligjor që rregullonte pozitën e të miturve të huaj në Itali nuk parashikonte një mbrojtje të posaçme, një procedurë pritje të standardizuar sipas parashikimeve të BE, institucione dhe qendra të specializuara, dhe mbi të gjitha nuk ishte mjaftueshëm gjithëpërfshirës nisur nga shifrat alarmante të të miturve të huaj që qarkullonin vitet e fundit në Itali. Si pasojë e nevojës për një ligj konkret që do të rregullonte pozitën e të miturve të pashoqëruar, që deri më tani rregullohej me të njëjtat

299 "Të drejtat e emigrantëve: Rasti i Greqisë dhe Italisë", Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shqipëri, 2009.

parashikime ligjore si rastet e të miturve të braktisur, dhe mbi të gjitha zhvillimeve të fundit në Mesdhe, shteti italian ndërmoi nismë legjislative në ndihmë të të miturve të pashoqëruar.

Shteti italian tashmë rregullon pozitën e të miturit të pashoqëruar në Itali me ligjin e 7 prillit 2017, një ligj më konkret dhe gjithëpërfshirës. Sipas këtij ligji të miturit e huaj që mbërrijnë në Itali pa prindër ose persona madhor përgjegjës për ta, nuk do të refuzohen dhe do të tutorohen nga një sistem mbrojtje i veçant. Ky ligj ka si qëllim forcimin e mbrojtjes ndaj të miturve të huaj të pashoqëruar për të siguruar zbatimin uniform të rregullave për pritjen në të gjithë vendin.

Në ligj parashikohet barazia mes të miturve të pashoqëruar dhe të miturve italian; metodat dhe procedurat e identifikimit të të miturit, prania e një përkthyesi gjatë gjithë procedurave, si dhe thjeshtimi i procedurës për marrjen e lejes së qëndrimit për të miturit e huaj: i mituri mund të aplikojë direkt për leje qëndrimi në departamentin kompetent të policisë, edhe nëse kujdestari nuk është emëruar.

Qendra të posaçme pritje për momentin e parë të identifikimit dhe pritjes së të miturve, ku koha maksimale e qëndrimit është 30 ditë, për të vijuar me transferimin më pas në sistemin e dytë të pritjes, në qendrat ku aplikohet për azil në shtetin italian.

Ligji parashikon figurën e kujdestarëve vullnetarë të cilët janë në dispozicion për të marrë nën kujdestari të miturit e pashoqëruar. Që prej publikimit të ligjit, ka vijuar njoftimi publik për përzgjedhjen dhe regjistrimin në listat e kujdestarëve vullnetarë për të miturit e huaj të pashoqëruar. Procedura ka për qëllim rekrutimin e vullnetarëve që aplikojnë pa kundërshtim, për të ushtruar kujdesatrinë për të mitur tashmë të pranishëm ose që do të hyjnë në territorin italian. Siç specifikohet në njoftim, qytetarët do të duhet jo vetëm të marrin përgjegjësinë e përfaqësimit ligjor, por do të konsiderohet si një “mbikëqyrës social” që kujdeset për zhvillimin psiko-social të të miturit, administron pasurinë e tyre, udhëheq formimin arsimor, por edhe përkujdeset për bashkimin familjar të të miturit të pashoqëruar. Mund të aplikojnë qytetarët që kanë mbushur moshën 25 vjeç. Kandidatët kalojnë një sër intervistash lidhur me përshtatshmërinë. Ligji gjithashtu i jep prioritet caktimit në familje si rruga kryesore e pritjes në lidhje me kontrollin dhe menaxhmin e duhur të situatës së

të miturve të pashoqëruar.³⁰⁰

Drejtoria e Përgjithshme e Emigracionit dhe e Politikave Integruese e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ishte institucioni i mëparshëm që shqyrtonte rastet e të miturve të pashoqëruar. Tashmë me ligjin e 7 prillit 2017, institucioni që ka juridiksionin për shqyrtimin e rasteve të të miturve të pashoqëruar është Gjykata e Miturve, organ i dedikuar me kushtetutë posaçërisht për të miturin.

Ligji parashtron se në procedurat administrative dhe gjyqësore në të cilat subjekt është i mituri, synohet që të zbatohen parimet për një proces të rregullt ligjor, ku një vend të rëndësishëm ka e drejta për tu dëgjuar si dhe e drejta për ndihmë juridike, e cila për kategorinë e të miturve është falas.

Në vija të përgjithshme, kuadri i sotëm ligjor për miturin e pashoqëruar në Itali parashikon:

- shkurtim afati pritje: qëndrimi maksimal prej 30 ditësh në qendrat e pritjes dhe e drejtë për të aplikuar dhe për të marrë leje qëndrimi;
- masa specifike për të promovuar plotësimin e shkollimit të detyrueshëm;
- garantim i të drejtës për kujdes shëndetësor;
- dispozita për të favorizuar përkujdesjen nga një familje, si një çështje më prioritare se mikpritja nga një strukturë pritje ose qendër;
- kompetenca për shqyrtimin e çështjeve lidhur me të miturit e pashoqëruar i kalon Gjykatës për të Miturit;
- e drejta për asistencë ligjore falas për procedurat administrative dhe gjyqësore. Çdo gjykatë e të miturve do të duhet të krijojë një listë të kujdestarëve “vullnetarë” për të siguruar një përfaqësues madhor për të miturin.³⁰¹

Nga analiza e ligjit rezulton se tashmë shteti italian ka ndërmarrë një nismë ligjore të nevojshme e cila kërkon angazhim dhe përdorim të të gjithë instrumentave për implementimin e saj. Por vlen të theksohet se ka ende disa

300 <http://www.lombardiatquotidiano.com/notizia/minori-non-accompagnati-parte-il-reclutamento-dei-tutori>

301 <http://www.rainews.it/ran24/speciali/2017/migranti-minori-non-accompagnati-scomparsi/>

çështje të cilat kërkojnë përmirësim. Vihet re një mungesë koordinimi midis ligjit të 7 prillit 2017 dhe legjislacionit ekzistues në lidhje me përcaktimin e gykatave kompetente që shqyrtojnë çështje ku subjekt është i mituri i huaj, si dhe nevoja për një plan financiar të detajuar për të siguruar mbështetjen në ndjekjen e procedurave, asistimin dhe kujdesin deri në një zgjidhje përfundimtare për të miturit e pashoqëruar.

KONKLUZIONE

Legjislacionet e reja dhe të posaçme të lidhura me të miturin e pashoqëruar në disa vende të Bashkimit Europian, janë një përpjekje e mirë për rregullimin e pozitës së tyre në vendet pritëse. Një shembull i tillë është ligji i 7 prillit 2017 në Itali, i cili pavarësisht kuadrit të plotë ligjor, mbetet ende për tu vlerësuar në vijueshmërinë e zbatimit në kohë.

Ky fenomen pavarësisht ekzistencës së legjislacionit, instrumentave dhe institucioneve, mbetet ende i pa kontrollueshëm me numrin e lartë të të miturve të pashoqëruar që qarkullojnë sot në Bashkimin Europian.

Rritja progresive e numrit të të miturve të pashoqëruar në BE, është një tregues i mungesës së menaxhimit të drejtë dhe gjithëpërfshirës të situatës nga vendeve evropiane në mbrojtje të të miturve. Deri më sot, politikat evropiane që lidhen me migracionin karakterizohen nga mungesa e qasjes së përqëndruar tek të miturit.

Ndaj shtrohet si domosdoshmëri për Bashkimin Evropian koordinimi mes shteteve, zbatimi i një kornize të standardeve të përbashkëta për të trajtuar situatën e të miturve të pashoqëruar, kontrolli më rigoroz në pikat kufitare nga shtetet e origjinës tek shtetet pritëse, si dhe promovimi i zbatimit të mekanizmave për monitorimin e institucioneve dhe qendrave përgjegjëse për asistimin dhe mbrojtjen e të miturve të pashoqëruar. Dhe në përfundim vlen të theksohet se nevojitet më tepër solidaritet dhe përgjegjëshmëri në drejtim të kontrollit dhe menaxhimit të këtij fenomeni delikat nga shtetet e BE.

BIBLIOGRAFIA:

1. Konventa mbi të drejtat e fëmijës, v 1992.
2. European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament and the Council “The protection of children in migration”, Brussels, 2017.
3. Legge 7 aprile 2017, n. 47 “Disposizioni in materia di misure di protezione dei minori stranieri non accompagnati”.
4. Luljeta Ikonimi, “E drejta e migracionit”, Tiranë, 2011.
5. “Të drejtat e emigrantëve: Rasti i Greqisë dhe Italisë”, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shqipëri, 2009.
6. Kriza globale dhe migracioni, monitorimi i një kanali kycc transmetimi në ekonominë shqiptare, studim i përbashkët i IOM-it, PNUD-it dhe BB, Tiranë 2010.
7. UNHCR, UNICEF and IOM - “Refugee and Migrant Children in Europe Accompanied, Unaccompanied and Separated”, Mid year Overview of Trends, January - June 2017.
8. Overview of international migration, IOM International Organization of Migration, 1997.
9. Unaccompanied minors in the EU, EU Agency for Fundamental Rights, 2010.
10. <https://openmigration.org/analisi/la-legge-zampa-sui-minori-stranieri-non-accompagnati-in-5-punti/>
11. <http://www.lombardiaquotidiano.com/notizia/minori-non-accompagnati-parte-il-reclutamento-dei-tutori>
12. <http://www.rainews.it/ran24/speciali/2017/migranti-minori-non-accompagnati-scomparsi/>
13. Report Ministero del Lavoro e della Politiche sociali. MSNA <http://www.lavoro.gov.it/temi-epriorita/immigrazione/focus-on/minori-stranieri/Documents/Report-MSNA-31032017.pdf>

KONFLIKTET JURIDIKE NË DREJTËSINË PENALE PËR TË MITURIT

Irida Danaj

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

irida-88@hotmail.com

ABSTRAKT

Vendet demokratike të zhvilluar kanë një dallim të qartë në legjislacionin e tyre penal ndërmjet autorëve të mitur të krimit dhe autorëve të maturuar të krimit.

Dallim ky i cili konsiston si në pozitën e tyre në procedurën penale, po ashtu edhe në sanksionet penale të cilat janë të një karakter më të butë, madje edhe në lidhje me sanksionet penale ku masat e karakterit jo-institucional janë kryesisht edukuese.

Duke pasur parasysh rolin e të miturve në shoqëri, ata duhet të trajtohen si viktima dhe jo si kriminelë, edhe nëse sjelljet e tyre mund të jenë të rrezikshme dhe kërcënuese. Kjo nuk do të thotë se ata mund të falen për fajet apo veprat e tyre, por duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë që të kontribohet pozitivisht në rehabilitimin e tyre nëpërmjet masave të marra.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë të gjitha llojet e masave si sanksione penale të parashikuara në Legjislacionin Penal Shqiptar për të Mitur, parimet e drejtësisë të ndjekura në këtë legjislacion, pozita e të miturit në drejtësinë penale, me qëllim zbatimin më të mirë të këtyre dispozitave në procedurat penale lidhur me të miturit në Shqipëri.

Hulumtimi vijon me analizat e znj. Danaj në lidhje me zbatueshmërinë e parimeve të drejtësisë në drejtësinë penale për të miturit referuar Marveshjeve Ndërkombëtare dhe situatat konkrete midis institucioneve ligjzbatuese që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

Sipas analizës dhe studimit të praktikave në Shqipëri dhe Kosovë, arrijmë të përfundimin se zona gjeografike të ndryshme kanë një zbatim të difer-

encueshëm të ligjshmërisë, duke lënë shkas për rritje të konfliktit ligjor nga të miturit referuar viteve të fundit.

Fjalët kyçe: *I mitur, konflikt ligjor, drejtësia penale për të mitur, parime të drejtësisë penale, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjykatë, masa disiplinore edukuese.*

HYRJE

Raporti i Komisionit European për Shqipërinë (2016) ndonëse vlerësonte punën e bërë për reformimin e sistemit gjyqësor, për sa i përket kuadrit ligjor lidhur me drejtësinë për të miturit, shprehej se duhet akoma punë për t'u përafuar me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu Komisioni European deklaroi përmes këtij raporti se mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës mbeten të pamjaftueshme.³⁰² Rekomandimet për përmirësimin e këtyre problematikave vijnë të përsëritura që nga Progres Raporti vjetor i Komisionit European për Shqipërinë (2015)³⁰³ Duke marrë shkas nga raportet e fundit për Shqipërinë nga Komisioni European si dhe prioritetet e lëna për Shqipërinë, Republika e Shqipërisë bëri pjesë të legjislacionit penal trajtimin e të miturve që janë në konflikt me ligjin, duke miratuar një ligj të veçantë Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur në vitin 2017.

1.1 Legjislacioni Kombëtar dhe drejtësia për të mitur

Nisur nga parimi i hierarkisë së normave që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të përcaktuar prej vet Kushtetutës (nenit 116) "Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e RSh janë:

- a. Kushtetuta;
- b. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c. Ligjet;
- d. Aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Është për tu nënvizuar qysh në fillim që nga ana e shtetit shqiptar janë

302 https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

303 <https://www.scribd.com/doc/289201543/Progres-Raporti-i-KE-se-per-Shqiperine-per-vitin-2015>

ndërmarrë njëserë reformash legislative me qëllim përputhjen me standardet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Standardet e drejtësisë për të mitur.

Kushtetuta është ligji suprem në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat më të thella të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës:

«... dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, janë baza ekëtij shteti, i cila ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë».

Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Kjo është njëra prej arsyeve që, pas daljes së Kushtetutës filloi një veprimtari legislative intensive, për të sjellë në kornizën e parimeve të saj të gjithë legjislacionin shqiptar.

Miratimi i ligjevetë reja sipas standardeve bashkëkohore dhe përqsja e tyre me standardet evropiane të të drejtavetë njeriut ka qenë arsyeja tjetër e kësaj reforme legislative e cila ka shërbyer si bazë shumë emirë e solide për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit prej sistemit të drejtësisë nga ana tjetër.

Një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri, për të treguar se bashkësia njerëzore të cilit i drejtohet dispozita nuk bën asnjëpërrjashtim, asnjë diskriminim, sepse të drejtat dhe liritë themelore u garantohen të gjithëve, të mitur e madhorë.

Kushtetuta e RSh në Kreun II të Pjesës II paraqet në mënyrë të përmbledhur parimet kryesore të drejtësisë penale dhe garancitë procedurale të të pandehurit të cilat nënkuptojnë shtrirjen e tyre edhe për të miturit në procesin penal.

B) Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijve, rregulla ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve dhe legjislacioni shqiptar për të miturit

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës, përmban norma të forta, zbatimi i të cilave mbikëqyret nga një komitet i posaçëm për të drejtat e fëmijëve. Është pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike, është konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera, ose trajtimit njerëzor, jonjerëzor, degradues, protokollit shtesë i kësaj konvente si dhe standardet e rregullave dhe udhëzimeve të OKB-së lidhur me drejtësinë për të miturit.

Po kështu, konventa ka një protokoll shtesë lidhur me shitje-prostitucionin dhe pornografinë e të miturve. Në nivelin e BE-së është Karta Themelore e të Drejtave të BE-së, Traktati i Lisbonës, direktivat e BE-së lidhur me përkthimin ose interpretimin, të drejtën e fëmijëve, aksesin për avokat, luftën kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, pornografisë së fëmijëve, për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe mbrojtjen e viktimave etj.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera.

Disa rregulla ndërkombëre për mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin;

Këshilli i Europës ka njohur Konvenën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut e garantuar nga jurisprudenca e gjerë e Gjykatës së Strasburgut ose Gjykatës për të Drejtat dhe Liritë Themeloreku janë caktuar rregulla standarte që janë referuar për mbrojtjen e fëmijëve si më poshte:

Rregullat minimum Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit referuar - Rregullat e Pekinit 1985;

Standartet minimum synojnë krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një legjislacioni të posaçëm. Këtu veçojmë:

- përjashtimin e të miturit nga dënimi kapital dhe nga ndëshkimet trupore
- trajtimin e paanshëm dhe njerëzor;
- mbajtjen parasysh të mendimeve të të miturit;
- burgimi të jetë mundësia e fundit dhe qëndrimi në burg të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur;
- heqja e lirisë duhet të aplikohet për raste shumë të rënda;
- dhënia e vendimeve sa më shpejt që të jetë e mundur;
- specializimi i organeve të drejtësisë;
- riintegrimi i të miturit.

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria - (rregullat e Havanës 1990);

Në tekstin e këtij dokumenti nënvizohen disa nga parimet për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria të tilla si:

- heqja e lirisë është masa e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar;
- heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv;
- krijimi i njësive të institucioneve të hapura të jetë prioritet
- përgatitja e të miturve të cilëve u është hequr liria për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet. Rëndësia e programeve edukuese për ta;
- mbajtja e kontakteve me familjen;
- trajnimi i personelit të institucioneve ose të qendrave.

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të rinjve- (udhëzimet e Riadit 1990);

Rregullat e minimumit Standart të Kombeve të Bashkuara lidhur me Non-custodial Measures (rregullat e Tokios) (1990);

Udhëzimet e Vjenës për Veprimin mbi Fëmijët në Sistemin e Drejtësisë Penale dhe duke pasur parasysh ditën e diskutimit të Komitetit në 1995•

Garancitë evropiane dhe ndërkombëtare të mbrojtjes të të drejtave të të miturit si autor dhe viktimë të veprave penale, janë bërë pjesë e legjislacionit shqiptarë nëpërmjet miratimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

C) Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, miratuar me Ligj Nr.37/2017

Kodi I Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedural lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grup moshal8deri në 21vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij

1.2 Shtrirja e parimeve të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin në Shqipëri ka ardhur në rritje. Një nga treguesit është pikërisht rritja e numrit të përsëritësve. Në një analizë të shkaqeve kryesore që i çon fëmijët në konflikt me ligjin padyshim është mungesa e masave social-ekonomike në drejtim të familjeve, por gjithashtu mungesa e një sistemi referimi kombëtar dhe lokal ka sjelle një situatë të tillë aq problematike.

Në sistemin tonë të drejtësisë dhe atë social fëmijët në konflikt me ligjin janë vulnerabel.

Drejtesia miqësore për fëmijët, të cilët e gjejnë veten në konflikt me ligjin është e pakët dhe disa here inekzistente. Alternativat e dënimit për fëmijët në konflikt me ligjin janë shumë të kufizuara si dhe përdorimi i diversionit është i rrallë.

Në Kodin e ri të miratuar janë parashikuar parimet e përgjithshme të drejtësisë për fëmijë si; Heqja e lirisë si alternativë e fundit e dënimit, E drejta e pjesëmarrjes së fëmijës; afati i përfundimit të procedurës; e drejta e privatësisë; të drejtat procedurale, etj. Kuptimin dhe pozitat e palës në procedurën e drejtësisë për fëmijët; kualifikimi, gjykimi i çështjeve, specializimi.

Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë; masa për mbrojtjen e fëmijëve dëshmitar janë çështje që rregullohen gjithashtu nga Kodi.

Standardi i trajtimit të vecantë dhe dinjitoz

Çdo fëmijë i dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thirur se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim që të zhvillohen ndjenjat e dinjitetit dhe të vlerës së personit, të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në menyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj (neni 40/1 KDF);

Standardi i pasojave jo prapavepruese.

Asnjë fëmijë nuk mund jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qënë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombtare në momentin kur ato janë kryer. (neni 40/1/ a KDF) (Kushtetuta R.Sh neni 29);³⁰⁴

304 http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_2016_1082.pdf

Garancite procedurale

Për fëmijët në procesin penal, pra për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar për shkelje të ligjit penal sipas nenit 40 të KDF përfshijnë:

- prezumimi i pafajësisë derisa të provohet pafajësia ligjrisht në përputhje kjo edhe me nenin 30 të Kushtetutës së R.Sh) ;
- e drejta e informimit menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose cdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes (neni 31 i Kushtetutës së R.Sh) ;
- shqyrtimi pa vonesë i çështjes nga një autoritet ose instancë gjyësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme sipas një procedure të drejtë ligjore në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë e femijes, sidomos për arsye të moshës ose gjëndjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve ligjorë,
- trajtimii femijëve në përputhje me mirëqënien e tyre dhe në raport me gjëndjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit
- femija të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor;
- të drejtën të pyesë ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës;
- të drejtën e ankimit;
- të drejtën për një përkthyes falas;
- shmangien nga procesi gjyqësor dhe procedurat gjyqësore;
- respektimin e jetes private.

2.1 Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri dhe llojet e veprave penale të kryera nga të miturit

Në Shqipëri, përveç rritjes së numrit të fëmijëve në konflikt me ligjin, vitet e fundit është vërejtur edhe një rritje e numrit të përsëritësve. Ndaj gjithnjë e më tepër kanë lindur nevojat se si i duhet përgjigjur këtij realiteti.

Drejtësia miqësore për fëmijët në kuadrin aktual është ose e pakët, ose herë

-herë inekzistente. Megjithatë, përveç mungesës së instrumenteve ligjore për të mbrojtur fëmijët në konflikt me ligjin, vërehet edhe mungesa e normave ose instrumenteve për riintegrimin e tyre me synim parandalimin.

Legjislacioni shqiptar përcakton se të miturit me masë sigurie arrest me burg dhe ata që marrin vendimin e formës së prerë nga gjykatat akomodohen në institucione për të mitur, ose në institucione me seksione të veçanta për të mitur.

3.1 I mituri, viktimë e veprave penale të ndryshme dhe mbrojtjet e mundshme

Dispozitat e përgjithshme të Kodit fillojnë me përcaktimin e objekti dhe qëllimi e këtij kodit. Më tej janë shprehur një sërë parimesh shumë të rëndësishme të drejtësisë penale për të mitur, si dhe të drejtat dhe garancitë për të miturit në konflikt me ligjin.

Po kështu një rëndësi e madhe i është kushtuar trajnimit dhe specializimit të personave që do të merren me administrimin e drejtësisë për të mitur.

Më tej trajtohet i mituri si viktimë dhe i mituri dëshmitar i veprës penale, duke pasur parasysh që rëndësia e personave që trajtohen në procesin penal të të miturve është pothuajse e të njëjtës gradë.

Kodi i krijon mbrojtje të miturit nëpërmjet trajtimit të rregullave të përgjithshme të procedurës së drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin.

3.2 Masat e sigurimit për të miturit

Në bazë të dispozitave të K.Pr.Penale, masat e sigurimit mund të përkufizohen si veprime procedurale të cilat heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit.³⁰⁵

Një përkufizim tjetër përcakton se masat e sigurimit janë heqje dhe kufizime të lirive dhe të të drejtave të personit të proceduar, të parashikuara nga ligji për të parandaluar atë në kryerjen e veprimeve, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, shmangien nga procedimi dhe veprimtaritë e mëtejshme kriminale, si dhe për të garantuar shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.³⁰⁶

305 Procedura Penale, H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Botime "Morava", Tiranë 2007, fq. 230

306 A.Gjoleka, E.Shoshi, Komente mbi masat e sigurimit personal, Tiranë 1999, Botime "GEER", fq. 6

Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal.

Në Kodin për Drejtësinë për të Mitur, neni 82 citon që përveç masave të sigurimit të përcaktuar në K.Pr.Penale duke pasur parasysh veçoritë për procedurën ndaj të miturve, duke caktuar cakton si masë sigurimi, vendosjen e të miturit në mbikqyrje si dhe vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar.

Vendosja e të miturit në mbikëqyrje synon garantimin e paraqitjes së të miturit, sa here kërkohet, përpara oficerit të policies gjyqësore, prokurorit ose gjykatës.

Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar bëhet ndaj të miturit, interes e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikëqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit ose personave të afërm.

Këto masa të përcaktuara në Kodin e ri kanë si qëllim ruajtjen e personalitetit të miturit, si dhe mos shkëputjen e tij nga mjedisi shoqëror dhe ai edukuese.

PËRFUNDIME, KONLUZIONE, OPINIONE

Shqipëria ka bërë ndryshime të rëndësishme në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale për fëmijët në përputhje me standartet e kërkuara nga instrumentat ndërkombëtare.

Miratimi i Kodit për Drejtësinë Penale për Miturit karregulluar;

- kornizën ligjore specifike për të miturit në konflikt me ligjin në përputhje me standartet ndërkombëtare.

- afatete procedimit penal për të miturit, në dritën e standarteve ndërkombëtare.

Korniza ligjore e drejtësisë për fëmijë ka implementuar gjithashtu të gjitha instrumentat ligjor ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Europian.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka parashikuar norma specifike procedurale për organet përgjegjës gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera.

Pjësë e Kodit për Drejtësisë Penale për të Mitur është dhe unifikimi i asistencës ligjore dhe psikologjike për të miturit, gjatë gjithë fazës së procedimit penal, gjykimit dhe implementimit, duke e bërë të mundur lehtësimin e të miturit në procesin penal.

Panvarsisht të gjithë masave të marra referuar rasteve të kriminalitetit viteve të fundit në Shqipëri konstatohet se ndonëse parandalimi i kriminalitetit është një prej funksioneve të ligjit dhe tëmasave penale të parashikuara prej tij, misioni parandalues i institucioneve gjatë zbatimit të ligjit është tepër i limituar.

Implementimi sa më pari i institucioneve edukuese dhe këshillues për të miturit, dhe zbatimi me rigorozitet i Kodit për Drejtësisë Penale për të Mitur mund të sjellë një ulje të shifrave të kriminalitetit nga të miturit në Shqipëri.

Në Kosovë, miratimi i Kodit të Drejtësisë për të Mitur ka përcaktuar disa lloj masash ndëshkimi në natyre edukuese për të miturit që janë në konflikt me ligjin. Është vënë re që korniza ligjore e miratuar nga Republika e Kosovës ka një lloj ndikimi në uljen e kriminalitetit.

BIBLIOGRAFIA

Konventa, Raporte, Botime

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_2016_1082.pdf
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës mmiratuar nga OKB
[https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/CRC_albanian_language_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf)
- Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2015; 2016
<https://ec.europa.eu/neighbourhood>
- A.Gjoleka, E.Shoshi, Komente mbi masat e sigurimit personal, Tiranë 1999, Botime “GEER”, fq. 6

Kodet dhe Ligjet

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2016_1033.pdf
- Kodi I Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
<https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/04/ligj-nr.-35-dt.-30.3.2017.pdf>
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur
<http://www.qbz.gov.al/botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fleto-re%2092/LIGJ%20nr.%2037,%20date%2030.3.2017.pdf>
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës, Prishtinë 2010



DREJTËSI NËPËRMJET RIEDUKIMIT TË TË MITURVE

Msc Eriola Hoxha

eriola.hoxha@raiffeisen.al

ABSTRAKT

Në situatat e konflikteve, fëmijët gjithnjë e më shumë dalin para sistemit të drejtësisë kombëtare e ndërkombëtare, qoftë si viktimë, dëshmitarë apo të pandehur.

Duke qënëse fëmijët fillojnë të preken nga ligji që në moshën 14 vjecare, lind nevoja që ligji t'i përshtatet edhe elementëve të veçantë që karakterizojnë këtë moshë. Vendosja para ligjit e fëmijëve të kësaj moshë ka ekspozuar zonat gri të sistemit ligjor shqiptar i cili nuk ka parashikuar në mënyrë të detajuarrehabilitimin e fëmijëve të cilët kryejnë kundravajtje apo vepra penale.

Interesi më i mirë i fëmijës është në fokus të çdo faktori human prandaj dhe rehabilitimi dhe riedukimi ifëmijëve është objektiv më i lartë se dënimi. Megjithëse një lloj infrastrukture është ngritur për rehabilitimin e fëmijëve që kanë kryer vepra penale, ende mbetet në nivele institucionale duke sjellë mungesë efience në zbatim.

Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë këto çështje :

- Së pari, dispozitat për rehabilitimin që janë pjesë e legjislacionit ndërkombëtar e pastaj shqiptar. Sa kanë gjetur ato praktikë këto vite.
- Së dyti, mekanizmat monitorues në vend për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e të gjithë procesit.
- Së fundmi, duke adresuar të metat në sistemin aktual, rekomandime për përmirësime duke iu referuar praktikave të suksesshme ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh natyrën shumëdimensionale të kësaj çështjeje, kufizimet e këtij dokumenti duhet të theksohen. Në këtë punim do të fokusohemi tek insi-

tutucionet e rehabilitimit, riedukimit dhe këshillimit, metodat e tjera si shërbi-
met komunitare nuk do të trajtohen.

Fjalët kyçe: *Të miturit, Drejtësia, Rehabilitimi, Riedukimi, Këshillimi*

HYRJA

*"Një pjesë e të miturve që kanë kryer vepra penale, kthehen në recidivistë."*³⁰⁷

Ky është një nga përfundimet e raportit të drejtorisë së përgjithshme të burgjeve. Është një fakt që të bën të reflektosh mbi mënyrën e dënimit të fëmijëve në konflikt me ligjin, si ndikon mënyra e dënimit tek ata dhe a rehabilitohen këta fëmijë apo rikthehen nga institucionet e dënimit me mendimin për të kryer vepra të tjera.

Fëmijët dhe të rinjtë janë një burim i madh njerëzor për zhvillim dhe agjentë kyçë për ndryshime kolektive shoqërore. Por kjo është e mundur vetëm kur ata përfshihen për në dialogjet domethënëse për çështjet që i prekin ata më së shumti. Ekziston nevoja për të forcuar familjen, shkollën dhe komunitetin - strukturat e tyre dhe sistemet e vlerave pasi ato sigurojnë një qëndrim gjithëpërfshirës dhe bëhen modele për fëmijët. Ekziston gjithashtu nevoja për të ndërmarrë veprime kolektive për të trajtuar problemin e tyre dhe për t'i fuqizuar ato, për t'i motivuar ata, duke u siguruar atyre një hartë rrugore për zhvillimin e vetvetes, në mënyrë që asnjëri të mos dale jashtë rrjetit të sigurisë shoqërore. Çdo fëmijë që vjen në kontakt me sistemin e drejtësisë për të mitur është një fëmijë në rrethana të vështira, i cili ka rënë nga rrjeti mbrojtës në një moment të caktuar. Fëmijët në konflikt me ligjin duhet të trajtohen si fëmijë në rrethana të vështira dhe qasja e sistemit të drejtësisë për të mitur duhet të synojë adresimin e dobësive të fëmijëve dhe sigurimin e rehabilitimit të tyre. Rëndësia e marrëdhënieve familjare dhe ndërnjerëzore duhet të mësohet nga prindërit tek fëmijët.

Një nga qëllimet e këtij punimi është të evidentojmë gjëndjen aktuale në Shqipëri të sistemit të riedukimit të të rinjve. Këtë do e arrijmë duke rishikuar literaturën dhe duke nxjerrë të dhëna nga raportet që janë publikuar në Shqipëri. Për të qënë më të qartë mbi gjëndjen aktuale të sistemit të edukimit zhvilluam një anketë në shkollat e mesme të Fierit dhe Patosit ku pati ne total 148 të anketuar online dhe shumë të tjerë që u përgjigjen gojarisht

307 (Ani Beqo, Blerta Doci, 2015)

PARIME NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË PËR TË MITURIT

*Kur kinezet e lashtë vendosën të jetojnë në paqe, ata ndërtuan Murin e Madh të Kinës. Gjatë 100 viteve të para të ekzistencës së saj, kinezët u pushtuan tri herë. Pushtuesit kurrë nuk paten nevojën të ngjiteshin në mur, ata korruptuan rojet dhe hapen dyert. Kinezët ndërtuan murin, por harruan ndërtimin e karakterit të rojeve! Kështu ndërtimi i karakterit njerëzor vjen përpara ndërtimit të çdo gjëje tjetër. Nëse dëshironi të shkatërroni qytetërimin e një kombi, ka tri mënyra: Shkatërroni strukturën e familjes, Shkatërroni arsimin, Ulni modelet e tyre te references.*³⁰⁸

Për të kuptuar më tepër mbi modelet më të mira ndërkombëtare mbi rehabilitimin e fëmijëve do të vendosim përbalëdy modele ndërkombëtare, modelin e mirëqenies dhe modelin e drejtësisë.³⁰⁹ Kur një individ dënohet për një vepër penale zakonisht merren në konsideratë tre pika kryesore : ndëshkimi , parandalimi dhe rehabilitimi. Në rastin kur individët janë të mitur, konsiderata më e lartëi shkon parimit të rehabilitimit.³¹⁰ Konsiderata e veçantë për të miturit brenda sistemit të drejtësisë penale nuk është një koncept i ri. Në sistemin ligjor romak, parimi “*doli incapax*” mbronte fëmijët e vegjël nga ndjekja penale për shkak të supozimit të mungesës së kapacitetit dhe të kuptuarit, fakt ky i nevojshëm për të qenë fajtor për një vepër penale. Kyparim vazhdon edhe sot dhe merret parasysht si nga prokurori ashtu dhe nga pala mbrojtëse.³¹¹ Shumica e vendeve kanë disa dispozita për trajtim të veçantë të fëmijëve që gjenden në konflikt me ligjin, megjithatë, shkalla në të cilën kjo ofrohet varion nga një vend në tjetrin .Në disa vende mbizotëron një model i “mirëqenies”, i cili fokusohet në nevojat e fëmijës, diagnozën, trajtimin dhe procedura më informale, ndërsa vendet e tjera favorizojnë një model ‘drejtësie’, i cili thekson përgjegjësinë, dënimin dhe formalitetin procedural. Belgjika përmendet shpesh si një shembull i një vendi me një proces të fortë të bazuar në mirëqenien e fëmijës, ku mosha minimale e përgjegjësisë penale është 18 vjeç. Kjo është edhe arsyeja pse kur u zhvillua një studim nga CRIN³¹², mbi efektivitetin me të cilin fëmijët e përdorin ligjin për të sfiduar shkeljetet e drejtave të tyre, ajo doli në vend të parë.³¹³ Në mënyrë të ngjashme, Franca ka

308 (REHABILITATION OF CHILDREN IN CONFLICT WITH THE LAW)

309 (Furbish, 1999)

310 (Alex Piquero, Laurence Steinberg, 2008)

311 (Matthew Johnston, Forbes Chambers, 2006)

312 Rjeti ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve.

313 (Yates, 2016)

ndërtuar një reputacion të fortë të drejtësisë bazuar në mirëqenie duke vendosur arsimim dhe rehabilitimin në qendër të reformave të drejtësisë rinore që në vitet 1940. Zelanda e Re në vitin 1989 krijoi sistemin e e Konferencës së Grupit Familjar si një pjesë integrale e drejtësisë për të miturit, me fokus në rivendosjen e marrëdhënieve dhe zvogëlimin e burgimit që do të konsiderohej pjesë e një qasjeje të mirëqenies. Në të kundërt, Britania e Madhe dhe SHBA-të tradicionalisht janë shoqëruar me një model drejtësie dhe moshë të ulët të përgjegjësisë penale - 10 vjet në Angli dhe Uells, dhe deri në 6 vjet në disa shtete të SHBA-së. Brenda tëdy-modeleve të mirëqenies apo drejtësisë, një i ri mund të privohet nga liria ku përfshihet paraburgimi dhe burgimi. Vendet në të cilat fëmijët mund të privohen nga liria përfshijnë stacionet e policise, qendrat e paraburgimit, burgjet e të miturve ose të rriturve etj. Megjithatë, do të ishte e gabuar të supozohej se sistemet e mirëqenies janë automatikisht të preferueshme ndaj një qasjeje të drejtësisë për të miturit, meqë rregullimet e mirëqenies mund të jenë po aq shtrënguese sa i përket privimit të lirisë së të miturve.

HISTORIA E DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

Për shumë vite Shqipëria nuk ka patur një kod dedikuar plotësisht të miturve po dispozita për ta gjendeshin në shumë kode dhe ligje. Nuk ka patur një sistem të unifikuar për fëmijët dhe shpesh ata trajtoheshin si të rriturit.³¹⁴ Sidoqoftë fëmijët para ligjit duhet të trajtohen sitë tillë. Në Shqipëri më parë nuk ka egzistuar një institucion dënimi i mirëfilltë për fëmijët. Burgu i Vaqarrit njihej si burg për të miturit por, ai thjesht kishte një seksion për të miturit, sic kishin edhe burgje të tjerë. Më pas u ndërtua institucioni në Kavajë që shërben si qendër rehabilitimi, shkollimi dhe këshillimi vetëm për të miturit të cilët për arsye të ndryshme kanë probleme me ligjin në Shqipëri. Për organizimin e aktiviteteve, implemtohen module të zbatuara nga institucionet evropiane për këtë kategori si Spanja, Holanda, etj. Pjesën më të madhe të kohës e zënë programet e ndryshme mësimore, sociale e psikologjike për t'i ardhur në ndihmë minorenëve dhe veçanërisht të mos përsërisin ato vepra penale për të cilat janë dënuar.³¹⁵ Statistikat e drejtorisë së përgjithshme të burgjeve treguan se ka patur një rritje të të dënuarve të moshës 14-16 vjec, vitin e kaluar në janar ka qenë 1 i dënuar ndërsa këtë vit janë 5. Të burgosurit nga 16-18 janë më pak por vlerën maksimale e kanë

314 (Arta Mandro, Altin Hazizaj, 2007)

315 (Instituti i të Miturve Kavajë: Aktivitete të Shumta për të Miturit, 2009)

patur në gusht të vitit të kaluar me 10 të dënuar. Shifrat janë më të larta për të miturit në paraburgim që kanë patur luhatje gjithë vitin me maksimumin e tyre në shkurt të vitut të kaluar me 49 të ndaluar te grupmoshës 16-18. Ndërkohë që trendi i të ndaluarve vjen duke u ulur drejt fundvitit për grupmoshen 16-18, në rastin e grupmoshës 14-16 vjen duke u rritur.

MONITORIMI

Kur flasim për monitorimin e kemi fjalën si për monitorimin e fëmijëve të cilët kanë kryer tashmë vepra penale dhe prirjete tyre për recidivizëm ashtuedhe monitorimin e efencës së projekteve që ka ndërmarrë shteti shqiptar për të mbrojtur të miturit nëpërmjet institucioneve të riedukimit.

Hapja e burgut të Kavajës ishte një hap shumë i rëndësishëm por ky institucion si dhe institucionet e tjera ku ka të mitur në burgim apo në paraburgim kanë hasur probleme për vite me rradhë. Informimi i të miturve për të drejtat e tyre ka qënë një problem shqetësues. Gjatë vëzhgimeve tëKShH janë vërejtur disa çështje shqetësuese për të miturit: Në momentin e arrestimit atyre nuk u janë bërë të ditura të drejtat e tyre dhe nuk kanë patur një avokat në dispozicion edhe pse e kanë kërkuar. Dhuna psikologjike dhe fizike nga punonjësit e policisë ka qënë prezente gjatë gjithë procesit dhe fatkeqësisht askush nuk është vënë para përgjegjësisë për këtë fakt. Në institucionet e dënimit mungonin programe rikrijuese , sportive e argëtuese.³¹⁶Problematika e dhunës vazhdon edhe sot. Shqetësuese mbetet përdorimi i forcës jo proporcionale, në disa raste, nga ana e forcave të policisë.³¹⁷ Gjithashtu juristët që bëjnë marrjen në pyetje nuk kanë kryer studime për psikologji dhe kështu të miturit privohen nga e drejta e tyre për të marre shërbim psikologjik. Për sa i përket edukimit të fëmijëve në IVM Kavajë, zhvillohet programi mësimor në 4 klasa të sistemit 9-vjecar. Për rehabilitimin e tyre ndërmerren programe të veçanta trajtimi dhe rehabilitimi, si dhe kurse profesionale të ndryshme (për hidraulik, elektrik dhe punë me dru, megjithëse rezultojn të ketë mungesë të furnizimit me lëndë të parë dhe materi-

316 (RAPORT MBI GJENDJEN E TË DREJTAVE TË TË MITURVE NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE , 2009) Vëzhgimi është kryer në kuadër të programit të reformës së drejtësisë për të miturit. Cjetjet e këtij raporti janë të KSHH-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të organizatave mbështetëse

317 (RAPORT MBI SITUATËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË KOMISARIATET E POLICISË SË SHTETIT,NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE NË SPITALET PSIKIATRIKE, 2016) fq 8


ale të nevojshme për punë). Edukimi i fëmijëve fillon nga familja , te shkolla dhe kur shkolla nuk ia del atëherë kalohet tek institucionet e riedukimit. Fëmijët mund të shfaqin sjellje jo të rregullta po ato ndalohen që në shkolla nëpërmjet informimit për të drejtat e tyre dhe konsultave të vazhdueshme me psikologët në momentet që fëmija mund të ketë probleme emocionale.

Gjatë vëzhgimit në shkollat e mesme të Fierit dhe Patosit dhe intervistave me studentët kuptuam që kishte prezencë të fëmijëve me probleme, disa prej tyre madje me krenari thanë se ishin ata vetë “të fortët e klasës”. Disa prej tyre, në anketën që kryem, për pyetjen a ka patur raste të situatave të rrezikshme në shkollë u shprehën :*“Kanë ndodhur disa konflikte midis nxënësve që kanë përfunduar me përdorim të dhunës fizike. Ka pasur disa probleme psikologjike kur nxënësit kanë përdorur ilaçe të dëmshme për qëllime vetvrasje”, “Janë rrahur me thika.”, “Sherr në shkollë”, “Zënka dhe rrahje”*... Nga rezultatet e anketës ku 62 % ishin femra doli që 85% prej tyre pranuan që kishin psikolog në shkollë por vetëm 42 % konsultoheshin me të në momentin që kishin njëproblem. Pyetjes a ka adoleshent apo fëmijë në shkollë që kanë probleme me ligjin iu përgjigjen me po 23 % e të anketuarve. Krahas të miturve me probleme me ligjin kemi edhe kategorinë tjetër që ka sjellje të rrezikshme ku mbi gjysma e të anketuarve pohuan se kishte të tillë në shkollën e tyre. Në momentin që një fëmijë bën sjellje të rrezikshme kjo reflektohet edhe tek mësuesit të cilët sillen ndryshe me të përprjekje për ta ndihmuar.

1 Grafik mbi anketimin

Nese ju shqetesoheni nga nje femije tjetere ne shkollë ku drejtoheni?

147 responses



Sic mund të shikohet dhe në grafik të miturit nuk drejtohen tek policia në rastet kur ata ndihen të shqetësuar. Autoriteti i mësuesit mbetet i fortë dhe ata i drejtohen mësuesit në përqindjen më të madhe.

REKOMANDIME

Studimet tregojnë se mënyra më efektive për të gjetur zgjidhje konstruktive për përfshirjen e fëmijëve në veprimtaritë që shkulin një ligj është përfshirja e fëmijëve në procesin e rehabilitimit dhe mos konsiderimi i tyre si thjesht “krijues problemesh” ose si “fëmijë problematik” që kanë nevojë për dënim . Njohja dhe respektimi i të drejtave të tyre si qenie njerëzore dhe si fëmijë është hapi i parë i rëndësishëm në këtë drejtim.

Për rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të fëmijëve në konflikt me ligjin bëhet e domosdoshme zhvillimi i një qasje shumëdimensionale. Parandalimi i krimeve nga të miturit, ndërhyrjet e duhura në kohë mund të ndihmojnë në forcimin e procesit të rehabilitimit. Fokus duhet të jepet në adresimin e të gjitha nevojave të jetës së fëmijës: emocionale, fizike, relacionale, intelektuale, krijuese dhe shpirtërore.

Ne duhet të zhvendosim qëndrimet tona nga qasja e bazuar në nevojë, tek qasja e bazuar në të drejta, ndërsa rehabilitojmë fëmijët në konflikt me ligjin.

MASAT PER REHABILITIM

Rehabilitimi është një hap vendimtar për t'i integruar viktimat dhe fëmijët në konflikt me ligjin në shoqëri, si dhe për të parandaluar recidivizmin. Kjo nuk mund të kryhet pa mbajtur asnjë të dhënë për të vlerësuar statusin e tyre socio-ekonomik dhe arsimor.

Masat e rehabilitimit gjithashtu duhet të jenë të ndryshme për fëmijët në konflikt me ligjin që janë në kujdesin institucional dhe ata që janë liruar nga institucioni. Ndërsa institucionet e kujdesit të fëmijëve duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar rehabilitimin e fëmijës kur ai / ajo është në kujdesin e tyre, punonjësit social gjithashtu duhet të sigurohen që procesi i rehabilitimit të mos ndërpritet kur fëmija të hyjë në komunitet. Ekzistojnë shumë faktorë që duhet të merren parasysh kur imagjinoni situatën e një fëmije në konflikt me ligjin. Këto përfshihen ndikimet socio-psikologjike, familjare dhe të lidhura me kolegët. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) pranon rëndësinë e largimit të shkelësve të rinj nga proceset zyrtare të sistemit të drejtësisë penale. Parandalimi i të miturve nga kryerja e kundërvajtjeve është një pjesë thelbësore e parandalimit të krimit në shoqëri. Parandalimi fillon nga programe

të bazuara në komunitet, duke u përpjekur të adresojë problemin aty ku fillon - në familje dhe në komunitet. Programet parandaluese mund të klasifikohen si: (a) parandalim i pastër ose parandalimi parësor, i cili synon të pengojë delikuencën para se të ndodhë, dhe (b) parandalimi rehabilitues ose parandalimi dytësor, merret me të rinjtë të cilët janë gjykuar si delinkuent nga gjykatat.

Për të nxitur parandalimin janë disa aktivitete që mund të kryhen në ndihmë të fëmijëve.

- Kryerja e kërkimeve për të gjetur shkakun rrënjësor të krimeve tek te miturit, në mënyrë që ndërhyrjet e duhura të mund të bëhen.
- Kryerja e programeve të ndërgjegjësimit në nivel komuniteti për fëmijët dhe të rriturit.
- Përforcimi i klubeve rinore
- Kryerja e mbledhjeve të rregullta të Komiteteve të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel fshati dhe qyteti

PËRFUNDIME

Fuqizimi i fëmijëve duke siguruar të drejtat dhe dinjitetin e tyre njerëzor, ofron një mundësi për të ndryshuar, ndryshimin që kërkohet për rritjen dhe zhvillimin e vendit tonë. Mënyra se si merremi me fëmijët tanë flet shumë për karakterin tonë dhe siguron krijimin e një baze konkrete për gjeneratat e ardhshme që do vijnë.

“Nënvlerësimi i vlerës së një fëmije nënvlerëson vlerën e kombit tonë.” Që rehabilitimi të jetë i suksesshëm bëhet e domosdoshme ndjekja e rregull e të miturve gjatë gjithë procesit të marrjes në pyetje, analizimit të gjendjes, paraburgimit, burgimit, daljes nga burgu dhe reintegrimit të tyre në shoqëri. Roli i punonjësve socialë bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm, pasi fëmijëve duhet t’u sigurohet ndihma e vazhdueshme edhe pas rehabilitimit që të shmanget përsëritja. Përgjegjësia për mbrojtjen e fëmijëve tanë nuk është vetëm për qeverinë dhe OJQ-ve që punojnë për të, por gjithashtu një përgjegjësi kolektive e të gjithë qytetarëve. Secili individ duhet të jetë i ndjeshëm ndaj punës dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Gjatë anketimit me të rinjtë e Fierit dhe Patosit kuptuam që ka të rinj me sjellje të rrezikshme dhe ka një përqindje të lartë të bullizmit. Një nga problemet so-

cialë në këtë mes është që këta fëmijë janë bërë modele në shkolla. Psikologët janë të pranishëm në shkolla por roli i tyre është i dobët. Ndërkohë roli i mësuesit mbetet i fortë dhe të miturit i drejtohen atyre kur kanë probleme me të miturit e tjerë.

BIBLIOGRAFIA

- Alex Piquero, Laurence Steinberg. (2008). *Rehabilitation Versus Incarceration of Juvenile Offenders*.
- Ani Beqo, Blerta Doci. (2015). *Të miturit në konflikt me ligjin: Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve*. Tirane: Drejtoria e përgjithshme e burgjeve.
- Arta Mandro, Altin Hazizaj. (2007). *Juvenile justice in albania: An analysis of the juvenile system and the situation of juveniles in Albania*. UNICEF Albania.
- Burgjeve, D. I. (2008). Hapet në Korrik Instituti i të Miturve në Kavajë. (G. Shekulli)
- Furbish, L. K. (1999). *Western european juvenile justice models*. Marre nga www.cga.ct.gov
- (2009). *Instituti i të Miturve Kavajë: Aktivitete të Shumta për të Miturit*. DPB
- Matthew Johnston, Forbes Chambers. (2006). *oli Incapax - The Criminal Responsibility of Children*. *Childrens Law News*.
- (2009). *Raport mbi gjendjen e të drejtave të të miturve në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale*. Komiteti shqiptar i Helsinkit.
- (2017). *Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për 2016*. Tirane: Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- (2016). *Raport mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisaritet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike*. Tirane: Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- *Rehabilitation of children in conflict with the law*. (n.d.).
- Susan Young, B. G. (2017). *Juvenile delinquency, welfare, justice and therapeutic interventions: a global perspective*. *NCBI*.
- Yates, V. (2016). *Press release: first global ranking on access to justice for children released*.

PERGJEGJESIA PENALE PER TE MITURIT NE KENDVESHTRIMIN KRAHASUES ME LEGJISLACIONIN PENAL TË DISA VENDEVE EUROPIANE

Doktorant Av. Arben V. PRIFTI

Pedagog në Universitetin Mesdhetar

arbenprifti@hotmail.com

Prof.Asoc. Alketa ELEZI

Zv/Dekane në Universitetin Mesdhetar

alketaelezi@umsh.edu.al

Prof. Asoc. Dr. Nevila RAMA

Zv/Rektore e Universitetit Mesdhetar

nevilarama@umsh.edu.al

HYRJE

Përgjegjësia penale për të mitur si një ndër institutet e të drejtës penale është një koncept juridik, i parashikuar në legjislacionin penal të çdo vendi. Ky nocion juridik lidhet me krieteret, veçoritë dhe karakteristikat e legjislacionit të vendeve të ndryshme që përfshijnë në mënyrë të veçantë subjektin fëmijë ose minoren. Kufijtë e moshës për përgjegjësinë penale për të miturit, nuk janë të njëjtë në çdo vend. Por, pothuajse në të gjitha vendet europiane, përa i përket kufirit maksimal të përgjegjësisë penale për këtë subjekt të së drejtës, është caktuar të jetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç. Në Shqipëri dhe vende të tilla si Gjermania, Anglia dhe Uells, Belgjika, Franca, Italia, Holanda dhe Zvicra, kanë parashikuar në ligjin penal, këtë kufi maksimal të moshës për përgjegjësinë penale për të miturit. Në *Spanjë*, kufiri maksimal për përgjegjësinë penale për të miturit është gjashtëmbëdhjetë vjeç, por Parlamenti po shqyrton aktualisht një projektligj që synon veçanërisht ta zgjerojë atë deri në tetëm-

bëdhjetë vjeç. Sa i përket Portugalisë, parashikohet që Kodi Penal nuk është i zbatueshëm për të rinjtë nga mosha gjashtëmbëdhjetë vjeç deri në njëzet e një vjeç.

Nga ana tjetër, mosha e përgjegjesisë penale, përkatësisht mosha në të cilën të miturit konsiderohen si kufiri i mjaftueshëm për të qënë në gjëndje të kryejnë një vepër penale dhe të jenë subjekt i një ligji të veçantë penal, ndryshon shumë në vende të ndryshme evropiane.

Kufijtë e moshës që lidhen me përgjegjësinë penale të të miturve dhe pasojat që vijnë nga kryerja e veprës penale janë studiuar në nëntë vende evropiane të përmendura më sipër ku dallojmë se:

a) mosha e përgjegjesisë penale është një koncept absolut në disa vende dhe relative në vende të tjera;

b) të miturit përgjegjës penalisht, ndëshkohen me burgim vetëm në raste të veçanta përjashtimore.

1) Kufiri i moshës së përgjegjesisë penale është një nocion absolut në disa vende dhe relative në disa të tjerë.

Duke trajtuar legjislacionin penal për të mitur të vendeve evropiane, ato i ndajmë në dy grupe: Anglia dhe Uellsi, Spanja, Holanda, Portugalia dhe Zvicra i përkasin grupit të parë, ndërsa Gjermania, Belgjika, Franca dhe Italia i përkasin grupit të dytë.

a) Përgjegjësia absolute.

Në Angli dhe Uells, Spanjë, Hollandë, Portugali dhe Zvicër, një i mitur që nuk ka arritur moshën e përgjegjesisë penale, në asnjë rast nuk mund të konsiderohet përgjegjës penalisht. Në këto pesë shtete, mosha e përgjegjesisë penale, ose kufiri minimal në të cilin fillon përgjegjësia penale varion nga shtatë deri në gjashtëmbëdhjetë vjeç: *shtatë* vjeç në Zvicër, *dhjetë* vjeç në Angli dhe Uells, *dymbëdhjetë* vjeç në Holandë dhe *gjashtëmbëdhjetë* vjeç në Francë, Spanjë dhe Portugali.

Pavarësisht përcaktimit të kufirit minimal të përgjegjesisë penale, këto vende po parashikojnë të ndryshojnë kufirin minimal. Kështu, Zvicra ka në plan

të rrisë përgjegjësinë penale deri në dhjetë vjeç. Holanda, në vitin 1994, e uli këtë kufi nga katërbëdhjetë vjeç në dymbëdhjetë vjeç. Parlamenti spanjoll po shqyrton aktualisht një projekt-ligj organik që rregullon drejtësinë penale për të miturit, që përfshin reduktimin e saj nga gjashtëmbëdhjetë në trembëdhjetë vjeç. Në Angli dhe Uells, supozimi i papërgjegjshmërisë që ekzistonte për të mirën e fëmijëve të moshës nga dhjetë deri në katërbëdhjetë vjeç, është hequr shumë vonë.

b) Përgjegjësia relative.

Në vende të tjera, një i mitur i cili nuk ka arritur moshën e përgjegjësive penale, mendohet të jetë i papërgjegjshëm, por, nga një moshë më e ulët se ajo e kufirit të përgjegjësive penale, përgjegjësi e cila mundet të caktohet nëse janë plotësuar disa rrethana. Moshë relative e përgjegjësive penale ndryshon në vendet e grupit të dytë: kështu, në Francë është trembëdhjetë vjeç, në Gjermani dhe Itali është 14-vjeç, dhe në Belgjikë është 16-vjeç. Përballë zhvillimit të shkeljeve të rënda penale të kryera nga të miturit dhe numrit të rritjes së tyre, disa vende si Gjermania dhe Belgjika kanë tendencë të ulin kufirin minimal të moshës së përgjegjësive penale në 12 vjeç.

Rrethanat që heqin dorë nga prezumimi i përgjegjësive penale të të miturve, gjithashtu, ndryshojnë nga vendi në vend. Gjermania dhe Italia mbajnë një kriter thelbësisht juridik: i pari, i referohet maturisë dhe dallimit të autorit të mitur delikuent, dhe i dyti, «*aftësisë së tij për të kuptuar dhe dëshiruar*» pasojat e veprës penale të kryer. Nga ana tjetër, Belgjika dhe Franca këmbëngulin për përshtatshmërinë e masave, që mund të vendosin gjykatat e specializuara për të miturit.

2) Autorët e mitur të veprave penale, në shumicën e rasteve, nuk dënohen me burgim.

(a) Legjislacioni penal për të mitur ka parashikuar si dënim minimal gjobën penale.

Në të gjitha vendet e studiuara më lartë, masat e zbatueshme për autorët minorë të kryerjes së veprës penale, janë kryesisht masa me karakter edukativ dhe disiplinor.

Kështu, në Gjermani, vetëm dënimi me burg është një sanksion penal shumë

i rëndë, por në praktikë asnjëherë nuk u është imponuar të rinjve nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Rasti është i ngjashëm në Belgjikë, ku vetëm të rinjtë mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç mund t'u nënshtrohen masave të tjera me karakter edukues. Ligji organik spanjoll që rregullon drejtësinë për të mitur favorizon masat social-edukative. Në Itali, një dekret i vitit 1988 parashikonte sanksione alternative të hartuara për të parandaluar burgosjen e të miturve. Në Holandë, shumica e kundërvajtjeve janë trajtuar jashtë procedurës penale, me anë të reparacionit personal. Në Portugali, kur vepra penale dënohet me burgim më pak se dy vjet, gjyqtari mund të caktojë ndaj autorit të mitur një ose më shumë masa educative për mbrojtjen e të miturve. Në Zvicër, nuk mund të caktohet sanksion penal ndaj të miturve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

Por, ndryshe zbatohet ligji anglez, të miratuar në vitin 1998, që parashikon mundësinë e burgimit të të miturve duke filluar nga moshë 12 vjeç.

(b) Belgjika dhe Holanda janë të vetmet vende ku gjyqtari mund të vendosë dënim me burg mbi moshën e përgjegjësive penale.

Në secilën nga këto dy vende, shkalla e shkeljes dhe personaliteti i autorit mund ta çojë gjykatësin të konsiderojë një delikuent të mitur si një person të rritur sapo të mbushë moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Në një rast të tillë, autori i ri i nënshtrohet ligjit penal të zbatueshëm për të rriturit. Në anën tjetër, disa vende parashikojnë mundësinë e shtyrjes së kufirit maksimal të moshës së përgjegjësive penale. Kështu, Gjermania dhe Holanda lejojnë zbatimin e ligjit penal për të mitur deri në moshën njëzet e një vjeç. Ligji spanjoll, gjithashtu, e përfshin këtë dispozitë. Në mënyrë të ngjashme, Kodi Penal Zviceran parashikon masa specifike për të rinjtë e moshës midis 18 dhe 25 vjeç, ndërsa në Portugali, të rinjtë ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë dhe njëzet e një nuk i nënshtrohen kodit penal, por në një teksti të veçantë të ligjit material.

3. Sistemi i përgjegjësive penale sipas legjislacionit në disa vende të Europës.

1. Në Shqipëri, me ligjin nr. 37/2017 të Kuvendit, është miratuar **Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur**, i cili përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Risia e këtij kodi është se ka parashikuar një sërë masash me karakter edukativ e social, por ai përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij.

Mosha e përgjegjesisë penale për të miturit.

Për qëllime të përgjegjesisë penale për krimet, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur ***moshën 14 vjeç***, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit. Ndërsa për përgjegjësinë për kundërvajtjet penale, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 16 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij.

Organi procedural mund të caktojë ***masa alternative*** të mundshme për shmangien nga ndjekja penale të të miturit. ***Masat alternative për shmangien*** nga ndjekja penale mund të përfshijnë:

a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit; b) këshillimin për të miturin dhe familjen; c) paralajmërimin me gojë; ç) paralajmërimin me shkrim; d) masat detyruese; dh) vendosjen nën kujdes.

Programi i drejtësisë restauruese, zbatohet nëse: a) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë; dhe b) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme ose e përshtatshme. Programi i drejtësisë restauruese, mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohej: a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës; b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë; c) t'i kërkojë falje viktimës; dhe ç) të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimat ose/dhe komuniteti.

Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore zhvillohet nga ndërmjetësi sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjit në fuqi për ndërmjetësimin. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimin i lirë për ndërmjetësimin i shprehur si nga i mituri i akuzuar i veprës penale dhe palës së dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues.

Sipas nenit 65 të këtij Kodi është parashikuar si masë dënimi ***Këshillimi për të miturin dhe familjen***. Ndërsa në nenin 66 të tij, është parashikuar si lloj

dënimi ***Paralajmërimi me gojë***, i cili përfshin gjithë shpjegimet që i jepen të miturit nga organet kompetente, mbi dëmin e shkaktuar prej veprimeve të tij dhe pasojave që rrjedhin nëse vepra penale do të përsëritet. Neni 67, parashikon ***Paralajmërimi me shkrim***, i cili përfshin pasqyrimin në një procesverbal të të gjitha shpjegimeve, sipas nenit 65, të këtij Kodi, që i jepen të miturit prej organeve kompetente.

Në nenin 68 të kodit janë parashikuar ***Masat detyruese ndaj të miturit***, të cilat mund të caktohet që ai të ndalohet:

a) të kontaktojë/takojë një person të caktuar b) të shkojë/vizitojë një vend të caktuar; c) të ndryshojë vendin e banimit; ç) të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar; d) të largohet pa leje nga një vend ose nga një rajon administrativ i përcaktuar; dh) të kryejë ndonjë veprim tjetër që pengon rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij.

Masat detyruese për të miturin janë:

a) të fillojë ose të rifillojë studimet në një institucion arsimor; b) të fillojë të punojë, duke pasur parasysh dhe respektuar dispozitat e Kodit të Punës; c) të kryejë një program edukativ, korrigjues dhe/ose mjekësor; ç) të përmbushë detyrime të tjera që do të përforcojnë rishoqërimin e tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale.

Në nenin 69 është parashikuar ***Vendosja nën kujdes e të miturit***, dhe në nenin 70 është parashikuar ***Përmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale*** si dhe Mospërmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale.

Në nenin 15 të këtij kodi është parashikuar Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit ndaj të miturit delikuent. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë.

Në neni 82 të këtij kodi, janë parashikuar ***masa sigurimi të veçanta për të miturit***. Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa:

a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje; b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.

Në neni 95 të kodit, janë parashikuar ***Llojet e dënimeve për të mitur*** të cilat

ndahen në dënime jo me burgim dhe dënimi me burgim. Në **dënimet jo me burgim** përfshihen: a) kufizimi i lirisë; b) qëndrimi në shtëpi; c) gjoba; ç) kryerja e një pune me interes publik; d) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; dh) përmbushja e detyrimeve të caktuara.

Në nenin 96 të kodit, është parashikuar **Klasifikimi dhe caktimi i dënimeve për të mitur** në dënime kryesore dhe plotësuese. Janë **dënime kryesore**: a) burgimi; b) kufizimi i lirisë; c) gjoba. Janë **dënime plotësuese**: a) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; b) kryerja e një pune me interes publik; c) përmbushja e detyrimeve të caktuara; ç) qëndrimi në shtëpi. Ndaj të miturit mund të **jepet vetëm një dënim kryesor**. Dënimi kryesor mund të jepet së bashku më jo më shumë se një dënim plotësues.

Sipas nenit 97 të këtij kodi, **Burgimi ndaj një të mituri** mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një veprë penale për të cilën **minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet** dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.

2.Kodi Penal Gjerman, përcakton parimin e papërgjegjshmërisë absolute të të miturve nën moshën **katërmëdhjetë vjeç**.

Ligji i Gjykatës për të Mitur nënkupton përgjegjësinë penale të të rinjve mbi moshën katërmëdhjetë vjeç dhe nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, por gjithashtu përcakton që përgjegjësia e tyre mund të vihet në zbatim nëse pjekuria intelektuale e tyre në kohën e kryerjes së veprës penale, justifikon veprimin e të miturit. Sidoqoftë, këta të rinj nuk i nënshtrohen asnjëherë ligjit të përgjithshëm penal, por një ligji penal specifik për Gjykatën e të Miturve.

1) Moshë e përgjegjësisë penale

Në lidhje me këtë institut, duhet të kemi parasysh kufirin minimal dhe maksimal të përgjegjësisë penale për të miturit. Kufiri i përgjegjësisë penale, si ai minimal por edhe ai maksimal, ndryshon sipas kushteve dhe veçorive të legjislacionit penal për të miturit.

a) Papërgjegjshmëri absolute e të miturve nën moshën katërmëdhjetë vjeç.

Neni 19 i Kodit Penal gjerman parashikon që “personi, që ende nuk ka mbushur katërbëdhjetë vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk mund të jetë fajtor”. Por, nga ana tjetër, duhet thënë se kohët e fundit po bëhen përpjekje dhe vërehen tendenca që përkrahin uljen e këtij kufiri në **dymbëdhjetë vjet**.

b) Përgjegjësia relative e të miturve duke filluar nga mosha 14 vjeç.

Ligji për Gjykatën për të Mitur, në nenin 3 përcakton: “*Një i mitur është përgjegjës penalisht nëse, në kohën e veprës, sipas zhvillimit të tij moral dhe shpirtëror, ka arritur mjaftueshëm pjekurinë për të dalluar dëmin e krijuar nga veprimi dhe për të vepruar në përputhje me rrethanat*”. Kur këta minorene janë përgjegjës penalisht për një veprë penale, ata nuk i nënshtrohen kodit penal, por ligjit penal për të mitur.

(c) Mundësia e shtyrjes të moshës të përgjegjësisë penale.

Të rinjtë e moshës nga 18 deri 21 vjeç janë teorikisht përgjegjës penalisht dhe gjykohen si të rritur nga gjykatat e zakonshme penale. Megjithatë, ato mund t'i nënshtrohen ligjit për gjykatën e të miturve, nëse “*një vlerësim i përgjithshëm i personalitetit të autorit, duke marrë parasysh edhe kushtet e jetesës, zbulon se ai është, me zhvillimin e tij moral dhe intelektual, në kohë e fakte, të ngjashme me një minorene*”.

Dispozita e mësipërme zbatohet në rreth dy të tretat e rasteve në praktikë. Kjo praktikë është në përputhje me kërkesat e Gjykatës Supreme Federale gjermane, sipas së cilës, është e nevojshme të kontrollohet në mënyrë shumë strikte, nëse janë plotësuar kushtet e zbatimit të ligjit të përgjithshëm penal. Kur është në dyshim, Gjykata e Lartë Federale avokon zbatimin e ligjit penal për të mitur.

2) Masat e zbatueshme për autorët e mitur.

Për të miturit nga mosha katërbëdhjetë vjeç deri në moshën që pjekuria e tyre e justifikon caktimin e saj, zbatohen një sërë masash të karakterit penal. Ligji i Gjykatës për të Mitur i klasifikon këto sanksione në tri kategori: masa edukative, masa disiplinore dhe burgim specifik për të rinjtë. Vetëm sanksioni i tretë përbën një dënim penal.

a) Masat edukative

Caktimi i këtyre masave në thelb kanë të bëjnë me detyrimin që kanë subjekti

“I mitur” për t’u nënshtruar rregullave të caktuara të sjelljes, të cilat veçanërisht kanë të bëjnë me vendbanimin, me pjesëmarrjen në trajnim, me ndalimin e frekuentimit të një kategorie të caktuar të personave delikuent dhe vendeve të caktuara.

(b) Masat disiplinore

Këto masa imponohen nëse masat edukative konsiderohen të pamjaftueshëm. Ato ndahen në tri grupe:

1.paralajmërimi solemn; 2.njoftimi i detyrimeve (apologjia personale, kompensimi i viktimës për dëmet e shkaktuara, pagesa e një shume parash për një organizatë me interes të përgjithshëm);

3.ndalim i posaçëm për autorin e mitur (*Jugendarrest*), dënim i cili nuk konsiderohet penalisht dhe nuk është futur në dosjen penale. Kjo masë trajtohet në një mjedis të specializuar në mënyra të ndryshme: ndalimin e fundjavës (maksimum dy fundjavë), afatshkurtër (dy deri në katër ditë) dhe afatgjatë (një deri në katër javë).

(c) dënimin me burgim

Dënimi me burgim(*Jugendstrafe*) caktohet kur masat edukative dhe disiplinore konsiderohen të pamjaftueshme duke marrë parasysh, seriozitetin e veprës së kryer, ose të “*dispozitave të rrezikshme*” të të riut delikuent.

Kohëzgjatja e dënimit, në parim nga ***gjashtë muaj deri në pesë vjet***, por mund të jetë deri në dhjetë vjet nëse ligji penal i përgjithshëm parashikon dënimin me burg prej më shumë se dhjetë vjet për veprën penale. Ligji gjithashtu thekson se kohëzgjatja e dënimit duhet të llogaritet në mënyrë të tillë që të mundësojë “*efektin arsimor të kërkuar*”.

Ky dënim kryhet në burgjet e të miturve. Këto nuk janë zakonisht institucione të specializuara, por mjedise të ndara në institucionet e të rriturve.

Në praktikë, ky dënim nuk u imponohet të rinjve nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Përveç kësaj, gjyqtarët po përdorin gjithnjë e më shumë lirinë e tyre për të hequr dënimet kur kohëzgjatja e dënimit nuk i kalon dy vjet.

3.Ligji për Krimet dhe prishjen e rendit publik , në Angli dhe Uells, i miratuar më 31 korrik 1998, hoqi prezumimin e papërgjegjshmërisë së të miturve mid-

is moshës 10 dhe 14 vjeç. Para kësaj date, një i mitur i moshës nga dhjetë deri në katëmbëdhjetë vjeç, i cili kishte kryer një vepër penale, ishte supozuar i papërgjegjshëm sepse nuk kishte pjekurinë për të dalluar të mirën dhe të keqen. Megjithatë, ky supozim mund të hidhej poshtë duke pohuar se fëmija ishte i vetëdijshëm për pasojat e veprimit të tij.

1) Mosha e përgjegjesisë penale

Si u theksua më sipër, Neni 34 i *Ligjit për "Krimet dhe prishjen e rendit publik"* ka hequr prezumimin e papërgjegjesisë penale për fëmijët e moshës 10 deri në 14 vjeç. Që atëherë, mosha e përgjegjesisë penale është dhjetë vjeç. Nga ana tjetër, mosha e kufirit maksimal të përgjegjesisë penale nuk ka ndryshuar: ai është tetëmbëdhjetë vjeç.

2) Masat e zbatueshme për autorët e rinj delikuent.

Të rinjtë ndaj të cilëve zbatohen këto sanksione janë fëmijët dhe adoleshentët në moshë ndërmjet dhjetë dhe shtatëmbëdhjetë vjeç.

a) Masat edukative dhe disiplinore.

Në rastin e një kundërvajtjeje të kryer për herë të parë, oficerët e policisë i drejtohen me një **këshillim**, autorit minoren. Kur vepra është më e rëndë, është **grykëta** që vendos. Ajo mund të imponojë masat e mëposhtme, shumica e të cilave janë të zbatueshme vetëm për të rinjtë mbi gjashtëmbëdhjetë vjeç si:

1.vënia në provë, për një maksimum prej tre vjetësh; 2.një **dënim me** shërbim në komunitet **nga** 40 deri në 240 orë; 3.**dënim i kombinuar** që përfshin provën dhe shërbimin e komunitetit; 4.respektimi i një **mbikëqyrjeje**, e cila, që nga viti 1996, mund të kontrollohet me mbajtjen e byzylykut elektronik; 5.një **urdhër mbikëqyrjeje** për një periudhë prej një deri në tre vjet, që mund të përfshijë një kërkesë për qëndrim, për të rinjtë nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç; 6.**detyrimi për të marrë pjesë**, për dy ose tre orë çdo të shtunë, **në aktivitete të organizuara**, shpesh nëpër shkolla. Ky dënim vlen për të rinjtë në mes të moshës dhjetë deri njëzet e një vjeç.

Masat e reja janë parashikuar nga Ligji për *Krimet dhe prishjen e rendit publik të vitit* 1998. Ata janë testuar që nga 30 shtatori i vitit 2000 në disa rajone dhe do të zbatohen në të gjithë vendin si: a)nëse është shkëlqej për herë të parë, autori do të marrë një **paralajmërim**, për

shkeljen e mëvonshme, ose një vepër më të rëndë; b) caktimi i një **urdhër për dëmshpërblim** për të mirën e viktimës, nëse ai e pranon, ose të bashkësisë; c) **urdhri i mbikëqyrjes** do të përfshijë gjithashtu një detyrim të dëmshpërblimit në dobi të viktimës ose komunitetit; d) **dënimi në shërbim të komunitetit** do të jetë për një periudhë prej tre muajsh. Programi që duhet të respektohet nga i mituri do të synojë parandalimin e recidivizmit dhe promovimin e riintegritimit.

(b) dënimin me burgim

Kur **faktet e pretenduara** ndaj të miturit mbi dymbëdhjetë vjeç janë aq serioze sa do të justifikonin, nëse do të ishin kryer nga një person që ka të paktën njëzet e një vjeç, në rast se lirimi i autorit paraqet rrezik për rendin publik, sanksioni i vendosur nga gjykata mund të jetë **një dënim me burgim**.

Kur autori delikuent është midis moshës nga dymbëdhjetë dhe katërmbëdhjetë vjeç, atëhere ai mund të ngarkohet me një *urdhër trajnimi të sigurt* për një periudhë **prej gjashtë muajsh deri në dy vjet**. Ai qëndron i ndaluar në një qendër të posaçme gjatë gjysmës së parë të dënimit dhe më pas lihet në gjendje të lirë, por mbetet nën mbikëqyrjen e një punonjësi të shërbimit të provës ose punonjësit social gjatë gjysmës së dytë të dënimit të tij.

Në bazë të nenit 73 të Ligjit për *Krime dhe prishje të rendit publik*, kjo masë është zëvendësuar me *urdhërin e ndalimit dhe trajnimit*, i cili është i zbatueshëm për autorët delikuent të moshës nga 10 deri 17 vjeç. Kohëzgjatja e tij do të jetë katër, gjashtë, tetë, dhjetë, dymbëdhjetë, tetëmbëdhjetë ose njëzet e katër muaj. Masa e re do të përfshijë një dënim me burgim që përfshin trajnimin e detyrueshëm dhe një periudhë të liritimit të mbikëqyrur.

Të miturit mbi moshën **15 vjeç** burgohen në **institucione për të mitur** ose në njësi të ndara të burgjeve për të rritur. Ata nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç janë të vendosur në institucione të specializuara, shtëpitë ose mjedise të rehabilitimit. Në përgjithësi, kohëzgjatja e burgimit nuk mund të kalojë një vit.

4.Në Belgjikë, të miturit nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç nuk mund të dënohen sipas Kodit Penal, por ato i nënshtrohen dispozitave të ligjit të 8 Prillit 1965 mbi mbrojtjen e të rinjve minorenë.

Sidoqoftë, nëse të miturit janë më shumë se gjashtëmbëdhjetë vjeç, ata mund, në rrethana të caktuara, t'i referohen gjykatave të zakonshme.

1) Moshë e përgjegjësisë penale

Në ligjin penal, është parashikuar kufiri maksimal për përgjegjësinë penale për të miturit delikuent që është **tetëmbëdhjetë vjeç**. Kështu, Neni 37 i Ligjit për Mbrojtjen e të Rinjve parashikon që të miturit e paraqitur para gjykatës për të Mitur mund të jenë subjekt i “*masave të ruajtjes, ruajtjes dhe edukimit*”. Asnjë sanksion penal nuk mund të caktohet kundër tyre.

Sidoqoftë, në disa raste, moshë e përgjegjësisë penale mund të ulet deri në gjashtëmbëdhjetë vjeç, sepse neni 38 i ligjit të lartpërmendur specifikon që, për shkak të veprës penale të kryer, nëse gjykata për të rinjtë, i konsideron masat të papërshtatshme parashikuar në nenin 37 të këtij ligji, ai mund ta dërgojë të miturin mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç përpara gjykatës së zakonshme.

Një projekt-ligj për reformimin e ligjit të vitit 1965 është duke u përgatitur. Në veçanti, po diskutohet ulja e moshës së përgjegjësisë penale në 12 vjeç.

2) Masat e zbatueshme për autorët e rinj.

(a) Masat e parashikuara nga ligji i Mbrojtjes së të Rinjve.

«*Masat e ruajtjes, ruajtjes ose edukimit*» janë si vijon:

1.vërejtje me urdhër ndaj të miturit, drejtuar prindërve ose personave që kanë kujdestarinë, për ta mbikëqyrur më mirë; 2.mbikëqyrjen e komitetit të mbrojtjes së të rinjve ose të një përfaqësuesi të mbrojtjes së të rinjve me një kujdestar në familje, me kusht që i pandehuri i ri të vijojë rregullisht në një shkollë, të kryejë «*shërbim edukativ ose filantropik në lidhje me moshën dhe burimet e tij*» dhe të paraqesë «*udhëzimet pedagogjike dhe mjekësore të një qendre për udhëzime edukimi ose higjienë mendore*»; 3.vendosja në një familje kujdestare ose një institucion i përshtatshëm nën mbikëqyrjen e komitetit të mbrojtjes së të rinjve ose përfaqësuesit të mbrojtjes së të rinjve; 4.vendosja në një qendër të specializuar.

(b) dënimin me burgim

Nëse një i mitur është mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe gjykata për të miturit «*e konsideron të papërshtatshme një masë kujdesi, ruajtjeje ose edukimi*», ose sjellja e të miturit konsiderohet e rrezikshme, i mituri mund të «*vihet në dispozicion të akuzës*» dhe në masë sigurimi të paraburgosur, në një institucion penitenciar ku ai i nënshtrohet një regjimi të posaçëm.

5.Në Spanjë, sipas Nenit 19 i Kodit të ri Penal, i botuar më 24 nëntor 1995 përcaktohet se «të miturit nën moshën 18 vjeç nuk do të jenë penalisht përgjegjës sipas rregullave të këtij Kodi. Nëse i mituri i kësaj moshe kryen një fakt që përbën veprë penale, ai mund të jetë përgjegjës sipas dispozitave të ligjit mbi përgjegjësinë penale të të miturit».

Megjithatë, këto dispozita nuk kanë efekt sipas dispozitës së shtatë përfundimtare të Kodit të ri Penal, i cili parashikon se neni 19 nuk hyn në fuqi derisa të miratohet ligji mbi përgjegjësinë penale të të miturit. Aktualisht, sipas Kodit të vjetër Penal, moshë e përgjegjësishë penale, **gjashtëmbëdhjetë vjeç**, përkon me atë të kufirit të sipërm të përgjegjësishë penale, ndërsa autorët e mitur ndërmjet moshave 12 dhe 16 vjeç janë nën juridiksionin e veçantë: gjykatës për të miturit. Një ligj organik që rregullon drejtësinë penale për të mitur është duke u shqyrtuar në Parlament. Ajo parashikon papërgjegjshmërinë absolute kriminale të të miturve nën moshën trembëdhjetë vjeç dhe përcakton moshën, ose kufirin maksimal të përgjegjësishë penale deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Dispozitat e projektligjit analizohen në tekstin në vijim.

1) Moshë e përgjegjësishë penale

a) Papërgjegjshmëria absolute e të miturve përcaktohet nën moshën trembëdhjetë vjeç.

Projektligji organik që rregullon përgjegjësinë penale të të miturve parshikon përjashtimin nga përgjegjësia penale të të miturve nën moshën trembëdhjetë vjeç. Midis kufirit të moshave 13 dhe 18 vjeç, një delikuent i mitur do t'i nënshtrohet dispozitave të ligjit që rregullojnë përgjegjësinë penale të të miturve.

b) Mundësia e shtyrjes deri në moshën **njëzet e një vjeç të kufirit maksimal të përgjegjësishë penale**. Në pajtim me dispozitat e nenit 69 të Kodit Penal, ligji i cili rregullon përgjegjësinë penale të të miturve mund të zbatohet për të rinjtë në mes të moshës tetëmbëdhjetë e njëzet e një, me kusht që nuk ka pasur dhunë, frikë dhe se faktet e supozuara nuk janë shumë serioze.

2) Sanksionet e zbatueshme për autorët minorenë.

a) Masat edukative

Projektligji organik që rregullon përgjegjësinë penale të të miturve parashikon

masat e zbatueshme për autorët e mitur, duke i dhënë **prioritet** masave social-edukuese. Sanksionet e propozuara marrin parasysh seriozitetin e veprës penale dhe mund të shtrihen deri në izolim të të miturve për veprat penale të karakterizuara nga dhuna ose frikësimi. Gjykatësi mund të vendosë masat e mëposhtme:

1. tërheqjen e patentës për motoçikleta ose automjete, ose edhe ndalimin e marrjes së një liçence të tillë;
2. të njëjtat dispozita për licencën e gjuetisë dhe për licencën për përdorimin e armëve; -paralajmërim;
3. realizimin e punës social-arsimore;
4. kryerjen e shërbimeve në dobi të komunitetit;
5. vendosja në një familje ose një grup arsimor;
6. liria e mbikëqyrur;
7. mbikëqyr lirinë me kontroll intensiv;
8. qëndrimet e fundjavës, nga e premtja në mbrëmje deri në mbrëmjen e së dielës, në shtëpi ose në qendër edukimi;
9. prania në një qendër ditore;
10. trajtimi ambulator; -internimi terapeutik;
11. vendosja në një qendër të hapur;
12. vendosja në një qendër gjysmë të hapur;
13. vendosja në një qendër të regjimit të mbyllur.

b) dënimin me burgim

Kur një i ri midis moshave 18 dhe 21 vjeç ka kryer një vepër penale të karakterizuar nga dhuna ose frikësimi, ai ose ajo nuk do të jetë në gjendje të zbatojë dispozitat e nenit 69 të Kodit Penal dhe për këtë arsye do të pësojë një dënim me burgim.

6.Në Francë, Neni 122-8 i **Kodit Penal** përcakton parimin e papërgjegjshmërisë kriminale absolute të të miturit nën moshën **trembëdhjetë vjeç**.

Të rinjtë midis **moshës 13 dhe 18 vjeç** konsiderohen të papërgjegjshëm, por mund të shpallen fajtorë për një vepër penale «*ku rrethanat dhe personaliteti i autorit të veprës së kryer*» e kërkojnë atë.

Masat e zbatueshme për të miturit janë të përfshira në Urdhëresën nr. 45-174 të 2 shkurtit 1945, që kanë të bëjnë me delikuencën e të miturve.

1) Moshë e përgjegjshërisë penale

Ajo përkon me moshën e kufirit maksimal për të miturit delikuent, domethënë tetëmbëdhjetë vjet, por në disa raste mund të ulet poshtë këtij kufiri deri në 13-vjeç.

a) Papërgjeshmëria absolute e të miturve nën moshën trembëdhjetë vjeç

Neni 122-8 i Kodit Penal parashikon vendosjen e sanksioneve penale vetëm ndaj të miturve mbi moshën 13 vjeçare.

Autorët e veprës penale të të miturit nën moshën 13 vjeç mund t'i nënshtrohen vetëm masave administrative si» *mbrojtjes, ndihmës, mbikëqyrjes dhe edukimit* «.

b) papërgjegjshmëria relative e të miturve mbi moshën 13 vjeç.

Neni 2 i Urdhëresës për Delikuencën për të Mitur specifikon që Gjykata për Fëmijët dhe Gjykata speciale për të Mitur, *megjithatë, kur rrethanat dhe personaliteti i autorit të veprës penale lidhen me të miturit mbi moshën trembëdhjetë vjeç, atëherë ndaj tyre caktohet një dënim penal.*

2) Masat e zbatueshme për autorët e veprës me moshë të re.

a) Masat edukative

Gjyqtari për të mitur mund të caktojë masat e mëposhtme, të përcaktuara në nenin 8 të Urdhrit të vitit 1945:

1. përjashtimi nga ndëshkimi, nëse del që është kryer riklasifikimi i të miturit fajtor, nëse dëmi i shkaktuar të riparohet dhe se prishja e rendit e shkaktuar nga vepra ka pushuar; 2. paralajmërim; 3. dorëzimi i prindërve, kujdestarit, personit që ka kujdestarinë e të miturit ose personit të besueshëm; 4. vendosja nën mbrojtje gjyqësore për një periudhë jo më të gjatë se pesë vjet; 5. vendosja në një institucion apo mjedis, publik ose privat, të arsimit ose formimit profesional, në një institucion mjekësor ose mjekësor-pedagogjik, në një shkollë të përshtatshme konviktesh ose, për të mitur nën trembëdhjetë vjeç, në shërbim kujdesi për fëmijët; 6. mbikëqyrje të lirisë deri në një moshë që nuk mund të tejkalojë kufirin maksimal të moshës 18-vjeç.

b) Ndërmjetësim-riparim

I mituri është i përfshirë në dëmshpërblimin e dëmit që ai ka shkaktuar duke kryer një aktivitet ndihmës, ose riparimit në dobi të viktimës, ose në interes të komunitetit. Kjo masë mund të urdhërohet vetëm me pëlqimin e viktimës dhe mund të shoqërohet me një falje nga viktimja. Të miturit midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç mund t'i nënshtrohen detyrimit për të kryer shërbimin e komunitetit „me natyrë formuese ose natyre për të nxitur integritetin social“.

c) dënimin me burgim

Dënimet e paraburgimit të caktuara ndaj të miturve mbi moshën trembëdhjetë vjeç nuk duhet të jenë më shumë se gjysma e dënimit të shkaktuar nga një person me zotësi të plotë për të vepruar për të njëjtën veprë penale.

Sidoqoftë, në rast serioziteti ekstrem, dënimi i caktuar ndaj të miturit mes moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç, mund të jetë i njëjtë me atë të imponuar ndaj një personi me moshë madhore.

Të miturit i kryejnë dënimet të tyre në institucione të specializuara të autorizuarara për t'i pranuar ata, ose në mjedise penitenciare të ndara nga të dënuarit në moshë madhore.

7.Në Itali, Kodi Penal përcakton parimin e papërgjegjshmërisë kriminale absolute të fëmijëve nën moshën ***katërmëdhjetë vjeç*** dhe papërgjegjshmërisë relative të të miturve midis moshës katërmëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç. Këta të fundit i nënshtrohen ligjit të përgjithshëm penal, por ndaj kësaj kategorie për të mitur mund të caktohen vetëm dënimet e zbutura.

1) Moshë e përgjegjësisë penale

Ajo përkon me kufirin maksimal të moshës së përgjegjësisë penale, domethënë tetëmbëdhjetë vjeç, por në kushte e rrethana të caktuara mund të ulet në katërmëdhjetë vjeç.

a) Papërgjegjshmëria absolute e të miturve nën moshën katërmëdhjetë vjeç.

Neni 97 i Kodit Penal parashikon: „*Personi i cili nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale nuk është përgjegjës për veprën e kryer*».

b) Përgjegjësia relative e të miturve nga moshë 14 vjeç e sipër.

Në nenin 98 të Kodit Penal, përcaktohet se: „*Një person i cili në kohën e krimit ishte mbi moshën katërmëdhjetë vjeç, por që nuk ka mbushur ende tetëmbëdhjetë vjeç, dhe që kishte aftësinë për të kuptuar dhe për të dëshiruar pasojën e veprës, atëherë ndaj tij caktohet një dënim penal më të zbutur*”. Jurisprudenca i konsideron të aftë rinjtë të kuptojnë seriozitetin e veprimeve të tyre, pasojat e tyre dhe faktin se ato janë ose nuk përrputhen me rendin shoqëror.

„Kapaciteti për vullnetin“ e të riut pasqyron shkallën e lirisë së tij në vendim dhe aftësinë e tij për t'i rezistuar kërkesave të mundshme nga të tjerët.

2) Masat e zbatueshme për autorët minorenë për veprën penale.

Ato zbatohen për të miturit nga mosha katërbëdhjetë vjeç, deri në masën që pjekuria e tyre e justifikon atë.

a) Reduktimi i dënimeve

Autorët minorenë të veprës penale, u nënshtrohen dënimeve të njëjta si të rriturit, por në një formë të zbutur. Për shembull, dënimi i përjetshëm reduktohet automatikisht në njëzet e katër vjet burg. Në mënyrë të ngjashme, kohëzgjatja e paraburgimit është zvogëluar me gjysmën e afatit maksimal të parashikuar, nëse të miturit janë midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç, dhe dy të tretat nëse janë midis katërbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç.

b) Sanksionet alternative dhe shërbimi i provës

Këto masa janë parashikuar me Dekretin nr. 448, datë 22.09.1988, që miraton dispozitat që kanë të bëjnë me gjykimin penal të të miturve. Ky tekst, pasqyron në një mënyrë të ngjashme kodin e procedurës penale për të miturit. Ai parashikon që gjyqtari mund të zëvendësojë dënimet e mëposhtme për një periudhë burgimi deri në dy vjet me:

1.Liria e kontrolluar; 2.gjysmë-liri.

I njëjti dekret i siguron gjyqtarit mundësinë e pezullimit të gjykimin për një periudhë kohe prej ***një deri në tre vjet*** (varësisht nga serioziteti i fakteve të supozuara) dhe për të vënë në provë të riut autor të veprës penale, dhe që ka mundësi të riparojë pasojat e veprimeve të tij. Gjykatësit po përdorin gjithnjë e më shumë këtë procedurë, e cila ka një rezultat pozitiv në më shumë se 70% të rasteve.

8.Kodi Penal Hollandez, përcakton parimin e papërgjegjshmërisë penale absolute të fëmijëve nën moshën ***dymbëdhjetë vjeç***.

Gjithashtu, ky kod parashikon zbatimin e dispozitave specifike për të rinjtë nën moshën dymbëdhjetë dhe mbi moshën 18 vjeç. Sidoqoftë, serioziteti i veprës dhe personaliteti i autorit të veprës mund ta çojë gjykatësin të mos e zbatojë atë tek të rinjtë mbi gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe t'i konsiderojnë ata si të rritur.

1) Moshë e përgjegjësisë penale

Sipas kodit penal hollandez, përgjegjësia penale për të miturit është dymbëdhjetë vjeç.

a) Papërgjegjshmëria absolute e të miturve nën dymbëdhjetë vjeç.

Më parë, moshë e përgjegjësisë penale ka qenë gjashtëmbëdhjetë vjeç, por ky kufi u ul në dymbëdhjetë vjeç nga ligji i 7 korrikut 1994, i cili reformoi ligjin penal të të miturve. Ky ligj hyri në fuqi më 1 shtator 1995.

Ekziston një ligj i veçantë penal, i zbatueshëm për të rinjtë e moshës mbi dymbëdhjetë vjeç. Neni 77/a i Kodit Penal parashikon që dispozita të caktuara penale nuk zbatohen për të rinjtë ndërmjet moshës 12 dhe 18 vjeç, dhe se ato zëvendësohen nga ato të Titullit 8 të librit të parë, të cilat përbëjnë të drejtën penale të të miturve.

b) Zvogëlimi i mundshëm i kufirit maksimal të moshës në gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Sipas nenit 77/b të Kodit Penal, rëndësia dhe rrethanat e veprës, si dhe personaliteti i autorit të veprës penale, mund ta çojë gjykatësin të konsiderojë një të mitur si të rritur sapo të mbushë moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, ndërsa kufiri maksimal i moshës për përgjegjësinë penale është zakonisht tetëmbëdhjetë vjeç.

Kjo dispozitë rrjedh edhe nga miratimi i ligjit të 7 korrikut 1994.

c) Mundësia e shtyrjes së kufirit maksimal deri në moshën njëzet e një vjeç.

Është parashikuar në nenin 77/c. se Gjykatësi merr vendimin e tij duke marrë parasysh «*personalitetin e fajtorit ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale*».

2) Masat e zbatueshme për autorët minorenë.

Ato zbatohen për të miturit që fillojnë nga moshë 12 vjeç.

a) Zgjidhja personale për kundërvajtje.

Neni 77/c i Kodit Penal parashikon se të rinjtë që kanë kryer një veprë penale (vjedhje e vogël, vandalizëm ...) mund të çlirohen nga faji i tyre duke ndërmarrë masa konkrete për të riparuar dëmet e shkaktuara, ose për të kryer veprime të vogla si punë në shërbimin publik.

Nëse personi i mitur që ka nënshkruar një marrëveshje të tillë respekton detyrimet e tij, procesverbali i hartuar nga policia, nuk i dërgohet prokurorit dhe nuk ka sanksion penal ose regjistrim në dosjen penale.

Nga ana tjetër, nëse i riu nuk i respekton zotimet e tij, mund të rishikohet procedura. Përveç kësaj, zëvendësimi i konvertimit të dënimit mundësohet vetëm një herë.

b) Sanksionet

Dispozitat e Kodit Penal për të miturit parashikojnë:

1.zbatimin e dënimeve kryesore të paraburgimit ose caktimin e gjobës, në varësi të rëndësisë së veprës penale; 2.aplikim, me propozimin e të miturit, të dënimeve alternative që zëvendësojnë dënimet kryesore; 3.aplikimi i mundshëm i dënimeve shtesë; 4.shpalljen e masave disiplinore. 5.gjobat kryesore.

Paraburgimi kryhet në institucione të specializuara. Kohëzgjatja e tij nuk mund të kalojë një vit nëse fëmija është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Nga mosha gjashtëmbëdhjetë vjeç, ai mund të dënohet me një mandat deri në dy vjet.

Shuma e **gjobës** që mund të caktohet një personi të ri varion ndërmjet 5 dhe 5.000 florins (domethënë midis 15 dhe 15.000 franga).

Dënimet alternative.

Gjykatësi mund të caktojë këto lloje dënimesh vetëm me propozimin e autorit të mitur të veprës penale. Kodi Penal parashikon ***dënimet alternative*** si më poshtë:

1.puna e papaguar e interesit të përgjithshëm, kohëzgjatja e përgjithshme e së cilës nuk mund të tejkalojë 200 orë; 2.kompensimi për dëmin e shkaktuar nga vepra penale; 3.pjesëmarrja në një projekt arsimor që ka për qëllim futjen në vlerat sociale të të rinjve, kohëzgjatja e të cilave nuk mund të tejkalojë 200 orë.

Dënime plotësuese.

Kodi ka parashikuar dy prej tyre që janë konfiskimi dhe tërheqja e patentës, e zbatueshme vetëm kur parashikohet në kodin rrugor.

Masat disiplinore

Kodi penal hollandez parashikon katër lloje masash të cilat janë:

-vendosja në një institucion të specializuar; -ndalimi i frekuentimit me disa njerëz me precedentë dhe vendeve të caktuara;-tërheqjen e përfitimeve të fituara në mënyrë të paligjshme; -riparimi i dëmit.

Vendosja në një institucion të specializuar mund të urdhërohet vetëm nëse vepra mund të justifikojë vendosjen e të miturit në paraburgim, nëse sigurimi i pronës dhe personave është i kërkueshëm, dhe nëse një masë e tillë mund të ketë pasoja të dobishme për caktimin e kësaj mase për të rinjtë delikuent.

9.Në Portugali, Kodi Penal përcakton parimin e përgjegjshmërisë kriminale absolute të fëmijëve nën moshën **gjashtëmbëdhjetë vjeç** dhe parashikon zbatimin e një ligji specifik për të rinjtë ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë dhe **njëzet e një vjeç**. Ky është dekreti ligjor i 23 shtatorit 1982 mbi regjimin penal të rinjve.

Përveç kësaj, autorët minorenë të veprës penale, deri në masën që ata ende janë të mitur, duhet t'i nënshtrohen Dekretit të Ligjit nr. 314, datë 27.10.1978 mbi mbrojtjen e të miturve, i cili përcakton në veçanti sanksionet që zbatohen ndaj tyre.

1) Moshë e përgjegjësisë penale

Në kod moshë e përgjegjësisë penale është fiksuar në **gjashtëmbëdhjetë vjeç**. Sipas nenit 19 të Kodit Penal portugez, “*të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç nuk kanë të drejtë të akuzohen*”. Autorët e veprës penale, të rinjtë, mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nën njëzet e një vjeç, nuk i nënshtrohen kodit penal, por një teksti ligjor të veçantë. Kodi Penal përcakton në nenin 9 se “*Dispozitat e një ligji të veçantë do të zbatohen për ata që janë mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nën moshën njëzet e një vjeç*”.

2) Masat e zbatueshme për shkelësit e rinj

Ato zbatohen për të miturit nga moshë **gjashtëmbëdhjetë vjeç**.

a) Masat mbrojtëse.

Kur vepra penale parashikon si lloj dënimi me burgim më të ulët se dy vjet dhe autori i saj është i mitur, gjyqtari mund të zgjedhë të zbatojë një ose më shumë masa të parashikuara në Dekretin e Ligjit për Mbrojtjen e të miturit.

Këto janë «*masa mbrojtëse, ndihmuese apo masa edukative*» të listuara në mënyrë të detajuar si më poshtë:

-paralajmërim, që është paralajmërim solemn dhe publik; -dorëzimi i të miturit në përgjegjësi të prindërve ose kujdestarit të caktuar; -njoftimi i detyrimeve të caktuara (falje publike ndaj viktimës, pjesëmarrja në një aktivitet me interes të përgjithshëm, kompensimi i dëmit dhe pagesa e një shume parash për një organizatë, ndihmë sociale publike ose private); -mbështetje arsimore nga shërbimet sociale; -vendosja në një familje kujdestare; -vendosja në një qendër rehabilitimi, një shtëpi gjysmë të hapur ose një institut mjek-psikologjik; -detyrimi për të kryer punë praktike ose punë.

b) Masat korrektuese

Kur autori i veprës është i moshës madhore, por nuk ka arritur ende moshën njëzet e një vjeç, gjyqtari mund të marrë parasysht, nëse rrethanat dhe personaliteti i personit në fjalë sugjerojnë që burgosja nuk është „*as e nevojshme e as e favorshme për riintegrimin e tij social*“, të zëvendësojë çdo dënim me burg prej më pak se dy vjet, me një „masë korrektuese“.

„Masat e korigjimit“ janë të përfshira në mënyrë të plotë në Dekretin e Ligjit për regjimin penal të të rinjve të cilat janë:

-paralajmërim; -përcaktimi i detyrimeve të caktuara (të cilat janë të njëjta me ato të parashikuara në dekret ligjin për mbrojtjen e të miturve); -gjobë; -internimi në një qendër ndalimi për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj. Ky internim mund të kryhet në mënyra të ndryshme (gjatë fundjavës, me kohë të plotë, me kohë të pjesshme ...). Periudha e paraburgimit, nëse është e nevojshme, mund të pasohet nga një periudhë e caktimit të shërbimit në provë deri në një vit.

c) dënimin me burgim

Gjyqtari mund të caktojë dënim me burg edhe nëse i riu ka kryer një vepër penale që normalisht është e sanksionuar në kod.

Megjithatë, gjykata duhet të zvogëlojë kohëzgjatjen nëse mendon se kjo zbulje mund të nxisë riintegrimin e të riut. Modalitetet e reduktimit të dënimit, që paraqiten në kodin penal, janë identike me ato që janë të zbatueshme për autorët kryesorë të veprës në rast të rrethanave lehtësuese.

10.Në Zvicër, Kodi Penal përcakton parimin e përgjegjshmërisë kriminale absolute për fëmijët nën moshën **shtatë vjeç**, dhe parashikon zbatimin e masave specifike për fëmijët e moshës shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjeç, për adoleshentët e moshës nga pesëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, dhe për të rinj të moshës **tetëmbëdhjetë** deri në **njëzet e pesë vjeç**.

Aktualisht është duke u shqyrtuar rishikimi i kodit penal. Një nga qëllimet e tij është që të ndahet ligji penal i të miturve nga ai i të rriturve. Ligji penal për të mitur do të rregullohet me ligj të veçantë, ligjin federal që rregullon statusin penal të të miturve.

Ky projekt-ligj propozon ngritjen e moshës së përgjegjshme penale në dhjetë vjeç dhe futjen e një sistemi të ri të sanksioneve duke zëvendësuar dënimet me burgim të shkurtër me dënime financiare dhe shërbime të komunitetit.

Duke pasur parasysh shkallën e këtij projekti, ka të ngjarë që nuk do të miratohet për disa vite. Janë studiuar vetëm masat që janë aktualisht në fuqi

1) Mosha e përgjegjshme penale

Në kodin penal është fiksuar në **moshën shtatë vjeç**. Neni 82 i Kodit Penal parashikon që *“kodi aktual nuk zbatohet për fëmijët që nuk kanë mbushur moshën shtatë vjeç”*. Të miturit i nënshtrohen një ligji penal specifik, i cili ndryshon sipas moshës së autorit të veprës.

2) Masat e zbatueshme për shkelësit e rinj.

a) Fëmijët e moshës nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjeç

Nenet 82 deri 88 të Kodit Penal kanë të bëjnë me masat e zbatueshme për fëmijët në mes të moshës nga **shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjeç**. Autoriteti kompetent gjykues për trajtimin e fëmijëve dhe adoleshentëve mund të caktojë masat e mëposhtme:

- 1.masat edukative, me mundësi vendosjen në familje ose në një shtëpi arsimore;
- 2.trajtim mjekësor, veçanërisht në rast të çrregullimeve fizike ose psikologjike;
- 3.masa disiplinore që mund të përbëjnë një qortim, detyrimin për të kryer punë ose gjashtë ditë pushimesh shkollore.

Kur vepra nuk është shumë serioze, autoriteti i gjyqimit mund të lërë kujdesin për të zemëruar me mbajtësin e fuqisë atërore.

Asnjë sanksion penal nuk mund të caktohet kundër të miturve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

(b) Adoleshentët e moshës 15 deri në 18 vjeç.

Masat e mëposhtme janë të zbatueshme për adoleshentët:

-masat edukative që mund të përfshijnë vendosjen në një familje kujdestare ose në një shtëpi të arsimit, ose detyrimin e qëndrimit, formimit profesional ose riparimit të dëmit; -trajtim mjekësor, veçanërisht në rast të çrregullimeve fizike ose psikologjike; -vendosja në një shtëpi arsimore në punë nga moshja 17 vjeç; -Vendosja terapeutike; -Vendosja në një shtëpi rehabilitimi; -sanksionet penale (gjoba dhe / ose një ditë deri në një vit burgim).

(c) Të rriturit e rinj nga moshja tetëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjeç.

Dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal zbatohen për të rinjtë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Megjithatë, ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë e njëzet e pesë vjeç, ato mund t'u nënshtrohen masave të mëposhtme:

-Vendosja në një shtëpi të arsimit profesional me mundësinë e marrjes së aftësisë profesionale ose punës jashtë institucionit; -Vendosja në institucion penitenciar kur të rriturit e rinj shkelin disiplinën e shtëpisë së arsimit në punë.

Në rastet ekstreme, për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykatat cakton për të miturit mbi 15-vjeç *dënimin me burgim*.

KONKLUZIONE

Në përfundim të këtij punimi, arrijmë të sintetizojmë rolin mjaft të rëndësishëm dhe kryesor që luan kufiri i moshës për përgjegjësinë penale të të miturve në kryerjen e veprës penale si në ligjin e brendshëm ashtu dhe në atë të huaj. Legjislacionet përkatëse të vendeve të tjera në Europë, por edhe ai në Shqipëri, të cilat njohin prej vitesh lloje të ndryshme të masave edukuese ndaj të miturve, ofrojnë një model të mirë për t'u marrë parasysh gjatë përcaktimit të llojeve të reja të masave edukuese. Ndryshimet e reja në Kodin e Drejtësisë për të Miturit në R.Sh., jo vetëm që e kanë afruar legjislacionin penal për të mitur me standartet ndërkombëtare, por njëkohësisht e bëjnë këtë legjislacion edhe më bashkëkohor dhe në përshtatje me zhvillimet dhe eksperiencën në Europë. Gjithashtu,

zgjerimi i masave edukuese me lloje të reja, i jep më shumë mundësi gjykatës të zbatojë parimin e proporcionalitetit në përcaktimin e masës më të përshtatshme me personalitetin e të miturit dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Roli i masave edukuese në raport me dënimin penal për të miturit është i nevojshëm që të përcaktohet si një rol parësor në dallim me atë sekondar që njihet në Kodin Penal. Synimi kryesor në përcaktimin e llojeve të masave edukuese duhet të jetë reflektimi i qëllimit pozitiv rehabilitues të sistemit të drejtësisë për të mitur, i mbështetur në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Nga ana tjetër, ndryshimet e reja në Kodin e Drejtësisë për të Mitur zgjerojnë kategorinë e personave ndaj të cilëve mund të zbatohen masat edukuese duke përfshirë edhe të rinjtë e moshës 18-21 vjeç.

BIBLIOGRAFI

- Ligji nr.8417, (1998), i ndryshuar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur,
- Ligji nr. 7949, (2007), Për Policinë e Shtetit në Republikën e Shqipërisë,
- Ligji nr.7905, (1995), i ndryshuar, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.7995, (1995), i ndryshuar, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji 8293, (1998) Për Policinë Kriminale.
- Ligji nr.8137, (1996), Konventa europiane e të drejtave të njeriut, Fl.Zyrtare 20, faqe 724.
- (1989)Konventa mbi të drejtat e fëmijës miratuar nga Asambleja e OKB-së;
- (1985)Rregullat standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së OKB-së 40/33, (Rregullat e Pekinit).
- Courtin, C. et Renucci, J.F.(2001) Le droit pénal des mineurs, PUF, coll. «Que sais-je ?» 2001 ; J.F. Renucci, La justice pénale des mineurs en

France, Revue Justice 1998, p. 116).

- **(2018) L'ordonnance n° 45-174 du 2 février 1945 relative à l'enfance délinquante;**
- Loi du 28 novembre 2000 relative à la protection pénale des mineurs, Belgique;
- Loi fédérale régissant la condition pénale des mineurs, Droit pénal des mineurs, du 20 juin 2003, Suisse (Etat le 1^{er} janvier 2018);
- *Dr. José Luis de la Cuesta, (2005) La nouvelle loi pénale espagnole pour mineurs et jeunes délinquants;*
- (2014) La loi de droit pénal aux Pays-Bas, spécifique des jeunes âgés de 15 à 23 ans;
- (2002) *La justice des mineurs en Angleterre*, Crawford; The prospects for restorative youth justice in England and Wales : A tale of two acts, in MCEVOY K., NEWBURN T. Eds *Criminology and Conflict Resolution*, London;
- DÜNKEL F., (1994), Les orientations actuelles de politique criminelle, *et Jeunes délinquants et jeunes en danger en milieu ouvert : utopie ou réalité?;*
- FADIGA L., (2003) Les évolutions actuelles du droit des mineurs en Italie;
- P. BONFILS, A. GOUTTENOIRE, (2008) Droit des mineurs, Dalloz, Paris, 1121 p.

PARIMET BAZË TË DREJTËSISË PENALE PËR FËMIJËT

Elona Doko

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Juridikut, Albanian University

e.doko@albanianuniversity.edu.al

ABSTRAKT

Objekti: Analiza e parimeve bazë të të drejtës penale për fëmijët, aktet ndërkombëtare dhe implementimi i tyre në legjislacionin shqiptar.

Vështrimi i përgjithshëm:

Vitet e fundit në Shqipëri janë hedhur hapa pozitive në përfaqësimin e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare të garantuara në aktet ndërkombëtare. Megjithatë, ka pasur mungesa në instrumentet ligjore për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe në fokusin e duhur për ri-integrimin e tyre përmes edukimit, trajnimit dhe punësimit.

Drejtësia miqësore për fëmijët ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjitha të drejtave të fëmijëve, në nivelin maksimal të mundshëm.

Të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël ndaj edhe mbrojtja e tyre përbën një ndër objektivat strategjike me të rëndësishëm të reformës në sistemin e drejtësisë penale. Analiza do të fokusohet në këto parime bazë të drejtësisë për fëmijët si: interesi me i lartë i fëmijës; mos-diskriminimi; proporcionaliteti; heqja e lirisë si alternativë e fundit e dënimit, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijës; afati i përfundimit të procedurës; e drejta e privatësisë; të drejtat procedurale; të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit. Gjithashtu duke pasur gjithmonë në fokus aktet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

Fjalët kyçe: *të drejtat e fëmijëve, kodi i drejtësisë penale për fëmijët, aktet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, parimet themelore të të drejtës penale për të miturit.*

HYRJE

Qëllimi i 'Kodit të Drejtësisë për të Miturit' është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dëshmitar dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e vepres penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Drejtësia miqësore për fëmijët nënkupton garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të aritshëm, në sistemet e drejtësisë së një vendi. Për këtë, në veçanti, kërkohet që drejtësia të jetë e aksesueshme, e përshtatur sipas moshave, e shpejtë, e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Kjo përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit.

Sipas **Neni 70** i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri (MSA) njeh rëndësinë e përafrimit të legjislacionit Shqipëtar me atë të Bashkimit Evropian.

Më në specifikë në Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) në nenin 24 Të drejtat e fëmijëve në të cilën shprehet *"Fëmijet kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqënien e tyre. Ata mund t'i shprehin pikëpamjet e tyre. Pikëpamje të tilla merren në konsideratë për çështje me interes për ta, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre"*.

Pra sipas akteve ndërkombëtare dhe implementimit të tyre në kodin penale për të mitur të gjitha veprimet që ndërmerren në lidhje me fëmijet si nga autoritetet publike qoftë dhe nga institucionet private, interesat më të larta të fëmijës gëzojnë vëmëndje parësore e cila evidentohet që në nenin 1 të Kodit.

1.1 Legjislacioni ndërkombëtar

Legjislacioni ndërkombëtar mbi të drejtat e fëmijëve janë të shumta po më kryesorët janë:

Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian, ku do të veçonim nenet 47, 48,49 i saj dhe më konkretisht **Neni 47¹, 48² dhe 49³** dhe Legjislacioni dytësor i BE-së⁴ si dhe Aktet e tjera Ndërkombëtare⁵. Sipas analizës së neneve të kodit të drejtësisë për të mitur, ky kod është në përputhje të plotë me aktet ndërkombëtare:

1.3 Konventa për të drejtat e fëmijës [KDF]

Konventa për të drejtat e fëmijëve përmban norma të forta zbatimi i të cilave mbikëqyret nga Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës. KDF është një instrument sintetik ku në mënyrë gjithë përfshirëse gjenden parimet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në tërësi por dhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit. Duke qënë ndryshe pikërisht sepse është një qenie në zhvillim e sipër, fëmija, ka ende kohe e mundësi për tu rehabilituar, ka nevoja të ndryshme prej të rriturve dhe terapitë që sistemi do të përdorë për “sherimin” e tyre janë dhe duhet të jenë krejt të ndryshme e të veçanta prej atyre të të rriturve. Në këtë rast, prioritet kanë trajtimet ambulatorë dhe jo ato institucionale. Me çdo fëmijë duhet të merresh në mënyrë të individualizuar. Ka një interes të forte publik për mbrojtjen e veçantë të të miturve, interesi parësor dhe mirëqenia e të miturve janë substanciale. Në këtë Konventa, me rëndësi të vecantë është neni 40 i cili i referohet drejtpërdrejtë çështjeve të drejtësisë për të miturit.

Neni 40 mbi administrimin e drejtësisë për të miturit përcakton standarde si në vijim:

- Standardi i trajtimit të vecantë dhe dinjitoz të çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim që të zhvillohen ndjenjat e dinjitetit dhe të vlerës se personit, të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj (neni 40/1 KDF);

- Standardi i pasojave jo prapavepruese. Asnjë fëmijë nuk mund të jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qënë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer. (neni 40/1/ a KDF) (Kushtetuta R.Sh neni 29);

Garancitë procedurale për fëmijët në procesin penal, pra për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar për shkelje të ligjit penal janë të parashikuara në nenin 40 të KDF⁶.

2. INSTRUMENTET NË NIVELIN E BASHKIMIT EUROPIAN

2.1. Karta e të drejtave themelore të BE

Në mënyrë të veçantë Karta⁷ përmban rregullime që i dedikohen parimeve të të drejtave të fëmijeve e të tilla si ato të përfshira kryesisht por jo vetëm në nenin 24 të saj. Ky nen nënvizon si parime kyç lidhur me të drejtat e fëmijëve⁸. Karta ka sjellë ndryshime të rëndësishme të cilat kanë rritur potencialin e BE-së për të avancuar të drejtat e fëmijeve, duke identifikuar «mbrojtjen e të drejtave të fëmijës» dhe nxitjen e kësaj mbrojtjeje, si një objektivi të përgjithshëm të deklaruar të BE-së (neni 3 (3) e TBE), dhe si një aspekt të rëndësishëm të politikës së jashtme të marrëdhënieve të BE-se (Neni 3 (5) të TBE).

Drejtësia miqësore për fëmijët përbëhet nga 5 parime të nënvizuar në udhëzuesin e Këshillit të Evropës mbi *Drejtësinë Miqësore për fëmijët*:

— Pjesëmarrja efektive dhe informimi: Në proceset që përfshijnë fëmijët ose i prekin ata, duhet të respektohet e drejta e të gjithë fëmijëve për t'u informuar mbi të drejtat e tyre, jepet akses i duhur në drejtësi si dhe të konsultohen e dëgjohen. Kjo përfshin dhënien e rëndësisë së duhur opinioneve të fëmijëve duke marrë në konsideratë pjekurinë e tyre dhe cdo problematikë që mund të ketë lidhur me komunikimin. Fëmijët duhet të merren në konsideratë dhe të trajtohen si bartës të plotë të të drejtave dhe duhet të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të të drejtave të tyre në mënyrë që merr parasysh kapacitetin e tyre për të formuar pikëpamjet e tyre dhe rrethanat e rastit. Procedimet gjyqësore të përshtaten me nevojat e fëmijes dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre efektive. Standardet ndërkombëtare lidhur me këtë të drejtë gjenden në nenin 47 të kartës së të drejtave themelore të BE; neni 6 i KEDNj dhe në Direktivën e propozuar mbi mbrojtjen procedurale të fëmijeve të akuzuar për vepra penal ose të akuzuar e cila përfshin të drejtën e pjesëmarrjes efektive si edhe të drejtën e përfaqësimit ligjor.

— Interesi më i lartë: Interesi më i lartë i fëmijëve duhet të jetë konsiderata mbi-zotëruese në të gjitha çështjet që prekin fëmijët. Në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijëve të përfshirë ose të prekur duhet të merren në konsideratë: a. Opinione dhe mendimet e tyre, të cilave duhet t'i jepet rëndësia e duhur; b. të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës, të tilla si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë, të cilat duhet të respektohen në cdo kohe; c. një qasje gjithëpërfshirëse duhet të miratohet nga të gjitha autoritetet shtetërore në mënyrë që të marrin

parasysh të gjitha interesat në rrezik, duke përfshirë edhe mirëqënien psikologjike dhe fizike dhe interesat juridike, ekonomike dhe sociale të fëmijës. Në rast konkurrimi të interesit më të lartë të dy ose më shumë fëmijëve të përfshirë në të njëjtën procedurë ose rast, ato duhet të vlerësohen veç e veç dhe të balancuar me qëllim për të pajtuar interesat e mundshme konfliktuale të fëmijëve.

— Dinjiteti: Fëmijet duhet të trajtohen me kujdes, ndjeshmeri, ndershmëri dhe respekt në cdo rast/procedure, duke pasur në vëmendje situatën e tyre personale, mirëqënien dhe nevojat e vecanta, dhe në respekt të plotë për integritetin e tyre fizik dhe psikologjik. Ky trajtim duhet t'u jepet atyre, në çfarë do mënyrë që ata kanë ardhur në kontakt me procedimet gjyqësore ose jo-gjyqësore apo ndërhyrje të tjera, pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor dhe kapacitetin në cdo procedurë apo rast. Mbrojtja nga diskriminimi: Fëmijëve duhet t'u garantohen të drejtat pa diskriminim me bazë seks, race, ngjyrë ose përkatësi etnike, moshe, gjuhë, feje, opinioni politik ose tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, gjendje socio-ekonomike, statusi të prindit/prindërve, përkatësi në një minoritet kombëtar, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor apo ndonjë statusi tjetër. Grupeve vulnerabel, si fëmijët emigrantë, refugjatë dhe azil-kërkues, fëmijët e pashoqëruar, me aftësi të kufizuara, fëmijët e rrugës, rom dhe fëmijët në institucionet rezidenciale, duhet t'u jepet mbrojtje e vecantë.

— Mbrojtja nga diskriminimi: Fëmijëve duhet t'u garantohen të drejtat pa diskriminim me bazë seks, race, ngjyrë ose përkatësi etnike, moshe, gjuhë, feje, opinioni politik ose tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, gjendje socio-ekonomike, statusi të prindit/prindërve, përkatësi në një minoritet kombëtar, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor apo ndonjë statusi tjetër. Grupeve vulnerabel, si fëmijët emigrantë, refugjatë dhe azil-kërkues, fëmijët e pashoqëruar, me aftësi të kufizuara, fëmijët e rrugës, rom dhe fëmijët në institucionet rezidenciale, duhet t'u jepet mbrojtje e vecantë. Shteti i së drejtës: Parimi i shtetit të së drejtës zbatohet plotësisht për fëmijët sikurse për të rriturit. Elementet e procesit të rregullt ligjor, të tilla si parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, të prezumimit të pafajësisë, e drejta për një gjykim të drejtë, për këshillim ligjor, e drejta aksesit në gjykata dhe ankimit, duhet të jetë e garantuar për fëmijët. Këto të drejta nuk duhen minimizuar ose mohuar nën pretekstin e interesit më të lartë të fëmijës. Kjo vlen për të gjitha procedurat gjyqësore, jashtëgjyqësore si dhe administrative. Fëmijët duhet të kenë të drejtën për të hyrë në mekanizmat e duhura të ankesave, të pavarura dhe efektive.

3. TË DREJTAT E GARANTUARA

Sipas të drejtës së BE, Direktive 2013/48/EU mbi Aksesin me një Avokat, ka referenca të drejtperdrejta në të drejtat e fëmijëve në citimet me nr.52 dhe 55 të preambulës së saj si edhe në nenet 5 (2)—(4) dhe (5)⁹.

Sipas nenit 2, direktiva zbatohet që nga casti që bëhet i qartë dyshimi ose akuzat mbi kryerjen e veprës penale e deri në arritjen e përfundimeve të procesit përmes dhënies së një vendimi fajësie ose pafajësie. Për me teper, neni 3 nënvizon se aksesin në një avokat përfshin të drejtën e të dyshuarit/akuzuarit që të takohet dhe komunikojë në privatësi me avokatin, duke përfshirë realizimin e së drejtës, përpara marrjes në pyetje [including before the first interrogation], prezencën dhe pjesëmarrjen efektive të avokatit gjatë marrjes në pyetje dhe prezencën e avokatit gjatë gjithë investigimit ose mbledhjes/marrjes së provave.

Sipas standardeve të Këshillit të Europës, GJEDNJ e konsideron aksesin në një avokat si një element thelbësor të procesit të rregullt gjyqësor, personat që dyshohen/akuzohen penalisht kanë të drejtën e një avokati që në fazat e hershme të investigimit policor. Kjo e drejte mund të kufizohet vetëm në raste përjashtimore duke siguruar që kufizimi nuk paragjykon në menyre jo të drejtë të drejtat e të akuzuarit¹⁰.

Një tjetër e drejtë e garantuar është ajo e privimit nga liria si mundësi e fundit dhe në kohë sa më të shkurtër. Zgjidhja e rasteve pa vonesa është thelbësore edhe për të kufizuar ndikimin negativ psikologjik të procedurave ligjore të fëmijët. Kur nuk shmanget dot privimi nga liria, fëmijët duhet, si rregull, të mbahen veç nga të rriturit. Në të gjitha rrethanat, fëmijët duhet të ndalohen në ambiente të përshtatshme për nevojat e tyre. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e fëmijëve të privuar nga liria, rëndësia e lidhjeve familjare dhe promovimi i ri-integrimit në shoqëri, autoritetet kompetente duhet të sigurojnë respekt dhe një mënyre aktive të mbështesin plotësimin e të drejtave të fëmijës.

Zbatimi i shërbimit të provës dhe dënimeve të tjera alternative sjell ndikim në uljen e përqindjes së rasteve të fëmijëve që dënohen me burgim.

Gjithashtu procedurat, mjedisi dhe komunikimi të jetë miqësor me fëmijët. Sipas standardeve, në të gjitha procedurat, fëmijët trajtohen me respekt për moshën, nevojat e tyre të veçanta, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit, duke pasur parasysh çdo vështirësi të mundshme në komunikim. Para se të fillojë

proçedura, fëmijët duhet të jenë të familjarizuar me konceptin e gjykatës dhe rolin e administratës gjyqësore. Gjuha duhet të jetë e përshtatshme për moshën dhe nivelin e zhvillimit të fëmijeve. Gjithashtu, gjyqtaret dhe/ose prokuroret duhet të kenë kujdes jo vetëm që informacioni të jetë i përshtatshëm për ta, por edhe për mënyrën e komunikimit. Gjatë proçesit hetimor dhe gjyqësor fëmijët duhet të jenë të shoqëruar nga prindërit apo një i rritur i zgjedhur prej tyre, kur pjesëmarrja e prindërve nuk është e mundur.

Një kujdes dhe vëmendje të veçantë i është dhënë dhe rasteve të përdorimit të paraburgimit si masë sigurimi. Kodi ka në vëmendje politikën dhe masat lidhur me minimizimin e kohës së qëndrimit në paraburgim:

KDF parashikon se proçedurat nuk mund të zgjasin më shumë se 6 muaj çka ndikon edhe në afatet e paraburgimit. Neni 324, pika I e Kodit të Procedurës Penale i Shqipërisë përcakton se hetimi duhet të përfundojë brenda një afati tre mujor nga data e regjistrimit të çështjes penale. Por pavaresisht kësaj ekziston mundësia e zgjatjes së këtij afati deri në dy vjet. Kjo bie në kundërshtim me parimet dhe standardet e parashikuara nga KDF të cilat kërkojnë që një fëmijë nuk mund të qëndrojë në paraburgim me shume se 6 muaj¹¹.

BIBLIOGRAFIA

1. E drejta për zgjidhje ligjore të efektshme dhe gjykim të drejtë.

Kushdo, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe Liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën për të marrë zgjidhje ligjore të efektshme para gjykatës në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen.

Kushdo ka të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brënda një afati kohor të arsyeshëm para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar më parë me ligj çdokujt i jepet mundësia që të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet.

Është e detyrueshme që ndihma juridike t'u ofrohet atyre të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme deri në masën që kërkohet për të siguruar mundësi të efektshme përdorimi të sistemit të drejtësisë.

2. Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta për mbrojtje

a. Kushdo ndaj të cilit është ngritur akuze, prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet se është fajtor sipas ligjit.

b. Garantohet respektimi i të drejtave të mbrojtjes të kujtdo ndaj të cilit është ngritur një akuzë.

c.Parimet e legjitimitetit dhe proporcionalitetit për veprat penale dhe dënimet

3. Askush nuk mund shpallet fajtor për një vepër penale, në bazë të veprimeve apo mosveprimeve të cilat në castin kur janë kryer, nuk përbënin vepër penale sipas ligjeve kombëtare apo të drejtës ndërkombëtare. Nuk vendoset as një dënim me i rëndë se sa ai që ishte i zbatueshem në castin kur u krye vepra penale. Nëse, pas kryerjes së një vepre penale, ligji parashikon një dënim me të lehtë atëhere zbatohet ky dënim.

a. Ky nen nuk çënon gjykimin dhe ndëshkimin e çdo personi për një veprim ose mosveprim, që në çastin kur është kryer konsiderohej vepër penale, sipas parimeve të përgjithshme të njohura nga bashkësia e kombeve.

b. Nuk lejohet që ashpërsia e dënimit të jetë në shpërpjesetim me veprën penale.

4. — Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 që përcakton të drejtën për përkthyes dhe përkthimin në procedimet penale;

— Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor,2011 për luftën ndaj abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmije;

— Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet bazë për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;

— Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 MAJ 2012 që përcakton të drejten për informim në një procedim penal.

— Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013 që përcakton standardet bazë për aksesin për një avokat në një procedim penal dhe ekzekutimin e një mandati arresti ndërkombëtar, të drejtën për të njoftuar një të tretë në momentin e heqjes së lirisë dhe të drejtën e tij për të komunikuar me autoritetet konsullore.

5.-Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike (miratuar në 1966 dhe hyrë në fuqi me 1976 ratifikuar prej vendit tonë.

Sipas këtij dokumenti, të rinjtë e burgosur duhet të ndahen prej të rriturve dhe ceshtja duhet të përfundoje sa më shpejt që të jetë e mundur (neni I 0.2.b.); Pro-

cedura që zbatohet për të rinjtë që nuk kanë mbushur moshën madhore .duhet të marrë parasysh moshën dhe interesin që paraqet riedukimi i tyre (neni 14.4); Fëmija ka të drejtë të mbrohet pa asnjë dallim bazuar në racën, ngjyrën etj, ka të drejtë për të pasur një emër, shtetësi, pa asnjë lloj diskriminimi dhe në rast divorci të prindërve duhet t'i sigurohet mbrojtja e duhur (nenet 23 e 24).

-Rregullat dhe udhëzimet e OKB lidhur me drejtësinë për të miturit standardet e të cilave janë përfshira në Projekt Kod

-Rregullat Standard minimum të Kombeve të bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit

-Rregullat e Pekinit 1985;

-Rregullat e Kombeve të bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (rregullat e Havanës 1990);

-Udhëzimet e Kombeve të bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve- (udhëzimet e Riadit 1990);

-Rregullat Standard Minimum të Kombeve të bashkuara lidhur me Non-custodial Measures (rregullat e Tokios) (1990);

-Udhëzimet e Vjenës për Veprimin mbi Fëmijët në Sistemin e Drejtësisë Penale dhe duke pasur parasysh ditën e diskutimit të Komitetit në 199 -mbi , administrimin e drejtësisë për të rinjtë . Në mënyrë të përmbledhur këto instrumente vendosin theksat mbi standarde në vijim:

— Mirëqënien e të miturit duke siguruar që cdo reagim ndaj të miturve të dënuar të jetë gjithmonë në përputhje me rrethanat e të dënuarit dhe të veprës penale;

— Nxisin riintegrimin e të miturit dhe rifitimin e një roli konstruktiv të tij në shoqëri;

— Zhvillojnë alternativa ndaj trajtimit me burgim ose institucional ose të kujdesit (edhe në rastet kur çështja është në gjykim e sipër) për të parandaluar kryerjen dhe përsëritjen e krimit dhe që të dënuarit e mitur të trajtohen sipas të drejtave që gëzojnë;

— Sigurojnë që të miturit të trajtohen në komunitetin e tyre sa më shumeë të jetë e mundur. Në rastet kur ata mbahen në paraburgim, të miturit duhet të vecohen nga të rriturit, duhet të ndërmerren të gjitha masat dhe mjetet për të siguruar që ata të mbajnë lidhje me familjet e tyre; duhet të merren të gjitha masat për të

përgatitur riintegrimin e tyre dhe që kur ata të rikthehen në komunitetin e tyre të sigurohet ndihma dhe përkrahja e duhur;

— Domosdoshmërinë e një stafi të kualifikuar dhe të trajnuar në të gjithë pjesët dhe komponentet e sistemit;

— Nënvizojnë se parandalimi i kriminalitetit tek të miturit kërkon përpjekje nga telt shoqëria (familja dhe komuniteti). Mireqenia e te rinjve qe nga femijeria e tyre e hershme duhet të jetë në vëmendjen e cdo programi parandalimi. Duhet të hartohen programe dhe shërbime të orientuara drejt komuniteti për të parandaluar kriminalitetin tek të miturit.

6. Ky nen duhet lexuar së bashku e nenet e tjera të kodit. Si me nenin 2: parimi i barazisë dhe mos diskriminimit, me nenin 3: parimi i interesit më të lartë të fëmijës, neni 6: e drejta e jetës dhe e mbijetesës, neni 12: respektimi i pikëpamjeve dhe e drejta e dëgjimit të fëmijës në cdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtperdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të peështatshëm. Gjithashtu neni 40 ka lidhje me nene të tjera të KDF ndër të cilat, kujdes i është kushtuar: neni 16: e drejta e privatësisë, neni 19: mbrojtja nga të gjitha format e dhunës, neni 20: përkujdesja alternative, neni 25: rishikimi periodik i masës/trajtimit, neni 37: ndalimi i dënimit me vdekje dhe burgim të përjetshëm, limite në kufizimin e lirisë, etj., neni 39: rehabilitimi i viktimave.

— prezumimi i pafajësisë derisa të provohet (pa)fajësia ligjërisht (në përputhje kjo edhe me nenin 30 të Kushtetutës së R.Sh);

— e drejta e informimit menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjore, dhe të ketë ndihmë juridike ose cdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes (neni 31 i Kushtetutës së R.Sh);

— shqyrtimi pa vonesë i çështjes nga një autoritet ose instance gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme sipas një procedure të drejte ligjore në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve ligjore,

— Trajtimi fëmijëve në përputhje me mirëqëniën e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit - Fëmija të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor;

- Të drejtën të pyesë ose të bëjë të pyeten dëshmitaret e akuzës;
- E drejta e ankimit;
- E drejta për një përkthyes falas;
- Shmangia nga procesi gjyqësor dhe procedurat gjyqësore;
- Respektimi i jetës private.

7. ka hyrë në fuqi me 27 Nentor 2016

8. neni 24 (1): e drejta që shprehin lirisht pikëpamjet e tyre në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre, — neni 24 (2): e drejta që në çdo vendimmarje lidhur me fëmijët, interesi më i lartë i fëmijës të gëzojë vëmendje parësore, e drejta e fëmijës që të ketë një marrëdhënie personale sistematike dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit e tij ose të saj, përverse kur kjo bie ndesh me interesat e tij ose të saj.

9. Sipas pikave 55 dhe nenit 5 (2), nëse një fëmijë është i privuar nga liria, ushtruesi i përgjegjësise prinderore duhet të njoftohet dhe ti spjegohen arsyet, me përjashtim të rastit kur kjo është në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Në këtë rast një tjetër i rritur i duhur duhet të informohet.

10. GJEDNJ ka konstatuar se kjo mund të ndodhë nëse pohimet e bëra jo në prani të avokatit janë përdorur për dënimin.

11. Në rastin kur në një proces gjyqësor janë përfshirë fëmijet, gjykatat dhe prokuroria duhet të zbatojë parimin e urgjencës në mënyrë që të sigurojë një përgjigje sa më të shpejtë dhe të mbrojtë interesin më të lartë të fëmijëve, në përputhje me standardet e shtetit të së drejtës. Në vitin 2012 Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve ka shprehur shqetësimin lidhur me “përdorimin e vazhdueshëm të paraburgimit të fëmijëve, të cilet mund të kalojnë muaj në paraburgim pa iu krijuar mundësia e arsimimit, e mbështetjes psikologjike dhe masave të riintegritit.



Ndërtojmë të ardhmen!

VENDODHJA JONË:

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52,
Kodi Postar: 1023, Tiranë
e-mail: aplikim@umsh.edu.al

NA KONTAKTONI

Phone: +355 (4) 2421774
Cel.: +355 68 50 47301
Email: info@umsh.edu.al

www.umsh.edu.al